



INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки
Journal of the Faculty of Human Sciences

5



INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences

5/2024

Botimi i këtij numri të revistës është mbështetur nga:

Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Shkup, 2024

ISSN 2671-3004



INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences

5

Përmbledhje punimesh nga Konferenca V Shkencore Ndërkombëtare për Interkulturën me temë: *“Zhvillimi i arsimit kombëtar dhe gjuha shqipe”* mbajtur më datën 18-19.11.2024 në Manastir dhe Shkup.

Збирка на трудови од VV Меѓународна научна конференција за интеркултурата со тема: *„Развојот на националното образование и албанскиот јазик“* одржана на ден 18-19.11.2024 год. во Битола и Скопје

Conference proceedings from the V International Scientific Conference on Interculture on the topic: *“Development of national education and the Albanian language”* held on November 18-19, 2024 in Bitola and Skopje.

Shkup/Skopje, 2024

ISSN 2671-3004

INTERKULTURA

Revistë shkencore / Научно списание / Scientific Journal

5/2024

Botues / Editor

Fakulteti i Shkencave Humane/ Faculty of Human Sciences

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup/ Mother Teresa University in Skopje

Redaktori përgjegjës / Editor-in-chief

Prof. dr. Mustafa IBRAHIMI

Këshilli botues / Editorial board:

Mustafa IBRAHIMI

Izer MAKSUTI

Mirvan XHEMAI

Arta TIKA – BEKTESHI

Rilind MAHMUDI

Edona VINCA

Redaksia ndërkombëtare / International editorial office:

Niko QAFOKU (SHBA)

Mateo MANDALA (Itali)

Robert PICHLER (Austri)

Laszlo MARÁCZ (Hollandë)

Goran Bandov (Kroaci)

Emil LAFE (Shqipëri)

Kristaq JORGO (Shqipëri)

Begzad BALIU (Kosovë)

Sejdi GASHI (Kosovë)

Vilson de MARKU (Kosovë)

Goran BASHIQ (Serbi)

Zeqirja NEZIRI (Maqedonia e Veriut)

Vebi BEXHETI (Maqedonia e Veriut)

Rubin ZEMON (Maqedonia e Veriut)

Izaim MURTEZANI (Maqedonia e Veriut)

Qatip ARIFI (Maqedonia e Veriut)

ISSN 2671-3004



Revista / Списание / Journal : INTERKULTURA, nr. / бр. / no: 5 / 2024
Botues/Издавач/Editor: Fakulteti i Shkencave Humane/ Faculty of Human Sciences
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup/ Mother Teresa University in Skopje
E-mail: interkultura@unt.edu.mk
Adresa: rr. "1669" nr. 11A – Shkup, P fah 57,1010, Republika e Maqedonisë së Veriut
<https://unt.edu.mk/sq/botime-te-unt-se/>
Shtypshkronja / Печатница /Printing House: "GRAFODEN" - Shkup
Tirazhi / Тираж / Circulation: 500 kopje
Shkup / Скопје / Skopje, 2024

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	5
MUSTAFA IBRAHIMI	7
KONTRIBUTI I ARBËRESHËVE PËR NJË ALFABET TË NJËSUAR	7
THE CONTRIBUTION OF THE ARBËRESH TO A UNIFIED ALPHABET	7
ZEQRJA NEZIRI	19
PËRPJEKJET E SHKRIMTARËVE TË MOÇËM PËR NJË ALFABET KOMBËTAR	19
THE EFFORTS OF OLD WRITERS FOR A NATIONAL ALPHABET.....	19
VEBI BEXHETI	27
“TRIMDITA”, SI METAFORË E QËNDRESËS ARBËRESHO-SHQIPTARE NË POEZINË E ZEF SKIRO DI MAXHOS.....	27
“TRIMDITA”, AS A METAPHOR OF THE ARBAN-ALBANIAN STABILITY IN THE POETRY OF ZEF SKIRO DI MAXHO.....	27
XHEMALUDIN IDRIZI	43
AUTORËT ARBËRESH NË TEKSTET SHKOLLORE TË GJUHËS SHQIPE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	43
ARBËRESH AUTHORS IN ALBANIAN LANGUAGE SCHOOL TEXTS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA	43
BEGZAD BALIU	63
NAUM VEQILHARXHI: NDËRMJET DY RILINDJEVE	63
NAUM VEQILHARXHI: BETWEEN TWO RENAISSANCES.....	63
ISMET OSMANI	77
MBI LEKSİKUN TERMINOLOGJIK TË TEKSTEVE MËSIMORE NË SHKOLLAT NËNTËVJEÇARE.....	77
ON THE TERMINOLOGICAL LEXICON OF TEXTBOOKS IN NINE-YEAR SCHOOLS	77
AJTEN HAJDARI - QAMILI	87
INTERFERENCA GJUHËSORE MES SHQIPES, TURQISHTES DHE MAQEDONISHTES NË MAQEDONINË E VERIUT	87
LANGUAGE INTERFERENCE BETWEEN ALBANIAN, TURKISH AND MACEDONIAN IN NORTH MACEDONIA	87
FARKETA DIBRA – ZEQRIRI	103
KONGRESI I MANASTIRIT - NGJARJE EPOKALE E HISTORISË DHE KULTURËS KOMBËTARE.....	103
THE CONGRESS OF BITOLA (MANASTIR) – AN EPOCHAL EVENT IN NATIONAL HISTORY AND CULTURE	103

ARTA TIKA BEKTESHI - TEUTA AGAJ AVDIU	111
MBI NATYRËN MOHUESE TË PËREMRAVE TË PACAKTUAR TË SHQIPES.....	111
ON THE NEGATIVE NATURE OF SOME ALBANIAN INDETERMINATE PRONOUNS..	111
SEJDI M. GASHI	119
MODALITETI I SAKTËSISË DHE KUPTIMI KOHOR I FORMAVE FOLJORE DO TË JEM /DO	
TË KEM NË GJUHËN SHQIPE (ANALIZË KONTRASTIVE)	119
TEMPORAL PRECISION AND TENSE MEANINGS OF THE VERB FORMS DO TË JEM/ DO	
TË KEM IN THE ALBANIAN LANGUAGE (CONTRASTIVE ANALYSIS)	119
RILIND MAHMUDI ¹ , MAJLINDA ISMAILI-MAHMUDI ²	129
THE ROLE OF LEXICON AND TRANSLATION IN SENTENCE STRUCTURE	129
ROLI I LEKSIKUT DHE I PËRKTHIMIT NË STRUKTURËN E FJALISË	129
MIRVAN XHEMAILI.....	137
ENHANCING STUDENTS' READING SKILLS IN THE EFL CLASSROOM THROUGH THE	
USE OF FILMS	137
PËRMIRËSIMI I AFTËSISË SË TË LEXUARIT TË NXENËSVE NË GJUHËN ANGLEZE	
PËRMES PËRDORIMIT TË FILMAVE.....	137
DRITA XHEMAILI	149
KOMPETENCA GJUHËSORE E BREZIT TË TRETË E EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË	
GJERMANI	149
LINGUISTIC COMPETENCE OF THE THIRD GENERATION OF ALBANIAN IMMIGRANTS	
IN GERMANY	149
RUBIN ZEMON	159
"IMAGJINARITETI I BALLKANIT NE KONTEKSTIN GLOBAL"	159
"IMAGINATION OF THE BALKANS IN THE GLOBAL CONTEXT"	159
MUHAMEDALI IBRAHIMI	165
ROLI I DIPLOMACISË NDËRKULTURORE	165
THE ROLE OF INTERCULTURAL DIPLOMACY	165
AVNI AVDIU	179
GLOBALIZMI MEDIATIK	179
MEDIA GLOBALIZATION.....	179
DRENUSHA KAMBERI.....	189
TELOSI I KULTURËS KAPITALISTE	189
THE TELOS OF CAPITALIST CULTURE.....	189
ALBULENA DEHARI.....	199
DALLIMET GJATË PËRSHËNDETJEVE NË MES GJINIVE TË KUNDËRTA.....	199
DIFFERENCES IN GREETINGS BETWEEN OPPOSITE GENDERS	199

ISSN 2671-3004

UDC 811.18'351(450)(091)
930.85(450:=18)

Punim studimor

Mustafa IBRAHIMIUniversiteti "Nënë Tereza" në Shkup
Fakulteti i Shkencave Humane
mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk**KONTRIBUTI I ARBËRESHËVE PËR NJË ALFABET TË NJËSUAR****THE CONTRIBUTION OF THE ARBËRESH TO A UNIFIED ALPHABET**

Formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar (gjuha standarde), si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, dhe përpjekjet për krijimin e një alfabeti të vetëm kanë qenë procese të gjata. Ata kanë filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i tyre hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare. Kështu del se gjer në prag të Kongresit të Manastirit u përdorën rreth 60 alfabetë të ndryshme për shkrimin e shqipes letrare. Përpjekjet për krijimin e një alfabeti të vetëm, edhe përpos gjendjes së padëshirueshme dhe dëshpëruese, filluan të shumohen kudo ku kishte shqiptarë.. Siç dihet, në historiografinë e kulturës shqiptare, edhe intelektualët arbëreshë të Italisë zënë një vend të veçantë në përpjekjet e tyre për lëvrimin e shqipes me alfabet latin, sidomos do të veçonim kontributin e At Gjergj Guxetës, Jeronim de Radës dhe Dhimitër Kamardës.

Por çështja nuk ishte thjesht filologjike, kulturore, letrare ose praktike. Kërkesat dhe përvoja e Lidhjes së Prizrenit për shqipen në veprimtarinë shtetërore nuk ishin fshirë, përkundrazi, mbeteshin të gjalla tek të gjithë veprimtarët e Rilindjes kudo ku jetojnë dhe mund të shpreheshin tashti edhe nëpërmjet shtypit.

Kur i madhi Jeronim de Rada do ta përdor një rën ndër gjetjet e tij grafike, së cilës kongresistët e Manastirit nuk munguan atëbotë t'i bënin vend në kodin e ri alfabetik, do të lënë gjurmë të pashlyeshme duke përjetësuar kështu edhe botën arbëreshe në matriksin e simboleve kombëtare të kulturës etnike gjithëshqiptare, por duke huazuar prej kodit

alfabetik të Guxetës, shkronjën zanore <ë> me ato dy pikat sipër. Në këtë mënyrë Gjergj Guxeta, do të jetë i pari që do të vendos platformën, ku zuri rrënjë Alfabeti ynë i Manastirit e që jemi mësuar ta quajmë sot si mbështetje në ‘parimin fonetik’. Po ashtu, ai do të jetë i pari që do të paralajmërojë me rreptësi përdorimin e tremës <“> që lejon Guxetën të dallojë një tingull zanor që është karakteristik vetëm për shqipen. Nuk do të ngel mbas as Dhimitër Kamarda me alfabetet e tij, që shpesh së bashku me Jeronim de Radën do të ndryshojnë qëndrimet dhe nga viti 1867 e më pas do të zbatojnë afabetin latin në botimet e tyre, për shembull edhe në „Gramatikën e vogël“ (Grammatichetta) (Lloshi 2008:155).

Për të ardhur në zgjidhjen e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe, janë edhe përpjekjet Jeronim de Radës dhe Dhimitër Kamardës me mbajtjen e dy Kongreseve. Në tetor 1895 do të themelohet një Shoqëri kombëtare shqiptare, e cila në statutin e vet do të përmendte nevojën e një alfabeti të vetëm. Po atë vit, do të mbahet një Kongres i studimeve gjuhësore arbëreshe në Koriliano Kalabro, i cili shtroi si hap të parë njësimin e botimeve arbëreshe sipas alfabetit të abetares së Jeronim de Radës. Një kongres i dytë në Lungro më 1897 kishte po atë program. Këto përpjekje njihen si tradita më e hershme e lëvrimit të shkrimit shqip, sepse falë këtyre kongreseve të patriotëve arbëreshë, do të miratohet alfabeti shqip me germa latine dhe falë kontributit të patriotëve shqiptarë, të cilët organizuan kongresin e Manastirit, do të miratohet alfabeti aktual. Këto përpjekje ndikuan që prej më se një shekulli të gjitha hapësirat kompakte shqipfolëse të gëzojnë statusin e simboleve mbarëkombëtare shqiptare. Edhe pse bën përpjekje për një alfabet të ri, megjithatë të dy nuk patën shumë jehonë.

Figura tjera që në mënyrë drekte apo indirekte lidhen me kontributin e arbëreshëve do t’i përfshijmë edhe **Luigj Gurakuqin**, i cili në moshën e tij 29 vjeçare, do të zgjidhet si delegat i arbëreshëve të Italisë dhe i “Bashkimit” të Shkodrës në Kongresin e Alfabetit në Manastir, ku do të zgjidhet si nënkryetar i Kongresit dhe sekretar i Komisionit. Vlen të përmendet edhe Hilë Mosi, i cili do të lexojë telegramet që kishin ardhur nga arbëreshët e Italisë. Të gjithë këta ishin përkrahës për të arritur një alfabet të përbashkët.

1. At Gjergj Guxeta dhe kontributi i tij në kodin grafik të shqipes

At Gjergj Guxeta (1682 - 1756), i lindur në Hora e Arbëreshëve, ishte prift bizantin dhe Shërbëtor i Perëndisë, Apostull i shqiptarëve të Sicilisë, konsiderohet si më i madhi i intelektualëve shqiptarë të Siçilisë të shk. XVIII. Në veprat e At Guxetës do të gjejmë gjetje grafike që do të ndikojnë në përmirësimet thelbësore në kodin grafik të shqipes me bazë të alfabetit latin. Nëse shikojmë Alfabetin e Manastirit nga këndvështrimi i sotshëm, përveç që gëzon statusin e simboleve mbarëkombëtare shqiptare prej më se një shekulli, atë e përcjell edhe një kolorit gjithëshqiptar sidomos dy

pikat (= trema <¨>) si karaktere grafike që rrekemi sot e gjithë ditën, pa i lënë anash edhe dyshkronjat. Janë pikërisht këto dy pika, që gjëlljnë në gjuhën e shkruar me një denduri aq të lartë e në çdo pozicion, çka parakupton gjithëherë përqendrim të plotë për të shkruar bukur e pastër.

Por, shumë rrallë e kemi përmendur se kush e përdori i pari njërën ndër gjetjet grafike që e përshkuan më së shumti Alfabetin e Manastirit, siç janë dy pikat (= trema <¨>). Zakonisht përmendet emri i arbëreshit zulmëmadh Jeronim de Rada, mirëpo, zhvillimet e fundit në filologjinë arbëreshe kanë bërë të mundur të qëmtohen në retrospektivë tëbanat kryesore, ku ka baritur dikur kjo grafi fatlume në viset arbëreshe, madje ndërkohë është vatëruar edhe gurra e saj zanafillëse (Mandalà 2006). Është fjala këtu për vepërzën të mbetur në dorëshkrim qysh prej gjysmës së parë të shek. 18-të e me autor apostullin e arbëreshëve të Sicilisë, At Gjergj Guxetën (= Padre Giorgio Guzzetta), një vepër kjo që përjetoi para disa vitesh dritën e botimit (Guzzetta 2007), duke u bërë kështu pronë e një rrethi të gjerë lexuesish dhe specialistësh të fushës. Kjo meritë i takon Guxetës, i cili i parë do ta përdor në veprat e tij tremën <¨> **si gjetje grafike dhe dhe do ketë rëndësi historike-kulturore në gjuhën shqipe, duke** propozuar përmirësime thelbësore në kodin grafik të shqipes me bazë alfabetin latin, i cili do të sendërtonte atëbotë një bashkëpërkim të plotë ndërmjet shqipes së shkruar dhe asaj të folur.

Merrita e Gjergj Guxetës për alfabetin e gjuhës shqipe ka të bëjë edhe me dy pikëpamjet e tij që do të gjejnë zbatim më vonë tek shkrimet arbëreshe dhe shqipe. Guxeta i pari vendosi raportin 1 x 1 në bashkëlidhjen *grafemë ~ fonemë* (= shkronjë ~ tingull me funksion kuptimdalues), për të cilin Guxeta në vepërzën e tij, na kujton pikërisht platformën, ku zuri rrënjë Alfabeti ynë i Manastirit e që jemi mësuar ta quajmë sot si mbështetje në 'parimin fonetik'. Po ashtu Guxeta do të paralajmëroj me rreptësi të zbatimit të këtij kriteri metodik, duke përdorur tremën <¨> që lejon Guxetën të dallojë një tingull zanor që është karakteristik vetëm për shqipen. Në inventarin e kësaj liste feksin dy pikat që Guxeta i vendos jo vetëm mbi shkronjën zanore <e>, por (më rrallë) edhe mbi gjegjësen <a> dhe në një rast edhe mbi shkronjën <u>¹(Demiraj 2011:311-312).

2. Kontributi i Jeronim de Radës për një alfabet të përbashkët

Në përpjekjet e vijueshme të Jeronim de Radës, kishte për qëllim krijimin e një alfabeti të përbashkët të shqipes që të jepte një sistem sa më të plotë dhe të përshtatshëm për shqipen me karaktere latine, të plotësuar me shenja diakritike. Pikërisht, nën kryesimin e Jeronim de Radës, do të

¹ Përjasja e listës së fjalëve shqipe me njësitë burimore përkatëse për nga perspektiva e paraqitjes grafike lejon të vendosen pak a shumë këto marrëdhënie distribucionale: grafitë shqipe <ä> dhe <ü> u përgjigjen në çdo rast grafive <a> përkatësisht <u> në njësitë leksikore të gjuhës dhënëse. Përndryshe grafia <ë> i përgjigjet ose grafisë <e> ose mungesës së një grafie zanore në gjuhën dhënëse.

organizohen tre kongrese gjuhësore, edhe atë në vitet: 1895, 1897 dhe 1903 ku u mor vendim që të përdorej alfabeti i De Radës, por që nuk gjeti zbatim në praktikë (Demiraj & Prifti 2004:43). De Rada bëri një punë të madhe për alfabetin e gjuhës shqipe, përpjekjen e tij për zgjidhjen e problemit ai e gjente në karakteret e shkronjave italiane me një shtesë shkronjash greke. (Kastrati, 1972: 79). Sipas Xhevat Lloshit, Jeronim de Rada për shkrimin e veprave të tij përdori një alfabet latin sipas variantit italian, por që në të gjenin vend edhe shkronjat greke për tingujt: dh -δ, th -θ, h - χ dhe z - ζ. (Lloshi 2008). Studiuesi Fadil Raka, rreth kontributit të arbëreshëve të Italisë për unifikimin e alfabetit thotë se edhe pse arritën të organizonin kongrese të ndryshme ata nuk arritën të kishin një alfabet të përbashkët. Sipas tij Kongresi i Manastirit nga alfabeti i De Radës gjeti zgjidhje të mirë për shkronjat ë, gj dhe nj. (Raka, 2008).

Kongreset qenë fryt i propogandës të pandërprerë për idenë kombëtare të Jeronim de Radës të mbajtur njëri në Koriliano Kalabro, tjetri në Lungro që mund ta quajmë kryeqytet të kolonive shqiptare të Kalabrisë.

Në letërkëmbimet mes De Radës dhe personalitete të shquara të kohës përmendim dhe një letër të dërguar nga Gussepina Knorr. Ajo i shkruan De Radës si më poshtë: *“Kam marrë një letër nga Krispi. Jam e lumtur që kam marrë një letër nga Krispi dhe po ju dërgoj një sonnet për ta korrigjuar. Krahsa të tjerave ajo shprehet: Shpresoj që në mbledhjen e kongresit linguistik shqiptar të përfitojë kauza patriotike shqiptare (AQSH, fq.24, D5, fq.211)....Përmes kësaj letre De Rada paraqet themelimin e Kongresit Linguistik si dhe hapjen e një Katedre në gjuhën shqipe. Ky kongres trajtoi dy linja të ndryshme si ato linguistike, në të njëjtën kohë edhe atë politike. De Rada ishte ndër të parët që parashtroi idenë e krijimit të një alfabeti dhe i pari që dërgoi në Shqipëri propozimin për alfabetin e tij, ndonëse ky propozim nuk u prit mirë nga pala shqiptare dhe pati kundërshtime nga Porta e Lartë. Rezultat i këtij kongresi krahas diskutimit për një alfabet të unifikuar ishte dhe krijimi i një Shoqërie Kombëtare Shqiptare. U krijua Societa Nazionale Albanese me qendër në San Demetrio Corona, e cila mes objektivave të saj, krahas afrimit mes kolonive të ndryshme të Italisë, synonte edhe nisjen e marëdhënies në shkallë të gjerë me mëmëdheun. 42 (De Rada 1928:7)*

Në vitin 1899, në Kolegjin e Shën Adriano filloi rregullisht mësimi i gjuhës shqipe, ku Jeronim de Rada shkonte tre ditë në javë për të dhënë mësim në gjuhën shqipe. Edhe pse i moshuar, De Rada udhëtonte në këmbë nga Shën Mitër deri në Shën Adriano për t’iu mësuar djelmërisë arbëreshe gjuhën e bukur shqipe.

3. Dhimitër Kamarda dhe përpjekjet e tij për një alfabet të shqipes

Një tjetër emër tek arbëreshët e Italisë, i cili ka qenë në qendër të diskutimeve për alfabetin e shqipes është ai i Dhimitër Kamarda (1821-1882), i lindur po ashtu në Horën e Arbëreshëve në Sicili. Ai ishte gjuhëtar

e atdhetar arbëresh, botues i folklorit, me formim shkencor edhe në fushën e gjuhësisë indoevropiane. Vepra e tij kryesore, “Sprovë e gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe”, është e para vepër shkencore nga një studiues shqiptar që i trajton faktet e gjuhës shqipe në planin historik krahasues. Vepra ka një lëndë mjaft të pasur e të përpiktë nga gjuha shqipe dhe një varg vëzhgimesh me vend për gramatikën dhe për etimologjinë e shqipes. La gjithashtu në dorëshkrim një gramatikë shqipe. Dhimitër Kamarda dha një ndihmesë të rëndësishme duke hartuar tre alfabetet të njëpasnjëshme, edhe atë në vitin 1869 “Alfabetin e përgjithshëm të shqipes”, kurse më 1870 boton alfabetin e tij më të përsosur i cili ofrohet shumë me këtë të sotshmin, edhe pse siç thamë më parë, ai nuk kishte ndonjë shtrirje të madhe, por kjo përpjekje e tij i jep shkas Kamardës të numërohet ndër filologët të mëdhenj.

Françesko Altimari mbështet mendimin se Kamarda për alfabetin është nisur nga qëndrimi politik për çështjen shqiptare dhe nga hipoteza e vet për farefisninë e afërt ndërmjet greqishtes dhe shqipes. Sipas T.Osmanit, veprën e vet Kamarda e shkroi me alfabetin grek. Ky pohim është i papranueshëm. Kamarda e shkroi veprën e vet italisht. Lëndën shqipe e paraqiti me alfabetin e përshtatur të greqishtes, duke hequr dorë prej një ideje të vitit 1861, se duhej mbajtur vetëm alfabeti grek. Në atë kohë në revistën “Elpis”, kishte mbrojtur idenë, se shqiptarët duhej të zotëronin greqishten si gjuhë e kulturës së tyre dhe prandaj u paraqiste alfabetin e vet si bazë. (Lloshi 2008:152). Me një fletushkë më 1869 Kamarda përhap alfabetin e vet me shkronja latine, për të cilën botoi edhe broshurën “Alfabetin e përgjithshëm të shqipe – epirotase”, ku ballafaqohet me dy alfabetet. Por ky alfabet iu duk i vështirë Zef Serembes, i cili ishte shprehur se baza e alfabetit të përbashkët të shqipes do të bëhej alfabeti i greqishtes (Lloshi 2008:153).

Në atë kohë përflitej shumë se alfabeti i Dhimitër Kamardës, ishte një krijim, apo një përshtatje e alfabetit grek. Mos ishte një filo grek Kamarda? Aspak! Përgjigjen mund të gjendet me përpjekjen e jashtëzakonshme të Greqisë, për të moslejuar që shqiptarët të kishin alfabetin e Kamardës. Kjo dukej absurde dhe pa sens në vështrim të parë, dukej si një goditje kundrejt vetvetes, sepse vende të zhvilluara aplikonin politikën e një " neokolonizimi" kulturor, përmes organizmave të mëdha anglosaksone dhe frankofone. Grekët ishin kundër alfabetit të Kamardës, sepse ai herët a vonë do t'i nxirrte pellazgët inspirues të helenëve, ishin kundër Kamardës, sepse druheshin që shqiptarët do të mund të lexonin një ditë Homerin në gjuhën shqipe... (Skënder Drini). Edhe përpos qëndrimeve të ndryshme, Kamardë duhet nderuar, sepse përfshirjen e alfabetit latin dhe vuri gurin e themelit të aspiratës evropiane të shqiptarëve.

Çfarë ishin Kongreset e patriotëve arbëresh?

Siç theksuam, një rol me rëndësi në pasqyrimin e çështjes kombëtare kanë luajtur kongreset linguistike të viteve 1895 dhe 1897 të cilët krahas karakterit linguistik dhe letrar shprehën dhe vullnetin politik të shqiptarëve të Italisë. (Shanto 2005:490).

1. Kongresi linguistik në Koriliano Kalabro

Kongresi i Parë i shqiptarëve të Italisë, që u zhvillua për tri ditë me radhë, nga data 1 deri më 3 tetor të vitit 1895, në ambientet e gjimnazit Garopoli Koriliano Kalabro në Kozencë. Kjo ngjarje u pasqyruar gjerësisht në shtypin italian dhe evropian i kohës, ku evidentohet se një kulturë e lashtë arbërore po rizgjohej. Mbi 200 mijë shqiptarë të larguar nga trojet e tyre, të shpërndarë në të gjithë Italinë e jugut, po bashkohen për të mos harruar identitetin e tyre. Në korrik të vitit 1895, u organizua një mbledhjeje në kolegjin kishtar të San Adrianos në San Demetrio Korone. Lindi një komitet i përkohshëm i kryesuar nga De Rada, i përbërë nga Konforti, nga priftërinjtë Anton Argondica e Anxhel Ferrari, me pranimin e kryemurgut Luixhi Lauda e të dr. Agostin Ribekos. Komiteti u mor me përgatitjen e një kongresi shqiptar, i thirrur në Koriliano Kalabro. Në të u mblodh shumica e intelektualëve arbëreshë që përfaqësonin thuajse të gjitha komunitetet arbëreshe të Kalabrisë.

Kongresi u udhëhoq nga Francesco Krispi i cilësuar “Shqiptar nga gjaku dhe zemra”. Tema e këtij kongresi ishte prezantimi i aspekteve gramatikale, leksikore dhe fonetike të gjuhës shqipe. Në të morën pjesë 25 delegatët e Kongresit (gjuhëtar, shkrimtarë, poetë, gazetarë dhe klerikë të shquar të kishës arbëreshe) dhe 500 intelektualët të tjerë nga regionet e Italisë së Jugut (Kalabria, Kampania, Pulia dhe Sicilia) që mbështetën këtë nismë duke lënë gjurmë të rëndësishme në ngjarjet gjuhësore dhe historike të kombit. Po si u prit hapja e kongresit të parë linguistik nga patriotë e njerëz të shquar të kohës? Iniciativa e De Radës dhe e patriotëve të tjerë gjeti mbështetje gjerësisht në Shqipërinë amë, por edhe kudo ku jetonin shqiptarë. Vetë Francesco Krispi shprehet kështu për iniciativën e De Radës: “Gëzohem që keni thirrur kongresin shqiptar me gjak e me zemër gëzohem për këtë iniciativë, e cila ka qënë e nevojshme për historinë e civilizimit shqiptar si dhe për lulëzimin e letërsisë së saj.”⁴⁰ (AQSH, fq.24, D54/1, fq.13).

Me 2 tetor 1895, pjesëmarrësit në Kongresin e Koriliano miratuan themelimin e Shoqërisë Kombëtare Shqiptare, statutin dhe këshillin drejtues: Kryetar nderi: Jeronim de Rada, Nënkretar: Pietro Kamodeka, Anselmo Lorekio dhe Akile Toçi.

Në artikullin 1 të Statutit theksohet: “Asht themelue nji Shoqni Kombëtare Shqiptare, e cila do të përkujdeset”:

a) Për njisimin e nji alfabeti të vetëm

- b) Për përpilimin e një fjalori
- c) Për përpilimin e abetares në gjuhën shqipe
- d) Për botimin e një reviste italo – shqiptare
- e) Për të fillue marrëdhëniet me Mamën – Atdhë.

Kongresi përshtati alfabetin e gjuhës shqipe që kishte përdorur Jeronim De Rada në vitin 1848 në gazetën “L’albanese d’Italia – shqiptari i Italisë”, në vitin 1888 në gazetën “Fiamuri i arbërit” që botohej në Kozenca, si dhe në shtypjen e “Rivista italo –albanese” me nëntitullin “Illi i arbresvet – Ylli i arbëreshëve” me drejtor Antonio Argonizza.

Alfabeti i Koriliano përbante 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore, që i përkonin tingujve të gjuhës së folur në dialektin arbëresh:

Zanoret: a, e, i, o, u, è, ë

Bashkëtingëlloret: b, c, d, f, g, j, l, m, n, p, q, s, t, v, x (si në italisht) dhe gj, gh (e egher – e egër), h (herë), ñ (një), r, rh – rr, ê (sh), k – q, dh – δ, th – θ, z – ζ (Zot), sg – zh.

Siç kuptohet nga struktura e alfabetit, gjuhëtarët arbëreshë ishin të ndikuar nga italishtja, si gjuhë e të folurës së përditshme në mjedisin shoqëror ku jetonin, andaj huazuan germa nga italishtja, kësisoj ne vend të germës “k” përdorën “q”, për “nj” morën “ñ” nga spanjishtja etj.

Për tingujt e gjuhës së folur arbëreshe, kongresistët huazuan dhe germa të veçanta, p.sh. shtuan germën è me theks si gjuha frënge, përdorën gërmen “ë”, për tingullin Z huazuan germën greke ζ, për bashkëtingëlloret dyshe “dh” përdorën grafemën greke δ; ndërsa për tingullin “th”, grafemën greke θ.

Alfabeti i Koriliano, ishte përshtatur dialektit arbëresh të gjuhës shqipe, andaj u përdor nga autorët arbëreshë në shumë vepra letrare, në tekstet mësimore për kolegjin e Shën Adriano, në shtypin arbëresh të kohës dhe në shumë vepra të botuara pas kongresit. Alfabeti i miratuar në Kongresin e Koriliano, mbijetoi 13 vjet, deri sa u miratua alfabeti i unifikuar dhe i standardizuar në Kongresin e Manastirit, në viti 1908. Pjesëmarrësit në Kongresin e Koriliano Kalabro, hartuan dhe miratuan abetaren e gjuhës shqipe. Në vitin 1896, Anselmo Lorekio (avokat, poet, gazetar dhe shkrimtar arbëresh), në zbatim të detyrave të kongresit të parë të gjuhës shqipe, botoi abetaren shqipe, ndërsa në vitin 1897 botoi gazetën në gjuhën shqipe “La nazione albanese”.

2. Kongresi linguistik i Lungros

Kongresi i Dytë u mbajt më 20 shkurt 1987, në Ungër/Lungro. Ky kongres ishte vijim i të parit, vendimet që u morën ishin një përshtatje e vendimeve të Kongresit të parë. De Rada mori pjesë në këtë kongres dhe në 1897, u zgjodh president i Shoqërisë kombëtare Shqiptare. Ky kongres rikonfirmoi objektivat e vendosur nga kongresi i parë dhe rishikoi statusin e Societa Albaneze Nazionale. Kongresi i Lungros zëvendësoi “Ilin e Arbëreshëve” një tjetër gazetë të udhëhequr nga Anselmo Lorecchio me

emrin “La Nazione Albanese”. Për botimet e saj bashkëpunuan shkrimtarë nga Shqipëria dhe kolonitë. 43 (Zgjimi 2000:202)

Programi i kongresit ishte gjuhësor, kulturor, e letrar. Siç u përmend dhe më sipër në kongres u diskutua çështja e një alfabeti të unifikuar dhe domosdoshmëria e njehsimit të të gjuhës. Kongresi shpjegoi dhe vuri në dukje rëndësinë e studimit të gjuhës dhe letërsisë shqiptare. Konkluzionet e kongresit i dha vetë De Rada. Ndër të tjera ai tha: “Shumë sy e kanë drejtuar vështrimin nga ky kongres gjuhësor. Unë besoj se mund të të them në emër të ju të gjithëve, që mëmëdheu ynë i të parëve, Shqipëria, don vetëm që të mos i merren tokat e saj. Dëshiron të ketë paqe e liri të plotë, që të lëvrojë gjuhën amtare, të mbajë shkollat shqipe, të ketë libra, tregti të hapët me miqtë në brigjet detare që t’i thërrasë për hapjen e mirqenies së saj; Për sa i takon fateve të saj të ardhme ne kemi besim të plotë se fati do t’i sjellë drejtësinë dhe virtytin 44 (Mehmeti 1980:143)

Një dokument zyrtar që vërteton mbajtjen e këtij kongresi, arsyet pse u themelua, si dhe lehtësirat që duhet të kishin në transport dhe të gjithë ata që do të merrnin pjesë në kongres paraqiten në një dokument të lëshuar nga Prefektura e Napolit. Në gazetën “La Nazione Albanese”, nga urimet që vinin nga vende të ndryshme kudo që kishte shqiptarë dhe shoqata patriotike shqiptare. Krahas të tjerave dukshëm u vu re shfaqja e publikimeve në faqet e gazetës La Nazione Albanese apo Kombi Shqiptar. Themelimi i kësaj katedre ishte një fitore e bukur për revistën “Kombi Shqiptar”, për të cilën një shqiptar i vërtetë nga Shkodra e Shqipërisë më 11 tetor 1987, shkruante, si më poshtë: “Pas shumë vitesh heshtje dhe terri, doli në dritë e para e vetmja dhe më patriotikja gazeta jonë Kombi Shqiptar, propoganduesja më e fortë dhe më e guximshme e të drejtave tona kombëtare, e vetmja që hapi për sytë tanë dritën e vet kombëtare”. (Kastrati 1979:193).

Ky kongres synoi që të forconte më tej lidhjet kulturore dhe politike mes shqiptarëve. U vendos dhe krijimi i një katedre në gjuhën shqipe në Institutin Oriental të Napolit. Ngritja e kongresit lingustik dhe hapja e katedrës në gjuhën shqipe konfirmohet dhe nga letrat dërguar Lorecchios nga De Rada, letra të gjetura në arkivin personal. Këtë fakt e konfirmojnë dhe të dhënat e marra nga gazeta La Nazione Albanese e Lorecchios sipas të cilës deklarohet se: “Senati i Mbretërisë të Italisë në 16 gusht ka diskutuar ligjin e aprovuar nga Dhoma e Deputetëve për të cilin akordohet (i jepet) nga qeveria e drejta për organizimin e Insitutit Oriental të Napolit”. 46 (La Nazione Albanese 1913:nr.10/7) Krijimi i një katedre në gjuhën shqipe do i hapte rrugë forcimit të lidhjeve mes arbereshëve. Krijimi i një katedre në gjuhën shqipe do t’i hapte rrugë forcimit të lidhjeve mes shqiptarëve në dy anët e Adriatikut. Katedra e gjuhës shqipe në Institutin Oriental të Napolit udhëheqja e së cilit i është besuar Prof. Giuseppe Schiroit nga Piana Dei Greci. 47 (La Nazione Albanese 1913:nr.3/7) Krahas këtij vendimi u morën dhe vendime të tjera:

a) Dhënia e bursave shqiptarve në mëmëdhe për studime në Collegio S. Adrianit dhe në San Demetrio Corone.

b) Fillimi i mësimit të gjuhës shqipe në shkollat publike të komuniteteve arbëreshe në c) Autonomia e Shqipërisë

d) Zhvillimi i marrëdhënieve mes federatës Italo; Shqiptare dhe shoqërive shqiptare në Rumani dhe Bullgari.

e) Të drejta të barabarta për të gjitha besimet në Shqipëri.

f) Themelimi i një gazete qendrore të federatës që do të botohej në Romë në gjuhët, frengjisht, italisht dhe shqip;

Në Palermo në maj 1902, lindi një Shoqëri shqiptare pikat kyçe të statusit të të cilës janë si më poshtë:

a) Mbrojtja e të drejtave të kolonive shqiptare të fitura në Sicili

b) Përhapja e gjuhës shqipe sidomos në kolonitë ku ka rrëzuar humbasë,

c) Domosdoshmëria e krijimit të një alfabeti unik që të merren vesh gjithë shqiptarët e kolonive të ndryshme dhe me tokën amë,

d) Rritja e studimeve gjuhësore dhe përhapja e gjuhës shqipe,

e) Krijimi i një arkivi me letërsinë shqipe që të kujdesen për botimin e kujtimeve të shenjta mbi atdheun dhe të ilustrojnë historinë,

f) Domosdoshmëria e një federate mes shoqatave shqiptare të Kalabrisë, Napolit, Korfuzit, Athinës, Egjiptit, Kostandinopojës, Bukureshtit, Sofjes.

Kjo shoqatë botoi një thirrje të ngrohtë që përfundoi me këto fjalë: “Çështja shqiptare, tashmë më e gjallëruar reklamoi se bijtë e Shqipërisë do të lëvizin me qëllime të harmonizuara për të mbështetur përpara Evropës civile të drejta e kombit të lirisë vllazërisë matanë Adriatikut”. 48 (La Nazione Albaneze 1913:nr.3/7)

Përfundim

Edhe përpos përpjekjeve të mëdha të Arbëreshëve, historia dhe rrethanat e alfabetit kanë lidhje të kuptueshme me zhvillimet në Ballkan dhe marrëdhëniet kulturologjike dhe të fushave të tjera që shqiptarët kishin me këtë mjedis. De Rada me të drejtë shkruante “Alfabeti nuk duhet të shkaktojë, që ne të zihemi si gratë”.

Prof. Lloshi hedh vështrimin tek arbëreshët e Italisë, në të cilët plekset një problematikë e gjerë dhe e diskutueshme, të cilët më së shumti, duke qenë ortodoks, siç kuptohet kanë shtegtuar me alfabetin grek, të trashëguar, i cili është më së shumti i pranishëm (me katër shkronja) dhe tek De Rada. Rritja e lëvizjes kombëtare, si faktori më i rëndësishëm i kohës, parashtrroi dhe tek arbëreshët, veçmas gjatë kohës së De Radës (gjatë viteve 1800), gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.

De Rada, tek i cili “qerthullohet” një problematikë e gjerë dhe e madhe iu drejtua alfabetit latin, duke ruajtur vetëm një shkronjë greke. “Milosao” u botua në latinisht me ca shkronja greke konvencionale, por më vonë ai u

rikthye përsëri tek përdorimi (d.m.th prania) e katër shkronjave të alfabetit grek, të përdorura tradicionalisht në shkrimet dhe alfabetin e arbëreshëve të Italisë. Diskutime ka edhe me Kamardën, shënon prof. Lloshi, për të cilin ai mendon se ka botuar në italisht, përkundër ndonjë tjetri, që mendon se ai ka shkruar në greqisht. Megjithatë, në vitin 1867 De Rada dhe Kamarda kanë përdorur alfabetin latin.

Alfabetet e tyre nuk patën shumë jehonë për shumë shkaqe, një prej tyre ishte struktura e alfabetit. Gjuhëtarët arbëreshë ishin të ndikuar nga italishtja, si gjuhë e të folurës së përditshme në mjedisin shoqëror ku jetonin, andaj huazuan germa nga italishtja, por germa huazuan edhe nga spanjishtja, frëngjishtja dhe greqishtja, p.sh. në vend të germës “k” përdorën “q”, për “nj” morën “ñ” nga spanjishtja, shtuan germën e me theks si gjuha frënge, për tingullin Z huazuan germën greke ζ, për bashkëtingëlloret dyshe “dh” përdorën grafemën greke δ; ndërsa për tingullin “th”, grafemën greke θ. Nga ana tjetër alfabeti i De Radës gjeti zgjidhje të mirë për shkronjat ë, gj dhe nj.

Përpyekjet e arbëreshëve për njësimin e një alfabeti të njësuar shqip, ashtu si vetë Kongresi i Manastirit kanë dhënë një ndihmesë të pranuar për rrugën e qytetërimit modern edhe jashtë caqeve thjesht kombëtare.

Abstrakt

Qëllimi ynë në këtë kumtesë do të jenë përpjekjet e Arbëreshëve për krijimin e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Ashtu si të gjithë shqiptarët edhe arbëreshët kishin vështirësi se me cilin alfabet duhet të shkruajnë dhe botojnë librat, sepse gjer në prag të Kongresit të Manastirit ishin në përdorim rreth 60 alfabete të ndryshme për shkrimin e shqipes letrare. Përpjekjet për krijimin e një alfabeti të vetëm, edhe përpos gjendjes së padëshirueshme dhe dëshpëruese, filluan të shumohen kudo ku kishte shqiptarë.. Siç dihet, në historiografinë e kulturës shqiptare, edhe intelektualët arbëreshë të Italisë zënë një vend të veçantë në përpjekjet e tyre për lëvrimin e shqipes me alfabet latin, sidomos do të veçonim kontributin e At Gjergj Guxetës, Jeronim de Radës dhe Dhimitër Kamardës. Për të ardhur në zgjidhjen e një alfabeti, arbëreshët do të mbajnë dy Kongrese. Në tetor 1895 do të themelohet një Shoqëri kombëtare shqiptare, e cila në statutin e vet do të përmendte nevojën e një alfabeti të vetëm. Po atë vit, do të mbahet një Kongres i studimeve gjuhësore arbëreshë në Koriliano Kalabro, i cili shtroi si hap të parë njësimin e botimeve arbëreshë sipas alfabetit të abetares së Jeronim de Radës. Një kongres i dytë në Lungro më 1897 kishte po atë program. Këto përpjekje njihen si tradita më e hershme e lëvrimin të shkrimit shqip.

Abstract

Our goal in this paper will be the efforts of the Arbëresh to create a single alphabet for the Albanian language. Just like all Albanians, the Arbëresh also had difficulties with which alphabet to write and publish books, because until the eve of the Congress of Manastir, about 60 different alphabets were in use

for writing literary Albanian. Efforts to create a single alphabet, despite the undesirable and depressing situation, began to multiply wherever there were Albanians. As is known, in the historiography of Albanian culture, the Arbëresh intellectuals of Italy also occupy a special place in their efforts to translate Albanian into the Latin alphabet, especially we would like to highlight the contribution of Father Gjergj Guxeta, Jeronim de Rada and Dhimitër Kamarda. Up to the selection of an alphabet, the Arbëresh held two Congresses. In October 1895, an Albanian National Society was founded, which in its statute mentioned the need for a single alphabet. That same year, a Congress of Arbëresh linguistic studies was held in Coriliano Calabro, which proposed as a first step the unification of Arbëresh publications according to the alphabet of Jeronim de Rada's primer. A second congress in Lungro in 1897 had the same program. These efforts are known as the earliest tradition of the development of Albanian writing.

LITERATURA

- ALTIMARI, Francesco. (1984). *Il movimento culturale della Rilindja e il Collegio di S. Adriano nella prima metà del secolo XIX*, nr. 11 i serisë “Quaderni di Zjarri” 11 [1984ç. Cosenza
- ALTIMARI, Françesko. (2010). “Kolegjet arbëreshe në marrëdhëniet italo-shqiptare. Roli i kolegjit të Shën Adrianit”. Në konferencën shkencore “Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare” 14 tetor 2010. Shkodër.
- BELLUSCIO, Giovanni M. G. (2002). *Un primo esperimento per la definizione elettroacustica del vocalismo di Hora e Arbëreshëvet* (PA), në: „Studi in onore di Antonino Guzzetta” (bot. F. Di Miceli – M. Mandalà), Palermo 2002, f. 51-62
- BLANCHUS, Franciscus (= Frang Bardhi). (1635). *Dictionarum latino-epiroticum*, Romæ 1635
- ÇABEJ, Eqrem: *Italo-albanische Studien*, Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades an der Universität Wien (drsh. 145 f.)
- DE RADA, Girolomo (1928). *Djalëria*. Viti IX, V, II, Nr.4.
- DEMIRAJ, Bardhyl. (2002). Sprovë për një lexim kritik të materialit gjuhësor në veprën e Angelo Masci-t, në: „Studi in onore di Antonino Guzzetta” (bot. F. Di Miceli – M. Mandalà), Palermo 2002, S. 115-131
- DEMIRAJ, Bardhyl. (2011). *Kodi alfabetik i At Gjergj Guxetës dhe disa çështje që lidhen me të*. Në aktet e Simpoziumit Nërkombëtar për Arbëreshët me temë “Gjuha dhe letërsia e Arbëreshëve”, (mbajtur në Tetovë, 28-29 prill 2008). UEJL, Tetovë 2011.
- DEMIRAJ, Shaban – PRIFTI, K. (1978). *Kongresi i Manastirit*. Tiranë.
- DRINI, Skënder.(2013). Rekuem per Karlo Ljarjen. Gazeta Shqiptare. 10 Mar 2013
- Gazeta “La Nazione Albanese”, nr.10, Pellagario – Katanzaro, 1913,7.

- Giorgio Guzzetta e le origini della filologia italo-albanese, në: "International JOURNAL of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction" 4 [2007ç 63-81. Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. e 18-të. Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë, në: "Hylli i Dritës" 3 [2007ç 9-37
- GUZZETTA, Giorgio. (2007). L'osservanza del rito preso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa (= titulli i origjinalit në dorëshkrim: De Albanesium Italiae ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint), Palermo 2007.
- JANURA, Petro. (1969). *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*. Shkup 1969.
- KASTRATI, Jup. (1972). De Rada për shkollën shqipe, «Revista pedagogjike», Tiranë, shtator - tetor 1972, XXII, 5, 145 - 155.
- KASTRATI, Jup.(1979) Jeronim de Rada (Jeta dhe vepra). Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori".
- LLOSHI, Xhevat. (2008). Rreth Alfabetit të Shqipes. Logos A, Shkup.
- MANDALÀ, Matteo (= Mateo Mandala). (2004). Luca Matranga, E Mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà), në serinë: "Albanica", nr. 21, Caltanissetta 2004.
- MANDALÀ, Matteo (= Mateo Mandala). (2006). Vepra e pabotuar e At Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII, në: "Studime Filologjike" 1-2 [2006] 11-41.
- MANDALÀ, Matteo (2010) "*Kolegjet arbëreshe në marrëdhëniet italo-shqiptare. Roli i Seminarit të Palermos*". Në konferencën shkencore "Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare" 14 tetor 2010. Shkodër.
- MASCI, Angelo.(1807). Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della nazione albanese, Napoli 1807.
- MEHMETI, Drita. (1980). *Studime historike*. Nr.4. Tiranë.
- PETROTTO, Gaetano.(1931). Studi di storia della letteratura albanese. Popolo lingua e letteratura albanese, Palermo 1931
- RAKA, Fadil. (2008). *100 vjet të Kongresit të Manastirit*, Prishtinë.
- SHANTOJA, Lazër. (2005). *Botime Françeskane*. Shkodër.
- TARE, Denisa. (2019). *Kongreset linguistike dhe kolegjet arsimore arbëreshe*. <https://www.radiandradi.com/kongreset-linguistike-dhe-kolegjet-arsimore-arbereshe-nga-dr-denisa-tare/> 7 korrik 2019.
- VISHKO, Ali. (1992). *Kongresi i alfabetit dhe të shkollës shqipe*. Flaka e vëllazërimit, Shkup 1992.
- Zgjimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912. (2000). Phoenix: Tiranë.

Zeqirja NEZIRI

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe
Universiteti `Shën Qirili dhe Metodi`-Shkup
zekoneziri@yahoo.com

**PËRDPJEKJET E SHKRIMTARËVE TË MOÇËM PËR NJË ALFABET
KOMBËTAR**

THE EFFORTS OF OLD WRITERS FOR A NATIONAL ALPHABET

1. Dëshmitë për një alfabet të veçantë

Derisa mendoja të them diçka me interes për këtë përvjetor shumë të rëndësishëm të historisë së popullit shqiptar – njëqindvjetorin e alfabetit të gjuhës shqipe, mu kujtua se **para 700** vjetësh, pikërisht **në vitin 1308**, një murg i panjohur perëndimor “që kaloi nga Shqipëria” në raportin e tij shkruante se shqiptarët janë një popull me gjuhë dhe shkrim të veçantë nga popujt e tjerë të Ballkanit Perëndimor (Elsie, 2001²: 13 – 14; Shuteriqi, 2005: 46).

Kjo datë na kujton kohën e daljes në skenën ndërkombëtare të shqiptarëve si popull me vetëdije të formuar kombëtare, kulturore, gjuhësore dhe letrare. **Njëzetekatër vjet** prapa, më **1332** murgu tjetër francez, tani me emër e mbiemër, Gulielm Ade dhe me pseudonimin Brokardus Monacus, do të shkruajë se shqiptarët në librat e tyre përdorin alfabetin latin, me çka do të dëshmojë edhe për ekzistimin e librave të shkruara. Ky monark francez shkruante: “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin (litteram latinam) në përdorim dhe në librat e tyre” (Shuteriqi, 2005: 39).

Janë këto vetëm dy prej datave nismëtare të cilat arbërit i përfshijnë në rrjedhën evropiane të Humanizmit, si njëra prej lëvizjeve më të përparuara evropiane, e cila bëri një kthesë shumë të madhe në historinë e njerëzimit, që edhe pas pesë shekujsh akoma nuk është tejkalar.

Vijnë pastaj shekujt dhe vitet që shënojnë secili nga një ditë të caktuar. Dhe, sikurse ka ndodhur atëbotë edhe me kulturat gjuhësore e letrare të popujve të tjerë evropianë, kështu ndodhi edhe me kulturën gjuhësore e letrare arbëre e shqiptare. Në shekullin e 16 – të nisin të kultivohen, gati paralelisht, dy orientime kulturore të shkruara: (1) edhe në gjuhën e përgjithshme latine, si botohen librat e Barletit (*Rrethimi i Shkodrës dhe Historia e Skënderbeut*), *Komentari i Dhimitër Frëngut e Gjenealogjia e Muzakëve*; (2) por edhe në gjuhën e kombit, si është *Meshari* i Gjon Buzukut, të cilat u botuan në të njëjtin vit, pra më 1555.

2. Fillet e shkrimit shqip

Gjithashtu, që në nismë, që në paraqitjen e saj publike, shqipja, na del e shkruar me fytyrën e dy alfabeteve të atëhershme evropiane: të diplomacisë, administratës, të kulturës e të shkencës, pra edhe të letërsisë: me fytyrën e alfabetit latin dhe me fytyrën e alfabetit grek, të cilët përdorëshin njëri në Perëndim dhe tjetri në Lindje të Evropës. Me fytyrën e këtyre dy alfabeteve të atëhershme evropiane janë shkruar edhe tekstet e para në gjuhën shqipe: pjesa e ngjalljes së Krishtit sipas *Ungjillit të Mateut* me alfabetin grek dhe në dialektin toskë, që duhet të jetë në mos më e hershme, të paktën e njëkohshme me *Formulën e pagëzimit* të Pal Engjëllit të **8 nëntorit të vitit 1462**, të shkruar me alfabetin latin dhe në dialektin e gegërishtes.

Në qoftë se këto dëshmi dhe këto tekste të shkurtra nuk flasin për një përdorim të madh të këtyre dy alfabeteve në shkrimin e gjuhës shqipe, me alfabetin latin e grek, kjo nuk do të thotë se ata nuk do të vijojnë të përdoren në shekujt vijues. Përkundrazi, ata do ta ndihmojnë vënien e gurthemelit të fortë e të shëndoshë - krijimin e një kulture dhe të një letërsie në gjuhën kombëtare të shqiptarëve.

3. Nisma e krijimit të kulturës kombëtare

Gjon Buzuku, ky katragjysh i madh nuk hezitoi dhe nuk u luhat aspak kur përktheu në gjuhën shqipe pjesë të *Librit të Shenjtë*, ashtu si kishin vepruar edhe popujt e tjerë të Evropës së atëhershme: anglezët, danezët, francezët, gjermanët, holandezët, hungarezët, italianët, kroatët, norvegjezët, polakët, portugezët, sllovakët, slovenët, spanjollët, të cilët njëri pas tjetrit, nën atmosferën e dritës dhe të dijes humaniste, si dhe të Reformës e të Kundërreformës, përkthyen *Librin e Shenjtë* ose hartuan në gjuhët e tyre libra mësimi fillestar të besimit të krishterë. Kështu, në shekujt vijues vepruan edhe shqiptarët me Gjon Buzukun e Lekë Matrangën në krye: njëri në Shqipëri dhe tjetri te arbëreshët e Italisë.

Në mosnjohje të rrethanave të plota bio-bibliografike të udhëtimit jetësor të Gjon Buzukut, mungesën e kopjes së plotë të librit të tij, si dhe të udhëtimit të librit të tij në një kohë më të afërt se deri te Gjon Nikollë

Kazazi (1740), ne sot nuk dimë as për vështirësitë që ka hasur autori në hartimin, përshtatjen dhe përdorimin e alfabetit latin të tipit gotik për ta shkruar librin e parë në gjuhën shqipe.

Në *Pasthënie të Mesharit* ai **nuk ankohet** (sikurse që **nuk ankohen as pasuesit** Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani) për **vështirësitë e alfabetit**, por për vështirësitë e natyrës së librit dhe të botimit të tij (për çka do të ankohen edhe pasuesit Budi, Bardhi e Bogdani). Ai në këtë *Pasthënie* shkruante: *“kjo tue klenë ma e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gjuhët tanë”* (Ismajli, 2000: 92), dëshmon se çështja e alfabetit konsiderohej e zgjidhur. Ndërkaq për alfabetin e tij profesor Tomor Osmani shprehet: “alfabeti i parë i plotë për gjuhën tonë që pasqyronte të gjithë tingujt – fonemat e shqipes, jo pa të meta dhe i përkryer” (Osmani, 2006: 229).

Përkrah tij, me frymë të njëjtë, Pjetër Budi, ankohet për neglizhencën, mosinteresimin e shqiptarëve ta shkruajnë gjuhën shqipe, se këta nuk kujdesen për lërimin e shkrimin e saj: “Ma ndë e vonë /.../, disa tue mos qenë kush ndimë, qishmos kundrështarë e shtiekëqi” (Ismajli, 2000: 166). Në *Parathënie të Doktrinës* do të shkruajë se librat e tij i shkroi dhe i botoi: *“për ndimë të Patriesë e të gjuhës sanë, qi u vduarrë ende po varenë ma të shumënë veçëse për letërë e për të mpsuom”* (Ismajli, 2000: 166). Ndërkaq, për alfabetin, si edhe Buzuku më parë, nuk jep kurrëfarë shpjegimi, edhe pse tregon kujdes të veçantë t’u kërkojë falje lexuesve për gabimet që kanë mundur t’i përvidhen dhe të arsyetohet: *“ndonë gjeçi kund ndonjë faj, o të mënguom këndo vepërë, përse aspak s’ka me qenë me vullënde(t) të zemërësë sime, veçëse m’pahir, tue mos qenë i zoti ma mirë me i kthiem e me i ndrequnë/.../, lutni Tënëzotnë ende për muo fajëtuorrë(në) e përmmkatnuom”* (Ismajli, 2000: 222).

Në këtë kontekst do të shprehet edhe Frang Bardhi, në *Parathënien e Fjalorit* të tij *latinisht – shqip*, i cili shkruante se këtë libër e hartoi dhe botoi për ta ndihmuar gjuhën shqipe: *“Tue pasunë ditë përditë (të dashunitë e mi, mbasi hina ndë kolegji) kujtuem me qish copë librë keshë me ndimuem mbë nj’anë giuhënë tanë qi po bdaretë e po bastardhohetë sa ma parë të ve”* (Ismajli, 2000: 247), por për vështirësitë që mund t’i dëlnin për përdorimin e alfabetit latin nuk jep ndonjë shpjegim. Përkundrazi, në fund edhe ai, si edhe pararendësit Buzuku e Budi përfundon me lutjen drejtuar lexuesve që t’ia falin fajin: *“u lus gjithëve me të prunjëtë të më ndëjeni e të më shkumoni (it. falni) përse s’mujta ma mirë me e nkëthiem, me e mbushunë e me e ndrequnë/.../. Vëllazënitë e dashunë, si e kam pasunë, e si e kam ndë më rantë fuqia me dhanë dorenë e me ndimuem së pafesë doresë arbëneshë”* (Ismajli, 2000: 251).

Përgjithësisht përdoren dy tipa të alfabetit latin: (a) **njëri**, për nevojat fonetike të shqipes, i plotësuar me grafema të alfabetit grek; dhe (b) **tjetri**, krejtësisht latin, me kombinime shkronjash sipas modelit italian.

Në aspektin kohor, të jetëgjatësisë së përdorimit të alfabeve të tyre, prof. Tomor Osmani veçon alfabetin e Pjetër Bogdanit. Këtë e mbështet në

dy faktorë praktikë dhe historikë; (a) “e para se alfabeti i Bogdanit ishte më i përpunuar, më i saktë dhe pak më i lehtë”; dhe (b) “e dyta, ka qenë më afër në kohë se të tjerët” (Osmani, 2006: 229).

Profesor Tomor Osmani mbron pikëpamjen se secili prej tyre duke ndjekur modelin e përdorimit të alfabetit të veçantë, duke sjellë veçori dalluese në kontekst të përshtatjes së alfabetit latin, janë udhëhequr nga parimi i theksimit të autorësisë (Osmani, 2006: 229). Prandaj sharra (ξ) me dy ose tre dhembë për shkrimin e **th – së** e **dh – së** del te secili autor, ashtu si del edhe shkrimi i **y – së** herë me (**8**) tetëshe të hapur lartë (te Buzuku) ose me tetëshe të mbyllur (**8**) te Budi (Ismajli, 2000: 244). Në fakt vazhdon më tej akademik Rexhep Ismajli “Budi zanoren **y** e kishte shënuar me numrin **8** të mbyllur, çka në fakt është përshtatje e shkronjës përkatëse të Buzukut **8**, Bardhi iu kthye formës së parme” (Ismajli, 2000: 244). Kjo argumenton se ata janë përpjekur të përdorin një alfabet fonetikiqist sa më të plotë të shqipes, i cili t’i paraqiste të gjithë tingujt – fonemat e shqipes (Osmani, 2006: 229).

4. Nevoja për një drejtshkrim të gjuhës shqipe

Budi, Bardhi e Bogdani, edhe pse jetuan në një hark kohor shumë të afërt me Buzukun, asnjëri nuk e përmend pararendësin e tyre, përveç Pjetër Bogdanit, i cili e përmend tërthorazi. Edhe pse Pjetër Budi e kishte shumë afër, domethënë kur ky ka lindur, Buzuku ka mundur të ketë qenë gjallë dhe në kuvendet kishtare, në të cilët ky u formua si prift, akoma ka qenë e freskët kujtesa e Buzukut, historiografia shqiptare nuk ka rënë në gjurmë ta dëshmojë një gjë të tillë. Përkundër kësaj, gjysmë shekulli më pas, Pjetër Bogdani shkon edhe më tej se hartimi i një alfabeti. Ai në një raport të vitit 1675 kërkon nga Vatikani jo vetëm ribotimin e katër librave (prej të cilave tri ishin të Pjetër Budit, kurse i katërti ka mbetur enigmë: i Buzukut apo i ndonjë tjetri), por angazhohet edhe për hartimin e një **drejtshkrimi** të gjuhës shqipe (Ismajli, 2000: 291). Kjo flet jo vetëm për një nivel të lartë të vetëdijes intelektuale kombëtare të Pjetër Bogdanit, por edhe për nivelin e lartë intelektual që kishin këta korifej të kombit tonë.

Merrni me mend: Bogdani, sikurse më parë Buzuku, Matranga, Budi e Bardhi, këtu nuk flet për alfabetin, ai këtë çështje e konsideron te zgjidhur. Ai theksonte nevojën e hartimit të një **drejtshkrimi** për një gjuhë standarde kombëtare, në një kohë kur shqiptarëve u mungonin shkollat kombëtare. Për këtë ndërmarrje të Pjetër Bogdanit, akademik Rexhep Ismajli do të theksojë: “projekti i tij për një gjuhë letrare pëmbante shume kriteret e nevojshme për ta bërë atë gjuhë standarde: e kishte mëvetësinë, për një pjesë të mirë e kishte kodifikimin, e kishte kriterin e mjetit kulturor, e kishte modernizimin për kohën dhe rrugën e hapur për modernizim të mëtejshëm, e kishte intelektualizmin, porse i mungonte njësimi (në kuptimin e të vetmit mjet për të gjithë shqipfolësit me potencialisht

variante të ndryshme), i mungonte shtresëzimi funksional” (Ismajli, 1991: 187; 2000: 291;

5. Katër modele grafike mbi fytyrën e tre alfabeteve

Në shekujt 16 – 18 shqipja nis të shkruhet me katër modele alfabetesh të veçanta:

(1) *njëri* është thjeshtë latin, me kombinimin e shkronjave (si e përdori Pal Engjëlli e Lekë Matranga dhe përgjithësisht arbëreshët e Italisë;

(2) *i dyti* është latin, por me përdorim të simboleve të alfabetit grek (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani);

(3) *i treti* është alfabeti i modifikuar grek (siç dëshmohet me fragmentin e *Ungjillit të Mateut*, në fillim dhe voskopojarët përgjatë shekullit të 18 – të; dhe

(4) *i katërti* është alfabeti i modifikuar arab.

Shkencërisht është argumentuar se të gjithë këta autorë, për nevojat e shqipes, mbi fytyrën e alfabetit latin kanë përdorur disa grafema që i mungonin këtij alfabeti dhe këto i huazuan nga alfabeti grek i tipit cirilik, të cilat ose ia kishte imponuar shtypshkronja ku i botuan librat; ose ndiqnin një traditë më të hershme; ose dëshmonin se . *Për të parën* është argumentuar se ky lloj alfabeti përdorej në shtypshkronjat venedikase, në të cilat, deri vonë, në fund të shekullit të 18 – të botoheshin libra në gjuhët e popujve të Lindjes së Bregdetit Adriatik (në kroatisht dhe sllovenisht). *E dyta* e ndërlihd me traditën e shkrimit perandorak (latin në Perëndim dhe grek në Lindje) dhe me përdorimin e tyre përgjatë Mesjetës për shkrimin e shqipes (fragmenti i *Ungjillit të Pashkës* dhe *Formula e pagëzimit*).

Me alfabetin latin qe shkruar edhe *Formula e pagëzimit* e Pal Engjëllit e vitit 1462, si edhe 27 vjet më pas qe botuar *E mbësuar e krishterë* e Lekë Matrangës, nga Hora (Piana) e arbëreshëve pranë Palermos në Sicili, i cili, për nevojat fonetike – fonologjike që kishte shqipja kombinoi alfabetin italian. Pas tyre, në shekullin e 17 – të edhe Pjetër Budi, Frang Bardhi e Pjetër Bogdani do ta përdorin në librat e tyre alfabetin latin, të ngjashëm me atë të Buzukut, për të cilin njëri prej tyre Frang Bardhi më 1635 do të dëshmojë: “shqiptarët përdorin gjithnjë ato shkronja, qi përdorin latint, posë tri shkronjash, qi ata i kanë në veti” (Rrota, 2006: 104).

Në shekujt vijues, në të shtatëmbëdhjetin e të tetëmbëdhjetin, si dhe në të nëntëmbëdhjetin ndjekin njëri - tjetrin Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi, të cilët në vija të përgjithshme përdorën *alfabetin e modifikuar latin* të Buzukut; Teodori i Bogomilit, Theodhor Kavalioti, Dhaskal Todhri, Theodhor Haxhifilipi, Grigori i Durrësi e Grigori i Gjirokastrës, secili në mënyrë të pavarur do të përpiqen mbi *fytyrën e alfabetit grek* të krijojnë një alfabet të posaçëm të shqipes. Atyre i bashkohet plejada e arbëreshëve Nikollë Keta, Nikollë Filja, Nikollë Brankati, Gavril e Ndre Dara, Jul Varibobba të cilët bashkë me shqiptarët vazhdojnë përpjekjet e arbëreshëve për *modifikimin e alfabetit italian* për nevojat e shqipes. Te këta të fundit, domethënë te arbëreshët në gjysmën e

parë të shekullit të 18 – të u hapën shkollat e kolegjet e para, në të cilët do të ligjërohej edhe në gjuhën shqipe.

6. Shqipja nis të shkruhet edhe me fytyrën e alfabetit arab

Për këtë nivel të lartë të vetëdijes kombëtare që tregon Pjetër Bogdani e argumenton edhe një dëshmi tjetër e kohës së tij, e gjysmës së dytë të shekullit të 17 – të, në të cilin thuhet se në Elbasan është regjistruar një këngë për sulltanin (Shuteriqi, 2005: 202). Si dhe dëshmia e regjistrimit të disa fjalëve (të tipit të numërorëve, përshëndetjeve e shprehjeve) që, në këtë hark kohor (1662), i shënoi, me alfabetin arab, udhëpërshkruesi i famshëm osman Evlia Çelebi (Ismajli, 2000: 269 – 273). Ndoshta ky është impulsi që e nxiti Bogdanin të kërkojë hartimin e një drejtshkrimi, por kjo dëshmon se që nga gjysma e dytë e shekullit të shtatëmbëdhjetë, për nevojat e veta, shqipja përkrah alfabeveve tanimë tradicionale më tepër se katër shekullore kishte nisur të shkruhej edhe me fytyrën e alfabetit arab.

Përkundër kësaj përpjekjeje vetëmohuese të shqiptarëve që gjuhën e tyre ta shkruajnë edhe me fytyrën e alfabetit arab, pushtetarët e Perandorisë Osmane u treguan jo vetëm të shurdhër, por edhe e ndaluan me “fetfatë” e njëpasnjëshme të sulltanit. Kështu veprimtaria letrare e Ibrahimit Nezimit e Sulejman Naibit, si dhe e Hasan Zykos, Zenel Bastarit e Muhamet Kyçykit do të mbesin dorëshkrim dhe nuk do të botohen gati deri në prag të Kongresit të Manastirit, kur Sami Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Hasan Tahsini e të tjerë u mbledhën më 1879 në Stamboll dhe sollën vendimin e parë largpamës e vizionar të përdorimit të një alfabeti dhe kështu i paraprinë Kongresit të Manastirit për ta sjellë vendimin përfundimtar të përdorimit të një alfabeti kombëtar me të cilin do të shkruhej gjuha e shqiptarëve.

Të gjitha këto përpjekje së bashku dëshmojnë mundin e pararendësve tanë të shquar për ngritjen dhe përparimin e kulturës së tyre kombëtare. Kjo dëshmon se përpjekja e shqiptarëve për një alfabet të veçantë kombëtar përgjatë shekujve shënon fazën e vet evolutive. Kjo nis në Mesjetën e vonë, vazhdohet përgjatë Humanizmit e Rilindjes Evropiane dhe përfundon në Periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në fund të shekullit të 19 – të dhe në decenien e parë të shekullit të 20 – të.

Abstrakti

*Artikulli i mëshon çështjes së përpjekjeve të shqiptarëve nga Mesjeta deri në fillim të shekullit të 20-të për krijimin e një alfabeti të veçantë për shkrimin e gjuhës së tyre. Mbështetur në **dëshmitë, shkrimet e para** në gjuhën shqipe dhe në **librat** e botuar përgjatë kësaj periudhe kohore dëshmohet se shqiptarët, në rrjedhë me rrethanat kulturore të kohës dhe në frymën e Humanizmit evropian, gjuhën e tyre përpiqen ta shkruajnë me modifikimin e tre alfabeveve: latin, grek dhe arab.*

Abstract

The article deals with the issue of the efforts of Albanians from the Middle Ages to the beginning of the 20th century to create a special alphabet for writing their language. Based on the evidence, the first writings in the Albanian language and the books published during this period of time, it is proven that Albanians, in line with the cultural circumstances of the time and in the spirit of European Humanism, tried to write their language by modifying three alphabets: Latin, Greek and Arabic.

Bibliografi:

- BARDHI, Frang (1983), *Fjalor latinisht – shqip*, Përgatiti: Engjëll Sedaj, Rilindja, Prishtinë.
- BOGDANI, Pjetër (1989), *Çeta e profetëve 1. Cuneus prophetarum 1*, Transliterimin në gjuhën e sotme, përkthimin dhe parathënien: Engjëll Sedaj, Rilindja, Prishtinë.
- BUDI, Pjetër (2006), *Poezi, Parathënia, tejshkrimi dhe komentet*: Rexhep Ismajli, ASHAK, Prishtinë.
- ÇABEJ, Eqrem (punuar 1988), *Meshari i Gjon Buzukut 1 – 2*, Rilindja, Prishtinë.
- ELSIE, Robert (2001²), *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë.
- ISLAMAJ, Shefkije (red. 2007), *Frang Bardhi. 400 – vjetori i lindjes*, IAP, Prishtinë.
- ISMAJLI, Rexhep (1991), *Bogdani dhe gjuha e tij: Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë.
- ISMAJLI, Rexhep (2000), *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë.
- MANSAKU, Seit (red. 2008), *Pjetër Budi*, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë.
- NEZIRI, Zeqirja (2006), *Meshari i Buzukut*, Logos – 5, Shkup.
- OSMANI, Tomor (2006), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor 1*, USH - SSHA, Shkodër.
- SHUTERIQI, Dhimitër S. (2005), *Shkrimet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800*, ASHSH – IGJL, Tiranë.
- SHUTERIQI, Dhimitër S. (1978), *Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850*, Rilindja, Prishtinë.

ISSN 2671-3004

UDC 821.18-1(450:=18)

Punim studimor

Vebi BEXHETI

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

E-mail: v.bexheti@seeu.edu.mk

**“TRIMDITA”, SI METAFORË E QËNDRESËS ARBËRESHO-SHQIPTARE
NË POEZINË E ZEF SKIRO DI MAXHOS****“TRIMDITA”, AS A METAPHOR OF THE ARBAN-ALBANIAN STABILITY
IN THE POETRY OF ZEF SKIRO DI MAXHO**

Zef Skiro Di Maxho në gjithë shtrirjen e krijimtarisë së tij, në qendër të interesimit i kishte arbëreshët, madje, që nga koha e ngulmimeve në jugun e Italisë, mënyrën e jetesës në kushte të reja dhe mbijetesën, e deri në ditët e sotme, që në mënyrë metaforike poeti e krahason me zhvillimet brenda një dite, nga mëngjesi, deri në mbrëmje, që i përgjigjet edhe titullit të përmbledhjes poetike dygjuhësore *Trimdita (2009)*. Ky libër lirikash dygjuhësore shqip- italisht, përbëhet nga këto cikle poezish: “Trimdita”, “Me të vërtet Morea”, “Vjersha të verëshme dhe vëllazërie”, “Anije me Ulqin” dhe “Kazallot”. Në poezitë e kësaj përmbledhjeje, si duket, poeti ndërton një model ndryshe, krijues, me tendencë të një mbylljeje, por pa e dëmtuar idenë dhe mesazhin e vargut të tij, drejtuar arbëreshëve dhe shqiptarëve në përgjithësi, ku nuk mungojnë edhe poezi me tema universale. Titulli i veprës deshifrohet që në poezitë e para, kur arbëreshi si i mençur që është, nxjerr nga kutia mëngjesin që do i shërbejë tërë ditës, metaforë kjo e fillimit të mbarë të jetës së tyre dhe përshtatjes në ambientin e ri, gjithsesi falë zgjuarësisë së tyre: *Arbëreshi/ “me mendje aq shumë pjellore” nxjerr nga mbështella kuti/ menatën dhe e vesh (Arbëreshi)*. Këtë lojë fjalësh, që e prodhon edhe titullin e veprës e gjejmë edhe te vargu ku përmendet Afëdita, perëndesha romake e dashurisë, e njohur edhe si planeti “Venus”, e paraqitur në skulpturë, që njëherit është edhe togfjalëshi “afër dita”, me kuptimin se dita është shumë afër, kjo ditë trime, që si titull del “Trimdita”, emërtim më tepër poetik, mbase gjuhësisht duhej të ishte “Trimedita”: *Afër ditës, Afërdita rri gdhendur/ te kristali i kaltër çë merr shëmbër/ nga kristalet e Muranos aq duket vepër/ specialistësh (Afër ditës)*.

Jeta e arbëreshit, që në fillimet e vendosjes në tokën e huaj, krahasohet me humnerën e natës, shpresën e sheh te dita, ardhmërinë dhe përballjen

me një botë tjetër, ku nuk do e ketë lehtë të ndahet nga kanuni i vjetër, për t'iu përshtatur një shoqërie të re: ...*Qytetrim/ është të mbajturit e zemërimit në gardhin shoqëror. Thuaj modernitet* (Rimerr). Poeti shpeshherë kur bën fjalë për arbëreshët, që i lanë vatrat e tyre, kthehet atje, te etërit, duke ua kujtuar arbëreshëve të rinj varret pa gjelbrim, etë lëna shkretë: *O të rreptë Etër Arbëreshë/ nga bindjet tuaja të përjetshme/ atje te varri u grisën nani degat* (Gjithë retë papritur). Në vargun e këtyre poezive shpeshherë shkëlqen edhe figura e gruas arbëreshe me veshjen e tyre karakteristike, mbi trupin e bukur sikur të jetë pikturë e Rafaelit. Shumë poetike tingëllojnë vargjet me të cilat poeti e konsideron të bekuar kostumin, që nget lëkurën e saj, si edhe kurorën e qëndisur të nënës së vajzës nuse, kësaj bukurie të vjetër e të re. Vargu: *bekuar ai kostum që nget lëkurën tënde*, ngjason me atë të poezisë së bukur “Veshja arbëreshe”, të Martin Camajt, ku edhe ai, duke e vlerësuar aq lart veshjen e grave arbëreshe, vargut të veti jep edhe ngjyrim erotik: *...linja –erëmirë/ e ngime me gji vashë*.² Këtë nuse arbëreshe, me tërë pushtetin tërheqës të bukurisë, bashkë me stolitë, që e begatojnë, poeti e krahason me një rrufe çasti: *Bukuri arbëreshe në ka ndonjë kuptim të thuhet/ madhështia dhe rrufetë e çastit që stolitë e tua hedhin*. Para tërë kësaj bukurie, sipas poetit, nuk mund të mendohet se arbëreshët kohëve të fundit me të madhe i nënshtrohen asimilimit: ... *Në ka/ ndonjë kuptim të thuhet/ se para kaq dukurie madhështore arbëreshe/ rri një zbrazëti arbëreshe*. (Rafaeli të pikturoi).

Përveç bukurisë magjepse të gruas arbëreshe, që me sytë e saj dhe “fuqi sensualiteti” i vë në lëvizje: ajrin, ujët, tokën dhe zjarrin vendës, poeti Skiro Di Maxho, e vlerëson lartë edhe për meritën e saj në lindjen e arbëreshëve të rinj, që do e mbajë gjallë këtë pjesë të kombit:

Ajo mblen. Ajo tërheq.

Kur më s'do të ndienjë dashuri për lirinë do të lindë bij të bukur arbëreshë kontributi i saj në mbajtjen e gjenisë.

(Ajo mblen)

Arbëreshët e vazhduan traditën artistike edhe në tokën e re. Teatri në natyrë për to ishte gjithmonë i hapur: *nga çelja e pare e pëlhurës mëngjesore/ tek ulja e perdes së madhe të natës*. Brenda kësaj skenografie u luajtën partiturat. Edhe në vargjet e kësaj poezie, poeti në mënyrë figurative flet për aftësinë e arbëreshëve për t'iu përshtatur rretahanave të reja, për të krijuar ngjashmëri me vendin e etërve të tyre: *Interpretojnë një varg o njëkohësisht/ dhithë partiturat./ Mund të krijojnë dheun e Zanafillës* (Këtu teatër i hapur).

Laerti, një personazh lirik, aq shumë i përmendur në vargjet e këtij poeti, ashtu si edhe i biri, Odiseu, shërben si pikë reference për ta kujtuar të kaluarën, Itakën e tij, gjithmonë, në shërbim të arit poetik. Ky personazh, në

² Shih te Vebi Bexheti, Arbëreshët në poezinë e Martin Camajt, te libri “Magjia e fjalës poetike”, Tetovë 2018, f. 47.

poezinë "Një herë" paraqitet si gjithmonë; i heshtur dhe në pritje të vazhdueshme për të birin. Kësaj historie të njohur, poeti i mvësh petkun artistik, ndërsa personazhin historik e shndërron në burim frymëzimi për këto vargje, që e shqetësojnë emocionalisht. Laertin, këtë burim frymëzimi, e të shoqëruar me pritjen e gjatë, ndonjëherë, ashtu të ndrojtur e gjejmë edhe te Fusha e Zonjave, toponim ky që flet mjaftë për kulturën arbërore, vendin dhe respektin e gruas (zonjës) në shoqëri. Me siguri që nëpër Arbëri ka pasur shumë vende që quheshin Fusha e Zonjave, apo Shtegu i Vashave, toponime karakteristike për aristokracinë e Arbërit, që i mori me vete dhe i vendosi në vendin e ri. Tashmë në Shqipëri kanë mbetur vetëm Shkëmbi i Vashave, të Krujës dhe Lëndina e lotëve, në Korriçë, që brenda vetes mbajnë histori të dhembshme:³ *Një herë laertin tim e gjeta ulur/ te pragu i së voglës shtëpi/ aty te Fusha e Zonjavet. Zef skiro Di Maxho shpeshherë objekt trajtimi e kishte Horën e tij, madje duke e përmendur emrin e vjetër të këtij vendbanimi arbëresh, Kazallot,⁴ jetën arbëreshe, që e zbukuron "vallja mëngjesore e kombonareve", me rastin e festave të ndryshme, por edhe të goditjeve të përmortshme:*

Në perspektivë tingulli

brënda arkitekturës të kësaj toke vertikale një kilometër afër një kilometër larg mbërrin këtu Kazallot vallja mëngjesore e kambanëvet në përputhje me festat.

(Në perspektivë tingulli)

Brenda ciklit "Trimdita", që njëherit është është titulli i kësaj përmbledhjeje poetike, përveç poezive të mbyllura e me kuptime metaforike, që kërkojnë edhe qasje për zbërtime nëntekstuale, përfshin edhe poezi më të hapura, dhe më konkrete, si në përmbajtje, ashtu dhe në formën e saj. Një poezi e këtillë është edhe ajo me titull "Në qendrën e botës", kushtuar vendlindjes së tij, Horës arbëreshe, që poeti e konsideron si qendër të botës. Ardhëmiria e këtij vendbanimi më të madh arbëresh është rinia, shpresa se Hora do mbijetojë, duke i rezistuar ndikimit të huaj. Me vajzat e bukura dhe moshatarët e saj, që e zbukurojnë Rrugën "8 Marsi", nën blirët e mbjellë shumë vite më parë, bashkë me dritat e mbrëmjes, kjo qytezë reflekton jetë e gjallëri. E tërë kjo pamje që hap perspektivë për jetë të lumtur në këtë mjedis arbëresh, është njëherit edhe shpresë për gjithë arbëreshët dhe gjithsesi dëshirë e poetit, që bashkëvenësit e tij mos të marrin rrugë të reja, për në vende të reja: *Në qendrën e botës/ të*

³ Shih atunispoetry.com, Timo Mërkuri, Te fusha e zonjave lexohet poezi, përsiatje mbi librin "Te liqeni i Zemrës" të Zef Skiro Di Maxhos.

⁴ Në bisedë me autorin, nëse toponimi Kazallot është vendbanim jashta Horës, ai e dha këtë spjegim: Kazallot është emri i vjetër i Horës së arbëreshëve dhe kazatllotianë na quanin banorët tjerë të katundeve arbëreshe të Siciulisë. Unë shtëpinë e kam aty. Ndodhem një km. larg nga qendra e Horës.

paktënt'asaj tënës/ pa ironi/ rrjedh arteria rinore plot të ardhme. Poetikur i këndon bukurisë së Horës, nuk ndalet vetëm tek ajo tokësorja, por shikimin e derdh edhe drejt qiellit me "hënën faqellore" e të "tepruar në bardhësinë e saj", që dallon nga ajo e "poetëve sqimatarë", që bëjnë dritë mbi liqen, e që është vetëm pjellë e fantazisë së tyre: *I dukej banal krahasimi pikërisht/ me hënën e poetëve sqimatarë te liqeni* (Dje mbrëma vërente hënën). Përmes lirikës së pejzazhit të vendlindjes, ku përmend edhe toponimet: Kazallo, Horë e Purtelja, poeti me vargun e vet sjell edhe pamje me mot të vështirë, me furtunë, erë e shi. Era që vërsulet nga Purtelja drejt kodrave të Kazallotit, për të zbrirur në gropën e Horës, me tërë ashpërsinë e vet, duke mbledhë ermirëne spartavet, bashkë me gurët, që shembëlajnë me pamjenjerëzish, paraqet një pejzash me plot figura stilistike, duke e zbukuruar këtë mjedis edhe në kushte të vështira klimatike, mbase vendlindja nuk është e bukur vetëm kur dielli shkëlqen, e hëna ndriçon në qiellin e kaltër: *Era në gatishmëri furtune/vërsulet nga Purtelja* (Era në gatishmëri furtune). Në këtë cikël poezish, trajtohen edhe tema të fateve individuale, shpeshherë edhe me përfundim tragjik. Një poezi e këtillë është edhe ajo me titull "Pasngrëni pa lajmërim", me personazhin lirik, djalin e ri, me plot pasion, që e humb jetën në lulen e rinisë. Kjo dhembje e shprehur përmes vargjeve elegji, të ciklit "Trimdita", sikur e ndal kohën e "ditës trime," metaforës së ekzistencës së arbëreshëve dhe përballjes së vazhdueshme të tyre gjatë tërë ditës, që nënkupton edhe tërë jetën.

Figurat stilistike siç është edhe krahasimi, dhe shprehjet e ndryshme metaforike, vargut i japin gjallëri e shumëkuptmësi. Me flamurin euforik, djalërinë e plotë, psherëtimën e motorëve dhe shumë shprehje tjera figurative, karakteristike për gjuhën poetike të Zef Di Maxhos, ai e ngren këtë varg nga një aksident komunikacioni, në vlerë estetike. Dëshirën e personazhit, të këtij djaloshti të ri për të dalë me motor, poeti e quan flamur euforik, emoshën e tij, djalëri të plotë, ndërsa shpejtësinë e krahason me erën banale, më të fortë se valavitja e djalërisë. Shuarjen e një jete të re dhe trupin e pajetë në asfalt, e quan flamur të djalërisë, ndërsa përplasjen si jehonë britme në labirintin e maleve "sa veshi e përfshin": *Kapelëza përkujtimore/ ka gjithmonë lulet e reja/ të kujt njëjtësohet/ në atë eufori djalërie të ndaluar.* Edhe në poezinë "Ndodhet një rrugë", poeti vazhdon t'i përshkruajë edhe viktimat tjera të tragjedive rrugore dhe stacionet e dhimbshme, siç ai i quan pikat e zeza, që marrin jetë njerëzish. Humbjen e dy jetëve rinore, dhe vendin ku mbetën të shtrirë, poeti e shenjon me dy gurë, dhjetë metra larg njëri-tjetrit: *Dy rrugë larg dhjetë metra/ njëri nga tjetri/ dy stacione të dhëmbjes.* Meqë Zef Di Maxho depërton në çdo vend e rrethanë për të gjetur frymëzimin poetik, me idenë që me vargun e vet, ta paraqesë jetën dhe vdekjen, ashtu si mendon se do i përshtatet më mirë poezisë, ai i trajtoi edhe këto tema të ndjeshme, si edhe interesimin i tij për gjendjen e kurmit të njeriut pas vdekjes mbase të gjitha kurmet nuk prishen për kohë të njëjtë: *Shtrohet problem i domethënies/ së kalbjes-*

moskalbjes së kurmit. Duke u nisur nga kjo kurrëshje se ky fenomen është çështje shenjtërie, apo proces, që e ka spjegimin e vet shkencor, poeti e shtron pyetjen: *Çfarë simboli janë sot/ kurmet kalbur menjëherë/ nga acidet e qelbura antitumorale?/ Shkencërisht asnjënjë/ mortja shpall: s'është problem imi* (Shtrohet problem).

Edhe në ciklin e dytë të këtij libri poezish, me titull "Me të vërtet Morea", poeti sjell poezi me temë nga Morea dhe disa të tjetra, ku trajton raporte mes arbëreshëve dhe shqiptarëve emigrantë në Itali. Takimi i shqiptares së re me arbëreshët e tjetër qytetërimi: *qytetërimi ynë Arbëreshësh bij dialektore t'Italisë*, ishte i zakonshëm, edhe pse emigrantja nga Shqipëria fliste ndryshe, ashtu si edhe arbëreshja siciliane, por "me të njëjtën sintoni zëri ashtu që ndërvënë fjalë dialektore siciliane me natyrshmërinë tonë". Sipas vargjeve që na sjell poeti, nostalgjia për Morenë nuk mban sepse tani më Morea janë shqiptarët arbëreshë dhe ata të trungut të vendit mëmë. Në vargjet e kësaj poezie, përveç këtij takimi vëllazëror, spikat edhe çështja e migrimit të shqiptarëve:

Jemi pikë refërimi të qytetërimit mundësor. Përralla e Moresë plot nostalgji nuk mban më:

Morea jemi ne e Bukur kështu

megjithëse është e çuditshme të jemi në botë imigrimi kur emigrantët tanë nisen drejt nje cilitdo Veri.

(Qytetërim mundësor)

Një takim të ngjashëm, mes një plake arbëreshe dhe një shqiptareje, poeti e sjell edhe në poezinë "Nga dy More të largëta". Dy personazhet lirike, motra të një gjaku, për poetin Skiro Di Maxho janë dy fatet, që vijnë nga dy Moretë, nga ajo e vërteta, që mbeti vetëm një kujtim i përcjell nga stërgjyshërit dhe Shqipëria, e zbuluar vonë nga arbëreshët: *Kushedi në kanë ndërgjegje/ se ritakohem pa mbarim/ nga dy More të largëta çdoherë/ mëma o bija/ motra o dama shoqërimi.* Dhe sërish shqiptarja të cilën poeti e përshkruan me tërë elegancën, e të zbukuruar "në të veshur e në të ecur", shqiptarja emigrante, që e adhuron ahengun e një feste, ashtu si edhe punën, që e konsideron gjithashtu. Kjo temë vazhdon të trajtohet edhe te poezia "Martesa", ku gjithashtu poeti mbetet te dhembja e vjetëre ndarjes dhe gjakut të shprishur, me dëshirën që në kushte të reja, shqiptarët të takohen me njëri-tjetrin, ndonse pjesa më e madhe e tyre, morën rrugën e detit për në Itali e vende tjera perëndimore. Përmes këtyre takimeve të arbëreshëve me shqiptarët e shtetit amë, qofshin edhe emigrantë, poeti dëshiron ta spikas edhe fenomenin e ikjes nga Shqipëria, që kohëve të fundit po merr përmasë të fikshme. Në vargjet e kësaj poezie takimin e dy të rinjve, poeti e realizon përmes martesës së një arbëreshi me nusen shqiptare elbasanase. Nusja e dhëndri, ashtu si do i përshkruante vargu popullor, janë të bukur. Vargjet: *Ajo/ me emër të pazakontë këtu na bie/ detet e pamposhtura nga*

hieshia e saj, tingëllojnë më tepër se një varg i zakonshëm poetik. Me emrin e pazakonshëm të nuses elbanase, poeti sikur e ironizon fenomenin e antropnimeve, që nuk kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, e as me identitetin kombëtar, por që: *bie dete të pamposhtura nga hijeshia e saj*. Dhëndri arbëresh në këtë poezi vjen me tiparet e një dashnori, "zbulues i dashurive, që nga shekujt e tij". Komunikimin mes veti të këtij çifti të ri, poeti e sheh si të lehtë, edhe pse përmes dy të folmeve shqipe, asaj arbëreshe, "të thatë të maleve tona të lodhura" dhe "shqiptimit të kënshtëm të Elbasanit". Këtë akt martesor, poeti e ngrit në një nivel më të lartë se një martesë të zakonshme, meqë e konsideron si ngjarje historike, që i bashkon shqiptarët e dy brigjeve të detit, këtij kufiri ndarës pesëqindvjeçar:

Të pranishëm vëllezër e motra të gjithë: si thoni "bukë"? E "verë"?

Ushqyer nga të njëjtat fjalë.

I sigurt ankorimi tani

nga brigjet e bashkuara të pësëqind deteve e sigurt e ardhmja si akt besimi.

(Martesa)

Preokupimi i poetit me Morenë është i përhershëm, prandaj ky vend nostalgjie për arbëreshët, është i pranishëm në të gjitha përmbledhjet poetike të tij: *Me të vërtetë Morea jeton ende/ dhe nostalgjia e saj. Morea, nuk do vdes kurrë*, janë vargjet e para të poezisë "Me të vërtetë Morea", që është edhe titulli i ciklit të veprës poetike "Trimdita". Edhe në vargjet e kësaj poezie, ku në qendër të vëmendjes është Morea, sërish vargje për emigrantët shqiptarë të cilët qëndrojnë në kënde të caktuar, mbështetur në murët e shtëpive të vjetra arbëreshe. Gjithsesi këto vargje prekin edhe fatin, apo fatkeqsinë e tyre: ... *duken anijembytur/ që shënojnë prani/ anijes More mbërthim shpëtues/ të ndjenjave...* Bashkë me përshkrimin e bukur të amientit të ri dhe fatit të këtyre emigranëve, poeti i përmend edhe disa qytete të Shqipërisë, kur i përshkruan ngjyrat e qiejve të Krujës, Korçës, e Beratit, vendet prej nga kishin ardhur ata: ... *Do të shpëtohen/ në këtë mbrëmë kushedi në e ngjashme/ me ngjyrat e qiejve të Krujës/ të Koçës o të Beratit.*

Poeti Zef Skiro Di Maxho, duke qenë i lidhur me rrënjët e të parëve të tij, si: Morea, Shqipëria Kosova dhe rajone tjera tjera shqiptare, nuk i la pa përfshirë në poezinë e vet edhe shqiptarët e këtyre rajoneve, bashkë me fatin e tyre brenda sistemesh e shtetesh të ndryshme. Edhe kur vargu poetik i tij vjen nga Shteti shqiptar, ai në njëfarë mënyre prek edhe sistemin totalitar të Shqipërisë së mbyllur. Kjo më së miri shihet te poezia "Këtu kalimthi", ku perspnazhet lirike janë gratë shqiptare, të sapodala nga sistemi i egër i Partisë Punës, të vuajtura e të lodhura, por të lumtura se e përjetuan demokracinë, duke u orientuar në profesione të ndryshme, ashtu sipas dëshirës dhe ngritjes profesionale. Ato tani janë ndërmarrëse të suksesshme dhe drejtuese të kompanive të ndryshme, udhëheqin shtëpi

botuese, televizione e shumë institucione tjera. Ato, sipas vargjeve të kësaj poezie, kishin punuar gjithmonë nënë komandë, e gjithmonë "të etshme për modernitet": *Mori grash rreth katërdhjetave/ në karrierë në gazeta/ shtëpibotuese tv/ të vendosura/ symprehtë/ të mësuara në komandë/ të uritura për modernitet.*

Në ciklin "Vjersha të verëshme dhe vëllazërie", poeti i ka përfshirë poezitë e frymëzuara në hapësirat shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi. Nga vet titulli i këtij cikli poezish, kuptojmë se bëhet fjalë për vargje të shkruara gjatë verës, kur ai shpeshherë i vizitonte vendbanimet e vëllezërve të tij të gjakut e të gjuhës, si pjesëmarrës nëpër aktivitete të ndryshme shkencore e kulturore, në Tetovë Shkup, Ulqin e Strugë. Takimin më vëllezërit shqiptarë, të ndarë me shekuj, e përjetonte me gëzimin më të madh, por edhe me dhembje për vitet e shekujt, që na ndanë deri në harrim të njëri jetrit. Përmes këtyre lirikave, ai shpreh mallin e pashuar, që e kishte prekur shpirtërisht, por edhe kënaqësinë për fatin, që e solli koha, për t'u takuar sërish. Ai si poet që gjithmonë ishte në kërkim të rrënjëve dhe degëve identitare, nuk pushoi kurrë së kërkuari të vërtetën historike për njëritë e gjakut e të gjuhës, jashta Shtetit amë, për vlerat shpirtërore, që e mbajtën gjallë ate, edhe pse të ndarë në shumë shtete, e sisteme denigruese politike, gjithmonë nën kompleksin e të qenit pakicë, mes kombesh të privilegjuar, të cilët për të realizuar qëllimet e tyre asimiluese, e keqpërdornin edhe fenë, bashkë me antroponimet me kuptime të huaj gjuhësore. Këtë fenomen, autori Zef di Maxho më së miri e trajton me gjuhën e artit poetik, në vargjet e poezisë "Emra", i frymëzuar në Tetovë, në takimin me profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore.⁵ Kjo ndarje gjeografike, gjithsesi ndikoi edhe në mënyrën e jetësës, mentalitetit tjetërfare të njëri-tjetrit, madje edhe në gjuhë e kulturë. Poeti Zef di Maxho me kohë i kishte kuptuar pasojat e këtij izolimi e mbyllje në vehte, pa fajin e shqiptarëve, prandaj takimet me shqiptarët e këndej detit, e në rastin konkret me këta të Tetovës, që përveç një tubimi me karakter shkencor, i konsideron edhe historik, sepse edhe në këtë rast, në një tavolinë u gjendën bashkë arbëreshët e krishterë të ritit bizantin dhe shqiptarët myslimanë, të cilët i lidh indi si ndjenjë e përbashkët kombëtare, sado që historia u tregua e padrejtë, në vazhdimësi, realitet ky, që poeti e spjeron më së miri

⁵ Poeti Zef Skiro Di Maxho, bashkë me disa kolegë tjerë, profesorë e studiues arbëreshë, me ftesë të Katedrës së albanologjisë të Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave e Komunikimit-UEJL, mori pjesë në Simpoziumin shkencor me temë "Gjuha dhe Letërsia e Arbëreshëve", që u mbajt në këtë Universitet, më datë 28 dhe 29 prill, të vitit 2008. Në këtë simpozium, të parin e këtij lloji, ku morën pjesë mbi 50 studiues e hulumtues shkencorë nga të gjitha hapësirat shqiptare, në mesin e të cilëve edhe shumë arbëreshë, Sef Skiro Di Maxho u paraqit me kumtesën "Magjia e farkës gjuhësore arbëreshe", përmes së cilës e shpreh qartë çudinë e mrekullisë, që është arbëreshi i cili pas pesëqind vjetësh, edhe sot e mban të gjallë gjuhën e tij, edhe pse në rrezik të vazhdueshëm

me gjuhën e poezisë, kur shprehet: *Të habitur nga shekujt që na tretën/ të gëzuar se jemi të gjallë/ tani e këtu*. Vetëm intuita poetike e një poeti siç është Zef Skiro di Maxho mund të ndërtojë varg aq të fuqishëm, që e sfidon historinë e padrejtë, madje përmes emrave të një grupi intelektualësh arbëreshë dhe një grupi tjetër shqiptarësh të cilet koha i takoi sërish, për t'i trguar njëri-tjetrit, se mbetën po ato, të para shprishjes së madhe:

*Biem emra që trgojnëplisat dhe ndërtimete historisë sonë.
Gjejmë emra që tregojnëplisat dhe ndërtimet
e historisë suaj.*

*Françesko Xhani Vinçenxi Mateo Gjuzepe Abdulmenafi Zeqiri Vebiu
Hamiti Mustafai.*

(Emra)

Takimin me vëllezërit e këndej detit në një qytet shqiptarësh, siç është Tetova, ai e përjeton me ndjenja të fuqishme që ngjallin emocione e frymëzim poetik. Në këtë mjedis mes vëllezërish aq sa është i lumtur, është edhe i pikëlluar për të kaluarën: *Tani që jemi bashkë por/ sa shkuam dete sa shkuam dete*. Në një atmosferë të këtyllë, e të ngrohtë vëllazërore, ku cakërrohen gotat, ai nuk dehet nga vera por nga dashuria vëllazërore e lëngut të komunitetit dhe xixat sa yjet që shkëlqejnë: *... por këto gota vetjake/ që marrin g nga shishja komunitet/ sonte kanë xixa sa yjet/ që mbi qelqet ndërtojnë/ përvijime të reja*. Edhe në poezinë "Darka aty në Tetovë", ai vjen me tërë emocionet dhe dashurinë, që i fal këtij mjedisi, ku sërishja me verë, sërish është në qendër të vëmëndjes, ndërsa në "gotën e qelqtë rrinin sy të miqve pritës, sy të miqve të ardhur". Përmes metaforës së vargjeve, kushtuar verës së kuqe tetovare, shtruar për miqtë arbëreshë, ai sërish e prek plagën e ndarjës, shprishjen e gjakut: *rubinin ua jep dhuratë gotave/ kush mund t'i mbajë regëtimat/ e çdo pikë vere/ e çdo pike gjaku?*. Figura poetike e verës dhe e vreshtës, që aq shpesh poeti i përmend në këtë poezi, reflektojnë kuptime më të thella se sa duken. Vargu: *Të ushqyer nga e njëjta vreshtë*, si duket, është dashuria e shqiptarëve për gjuhën dhe kombin, kudo që ndodhet, ndërsa me vargjet: *Kush lëvroi vreshtën e dinte/ se punonte për miqësi/ për frymëzimin e poetëve*, poeti na përkujton vargjet e Naimit, Omar Khajamit dhe të shumëpoetëve tjerë, që vargjet e tyre poetike i stërpikën me këtë ujë të bekuar. Poezia e radhës, që gjithashtu ia kushtoi qytetit rrëzë maleve të Sharrit ëshë ajo me titullin "Tetova". Edhe kur i këndon këtij qyteti, bukurisë magjike, me kurorën e maleve mbi kokë dhe me rrafshin e Pollogut nënë këmbë, ai mendon edhe për Horën e tij, të ngjashme, me fusha, male e dete, prandaj edhe do shprehej:

*Duket sikurse ia vutë ju mbi kokë
këtë kurorë kodra malesh kësaj nuse Tetovë si duket se ia vumë ne mbi
kokë atë rreth malesh kurorë atyre katundeveandidherash.*

(Tetova)

Poeti, si në shumë vendbanime tjera shqiptare, edhe në Tetovë e gjen burimin e frymëzimit poetik, magjinë e vargut të vet, me gjithë fuqinë e lirizmit të theksuar me spjegim të figurshëm. Ai në këto mjedise ndjehet si në vendlindjen e vet: *Kudo shkeli këtë truall/ ndiej njerëzi të mirë/ njerëzore duke qenë trevat tona*. Pozita gjeografike, e Tetovës, ambienti i ngrohtë vëllazëror, gjuha dhe çdo gjë tjetër shqiptare, ngjasojnë me token arbëreshe: *Prandaj këto lartësi toke më janë të njohura/ andej detit përkëtej detit*. Edhe në poezinë "Ngrejmë dolli", sërish në mjedisëe tetovare, mes miqsh duke ngritur dolli për djalërinë tani, e pleqërinë nesër. Këta momente për poetin janë të një rëndësie historike, pranaj nuk do që të ikin shpejt: *E megjithse ne kërkojmë/ të lidhim me pranga këta minuta/ të bashkimit të rrallënga treva/ të ndryshme të ngjashme/ ata rendin drejt së shkuarës*. Dhe sërish dolli, për takimin dhe momentet, që kushedi nëse do përsëriten. Edhe në këtë rast me "shishen komunitet", poeti e metaforizon kënaqësinë e takimit dhe dehjen jo nga alkooli, por nga dashuria e çmallja mes shqiptarësh, që të tjerët i kishin ndarë e përçarë. Poeti, i vetëdëshëm për ndarjen e nesërme, dhe shijen e hidhur të ndarjeve, dëshiron që ta shijojë të sotmen me këngën arbëreshe dhe shijen e verës tetovare.

*...por gatuajmë me shpirtin e hollë të verës tetovare këngët arbëreshe
përzierje gëzimi të mbledhjes përzierje ankthi të ndarjes
që në sipërfaqe nuk duketpor është shija që mbetet e hidhët.
(Ngrejmë dolli)*

Poezia e radhës e këtij cikli për Tetovën dhe qëndrimin e poetit në këtë qytet është ajo me titull "Poeti i Tetovës", që ia kushton poetit Shaip, Emurllahut, drejtorit të Festivalit tradicional "Ditët e Naimit", që mbahet në Këtë qytet. Poeti Zef di Maxho, si pjesëmarrës i kësaj ngjarjeje kulturore-poetike, që çdo vit mbledh poetë nga të gjitha anët e botës letrare, ndjehet shumë i emocionuar para shtatores së poetit tonë kombëtar, Naim Frashërit, që qëndron krenar në parkun e Qendrës për kulturë, pranë sheshit të qytetit, aty ku e pret drejtori i këtij manifestimi, Shaipi. Zefi si poet i kërkimeve të gjurmëve të kulturës shqiptare, gjatë qëndrimit në këto mjedise, i rrethuar me miq poetë, ndjehet tepër i privilegjuar dhe me fat, që si përfaqësues i poetëve arbëreshë gjendet në qytetin e poezisë. Ashtu si zakonisht për kësaj takimesh, e veçmas në këto ku jehon zëri i poezisë, sërish kupat e tejdukshme ngjyrë flamuri, ku pihet: *për shëndëtin e Arbërit/ që ngaherë bashkohet ku ne jemi/ eme ne ndodhet dhe ecën*.

Zef Skio di Maxho e shpreh me vargje qëndrimin e vet për çështje fetare, edhe kur gjendet në Tetovë. Besimin islam e trajton përmes vargjeve poetike, madje edhe muezinin me "zërin e shenjtë" të ezanit në kufurin kohor ku ndahet nata me ditën, e quan poet. Për poetin arbëresh, të një mjedisi, ku nuk dëgjohet thirrja për namaz, madje edhe kur e

pranon realitetin historik se shkak për largim nga trojet e të parëve, përveç tjerash, ishte edhe çështja fetare, zërin e muezinit nuk e konsideron si diçka që e pengon, përkundrazi, në një mjedis shqiptar, siç është Tetova edhe këtë thirrje mëngjesore e konsideron si poezi, sepse i këndon Zotit të paanshëm:

*Çudi arbëreshe
të ikur-si thuhet-për fenë.E dëgjove në mëngjes?
Po.
Si të pyesësh të frynëzoi
Zoti i paanshëm?
(Poezi në Tetovë)*

Tetovën mikpritëse, të qeshur, me sytë si rubini në gotë e zjarr dashurie që ndez zemra, poeti do e ketë gjithmonë në zemër me mesazhet që ngazëllojnë. Kjo lidhje me Tetovën dhe bukën e saj për poetin janë gazi i bukur, që do jetojë gjithmonë: *Buka e tokës tetovare/ vera e tokës tetovare/ festojnë dasma* (Tetova ime di të qeshë).

Edhe Struga, ky qytet i bukur buzë liqenit të Ohrit, i ndarë m'dysh nga Drini i Zi, e bëri për vete poetin Zef di Maxho, e frymëzoi dhe e nxiti atë t'i shkruajë poezitë "Strugës" dhe "Sallata e Nuses". Në poezinë e parë ai e përshkruan bukurinë e këtij qyteti, madje duke e quajtur edhe nuse, metaforë e bukurisë, me të cilën do edhe të martohet: *Unë të martoja moj nuse Strugë/ që sensual më prite me pamjet e tua*. Në vargjet në vijim, ai vazhdon me përshkrimin e kësaj bukurie të rrallë, duke e përshkruar profilin e trupin të saj, "mbështjellë nga mëndafshi i qiellit dhe ujit". Ai shpreh kënaqësinë që gjendet brenda kësaj mrekullie, prandaj dëshiron që ta mbështesë kokën midis kodrave përreth, ndërsa flokët t'ia lëmojnë ujërat e kristaltë. Lidhja e poetit me Strugën është e fuqishme madje me rrënjë historike: *... ndej lidhur zemrën time retmike/ me ritmin e zemrës sate përvëluese/ nga ajo e vjetër dashuri arbëreshë*. Poezia "Sallata e nuses"⁶ është frymëzim momenti, i poetit, kur objekt trajtimi artistik e bën

⁶ Pas përfundimit të Simpoziumit për gjuhën dhe letërsinë arbëreshe, të mbajtur në auditorët e Universitetit të Evropës Jiglindore, në Tetovë, më datë 30 prill 2008, me mysafirët arbëreshë, në mesin e të cilëve i pranishëm ishte edhe poeti Zef Skiro Di Maxho, organizuam një shëtitje në Ohër e Strugë. Pas vizitës që u bëmë këtyre dy qyteteve buzë Liqenit të Ohrit, u ndalëm për drekë në Restoranin "Aquarius", në Strugë, që atë kohë e menaxhonte kolegu im, pedagogu Agim Poshka. Pasi e bëmë porosinë, fillimisht kamrieri na solli nga një gotë raki rrushi, të shoqëruar me një sallatë perimesh të freskëta, të kombinuar me domate, qepë djath e marullë jeshile. Ishte një përzierje ngjyrërash, që Zefi e pëlqeu, më tepër për bukurinë se ndoshta për shijen që ende nuk e kishim provuar. Me këtë rast, iu drejtova poetit, nëse mund ta shkruajë një poezi për këtë sallatë, që e zbukuroi tavolinën. Zefi në atë moment e nxori lapsin, i kërkoi kamrierit një fletë të bardhë dhe pasi priti pak t'i kujtohejtitulli, në pjesën e epërme të kësaj letre shkruajti " Sallata e nuses". Duke e ditur se si lindi kjo poezi, u ngazëlleva, kur në përmbledhjen poetike me titull

sallatën, një gatim të zakonshëm, që nxiti emocione, nga të cilat lindi kjo poezi. Ashtu si në shumë raste tjera të frymëzimit të fuqishëm poetik, edhe përmes këtyre vargjeve, kushtuar sallatës, që duket se nuk paraqesin ndonjë lidhje kuptimore mes veti, poeti vjen te qëllimi, që është portretii nuses, me tërë bukurinë e saj dhe të ngjyrave të veshjes së nusërisë, që poeti i gjen në kaltërsisë e liqenit e qiellit, në të kuqtë e trëndafilin dhe në të gjelbrën e barit të mëngjesit me vesë. Figura e nuses me tërë shkëlqimin dhe buzëqeshjen, di të falë vetëm dashuri: *...Nuse e kuqe/ si fjalë e dalë/ nga ferri i buzëve/ që mot e monë shpirtin tim djeg*. Nga kjo poezi, që lindi nga sallata me ngjyra perimesh, poeti ndërton vargje që reflektojnë përpëlajtje erotike: *...unë të them/ se cilat mollëza/ që do të ha/ sapo ti mbyll/ bebzat prani/ Fillon të kaltërit/ fërtele qielli/ në përpëlajtje/ urim parajse*. Vallja si veprim dhe nusja, si personazhe lirike, ndërlidhen mirë mes veti, duke prodhuar metaforën e të bukurës dhe të jetës së një familjeje të re. Siç kuptojmë nga këto vargje, poeti është mjeshtër në harmonizimin dhe ndërlidhjen e pjesëve me të vogla në tërësi më të mëdha, që do të thotë se nga ngjyrat e sallatës, krijon një tërësi kuptimore që mbaron me ndjeja mbytëse të dashurisë. Edhe pas këtyre vargjeve që spikasin dashuri, sërish e kuqja e verës në shishen e komunitetit, metafora e dehjes nga dashuria mes vëllezërish: *Bekon e kuqja/ që tani u mbyll/ aty në shishen/ - komunitet/ që na mbush venat/ kur flij'dhurohet/ e na lidh neve/ hardhi të shenjta*.

Gjatë vizitave që Zef Skiro di Maxho i bënte Maqedonisë, gjithsesi të parin qytet që e vizitonte, ishte kryeqyteti, Shkupi, ky vendbanim i lashtë me histori të njohur, së pari si kryeqendër e Dardanisë, kryeqendër e Vilajetit të Kosovës e së fundi edhe kryeqytet i shtetit të Maqedonisë, tani Maqedonia e Veriut, ku jetojnë numër i madh shqiptarësh, dhe politikanësh shqiptarë, që veprojnë në institucionet shtetërore bashkë me ata maqedonas dhe të tjerë. Poeti nga të gjitha përmendoret e ngritura në qendrën e këtij qyteti, zgjodhi vetëm dy monumente, për t'i bërë pjesë të vargut poetik, përmendoren e Skënderbeut dhe ate të Lekës së Madh, që e quan me emrin Lishëndri. Poeti tërë historinë e këtij qyteti e paraqet përmes dhjetë vargjeve të poezisë “Në Shkup”. Përmendorja e parë që i bëri përshtypje, madje që i fali edhe emocione të fuqishme, ishte shtatorja e Skënderbeut, hypur në kalë, e vendosur pikërisht në sheshin me të njëjtin emër. Përmes kalit të tij, që: *... ngre/ dhe ul natyrshëm/ putrat përpara e të prapme*, ai e paraqet edhe madhësitinë e kryeheroit të kombit, që qëndron ashtu krenar e me dinjitet. Në vend të përmendores tjetër gjigante në sheshin qendror të Shkupit, asaj të Aleksandrit të Madh, që maqedonasit e sotëm e konsideronin të tyrin, ndërsa Greqia e kontestonte, poeti e lartëson

“Trimdita”, që ma dërgoi poeti nga Italia, e gjeta poezinë me emrin e nuses, që ndoshta nuk do shkruhej asnjehere, nëse nuk do insistoja unë. Kështu lindi “Sallata e nuses”.

bustin e tij, të vendosur në hollin kryesor të Aeroportit të Shkupit, ndoshta pse atë e pa të parin, pasi ka zbritur nga aeroplani. Sidoqoftë, nga shumë përmendoret në pjesën qendrore të këtij qyteti, të parapara me projektin “Shkupi 2014”, pjesë e përmbledhjes së tij poetike “Trimdita” u bënë vetëm Skënderbeu dhe Leka i Madh, për të cilin flasin vargjet: *Lishëndri i Madh për turistët/ rimerr trupin/ e kokës madhështore n’aeropart*. Siç shihet, ai me “kokën madhështore”, të vendosur

në aeroport, që sipas tij, duhet ta marrë trupin, ndoshta fjalën e ka për trupin, bashkë me kalin, të vendosur në sheshin kryesor të Skupit.⁷

Përveç Tetovës, që si vendbanin me shumicë shqiptare u bë pjesë e shtatë poezive të ciklit “Vjersha të verëshme dhe vëllazërie” dhe Shkupit, të përfaqësuar vetëm me një poezi të kësaj përmbledhjeje, ishte edhe qyteti bregdetar i Malit të Zi, Ulqini, të cilit, poeti i kushtoi gjashtë poezi, të përfshira në cikëlin e posaçëm “Anija ime Ulqin”. Ky vendbanim i vjetër shqiptar, i shtrirë buzë Detit Adriatik në Mal të Zi dhe me histori të njohur, jorastësisht u bë burim frymëzimi për poetin Zef Skiro Di Maxho i cili për detin, anijet dhe udhëtimet nëpër detë shkruajti edhe në shumë vepra tjera poetike. Kur ai shkruan për detin dhe Ulqinin e ka parasysh edhe shkëputjen e padrejtë nga shteti amë, prandaj udhëtimin me anije drejt Ulqinit e preferon më tepër, nga se nuk ka ndonjë pikë kufitare mes rrugës. Në poezinë, me të njëjtin titull me atë të këtij cikli, ai e përshkruan bukurinë e qytetit, bashkë me banorët bregdetarë, e sidomos pamjen e vajzave, disa nga të cilat me minifunda, por disa edhe tëmbuluara me vel. Këtë laramani të veshjes e krahason me “grumbuj rruzullakë yjesh. Ndarjen me kufij, të Ulqinit me Shkodrën dhe jo vetëm, poeti e konsideron si absurd, prandaj e shtron namën: I mallkuar qoftë, kush shpiku kufijët/ ...E humb durimin/ dhe e marr me Evropën që nuk nxitohet/ a më keq e marr me dy popuj/ deri dje vëllezër e sot me nje kufi në mes ku/duhet vula: pesë orë e më pritjeje të kalosh/ një të nëmur

kufi...(Anija ime Ulqi).

Krahasimi i peshkatarëve me poetët, është një krahasim i veçantë dhe shumë domethënës i Zefit, mbase, ashtu si peshkatari me llambën në ballë, pët ta gjetur peshkun në terrin e natës, edhe poetët nuk e kane lehtë ta gjejnë fjalën poetike, që do prodhonte shumëkuptimësi nëntekstuale:

⁷ Me projektin “Shkupi 2014”, autoritetet shtetërore të Maqedonisë së kohës, përveç ndryshimit të fasadave të shumë institucioneve me stilin barrok, të qytetit të Shkupit, që këtë shtet ta identifikojnë me Maqedoninë antike, me personalitetet e njohura: Filipi Dytë dhe Leka Madh i emërtuan disa objekte sportive e infrastrukture të këtij shteti. Me emrin Filipi i Dytë u emërtua Stadiumi i qytetit, në Shkup, ndërsa me emrin e Aleksandrit të Maqedonisë, u emërtuan Aeroporti i Shkupit dhe autostrada e korridorit të dhjetë. Me insistimin e Greqisë, që ky shtet të heq dorë nga emrat e këtyre personaliteteve, si kusht për t’u bërë anëtare e barabartë e NATOS, Maqedonia i ndërroi këta emra, madje e fshiu edhe emrin e shtatores së Lekës së Madh në qendër të Shkupit.

Llambara është Ulqini/ që natën thërret detin/ sytë u zbyll poetëve/ që peshkojnë poezi.(Llambara është Ulqini). Lidhjen e poetëve më këtë perlë shqiptare e gjejmë edhe në poezinë “Me shtëpitë e larta”, ku poeti e përshkruan bukurinë e shtëpive kulla, brenda mureve të kalasë së vjetër, që flet sa vet historia. Këtë qytet, që detin e sheh si në shuplakë të dorës, poeti e konsideron, si vend të poezisëdhe detarëve, hapësirë e kërkimit të frymëzimit poetik dhe e peshkatarëve, që lundrojnë mes dy kaltërsive në kërkim të gjahut të tye:

*Brenda sëndukut det poezitë e mbyllura në pritje:mjafton me radhë
në peshkim të zhytesh
e t'i hapësh
me një kyç vargu fillestar.
Të vjetër detarë poetët dukenqë lundruar kanë
përgjatë vjershavetë kohëve të gjitha.
(Me shtëpitë e larta)*

Pozita gjeografike buzë deti dhe lulet e plasave shkëmbore me aromë parfumi, këtij qyteti i shtojnë edhe më tepër bukurinë. Ai si gjithmonë, ashtu krenarë për historinë e vet, qëndron i palëkundshëm në përballje me erërat dhe stuhitë detare: *Ulqini është qytezë që nuk druan/ as erërat as detin./Edhe ne/ andidetesh/ andidherash* (Lulja ulqinake). Ky det me ngjyrë blu, e i zbukuruar me kordele shkëmbinjsh, që krijojnë laramani ngjyrërash, dhe shtëpitë e vjetra me të kuqen shqiptare e karakterizojnë këtë vend parajsë, por një gjë e shqetëson poetin tonë, blerja e tokës shqiptare nga rusët e pasur, dhe ndërtimi i vilave në këto prona, që na përkujton vargjet e poemës së tij, “Bulku” dhe namët, që ua drejton pemëve, që mos të bëjnë asnjë kokërr fryti, pasi i kishte blerë bujku lëtit.⁸ Vizitën e poetit, që i bëri këtij qyteti të lashtë shqiptar, me rastin e e një takimi poetik dhe kënaqësinë për pamjet e mrekullueshme ulqinake, sikur e vrau shpirtërisht fenomeni i depërtimit të familjeve ruse në tokat shqiptare:

*Në barkën e mbushur me poetë që Kalimerja sivjet mbledh dikush më pëshpërit
në brambullimën e motorit:
“toka shqiptare të huajve nuk u shitet.”
Fjalë ngjyrë
E kuqe shqiptare.
(Det i Ulqinit)*

⁸ Për më tepër, lexo te Vebi Bexheti, “Dy poemat e Di Maxhos, Mes profilit të epikës tradicionale dhe atij të modernitetit”, f.47, botuar në librin Studime arbëreshe, Tetovë 2002.

Gushti si muaji i bredhjeve të poetit dhe i frymëzimit të tij poetik, që i ngjallte emocione dhe nxitje për ta shprehur lirizmin e fuqishëm përmes vargut, i tillë ishte edhe në këtë vizitë Ulqinit. Ky ishte muaji, që më së shumti e zbukuronte këtë qytet, prandaj poetit as që i interesonte se si do dukej kjo parajsë gushtore në dhjetor apo shkurt: *Ky është gushti ulqinak,/ flamuri çdo gjëje plotjetë/ dhe vdekja është larg/ dhe s'ma ka ënda të di/ për dhjetorin tënd o për tëndin shkurt* (Ky është gushti ulqinak).

Përmbledhja poetike dygjuhëshe mbyllet me poezinë **Kazallot**, që njëherit është edhe cikël në vete, e që nuk ka të bëjë me Ulqinin. Këtë emërtim të vjetër të Horës së Arbëreshëve, poeti e bëri titull të poezisë, i frymëzuar nga historia e vjetër, e kohës kur edhe të parët e tij u vendosën në këtë vend, para se të quhet me emrin e ri. Sidoqoftë, edhe pse poezia trajton një temë krejtësisht tjetër, të frymëzuar nga një zarfë me librat e dërguara nga poeti i madh, e miku i tij, Ali Podrimja, por ajo që e gëzoi më tepër, e që i la përshtypje të veçantë, ishte emërtimi i plotë i Kosovës: ... *Por/ nën adresën e tij për të parën herë/ me natyrshmëri shoh shkruar/ REPUBLIKA E KOSOVES. Hare/ krejt normale thua?*

Siç shihet, poezia e poetit Zef Skiro di Maxhos për nga shtrirja hapësinore e frymëzimit poetik, përveç krahinave arbëreshe, Shqipërisë dhe Kosovës, përfshin edhe vendbanime shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi. Interesimi i poetit, që në vargjet e tij, t'i përfshijë edhe këto hapësira, e dëshmon edhe njëherë se Zef Skiri di Maxho është poet, që frymëzimin e gjen gjithandej, ku jetojnë shqiptarët. Me rreth 20 përmbledhje poetike, një pjesë nga të cilat dygjuhësore, arbërisht/shqip dhe italisht, me tema nga më të ndryshmet, me 20 vepra dramatike, shumë libra me poezi të zgjedhura, të botuara ndër arbëreshë, Shqipëri dhe Kosovë, në brendinë të cilave më tepër spikat brenga për fatin e arbëreshëve, që nga ngulmimet e para të tyre në Italinë jugore e deri më sot, poeti Zef Skiro di Maxho u ngrit në majat e letërsisë së sotme arbëreshe dhe si një ndër më të suksesshmit e poezisë mbarëkombëtare.

Abstrakt

Në këtë studim do të merremi me krijimtarinë e një nga poetët dhe dramaturgët më të mirë arbëresh sot, z. Zef Skiro di Maxho. Si në gjithë shtrirjen e krijimtarisë së tij, ashtu edhe në përmbledhjen poetike dygjuhësore **Trimdita (2009)** në qendër të interesimit i kishte arbëreshët, madje, që nga koha e ngulmimeve në jugun e Italisë, mënyrën e jetesës në kushte të reja dhe mbijetesën, e deri në ditët e sotme, që në mënyrë metaforike poeti e krahason me zhvillimet brenda një dite, nga mëngjesi, deri në mbrëmje, që i përgjigjet edhe vetë titulli. Ky libër lirikash dygjuhësore shqip- italisht, përbëhet nga këto cikle poezish: “Trimdita”, “Me të vërtet Morea”, “Vjersha të verëshme dhe vëllazërie”, “Anije me Ulqin” dhe “Kazallot”. Në poezitë e kësaj përmbledhjeje, si duket, poeti ndërton një model ndryshe, krijues, me tendencë të një mbylljeje, por pa e dëmtuar

idenë dhemesazhin e vargut të tij, drejtuar arbëreshëve dhe shqiptarëve në përgjithësi, ku nuk mungojnë edhe poezi me tema universale.

Abstract

In this study, we will deal with the creativity of one of the best Arbëresh poets and playwrights today, Mr. Zef Skiro Di Maxho. Both in the entire scope of his creativity, as well as in the bilingual poetic collection Trimdita (2009), the Arbëresh were at the center of his interest, even from the time of his settlement in southern Italy, their way of life in new conditions and survival, and until today, which the poet metaphorically compares with the developments within a day, from morning to evening, which the title itself corresponds to. This bilingual Albanian-Italian lyric book consists of the following poetry cycles: "Me të vërtet Morea", "Vjersha të verëshme dhe vëllazërie", "Anije me Ulqin" and "Kazallot". In the poems of this collection, it seems that the poet builds a different, creative model, with a tendency towards closure, but without damaging the idea and message of his verse, addressed to the Arbëresh and Albanians in general, where there is no shortage of poems with universal themes.

LITERATURA

Zef Skiro Di Maxho, Poema Arbëreshe- Poemi Arberischi Poema arbëreshe, Tiranë, 2018.

Zef Skiro Di Maxho, Sunata – Sonata-Settino torinese, Torino, 1976.

Zef Skiro Di Maxho, Kopica e Ndryshku-La tignola e la ruggine, Palermo, 1981.

Zef Skiro Di Maxho, Përtej maleve prapa kodrës, zgjedhur dhe përgatitur nga Nasho Jorgaqi, "Naim Frashëri" Tiranë 1985.

Zef Skiro Di Maxho, Mas Rushi, Palermo, 1981.

Zef Skiro Di Maxho, Vjeç të tua 500 - Anni tuoi-Mas Rushi Arbëresh-Mastro Gio italo, Palermo, 1988.

Zef Skiro Di Maxho, Kopshti im me dritare-L'oreto e le finestre-Ed Mondo Albaneze, 1995.

Zef Skiro Di Maxho, Kosova lule (vjersha) - Fiore Kosovo-(poesie)Ed. Mondo Albanese, 1991.

Zef Skiro Di Maxho, Anije me vela e me motor-Navi a vela amatore- Mondo Albaneze, 1992.

Zef Skiro Di Maxho, Canzoniere arbëresh (Sonete dygjuhësh), Hora e Arbëreshëve, 1999.

Zef Skiro Di Maxho, Gjeometri dhe ikje-Sonete dygjuhësh, Hora e Arbëreshëve-Piana degli Albanesi, 1998.

Zef Skiro Di Maxho, Metaforë-Metafora-ristampa arbërisht-versi bilingui.Perifazione di Matteo Mandala-Salvatore Sciascia Editore, Caltanissetta, 2005.

- Zef Skiro Di Maxho**, Trimdita (Poezi dygjuhësh) Giorneroe (poesia bilingue), Palermo, 2009.
- Zef Skiro Di Maxho**, Laerti, i jati (poezi)- il padre-Ed. (poezi),- Mondo albaneze, 1989.
- Zef Skiro Di Maxho**, Poezi gushtore e tjera, ASS.CULT Mondo Albanese, Piana degli Albanesi, Palermo, 1994.
- Zef Skiro Di Maxho**, Poezi Dashurie në Kohë Vdekjeje (Kosova Dëshmore Tremujori i dytë –Poessie d’Amore in Tempo di Morte (Kosova Martire Sekondo Trimestre ’99-Testi bilingui - Prefazione di Matteo Mandala Salvatore Sciascia Ed Calttanisseta, 2000.
- Zef Skiro Di Maxho**, Përtej maleve, prapa Kodrës, Vjersha,Tiranë, 1985.
- Zef Skiro Di Maxho**, Atje kam (vjersha dygjuhësh) –La mia Morea (versi bilingui)-Prefazione di Matteo Mndala, (përrkthyer në shqip nga Zef Skiro Di Maxho) Tipgrafia Lusografica di Caltanissetta Hora e Arbëreshëve, 2004.
- Françeshko Alimari**, Vëzhgime gjuhësore dhe letrare, Prishtinë,2002.
- Gjuha dhe letërsia e arbëreshëve** (Simpoziumi Ndërkombëtar për Arbëreshët), Tetovë, 2011.
- Anton Nikë Berisha**, Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, Kozencë, 2008.
- Contium**-Revistë e studimeve arbëreshe, Tiranë, 2021.
- Nasho Jorgaqi**, Antologji e poezisë bashkëkohore arbëreshe,Tiranë, 2001.
- Rexhep Ismajli**, Gjuha e bukës, përmbledhje me poezi të zgjedhura të zef Skiro Di Maxhos, Parathënia, Pishtinë, 1981.
- Sadik Bjko**, Përtej një apokalipsi. Mbi poezinë e sotme arbereshe 1946-1984, Tiranë, 1999.
- Mustafa Ibrahim**, Në Kalabri me arbëreshët, Shkup, 2021.
- Emin Kabashi**, Hapësira evropiane e letërsisë shqipe të arbëreshëve të Italisë, botuar në librin “Gjuha dhe letësia e arbëreshëve”. Tetovë, 2011.
- Ali Aliu**, Don Kishoti shqiptar, Tiranë, 2007.
- Ali Aliu**, Ontologji e poezisë shqipe (Gjysëmshkulli i artë),Tetovë, 2000.
- Luan Tpçiu**, Udhëtimi në universin poetik, parathënia e librit “Poema Aebëreshe”, të Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Gianifranco Romagnoli**, parathënia e librit “Poema arbëreshe”, të Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Giuseppe Schiro Di Maggio**, Poezi Dashurie në Kohë Vdekjeje (Kosova Dëshmore Tremujori i Dytë)- Poesie d’Amore in Tempo di Morte (Kosova Martire Secondi Trimestre), Caltanissetta-Romë, 2000.
- Andrëa Varfi**, Duke folur për krijimtarinë poetike të Xhuzepe di Maxhos, fjala e tij në përrurimin e librit “Përtej maleve prapa kodrës, Tiranë, 1985.
- Andrea Varfi**, Tradita dhe poezia e sotme arbëreshe, revista “Nëntori” 3, 1983.
- Visar Zhiti**, Një poet i ri 500 vjeçar, parathënia e librit “Poema arbëreshe”e Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Ahmet Selmani**, Poezia e shprishur, Shkup, 2011. **Vebi Bexheti**, Studime arbëreshe, Tetovë, 2020.

Punim studimor

Xhemaludin IDRIZI

Universiteti i Evropës Juglindore

xhemaludin@yahoo.com**AUTORËT ARBËRESH NË TEKSTET SHKOLLORE TË GJUHËS SHQIPE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT****ARBËRESH AUTHORS IN ALBANIAN LANGUAGE SCHOOL TEXTS IN THE
REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA**

Letërsia që lindi dhe u zhvillua në trojet arbëreshe të Italisë nuk mbeti pa u përfshirë edhe në tekstet shkollore – librat e leximit të gjuhës shqipe të shkollave fillore dhe librat për gjuhë shqipe dhe letërsi për shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë. Letërsia arbëreshe do të luajë rolin e vet në emancipimin arsimor, kulturor, moral, gjuhësor të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Zgjedhja e krijimeve letrare dhe vendosja e tyre në librat e leximit në periudha të ndryshme kohore do të jetë një formë e veçantë e ushqimit letrar të filloristëve shqiptarë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërkaq, me programet mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollat e mesme parashihet të realizohen poetë të dalluar të letërsisë arbëreshe. Në periudha të ndryshme kohore programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë kanë pësuar ndryshime të shumta, ndërsa shkrimtarë të dalluar të letërsisë arbëreshe janë përfshirë në vtin e parë ose në të dytin të arsimit gjimnazor e të mesëm. Ky fakt flet qartë se nxënësit shqiptarë të Republikës së Maqedonisë kanë mësuar dhe lexuar krijimet letrare të shkrimtarëve arbëreshë, madje më shumë se sa vetë nxënësit arbëreshë të Italisë së Jugut. Ndoshta nuk do jetë e tepërt të theksohet konstatimi i Rexhep Zllatkut në librin e tij “Me arbëreshët”, (Shkupi – 1996) : *“Në këto kushte arbëreshët që gjithnjë e më pak e njihnin historinë e kulturën e tyre, erdhën deri në atë shkallë (përfshirë nuk janë aq të rëndësishme) sa kujtonin se s’kanë kurrfarë kulture. Dhe sot veprën e figurës së madhe të De Radës fëmijët tanë e njohin shumë më mirë se fëmijët e shqiptarëve të Italisë. Madje, për fat të keq, De Radën dhe Arbëreshët e tjerë të dalluar, me përjashtim të banorëve të vendlindjes dhe të fshatrave të afërta, i njohin vetëm njerëzit e informuar mirë për të kaluarën e arbëreshëve”. (faqe 21).*

2. Përfshirja e teksteve nga letërsia arbëreshe në librat e leximit të shkollës fillore (V-VIII)

Librat shkollorë (librat e leximit dhe të gjuhës shqipe dhe letërsisë) kanë një vend me rëndësi në procesin e mësimin dhe edukimit. Ato i hedhin themelet e një edukimi të mirëfilltë letrar e gjuhësor të fëmijëve shkollorë (nxënësit fitojnë dituri nga gjuha shqipe – në fonetikë, leksikologji, fjalëformim, gramatikë e drejtshkrim).

Në tekstin shkollor **Liximi letrar për klasën VIII**, botuar në vitin 1975 nga Prosvetno dello, Shkup, autor Dr. Ali Aliu, janë përfshirë dy tekste nga poetët e dalluar arbëreshë të letërsisë romantike, nga Jeronim de Rada poezia **“Mëngjes në fshat”** (faqe 44), **kënga e parë nga Poema “Këngët e Milosaos”** dhe teksti **“Parathënie të arbëreshëve”** (faqe 67) nga **Gavril Dara i Ri**. Autori i librit i lë hapësirë vetë arsimtarit të zgjedhë vlerat e këngës për interpretim letrar e gjuhësor. Në fund të këngës autori i tekstit ka përzgjedhur fragmente vlerësimi të **Razi Brahimit** dhe të **Ismail Kadaresë**, ku theksohen **motivet e shumta lirike: intime, atdhetare, shoqërore e filozofike**. Në tekstin **“Parathënie të arbëreshëve”** të Gavril Darës jepen të dhëna mbi shpërnguljen e arbëreshëve nga Arbëria dhe themelimin e Palac Adrianos në vitin 1482, ruajtjen e kujtimit dhe mallit për atdheun e humbur, përcjelljen e historisë brez pas brezi, luftërat e ndershme të kohës së Skenderbeut, përçarjen e shqiptarëve pas vdekjes së Skenderbeut dhe në fund mbi bashkimin e shqiptarëve të konfesioneve të ndryshme duke menduar se janë vetëm arbëreshë.

Në tekstin shkollor **Liximi letrar 6** (libër leximi për kl.VI) autor Xhemaludin Idrizi (Alb-bas Tetovë, 2001) haset vetëm teksti **“Këngë për vdekjen e Skenderbeut”** nga Jeronim de Rada. *Në krye të teskit jepet shënimi: “ Kjo pjesë është marrë nga libri “Vepra të zgjedhura” të shkrimtarit arbëresh Jeronim de Rada , i cili është përfaqësues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.”* Teksti ka një aparaturë të veçantë metodiko-didaktike si: kuptojmë tekstin; vlerësojmë dhe interpretojmë tekstin, studiojmë gjuhën e tekstit dhe në fund parashtrohet detyra : “përpikuni të shkruani një fragment të kësaj pjese në formën e një poezie (me varg të lirë). Shmangni disa fjalë të tepërta.”

P.sh. Cila erë do ta rrëmbejë këtë trup

Oh sa orë hareje, shpresoi ai,

Edhe s’pati kurrë!

Në tekstin shkollor **Libër leximi për kl. VI**, autorë Zihni Osmani dhe Islam Karanfli ,Logos –A, Shkup 2001, janë përfshirë autorët Zef Serembe me poezinë **“Vrull”** (f. 80-81) dhe Jeronim de Rada me poezinë **“Luleve që valvit era”** nga Këngët e Milosaos. Këtu jepet ideja për poezinë patriotike (Vrull) dhe biografi të shkurtëra me veprat kryesore të autorëve (Zef Serembes dhe Jeronim de Radës).

Në tekstin shkollor **Libër leximi për kl.VII**, autorë Resul Bekteshi dhe Tahir Hoda, Logos –A 2002, nëpërmjet poezive **“ Më të bukurës që**

është në Strigar” të Zef Serembes dhe **“Këngët e Milosaos” (kënga e parë)** të Jeronim de Radës autorët sjellin të dhëna elementare për letërsinë arbëreshe . Përmenden De Rada, Gavril Dara i Ri dhe Zef Serembe , ndërsa për Sicilinë dhe Kalabrinë thuhet se janë dy koloni më të banuara me arbëreshë.

Në tekstin shkollor ***Gjuhë shqipe dhe letërsi për kl. VII*** të autorëve Mahmud Hysa dhe Xhemaludin Idrizi, Prosvetno dello, Shkup, 2002, janë përfshirë tre autorë të letërsisë arbëreshe, Jeronim de Rada me fragmentin poetik **“Kënga I”** nga poema liriko-epike “Këngët e Milosaos” (faqe 217), Gavril Dara i Ri me tekstin prozaik **“Parathënie të arbëreshëve”** (faqe 160) dhe Zef Serembe me poezinë **“Miqësia”** (faqe 151). Në fillim të këngës I të “Këngëve të Milosaos” jepet ky sqarim: “ Kjo këngë është marrë nga poema “Këngët e Milosaos” të Jeronim de Radës . Poema është botuar në vitin 1836. Me këtë poemë Jeronim de Rada hap një faqe të re në letërsinë shqiptare të kohës”. Mandej jepet një biografi e shkurtër e De Radës dhe veprat kryesore të tij.

Me poezinë **“Miqësia” të Zef Serembes** nxënësit kanë mundësi të ndjejnë mallin e flaktë të arbëreshëve për atdheun e tyre të parë. Për poetin, Zef Serembe, autorët japin një fragment biografik dhe veprat e tij kryesore. Ndërkaq , për Gavril Darën e Ri japin një biografi të shkurtër dhe titullin e veprës kryesore të tij **“Kënka e sprasme e Balës”**. Nga ky tekst nxënësit mësojnë se shqiptarët në periudhën e Skenderbeut e karakterizonin dashuria për nderin dhe lirinë, porosinë e autorit : Të bashkohen myslimanë e të krishterë , katolikë e ortodoksë duke menduar se janë vetëm arbëreshë!

Në tekstin shkollor ***Gjuha shqipe dhe leximi 8*** të autorëve Rita Petro, Xhemaludin Idrizi, Natasha Pepivani dhe Zeqir Kadriu, Alb-bas, Tetovë, 2003, nga letërsia arbëreshe kemi fragmentin **“Kënga e Beratit”** të Gavril Darës së Riut. Në krye të tekstit qëndron sqarimi: “ Ky fragment është shkëputur nga poema “Kënga e sprasme e Balës”, e cila temën e merr nga betejat që kanë zhvilluar shqiptarët në kohën e Skenderbeut. Nik Peta dhe Pal Golemi janë dy heronjtë kryesorë, të cilët kanë udhëhequr betejën e përgjakshme të Vajkalit, ku fituan shqiptarët, por në fushën e luftës mbetën të vrarë shumë trima”.

Në tekstin shkollor ***Libër leximi për kl. VIII*** , autorë Tahir Hoda dhe Resul Bekteshi Logos –A , 2003 ,janë përfshirë poezitë **“ Shkodra më s’quhet qytet”** të Jeronim de Radës (fragment nga poema Këngët e Milosaos) (faqe 58-59), **“Vasha e Lalës** (f.198), fragment nga poema “Kënga e sprasme e Balës” e Gavril Darës së Riut dhe poezia **“Fati”** , e Zef Serembes . Për të tre autorët jepet një biografi e shkurtër me veprat e tyre më të rëndësishme. Me poezinë e parë jepet kuptimi mbi poemën epiko-lirike, ndërsa me poezinë e tretë jepet kuptimi mbi sonetin, kërkesa këto që janë në programin e kësaj klase.

3. Përfshirja e letërsia arbëreshe në librat e gjuhës dhe letërsisë së shkollave të mesme

Në programet mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë letërsia arbëreshe në periudha të ndryshme kohore janë përfshirë disa shkrimtarë të letërsisë filobiblike arbëreshe (**Lekë Matrënga, Nikollë Keta, Nikollë Filja, Nikollë Brankati, Jul Variboba**) dhe disa shkrimtarë të letërsisë romantike arbëreshe (veçanërisht **Jeronim de Rada, Gavril Dara i Ri, Zef Serembe dhe kohëve të fundit Zef Sjiroi**). Është me rëndësi të veçantë të theksohet se deri në vitet e 70-ta si mjete ndihmëse janë shfrytëzuar tekste shkollore të botuara në Prishtinë (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë), ndërsa pas viteve 1970- '75, me marrjen përsipër botimin e teksteve shkollore nga ndërmarrja e specializuar për botimin e teksteve shkollore "Prosvetno dello"- Shkup, teksteve shkollore për gjuhë shqipe dhe letërsi për shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë do të botohen në Shkup nga ndërmarrja e lartpërmendur me autorë kryesisht nga Maqedonia.

Meqë deri në vitet e 70-75-ta nxënësit dhe mësuesit e shkollave të mesme të gjuhës shqipe dhe letërsisë në Republikën e Maqedonisë kanë shfrytëzuar tekste të botuara nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, prandaj edhe programet mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë kanë qenë të përafërta me ata të Kosovës. Teksti shkollor ***Histori e letërsisë shqipe – doracak për shkolla të mesme***, autor Dhimitër Shuteriqi, botuar nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1972, është shfrytëzuar si mjet mësimor nga nxënësit dhe mësuesit e shkollave të mesme të gjuhës shqipe dhe letërsisë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë tekst shkollor nga shkrimtarët arbëreshë janë përfshirë **Jul Variboba, Jeronim de Rada, Anton Santori, Gavril Dara i Ri dhe Zef Serembe**.

Në kapitullin **Letërsia arbëreshe e Italisë** jepet një pasqyrë e shkurtër mbi paraqitjen dhe zhvillimin e letërsisë arbëreshe, themelimin e kolegjeve – seminareve italo-arbëreshe në San Benedetto Ullano të Kalabrisë (1732) dhe në Palermo të Sicelisë (1734). Këtu përmendet si autor i parë i letërsisë arbëreshe të Italisë Nilo Katalano, mandej vijnë me radhë Nikollë Brankati (1675-1741) dhe Nikollë Filia (1691-1769), vjershëtorë që kanë përshtatur me mjaft siguri gjuhë dhe metri këngë të ndryshme fetare italiane, duke shkruar edhe ndonjë origjinale.

Për Jul Varibobën, nga ky tekst shkollor, nxënësit mund të mësojnë mbi biografinë e tij të shkurtër, arsimimin dhe veprimtarinë e tij fetare, botimin e veprës kryesore **Gjella e Shën Mërisë Virgjër** (1762), për të cilën autori thotë : "***Vepra e Varibobës është një përmbledhje vjershash e poemthash fetare që vërviten kryesisht rreth jetës së Shën Mërisë e të Krishtit. Ka të ngjarë që Variboba i shkroi në kohë të ndryshme e jo me qëllim që t'i bashkonte një ditë e të formonte me to një vepër organike.***"

Më poshtë të vazhdojë:” *Nuk po merremi me analizën e veprës. Një gjë është e vërtetë se poeti ka një talent të natyrshëm që spikat menjëherë dhe se një pjesë e vjershave të tij është e frymëzuar. Këto vjersha janë sidomos pjesët lirike, në të cilat poeti i këndon, fjala vjen, bukurisë së virgjëreshës Marë.*” Në vazhdim i bëhet një interpretim i denjë kësaj vepre, që u ndihmohet nxënësve t’i përvetësojnë vlerat themelore të saj.”⁹

Në këtë tekst shkollor , në kapitullin **Letërsia Shqipe e Rilindjes Kombëtare** përfshihen shkrimtarët **Jeronim de Rada, Anton Santori, Gavril Dara i Ri dhe Zef Serembe**. Për Jeronim de Radën autori ka dhënë një biografi më të gjerë se që jepen zakonisht në tekstet shkollore, arsimimin, pjesëmarrjen në lëvizjet progresive të kohës ,botimin e gazetës *L’Albanese d’Italia*, mbledhjen e letërsisë arbëreshe në fshatin e vendlindjes, botimin e një sërë veprash të ndryshme letrare, shkencore, folklorike, botimin e revistës *Fiamuri i Arbërit*, shkrime gjuhësore etj. **Poemës “Këngët e Milosaos”** i bëhet një analizë më e plotë, që ndihmon nxënësit ta kuptojnë dhe lexojnë veprën. Interpretimi i poemës bëhet me shembuj nga poema. Gjithashtu këtu preken edhe poemat “Këngët e Serafina Topisë” dhe “Skenderbeu i pafan”.

Anton Santori përpunohet në një mënyrë më të shkurtër. Jepen të dhëna modeste biografike për poetin, veprat e botuara -vepra e parë e tij poetike **“Këngëtorja arbëreshe”** (1839), vjersha e gjatë **“Valle e haresë së madhe”**, poema italisht **“ I burgosuri politik”**, ndërsa si vepër kryesore përmendet drama **“ Emira”**. Autori përfundon se:” *Anton Santori, me gjithë veprën e tij të gjerë, mbetet një autor akoma pak i njohur, për arsye se veprat e tij s’janë vënë mirë në dritë e s’i kemi të plota. Këto vepra janë të rrymës romantike që sundoi në letërsinë tonë të rilindjes. Prapë, aty gjejmë shfaqjen më të parë të realizmit në letërsinë tonë të re, veçanërisht te drama “Emira” ku na përshkruhet me mjaft vërtetësi jeta e fshatit.*”¹⁰

Për Gavril Darën e Ri jepet një biografi më e plotë , përmenden Gavril Dara Plaku si mbledhës i folklorit (këngët e pleqërisë) doktor në mjekësi e drejtësi, i biri i tij Ndrica (Andrea) (1796- 1872) doktor në drejtësi, mbledhës i folklorit e zakoneve arbëreshe dhe studiues i gjuhës. Nxënësit kanë mundësi të mësojnë për pjesëmarrjen e tij në lëvizjet përparimtare (në lëvizjen kombëtare italiane) për përmbysjen e Burbonëve, njëri nga udhëheqësit krahinorë të fushatës garibaldine (më 1860 Dara është anëtar i Komitetit Revolucionar të Agrixhentos, ndërsa Garibaldi e emëron si këshilltar të prefekturës së Palermos, sekretar të këtij qyteti etj.). Dara e kish ndjekur me shumë interes lëvizjen kombëtare shqiptare, në vitin 1878 e merr anën e Lidhjes së Prizrenit, ndërsa në parathënien e veprës së tij

⁹ Histori e letërsisë shqipe – doracak për shkolla të mesme, Dhimitër Shuteriqi, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë , 1972) f. 43-44-45)

¹⁰ Po aty (f. 85)

poetike “**Kënka e sprasme e Balës**” i dënon me këto fjalë fuqitë e mëdha evropiane, të cilët i morën nëpër këmbë të drejtat e popullit tonë në Berlin: “**Mbretëritë e Evropës shohin pa kujdes (në mos me përbuzje) vuajtjet e popujve të shkelur nga Turqit**”. Gavril Dara , si edhe disa patriotë të tjerë , mendonte se populli shqiptar ishte një popull i vogël, ai nuk mund të lirohej pa u mbështetur diku. Mendonte mbështetjen te greku, pa e kuptuar se si borgjezia greke e asaj kohe përpiquej ta zhdukë me një mënyrë, me një tjetër, lëvizjen tonë kombëtare e ta copëtojë Shqipërinë, duke dashur të marrë për vete tërë pjesën jugore të vendit. Nuk dimë, thotë autori i tekstit, në e kuptoi Dara më vonë atë gabim, si e kuptoi , fjala vjen ndër ne, një Thimi Mitko. Sipas autorit, dëshira e madhe e Darës për t’i ardhur në ndihmë çështjes kombëtare të popullit tonë, e shkroi “Kënkën e sprasme të Balës”, me të cilën ai la një emër të shquar në letërsinë shqipe të lëvizjes kombëtare. Në vazhdim autori përpunon poemën “**Kënka e sprasme e Balës**”, subjektin e poemës, personazhet Nik Petën, Pal Golemin e Marën, mandej personazhet historikë Skenderbeun e Baderin (Ballabanin) etj. Në fund të këtij teksti thuhet: “**Dara, si poet, e çoi më tej punën e De Radës. Vepra e tij i përket romantizmit përparimtar. Ajo ia arrin qëllimit që të rikrijojë përpara syve tona kohën heroike të Skenderbeut, të ndezë zjarrin e atdhedashurisë e urrejtjen më të madhe për turqit . Poema ka cilësi të larta artistike, veçanërisht në përshkrimin e ndjenjave të personazheve, në përshkrimin e ambienteve, të luftave, të natyrës. Dara është një krijues i rallë figurash. Ai ka një gjuhë të pasur e shumë të bukur. Poeti na jep një shembull të çmuar të mbështetjes në poezinë popullore**”.¹¹

Për Zef Seremben autori ka sajuar një tekst të kapshëm për nxënësit e kësaj moshe. Jepet biografia e autorit ,mandej lirikat e Zef Serembes me motive patriotike (**Për lirinë e Venetisë , “Elena Gjikën”**) , lirikat me motive të dashurisë (tingëllimën **“Fytyra e saj”**,, **Kënga e mallit parë**”, **“Malli”** , **“ Më të bukurës që është në Strigar”** etj), flet mbi vlerat artistike të lirikës së Serembes (përpunoi me mjeshtëri tingëllimën, elegjinë, oden) dhe se personazhet e poetit janë populli që lufton për liri, heronjtë popullorë, e dashura e tij e thjeshtë fshatare dhe se vjershat e tij janë plot me antiteza të forta, që i shërbejnë për ta treguar mjerimin e brengën e tij:

“ Zogj të bukur këndojnë me hare

po zemra do t’më plasë mua në gji.”

Si përfundim autori thekson se: “**Serembeja, me veprën e tij solli një notë të re në poezinë arbëreshe të shekullit të kaluar, duke kënduar haptazi e me forcë për lirinë e popullit tonë nga Turqia, si një njeri që kërkon edhe lirinë e popujve të tjerë.**”

Teksti shkollor **Letërsia dhe teoria e letërsisë për vitin I të shkollave të mesme** të autorëve **Dr. Mahmud Hysa dhe Xhevat Gega** , botuar nga Prosvetno dello”, Shkup, 1981 (vendimi i këshillit Republikan

¹¹ Histori e letërsisë shqipe – doracak për shkolla të mesme, Dhimitër Shuteriqi, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë , 1972

Pedagogjik nr. 03-193,të datës 20.X.1981) , si duket është edhe libri i parë i letërsisë për shkollat e mesme i lejuar nga organet kompetente arsimore të Maqedonisë . Në të përfshihet një pjesë me titullin **Dega e letërsisë arbëreshe** (faqe 188). Këtu autorët japin të dhëna mbi shpërnguljet e shqiptarëve në Itali (përmenden vitet 1468 , 1479). Në këtë pjesë jepet fragmenti , në të cilin thuhet se për gjendjen e mjerë të këtyre refugjatëve flasin më së miri kronikat e kohës: **“Nuk mund të të shohë njeriu pa derdhur lot këta refugjatë nëpër limanet e Italisë të uritur që rrinë anës së detit, e ngrenë duart në qiell, e qajnë e vajtojnë në një gjuhë që s’ua marrim dot vesh”**.Theksohet viti 1592 , botimi i veprës së parë i Lekë Matrëngës, i cili plotëson një zbrastirë në jetën e arbëreshëve dhe mendohet se e vazhdon traditën e shkrimit të shqipes të trashëguar nga vendlindja e të parëve.Këtu thuhet se:” **Poezia arbëreshe e shekullit XVIII është kryesisht fetare. Por te ata për herë të parë hasim edhe poezi patriotike, siç është p.sh. poezia “Për vetëhenë” e Nikollë Ketës, e cila i bën jehonë dashurisë për atdheun e të parëve dhe fton të ruhet gjaku i të parëve:**

*Kush arbit s’i ruan kraht’ me gjak edhe
Arbr’s’isht e gjakun e dhelpresë ka...*

Arbri qime ndërroi, zakon s’e la

Me kordhë, me tëfeq ,arbri përble

Për gjakun e tij, po gjak arbri dha. (f. 189).

Këtu theksohet edhe vepra shkencore e Nikollë Ketës **“Thesar njohtimesh mbi Maqedonasit”** (1777), në të cilën autori flet mbi të kaluarën e lashtë të maqedonasve (siç mendon se quheshin aso kohe shqiptarët). Përmendet se krijues të këtij shekulli janë Nikollë Brankati,Nikollë Filja, Gabriel Dara Plaku, Jul Variboba etj.

Për Lekë Matrëngën (është mësuar si shkrimtar i letërsisë së vjetër arbëreshe) thuhet se me veprën e tij hapet një faqe e re e letërsisë së vjetër shqiptare, ajo e degës së rëndësishme të letërsisë arbëreshe e që është e një trangu të përbashkët me atë që zhvillohet këtej Adriatikut. Nga kjo pjesë nxënësit informohen mbi biografinë e shkurtër të Lekë Matrëngës , mbi veprën e tij të përkthyer **“ E msueme e kreshterë”** , që ka rëndësi për historinë e letërsisë e për gjuhën shqipe. Potencohet qëllimi i përkthimit të kësaj vepre :” **gjithë fëmijëve arbëreshë, si atyre të Siqelisë dhe atyre të Kalabrisë, t’ua mësojë meshën në gjuhën arbëreshe, pse për ta ishte e pamundur që ta mësonin në italishten, që nuk e njihnin**”. Në vazhdim thuhet se vjersha e Matrëngës **“Këngë e përsheptshme”** është një përkthim nga italishtja , një poezi me motiv fetar, me një strofë me tetë vargje njëmbëdhjetërrokëshe, me rimë të alternuar. Gjuha e veprës së Matrëngës është pjesa më e rëndësishme e veprës , që dëshmon ekzistencën e kryedialektit toskë, si edhe afërsinë më të madhe që ka pasur në fazën e atëhershme me kryedialektin gegë. Si shembuj për lexime tekstesh jepen: **“Këngë e përsheptshme”** dhe fragmentet prozaike **“Besoj”** e **“Ati inë”** nga Lekë Matrënga; poezia **“Për vetëhenë”** nga Nikollë Keta.

Për Jul Varibobën autorët e këtij teksti shkollor japin të dhëna të shkurtëra biografike, si p.sh. se zgjidhet rektor në seminarin e Shën Benedetos, në vend të arbëreshit tjetër Françesk Avatit dhe se opinioni e heq prej këtu pas një viti, shërben si prift në vendlindje në vend të babait të vet. Boton veprën **“Gjella e Shën Mërisë Virgjër”** aty nga viti 1762, në të cilën trajton jetën e Shën Mërisë dhe të djalit të saj Shën Bambinit. Tema e veprës është marrë nga ungjilli, ndërsa autori nuk i ka ndenjtur besnik tekstit biblik Kështu Shën Mëria është , në pjesën më të madhe , një grua arbëreshe, një bashkëshorte e mirë, një fshatare e thjeshtë e përvuajtur , një nënë e vërtetë që gëzohet si gjithë të tjerat pse do të lindë fëmijë, ajo përgatit të lindat, djepin,kërkon ta lidhë e ta zgjidhë vetë foshnjën,, i këndon ninulla dhe krenohet me pjellën e vet. Për Jezu Krishtin thuhet se është më tepër figurë biblike. Si shembuj për lexim tekstesh nga kjo vepër e Jul Varibobës merren : **Ninull** (f. 193), **Kënga e të zgjuarit** (f. 194), **O biri im** (f. 195), **Shën Mëria qan të birin** (f.195). Autorët kujdesen me sqarime të fjalëve të vështira e të pakuptueshme,që u ndihmojnë nxënësve dhe pedagogëve interpretimin adekuat të shembujve të larpërmendur. Në këtë tekst shkollor hasim edhe si shembull një fragment nga **“Kënga e sprasme e Balës” pjesën IV “Kënga e Lalës”** (350 vargje) me një sqarim të plotë për interpretimin e këtij fragmenti. Ky shembull jepet për të mësuar nocionin mbi epin romantik (kalorsiak), ku thuhet: “ Në letërsinë shqiptare këtë lloj të epit mund ta radhisim deri diku , poemën **“Kënka e sprasme e Balës”** të Gavril Dara të Riut (edhe pse po aq mund të radhitet edhe në llojin e epit historik) mu për shkak të personazheve Nik Peta, Pal Golemi dhe Mara ,që janë krijime të fantazisë së poetit dhe të një varg momentesh tjera të shtruar në vepër.”¹²

Në tekstin shkollor **Letërsia me shembuj për vitin e parë**, autorë **Xhevat Gega – Mahmud Hysa**, Prosvetno dello, Shkup 1994,nën temën Letërsia e vjetër shqipe jepet Lekë Matrënga si një autor , me veprën e të cilit hapet një faqe e re e letërsisë së vjetër shqiptare, ajo e degës së letërsisë arbëreshe që është e një trangu të përbashkët me atë që zhvillohej këtej Adriatikut . Në këtë pjesë të shkurtër prej gjysmë faqeje jepen të dhëna të pakta për jetën e Lekë Matrëngës dhe fakti se ky shkrimtar ka bërë sprovën e parë në historinë e letërsisë sonë që të përpilojë vargje në gjuhën shqipe, para Pjetër Budit, si edhe se vjersha **“Kënga e përschirtshme”** është një përkthim nga italishtja e një poezie me motiv religjioz, një vjershë me tetë vargje njëmbëdhjetërokëshe, me rimë të alternuar,dhe se gjuha e saj dëshmon ekzistimin e kryedialektit toskë , si edhe afërsinë më të madhe që ka pasur në fazën e atëhershme me kryedialektin gegë. Në faqen 88 si shembull jepet **Kënga e përschirtshme** me sqarimin e fjalës ndëliesë = ndjesë, që me ndihmën e mësimdhënësit e njëjta kuptohet lehtë dhe mandej , si shembull , një fragment në prozë me titull **Ati inë** që , me

¹².Letërsia dhe teoria e letërisë për vitin I të shkollave të mesme , Dr. Mahmud Hysa - Xhevat Gega , Prosvetno dello”, Shkup, 1981 (vendimi i këshillit Republikan Pedagogjik nr. 03-193,të datës 20.X.1981) , (f.259)

shpjegimin e disa fjalëve të vështira , për nxënësit , kuptimi është shumë i qartë. Në këtë tekst shkollor nën temën **Romantizmi në letërsinë shqiptare**, janë përfshirë shkrimtarët arbëreshë Jeronim de Rada dhe Gavril Dara i Ri.

Për Jeronim de Radën jepen të dhëna biografske,veprat e botuara etj. Në fund theksohet edhe merita e Jeronim de Radës për themelimin e Katedrës së Gjuhës Shqipe pranë Institutit të Gjuhëve Orientale në vitin 1899 në Napoli. Sipas programit të letërsisë, autorët përpunojnë poemën “Këngët e Milosaos”, me ç’rast thuhet se me të shënohen fillimet e romantizmit në letërsinë tonë kombëtare dhe vihen bazat e vlerave të njëmendëta artistike.Si shembuj jepen disa fragmente nga poema këngët e Milosaos si : kënga I me sqarimin” ***Në bukurinë mahnitëse të natyrës së fshatit arbëresh një gëzim i madh pushton të riun, që është kthyer plot mall në gjirin e familjes, në vendlindje. I riu(mund të themi, ky është vetë poeti) frymëzohet nga poezia e lashtë klasike, por aty afër dëgjohen edhe këngët e bukura popullore, që gratë fshatare këndojnë duke punuar nëpër ara.***¹³ kënga II me sqarim, kënga IV me sqarim , kënga V me sqarim, kënga VII me sqarim,kënga IX, kënga XII,kënga XIII, kënga XX, kënga XXII dhe kënga XXX. Në fund autorët janë kujdesur dhe kanë punuar një aparaturë metodiko-didaktike.

Ndërkaq, Gavril Dara i Ri përfshihet me poemën “**Kënka e sprasme e Balës**”. Nëpërmjet interpretimit metodik të saj nxënësit kanë mundësi të informohen me strukturën përmbajtësore, evokimin e subjektit nëpërmjet gojës së rapsodit të imagjinuar Balës. Në epiqendër të veprimit është sa dashuria e zjarrtë e Nik Petës ndaj Marës , bijës së princit të Lalës së More-së, aq edhe flijimi i jetës në fushën e betejës për mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të krenarisë kombëtare. Jepen vlerësime të shkurtëra mbi personazhet kryesore të poemës, si Nik Peta, Pal Golemi, Mara , Ballaban Pasha e Kauri i Lalës (faqe 214). Në vazhdim jepet shembulli për lexim nga poema “**Kënga e sprasme e Balës**”, fragmenti Pjesa e parë III **Kënga e Hënzës** me një sqarim hyrës (155 vargje), me një fjalorth të pasur sqarues të fjalëve të vështira e të panjohura për nxënësit , dhe në fund autorët kujdesen për një aparaturë metodiko-didaktike në lidhje me shembullin e theksuar.

Në vitin 2000 Planprogramet e gjuhës shqipe dhe letërsisë pësuan ndryshime radikale. Kështu u botuan tekste të reja sipas kërkesave të Programeve më të reja të gjuhës shqipe dhe letërsisë .Në tekstin shkollor **Letërsia I (për shkollat e mesme) të autorëve Ali Aliu dhe Xhemaludin Idrizi botuar në vitin 2001 nga Alb-bas Tetovë, në librin shkollor Gjuha shqipe dhe letërsia I për gjimnazet e reformuara të autorëve Sabri Hamiti, Ali Aliu, Kujtim Shala, Idriz Metani dhe Xhemaludin Idrizi , botuar në vitin 2003 nga Alb-bas Tetovë – Tiranë dhe në librin shkollor Gjuha shqipe dhe letërsia për klasën I të shkollave të mesme profesio-**

¹³ Letërsia me shembuj për vitin e parë, autorë Xhevat Gega – Mahmud Hysa, Prosvetno dello, Shkup ,1994, (faqe 208)

onale të autorëve **Ali Aliu, Luljeta Isaku, Vehbi Kadriu dhe Xhemaludin Idrizi**, është përfshirë Jul Variboba, shkrimtari i parë që shkroi një vepër thjesht letrare dhe poeti që hodhi themelet e letërsisë arbëreshe.

Në librin shkollor **Letërsia I** (botuar në vitin 2001 autorë Ali Aliu dhe Xhemaludin Idrizi) dhe në librin shkollor **Gjuha shqipe dhe letërsia 1 për gjimnazet e reformuara** jepet një hyrje për letërsinë arbëreshe si një degë e letërsisë së hershme që u zhvillua jashtë Ballkanit, te arbëreshët e Italisë Jugore, mandej për ngulmimet e shqiptarëve drejt këtij shteti që nga vitet 1272 , 1388 dhe 1393 , po mbi të gjitha popullimin e mbi njëqind qytete e fshatra në Italinë Jugore në shekullin XV, thirrjen e shumë shqiptarëve nga mbreti i Napolit për të mposhtur një kryengritje në Itali. Ngulmimet më të mëdha, sipas këtyre teksteve, ka pasur pas vdekjes së Skendërbaut dhe robërimit të Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Vepra e parë e letërsisë arbëreshe me të cilën njihen nxënësit shqiptarë të RM-së nga këto libra është **Dottrina Christiana** e Lekë Matrëngës (1560-1619) – shkrimtari më i hershëm i arbëreshëve të Italisë dhe autori i vjershës së parë të shkruar shqip (në dialektin toskë). Vepra e Lekë Matrëngës vjen si vepra e dytë e letërsisë shqipe, pas Mesharit të Gjon Buzukut (1555). Ajo ruhet sot në Bibliotekën e Vatikanit në tri kopje dhe ka gjithsej 174 faqe. Një botim të kësaj vepre pajisur me shënime e ka bërë Justin Rrota në Shkodër në vitin 1939, sipas botimit më të hershëm në revistën “Hylli i Dritës”. Në lidhje me rëndësinë e veprës së Matrëngës thuhet se **“ka vlerë historike se aty është një këngë e përshpirtshme, që në të vërtetë është vjersha e parë e dëshmuar deri më sot në shqip”**.¹⁴ Tiranë Edhe në aspektin e thurjes dhe të porosisë kjo këngë përmban tekstin më të fuqishëm, më të vlefshëm të gjithë veprës.

Në këtë pjesë jepet një informatë në lidhje me atë se shekulli XVII ka qenë mjaft i heshtur për arbëreshët në drejtim të zhvillimit të letërsisë. Ndërsa në vazhdim thuhet se një shpërthim të vërtetë kulturor do të ndodhë pas një shekulli e gjysmë, sidomos në Horën e arbëreshëve. Do të dallohet një grup poetësh arbëreshë me poezinë e tyre të pasur e të përpunuar , si Nikollë Brankati (1675- 1741) , Nikollë Filja (1682-1769), Nikollë Keta (174) – 1803) dhe më i rëndësishmi prej tyre Jul Variboba (1724- 1788). Prej poetëve që u përmendën më lartë, nxënësit e vitit të parë të shkollave të mesme , në mënyrë të veçantë të gjimnazeve të reformuara, do të mësojnë mbi Jul Varibobën dhe atë mbi biografinë , kolegjin San Benedetto Ulano themeluar në vitin 1735 nga Klementi XII (për arsimimin e të rinjve shqiptarë të Kalabrisë), botimin e veprës **“Gjella e Shën Mërisë Virgjër”** (1762).Në këto tekste për komente jepet fragmenti **“Vajtimi i Marisë”**, i cili nga nxënësit mund të kuptohet pak me vështirësi edhe përkundër sqarimit të një numri të madh të fjalëve të panjohura. Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit zbulojnë emocionet e vetë poetit në këtë

¹⁴ Letërsia I (për shkollat e mesme) Ali Aliu, Xhemaludin Idrizi ,2001, Alb-bas ,Tetovë; Gjuha shqipe dhe letërsia I për gjimnazet e reformuara, Sabri Hamiti, Ali Aliu, Kujtim Shala, Idriz Metani, Xhemaludin Idrizi 2003, Alb-bas Tetovë –

fragment në vajtimin e Marisë nëntekstin e vajtimit të nënës për të birin. Në fund jepet për koment **“Kënga e Shëngjergjit”** përshtatur në gjuhën e sotme nga Z. Kodra, pa aparaturë metodiko-didaktike.

Ndërsa në tekstin shkollor **“Gjuha shqipe dhe letërsia”** për vitin e parë të shkollave të mesme botuar nga Alb-bas Tetovë 2006, jepen të dhëna për Jul Varibobën, një analizë e shkurtër e veprës **“Gjella e Shën Mërisë Virgjër”** dhe për komente një fragment i shkurtër me titull **“Vajtimi i Marisë”**, ku sqarohen vetëm 3 fjalë e që kuptrimi i tij është i vështirë. Si fjalë të vështira që e vështirësojnë të kuptuarit e fragmentit janë **furnuan, qagartin të veerjatinrrevove, ka dhullur thien ...**

Në tekstin **Gjuhë shqipe dhe letërsi për gjimnazin e reformuar** për vitin e parë (autorë Remzi Nesimi, Mahmud Hysa, Xhevat Gega, 2001, Prosvetno dello, Shkup) përfshihet Jul Variboba (1724-1788). Përveç biogra_fisë së poetit jepen të dhëna edhe për shpërnguljen e shqiptarëve pas vdekjes së Skenderbeut (1468), vendosjen e shqiptarëve të Shqipërisë së Jugut në Italinë Jugore dhe të shqiptarëve të Shqipërisë Veriore në Italinë Veriore. Përmenden vitet e shpërnguljeve 1488, 1508 dhe 1532 – 33. Për arbëreshët e Italisë Jugore nxënësit mësojnë edhe mbi përkatësinë e tyre fetare – atë bizantin, që e mbron nga asimilimi, fushatën e vendasve për katolicizimin e tyre. Arbëreshët duke e ruajtur fenë e tyre e ruajtën edhe gjuhën shqipe, ritet fetare e familjare, këngët popullore, veshjen kombëtare, pra etnogjenezën dhe etnopsikologjinë e tyre. Përmenden dy kolegjet arbëreshe që u hapën në shekullin XVIII, në Shën Benedetto Ulano, në Kalabri në vitin 1731 dhe në Palermo, Sicili në vitin 1734, në të cilët mësohej gjuha shqipe, historia kombëtare, folklori arbëresh. Autorët trajtojnë përmbajtjen e veprës **“Gjella e Shën Mërisë Virgjër”** të ndarë në dy pjesë – Jeta e Shën Mërisë dhe jeta e Shën Bambinit. Në vazhdim janë dhënë shembuj tekstesh nga vepra e Jul Varibobës me titujt **Më e bukura kopile, Më e bukura vajzë, Kurmëthin e ka të xhveshur, Trupthin e ka të xhveshur, Ninull, Oj biri im, Kënga e të zgjuarit dhe Shën Mëria qan të birin.**

Në programin e gjuhës shqipe dhe letërsisë për vitin e dytë për gjimnazet e reformuara nga letërsia arbëreshe (arbëreshëve të Italisë Jugore) parashihen të realizohen shkrimtarët: Jeronim de Rada, Anton Santori, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe dhe Zef Sqiroi.

Nxënësit shqiptarë në Republikën e Maqedonisë (nxënësit e gjimnazeve të reformuara) shfrytëzojnë vetëm një tekst.¹⁵ Për Jeronim de Radën në këtë tekst shkollor thuhet se **“është një figurë e ndritur dhe poliedrike, figura e poetit, e folkloristit, publicistit, filologut, estetit, mësuesit. Këto të gjitha bashkohen te patrioti i kulluar që shkrin tërë energjinë e vet për zgjimin e shqiptarëve dhe për lirinë e atdheut të stërgjyshërve”**. Autorët japin një panoramë të shkurtër të biografisë së De Radës- nxënës i kolegjit të Shën Adrianos, mbledhës i këngëve popullore në

¹⁵ Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë të gjimnazit të reformuar, Remzi Nesimi, Mahmud Hysa, Prosvetno dello, Shkup, 2002,

fshatin e vendlindjes Maki, student i drejtësisë, por adhures i flaktë i letërsisë, leximi i shumë shkrimtarëve të antikitetit, romantizmit italian dhe botëror, marrja e tij me letërsi që në moshë të re dhe ardhja në vendlindje për pushime me veprën e parë **“Këngët e Milosaos”** (Napoli 1836), pjesëmarrja në lëvizjen politike të qytetit kundër Burbonëve, dënimi me gjashtë muaj burg etj. Përmenden veprat e De Radës të botuara deri në vitet 1850 si: **Këngët e Serafina Topisë** (1839), tragjedia **Numidët** (1846), **Variante të Këngëve të Milosaos** (1847) dhe poema **Rrëfime të Arbërit** (1847), botimi i gazetës së parë në historinë shqiptare **L’Albanese d’Italia (Shqiptari i Italisë)**, në faqet e së cilës do të mbrojtë idetë e liberalëve për të cilën gjë gazeta mbyllet. Në vazhdim jepen veprat e botuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX si: **Parimet e estetikës** (1864), **Rapsodi e një poemthi arbëresh** (1866), **Skenderbeu i pafan** (1873), ku janë përfshirë edhe **Këngët e Serafina Topisë**. Theks të veçantë ka për reagimin e De Radës në dobi të çështjes kombëtare në nxjerrjen e revistës **“Fiamuri i Arbërit”** (1883), ku e shpreh atdhetarizmin dhe vihet në mbrojtje të tërësisë territoriale që kërcënohej nga fqinjët dhe nga politika austriake – italiane, korrespondencën me dijetarët e shquar të huaj – si me G.Mejerin, N.Tomazeun, A.Doizonin etj, si dhe me ata shqiptarë- Dora d’Istrien, Naim Frashërin, Sami Frashërin, Th. Mitkon etj.

Përmendet edhe botimi i veprave: **Sofonizba** (1892), **Pellazgë dhe shqiptarë** (1899), **Konferenca mbi gjuhën shqipe** (1894) ripunimi i **Këngëve të Serafina Topisë** dhe **“Autobiologjia** (1899).

Nxënësit mësojnë edhe për organizimin e dy kongreseve gjuhësore: atë në Koroliano Kalabro (1895) dhe në Ungro (1897) dhe për pjesëmarrjen e tij në Kongresin XII të Orientalistëve në Romë, ku flet për gjuhën shqipe, mandej për iniciativën e tij për hapjen e katedrës së gjuhës shqipe pranë Institutit të Gjuhëve Orientale në Napoli.

Në një faqe të veçantë citohen të dhëna për personalitetin e De Radës si: nga vepra e Markianoit **“Shqipëria dhe vepra e Jeronim de Radës”**, nga vepra **“Historia e shqiptarëve të Italisë** (1921) e studiuesit Petro Skaljone dhe nga vepra **“Historia e letërsisë shqipe”** (1958) e studiuesit Zef Sqiroidi i Ri.

Në Planin dhe Programin e gjuhës shqipe dhe letërsisë për arsimin gjimnazor është paraparë që nga vepra e De Radës të përpunohen poemat Serafina Topia dhe Skenderbeu i pafan. Në librin e autorëve të përmendur është dhënë njëinterpretim metodik i këtyre dy poemave me shembuj (fragmente). Për poemën Serafina Topia kemi fragmentin **“Kënga e Serafinës”** (libri I , Artë verë 1441); **“Knëgë lamtumire** (Artë , 8 tetor 1443); **“Kënga e Bozdarit** “(2) dhe **“Kënga e Serafinës”**; **“Martesa e Skenderbeut** “ (nga libri V , kënga I, Krujë 26 prill 1451) Ndërkaq për për poemën epike **“Skenderbeu i pafan”** si shembuj janë marrë **“Ndeshja e Skenderbeut me dy tatarët** (libri IV, kënga 4, Adrianopol , vjeshtë 1443) dhe **Kënga vashës së Danjës** (libri I, kënga 6, Janinë 1442).

Në fund autorët kanë zgjedhur vlerësime kritike të disa autorëve si: Mikel Markiane, Ali Xhiku, Rexhep Qosja, Dora d'Istria, Eqrem Çabej, Ernest Koliqi, Viktor Hygo, Lamartini, Frederik Mistral, Ismail Kadare dhe Emin Kabashi. Viktor Hygonë thotë: **“Kush dëshiron të shohë plotësimin e poezisë romantike moderne, të lexojë “Këngët e Milosaos” të zotëri Jeronim de Radës”**.

Eqrem Çabej mes tjerash thotë : **“Veprat e De Radës kanë ruajtur në një frymë thjesht romantike koloritin etnografik. Ato janë pasqyra besnike dhe e lartësuar në sferën e poezisë së jetës shqiptare e zakonet e saj. De Rada është i pari këngëtar i shpirtit të gruas në letërsinë shqiptare”**. Lamartini thotë këtë: **“Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja dhe atje duhet të kthehet përsëri”**.

Anton Santori në arsin gjimnazor dhe në shkolla të mesme në Republikën e Maqedonisë mësohet si shkrimtar i romantizmit arbëresh, sepse këtij, me dramën Emira, i takon merita e dramaturgut të parë në letërsinë shqiptare. Përveç biografisë së shkurtër, nxënësit e kësaj moshe kanë mundësi të njihen me të dhëna për personalitetin e shkrimtarit, titujt e veprave letrare të botuara me tematikë jashtëfetare, me temë fetare dhe vepra të mbetura në dorëshkrim. Në vazhdim jepen të dhëna për bashkëpunimin e De Radës me Santorin, ndikimin në poezinë e tij (Këngëtorja arbëreshe). Përmenden shkurtimisht poemat: **Valle e haresë së madhe, I burgosuri politik**, poezitë satirike – humoristike, që flasin për dukuritë politike- si burokracia (**Propagandisti**) , për dukuri sociale (**Varfanjakja e gjorë**), për tiparet negative karakteristike të njeriut: vjedhja, gënjeshtria, llafosja, përtacia, koprracia, hipokrizia etj., novelat dhe romanet në të cilët prezantohet jeta arbëreshe në Itali, duke i përfshirë të gjitha shtresat njerëzore.

Si vepër e caktuar për përpunim në këtë klasë të arsimimit gjimnazor është paraparë drama **“Emira”**, për të cilën në tekst jepet njëpërpunim metodik për përmbajtjen e saj , si edhe shkurtimisht analizohen personazhet kryesore – Emira, Miriani, Kallonjeri, Kalina, Albenci. Dallohen personazhe plotësisht pozitive, siç është Emira e çiltër , e sinqertë, besnike, po edhe e kthjellët dhe me dinjitet; personazhe krejtësisht negative, siç është Kallonjeri intrigant, xheloz, agresiv, arrogant, kriminel, shpifës; Kalina që gërsheton dy karaktere: e sinqertë, objektive, lozonjare, por edhe intrigante, ziliqare, ambicioze. Për lexim tekstesh nga drama Emira shfrytëzohet akti II, skena 3, 4, 6 dhe 7, akti III, skena 3 dhe akti V, skena 1.

Në fund prezantohen vlerësime kritike për Anton Santorin marrë nga *“Historia e letërsisë shqiptare”* (1989) të Rexhep Qosjes i cili mes tjerash thotë: **“ Anton Santori në letërsinë shqipe përgjithësisht sjell i pari tri lloje të reja : dramën, novelën dhe romanin”**.

Për Gavril Darën e Ri nxënësit e kësaj moshe mësojnë se **“ ai me poemën Kënka e sprasme e Balës do të bëjë jehonë në kohën kur u botua dhe më vonë, duke e bërë autorin si njërin nga shkrimtarët më të shquar të letërsisë arbëreshe dhe të letërsisë shqiptare në përgjithësi “**

(faqe 132). Autorët japin të dhëna biografike për Gavril Darën e Ri, arsimimin , pjesëmarrjen në radhët e Garibaldit, marrjen me gazetari, drejtimin e gazetës Reforma të arbëreshit F. Krispi (1871-1874), marrjen me studime shkencore dhe me krijimtari letrare, përfundimin e jetës në një gjendje të rëndë ekonomike. Veprat e poetit veçohen si vepra letrare ku përmenden: Përmbledhja **Disa poezi**, shkruar italisht, botuar 1874; poema **Ana Maria Kominiate**, italisht me subjekt shqiptar, botuar 1864; poezia e gjatë **Të zezat tona** , italisht , 1870 dhe poema **Kënka e sprasme e Balës**, botuar pjesërisht në revistën Arbëri i ri, Palermo 1887 dhe si libër më 1906; dhe si vepra shkencore përfshihen: **Mbi topografinë e Gjirgjendit** , botuar më 1863 dhe **Topografia e Palac Adrianos**, botuar në revistën Flamuri i Arbërit më 1887.

Me titullin Poetika e veprave të Darës së Ri përpunohet poema **“Kënka e sprasme e Balës”**. Bëhet një krahasim i poemës së Darës me poemën e De Radës – Këngët e Milosaos, si tema e dashurisë ndaj atdheut dhe e dashurisë ndaj gruas, ku nuk ka lumturi kombëtare nuk mund të ketë lumturi individuale-familjare, kur atdheu është dhe vuan nga robëria. Bëhen analiza të shkurtëra mbi personazhet kryesore si: Nik Peta dhe Pal Golemi, figura e Skenderbeut del më autoritative për veprimet e matura, për virtutet dhe aftësitë, për largpamësinë dhe zemërgjerësinë, Marës si një e huaj që ka shumë tipare të një shqiptareje- e bukur, e mençur, dashnore, trimëreshë, e shpëton nga kurthi i babait të dashurin e vet Nik Petën.

Për lexime tekstesh përfshihen pjesët Bala, Kënka e hënëzës, Kënka e Beratit me nga një fjalorth veç e veç për çdo pjesë dhe me një aparaturë adekuate metodiko-pedagogjike. Në fund jepen vlerësime kritike të figurave të shquara si : Eqrem Çabej, Zef Sqiropi i Ri dhe Rexhep Qosja.

Zef Serembeja është përfshirë në programin e gjuhës shqipe dhe letërsisë në vitin e dytë , si përfaqësues i lirikës romantrike shqiptare.Në librin Gjuha shqipe dhe letërsia e vitit të dytë të autorëve të lartpërmendur jepet një biografi për jetën dhe veprimtarinë letrare të Zef Serembespastaj se **“ poezia e Zef Serembes e pasuroi poezinë e romantizmit shqiptar me motive dhe forma të ndryshme të shprehjes letrare, veçmas me poezinë erotike, patriotike dhe meditative të nivelit më të lartë.”** Zef Serembe lindi në Strigari të Kozencës, fshat buzë detit Jon që la mbresa në vetëdijen e poetit, në shpirtin e tij poetik dhe në sensibilitetin e shprehjes letrare. Në vazhdim jepen të dhëna për ngjarjet që ndikojnë në personalitetin e psikologjinë e Serembes – dy momentet:” ngjarjet e vitit 1848 që ndikuan në fatin jetësor dhe në formimin e psikologjisë së përjetshme të skamnorit, e cila e ndoqi gjatë tërë jetës si njëra nga dy fatkeqësitë më të mëdha për krijimtarinë e tij dhe ngjarjet e vitit 1860 që e vulosën këtë psikologji përgjithmonë”. Fjala është për babain e Serembes, Mikelangjelin, që mori pjesë në këtë lëvizje e cila dështoi, ndërsa ai u dënua me burg në mungesë e që ishte fatale. Kjo e varfëroi deri në skamje familjen e vet, ndërsa Zefin e detyroi ta ndërpriste shkollimin. Mandej flitet edhe për

përkrahjen e arbëreshëve Garibaldit dhe për pjesëmarrjen e tyre aktive në lëvizjen që e udhëhiqte ai.

Shëtitja e fshatrave të Kalabrisë e të Siqelisë në kohën e vlimeve politike që e dobishme sepse pati rastin të interesohet për zakonet, folklorin e gjuhën e ngulmimeve arbëreshe duke shpresuar se do të gjejë qetësinë shpirtërore.

Nga vepra e Serembes përmendet se qysh si 16-17 vjeçar shkroi poezinë e parë “ **Për lirinë e Venetisë**” ku shpreh përcaktimet e tij ideore dhe Garibaldin e krahason me kryeheroi shqiptar dhe krenarinë e kombit Skenderbeun, se entuziazmohet me pjesëmarrjen e arbëreshëve në këtë lëvizje, se në vitin 1868 shkruan poezinë “**Zonjës Elena Gjikä**” ku flet qartë për idenë e bashkimit dhe të çlirimit të atdheut të të parëve. Përmendet edhe njohja me një vajzë, me të cilën u dashurua poeti, që i krijoi lumturinë më të madhe në jetë, i krijoi një botë të mbushur me pasione e iluzione, një dashuri pak e përjetuar dhe më tepër e imagjinuar, sepse kjo vajzë, bashkë me prindërit migron në Brazil. Shkuarja e poetit në Brazil ndodh në vitin 1875. Dëshpërimi nga jeta në oborrin mbretëror, korrupsioni dhe degjenerimi i aristoktaxisë braziliane e kthejnë poetin nga Brazili. Në rrugë për në vendlindje poeti humb një pjesë të madhe të poezive të tij. Po edhe ato që i shkruante nuk kishte mundësi t’i botonte. Në vitin 1893 boton baladën në gjuhë italishte “**Ushtari i kthyer**”, ndërsa në vitin 1884 De Radës i shkruan se ka përgatitur një vepër prej 400 faqesh, që flet për historinë e Shqipërisë, në vitin 1895 poeti sërish merr rrugën për në Brazil, prej ku edhe nuk kthehet më (vdes në vitin 1901), ndërsa në vitin 1897 në Buenos Aires boton poezinë “**Zotit**”, në vitin 1898 “**Për vdekjen e Pjetër Irianit**”.

Për personalitetin e poetit jepen shënime nga D. Mikeli dhe Nasho Jorgaqi. D. Mikeli kështu e përshkruan portretin e Serembes: “ *... **E kishin parë poetin nga larg udhëve... i verdhë si brazilian me një lëvizje të çuditshme drite në sy, dhe e kishin treguar si një farë ëndërronjës vizionesh , një farë Poe ose Nervali, i zbritur këtu nga malet e tij të afërta arbëreshe.***”

Ndërkaq Nasho Jorgaqi në librin e tij **Udhëve të Serembes** jep këto shënime: “ **Arbëreshët e Sao Paolos e njihnin poetin dhe e çmonin. Kishin qejf dhe ta dëgjonin kur fliste, sepse thonë, ai fliste bukur dhe, akoma më bukur, kur recitonte arbëresht... Poeti u ka mbetur në kujtesë si një njeri që nuk rrinte kurrë në një vend , gjithnjë ecte kokëvarur , dimër e verë dhe në çdo kohë e shikoje të mbante nën krah e nëpër xhepa vandakë gazetash e revistash.**”

Në pjesën Poetika e veprave të Zef Serembes theksohet se ai mbeti si simbol i poezive lirike, edhe pse lëvroi edhe gjini të tjera letrare. Ndërkaq në lirikën e tij dallohen dy lloj motivesh : patriotike dhe dashurore.

Për sqarimin e poezive me motive patriotike si shembuj merren poezitë **Rrotullupë (Vrull)**, ku mes tjerash, thuhet se:” **në vjershën Rrotullupë shtresohen tri drama të mëdha të popullit shqiptar: ajo e**

dobësisë së lëvizjes kombëtare, drama e arbëreshëve që kanë mbetur pa atdhe, tek ata ka filluar harresa ta mbulojë kujtesën historike, dhe drama e vetë poetit që i përjeton shumë rënëdë dy dramat e para.” Pastaj nëpërmjet vjershës “**Detari**” jepet luftëtari që është nisur në detyrën e shenjtë: T’i përgjigjet ftesës së atdheut për të luftuar kundër armikut, moment që luftëtari e ka pritur një kohë të gjatë se:” zgjedhën si iringëtituritë qenit turk ,mallkonja.” Këtu jepet portreti i një luftëtari të vendosur dhe të ndërgjegjshëm që e ka përcaktuar pa imponim se flamurin do ta ketë si nuse e se dashuri detin, luftën drejt atdheut. Këtu thuhet se ky luftëtar si shembull ka Teutën dhe Bardhylin.

Me poezinë “**Zonjës Elena Gjike**” autorët thonë se poeti e ndërton figurën e saj në aspektin intelektual e jo militant, ajo i shërbeu si uinazë që lidh, apo si yll i lirisë që ndriçon me diturinë e saj , atë që është këputur dhe atë që është megjulluar nga robëria e atdheut të përbashkët.

Në poezinë “**Për lirinë e Venetisë**” (1860) këndon për luftën çlirimtare të Venedikut, të udhëhequr nga Garibaldi, ku marrin pjesë edhe arbëreshët, që e gëzon Seremben se i jep të shpresojë se një ditë ata do të luftojnë edhe për lirinë e atdheut të të parëve.

Në vazhdim jepen tekste letrare për lexime si : vjersha **Rrotullupë (Vrull), Detari, Zonjës Elena Gjike** dhe **Për lirinë e Venetisë** me një fjalorth të shkurtër dhe aparaturë metodiko-didaktike, që ndihmon për kuptimin dhe ndjeshmërinë e poezive të lartshënuara.

Lirika dashurore e Zef Serembes u ofrohet nxënësve me poezitë **Kënka e dashurisë së parë, Kënka e gëzueshme, Fytyra e saj , Kënka gazmore, Kujtim** dhe me poezinë **Më të bukurës që është në Strigar**. Për poezitë e sipërpërmendura autorët kanë dhënë një aparaturë metodiko-didaktike për interpretimin e tyre.

Dhe në fund jepen vlerësime kritike për veprën e Serembes nga Rexhep Qosja, Zef Sqiroidi i Ri dhe Klara Kodra . Për Zef Sqiroidin theksohet se është krijues që e vazhdoi me plot sukses traditën letrare të romantizmit arbëresh, madje që e avancoi me tema e ide të reja. Ai do të bëhet njëri nga figurat më të popullarizuara tek arbëreshët dhe në mbarë kulturën shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX.

Autorët japin të dhëna të mjaftueshme biografike si: i merr mësimet në Seminarin arbëresh të Palermos, ku e shkruan poemën Skenderbeu në gjuhën shqipe dhe merr shpërblimin e parë letrar në konkursin e këtij seminari, në Palermo i vazhdon studimet në drejtësi, por interesohej më tepër për letërsi, bashkëpunon me shkrimtarin e njohur italian Luigi Pirandello, merret edhe me mbledhjen e këngëve popullore (1887- boton përmbledhjen **Rapsodi shqiptare**, bashkë me Frano Petën boton revistën në gjuhën shqipe **Arbëri i ri**, emërohet docent në i letërsisë antike në liceun Garibaldi të Palermos, bashkëpunon me shkrimtarë në zë të Rilindjes , me Kristoforidhin, Vason, Mitkon, Naimin, Konicën dhe me albanologë të huaj, G. Majerin, O. Dozonin etj., pati interesime të përhershme për ngulmimet e arbëreshëve në Itali, zgjidhet si profesor i gjuhës dhe letërsisë shqiptare në

Institutin Oriental të Napolit, merr pjesë në Kongresin e Trieshtës, po atë vit vjen në Shqipëri ku qëndron deri në vitin 1914, ia vrasin djalin, Minon që e pikëllon pa masë.

Të dhëna për personalitetin e shkrimtarit jep Zijadin Kodra .

Autorët veprat e Zef Sqiroid i ndajnë në tre grupe. Në grupin e parë vihen veprat letrare: **Versi** (vargje) përmbledhje poetike në gjuhën italiane, Palermo 1887; **Mili e Hajdhia**, poemë idilike, Palermo 1891; **Kënkat e luftës**, poezi italisht, Palermo 1894; **Te dheu i huaj** poemë, Palermo 1900. Në grupin e dytë jepen veprat folklorike: **Rapsodi arbëreshe** , Palermo 1887; **Këngë tradicionale të kolonive arbëreshe në Sicili**, 1923; **Kënga popullore shqiptare**, 1901; **Këngë të përshpirtshme të kolonive arbëreshe në Sicili**, 1923. Në grupin e tretë jepen vepra të mbetura në dorëshkrim: **Vistari**, poemë historike , një këngë botuar në revistën La nazione albanese; **Këthimi**, poemë ; **Mino**, poemë lirike, kryevepër e autorit.

Autorët përmes poemës **Te dheu i huaj** japin idenë për llojin e poemës historike – kombëtare të Zef Sqiroid, si krijues që zgjeron kontekstin kohor. Poema përfshin jo vetëm periudhën e lavdishme të Skenderbeut – periudhën e shekullit XV, por edhe periudhën deri te bashkëkohësia e tij , deri në shejullin XIX, që fut brenda edhe historinë arbëreshe, me fatin dhe tragjikën a tyre në të kaluarën dhe të sotmen dhe me një vizion për të nesërmen. Si tregimtar i ngjarjes në këtë poemë na del një anëtar i familjes së poetit, i cili e zgjeron interesimin e anëtarëve të familjes për historinë arbëreshe , ku përmenden figura të rëndësishme historike si M. Golemi, Bushatasit. Ali Pashë Tepelena, vdekja e Skenderbeut, rrethimi i Shkodrës, gojëdhëna e Rozafës, Donika , dhe përfundon me një urim për paqen në përgjithësi. Dhe si përfundim , në fund jepet edhe mesazhi i qartë i poemës : aspiratat e arbëreshëve për një atdhe të lirë të të parëve dhe idenë për një jetë të lumtur e të barabartë në të ardhmen me tërë popujt paqedashës.

Për lexime tekstesh letrare është përzgjedhur një fragment nga poema **Dheu i huaj**, me një fjalorth të shkurtër dhe me interpretime tekstesh letrare e të gjuhës poetike. Dhe në fund jepen vlerësime kritike për veprën letrare të poetit nga Eqrem Çabej, Zef Sqiroid i Ri dhe Rexhep Qosja.

Nga Eqrem Çabej është përzgjedhur fragmenti :” **Kur një ditë veprat e Zef Sqiroid do të dalin në dritë, ai do të zejë sigurisht e me meritë një nga vendet e para të literaturës shqipe.**” ;nga Zef Sqiroid i Ri fragmenti: **“Sqiroid qe këngëtar i më pjellor e më ndërtimtar. Veprave të veta ua imponoi disiplinën që vinte nga një formim humanist, harmonia e pjesëve, fisnikërimi i shprehjeve. Nuk ishte aq i prirur ndaj ëndërrës së De Radës, po më tepër i ndieshëm ndaj entuziazmit. Dhe bashkë me entuziazmin e ndjeshëm edhe figurat më të ndryshme që gjallërojnë krijimet poetike.”**;ndërsa nga Rexhep Qosja fragmenti : **“ Vargjet, pamjet, përshkrimet, idetë dhe mendimet e tilla, artistikisht, vërtet, të pafuqishme, nuk janë të mjaftueshme që poema Te dheu i huaj , si tërësi, të çmohet edhe sot si dikur: poemë e madhe e romantizmit shqiptar.”**

4. Përfundim

Krijimtaria arbëreshe, pa dyshim, në etapa të ndryshme kohore prej viteve të 70-ta është përfshirë ku më pak e ku më shumë në tekstet shkollore të shkollave fillore (librat e leximit për kl.V,VI,VII,VIII). Deri në vitet e 2000-ta , përfshirja e kësaj krijimtarie ka qenë pak ose aspak, ndërsa pas , me liberalizimin e teksteve shkollore – librave të leximit për një klasë, përfshirja e fragmenteve nga veprat e autorëve arbëreshë rritet me një, dy e më tepër syresh.

Letërsia arbëreshe në tekstet shkollore të shkollave të mesme, në periudha të ndryshme, ka qenë e përfshirë sipas programeve mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë – letërsia filobiblrike dhe ajo romantike (janë përmendur dhe përpunuar Lekë matrënga, Nikollë Keta, Nikollë Filja, Nikollë Brankati, Jul Variboba, Jeronim de Rada, Gavril Dara i Ri, Anton Santori, Zef Serembe dhe Zef Skiroi. Kjo ka qenë edhe e vetmja mundësi dhe mënyrë që nxënësit shqiptarë të shkollave fillore dhe të mesme të mësojnë për arbëreshët e Italisë.

Abstrakt

Për arbëreshët e Italisë nxënësit shqiptarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë mësuar dhe mësojnë nga tekstet shkollore të shkollave fillore dhe të mesme (në librat e leximit për kl. V,VI,VII dhe VIII dhe në librat e letërsisë për kl I dhe II për shkollat e mesme). Në këto tekste nga krijimtaria letrare arbëreshe përfshihen shkrimtarët e dalluar arbëreshë të letërsisë romantike si: Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe, Anton Santori dhe Zef Skiroi. Fragmente nga krijimtaria letrare e tyre ka në tekstet e shkollave fillore të botuara në Republiën e Maqedonisë së Veriut duke filluar aty rreth viteve të 70-ta e deri më sot. Në periudha të ndryshme , në shkollat e mesme janë mësuar dhe mësohen veprat më të njohura të shkrimtarëve të letërsisë arbëreshe si: Këngët e Milosaos, Kënka e sprasme e Balës, Emira, Te dheu i huaj, poezi me motive patriotike e erotike të Serembes .

Abstract

Albanian students of the Republic of North Macedonia have learned and are learning about the Arbereshes of Italy from primary and secondary school textbooks (in reading books for grades V, VI, VII and VIII and in literature books for grades I and II for secondary schools). These texts from Arbereshe literary creativity include distinguished Arbereshe writers of romantic literature such as: Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe, Anton Santori and Zef Skiroi. Fragments of their literary creativity are found in primary school textbooks published in the Republic of Macedonia, since there around the 70s and up to the present day. At different times, the most famous works of Arbëresh literature writers have been and are taught in high schools, such as: Songs of Milosao, The Last Song of Bala, Emira, On a Foreign Land, poems with patriotic and erotic motifs by Serembe.

Literaturë

- ALIU A. IDRIZI Xh. (2001). Letërsia I (për shkollat e mesme), Alb-bas, Tetovë.
- ALIU A. ISAKU L. KADRIU V. IDRIZI Xh. (2006). Gjuha shqipe dhe letërsia për klasën e parë të shkollave të mesme profesionale, Alb-bas , Tetovë.
- ALIU.A. (1975). Leximi letrar për kl. VIII , Prosvetno dello, Shku.
- BEKTESHI R. HODA T.(2002). Libër leximi për kl.VII, Logos –A,Shkup.
- GEGA Xh. HYSA M. (1994). Letërsia me shembuj për vitin e parë, Prosvetno dello, Shkup.
- HAMITI S. ALIU A. SHALA K. METANI I. IDRIZI Xh. (2003). Gjuha shqipe dhe letërsia I për gjimnazet e reformuara, Alb-bas , Tetovë.
- Historia e letërsisë shqipe I-II. (1975). Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë. (botimi i tretë)
- HODA T. BEKTESHI R. (2003). Libër leximi për kl.VIII,Logos –A, Shkup.
- HYSA M. GEGA Xh. (1981). Letërsia dhe teoria e letërsisë për vitin I të shkollave të mesme, Prosvetno dello, Shkup.
- HYSA M. IDRIZI Xh. (2001). Gjuhë shqipe dhe letërsi për kl.VII, Prosvetno dello,Shkup,2002
- IDRIZI. Xh. (2001). Leximi letrar 6 , Alb-bas ,Tetovë.
- NESIMI R. HYSA M. GEGA Xh. (2001). Prosvetno dello, Shkup.
- NESIMI R. HYSA M. (2002). Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë të gjimnazit të reformuar, Prosvetno dello, Shkup.
- OSMANI Z. KARANFILI I. (2001). Libër leximi për kl. VI, Logos –A, Shkup.
- PETRO R. IDRIZI Xh. (2003). Pepivani N. Kadriu Z. Gjuha shqipe dhe leximi 8, Alb-bas, Tetovë.
- SHUTERIQI Dh. (1972). *Histori e letërsisë shqipe – doracak për shkolla të mesme*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë.
- ZLLATKU R. (1996). Me arbëreshët, Shkupi, Shkup.

ISSN 2671-3004

UDC 821.18.09

Punim studimor

Begzad BALIU

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë
 Fakulteti i Edukimit
 e-mail: begzad.baliu@uni-pr.edu

NAUM VEQILHARXHI: NDËRMJET DY RILINDJEVE**NAUM VEQILHARXHI: BETWEEN TWO RENAISSANCES**

Në vitin 1985 Profesor Jup Kastrati botoi një dispensë për studentët e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, me titull *Histori e gjuhësisë shqiptare*¹⁶, në të cilën veç tjerash në një format mjaft të argumentuar, por jo me synim të caktuar, tërhiqte vërejtjen për disa personalitete, dorëshkrime, vepra e madje institucione ndër arbëreshët e Italisë, të cilët jo më pak se dy shekuj para Naum Veqilharxhit, kishin sjellë përbërës të rëndësishëm: gjuhësorë, kulturorë, etnografikë, folklorikë e madje institucional, me të cilët i kishin paraprirë kërkimit në gjuhën shqipe, krijimit të vetëdijes kombëtare shqiptare, idesë mbi rëndësinë e trashëgimisë dhe rolit të identitetit historik kombëtar etj.

Të dhëna të tilla, referenca dhe madje paradigma të kësaj natyre, Profesor Jup Kastrati kishte theksuar edhe në disa zëra enciklopedikë të vëllimit “Fjalori enciklopedik shqiptar”(1985)¹⁷, por sikur nuk ishte vënë

¹⁶ *Histori e gjuhësisë shqiptare*. Pjesa e parë (1497 - 1944). Kurs special në gjuhë. Material në ndihmë të studentëve. Instituti i Lartë Pedagogjik “Luigj Gurakuqi”. Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë. Katedra e gjuhës shqipe. Shkodër, tetor 1989. Për përdorim të brendshëm. Për studentët e vitit të tretë të Degës së gjuhës e letërsisë shqipe të Institutit të Lartë Pedagogjik 4 - vjeçar “Luigj Gurakuqi”. Shkodër. Botimi I: 1985, 58 faqe të shaptilografuara; Botimi II: 1989, 271 faqe të shaptilografuara.

¹⁷ Shih, veç tjerash zërat: *Dr. Pal M. Parrino - albanolog arbëresh*, “Universale”, I, 1, 2, Tiranë, 8 dhjetor 1991; *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të Akademisë së Shkencave, FESH (1985)*; *Jeronim de Rada (1814 - 1903)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë, 1985, f. 171- 172; *Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda) (1821 - 1882)*,

re, për të mos thënë, se studiuesit e gjuhës, letërsisë dhe madje historisë kombëtare prej kohësh kishin vënë kufijtë zyrtarë të zhvillimeve historiko-gjuhësore, etno-letrare e kulturore të popullit shqiptar dhe zhvendosja, shtyrja apo hapja e kufijve të periudhave të caktuara (kufijtë hapësinorë e kohorë të Ilirisë, Epoka e Skënderbeut, Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Periudha e Pavarësisë), pra sidomos e atyre epokave që kishin shënuar kufijtë e ngritjes historike të popullit shqiptar e të hapësirës identitare, kishin marrë dimensione zyrtare, për të mos thënë, sikur kishin marrë vlera mitike.

Në këtë rrjedhë, janë tre aspekte të natyrës historike, shkencore dhe identitare, të cilat Profesor Jup Kastrati i theksonte në hyrje të kapitullit mbi zhvillimin e studimeve gjuhësore, përkatësisht albanologjike ndër arbëreshët e Italisë.

Në plan të parë ai theksonte kontributet e tre personaliteteve pak të njohura dhe veprat e dorëshkrimit e tyre: “dorëshkrimet e Gjergj Guxetës, punimet historike-gjuhësore të Pal Maria Parrinos si edhe veprat etnografike, leksikografike dhe gramatikore të Nikollë Ketës. Lulëzonte, në atë kohë, - theksonte Profesor Jup Kastrati, - në Sicili e në Kalabri, një veprimtari e gjallë studimesh shqiptare. Gjatë atij qindvjeti, në jetën mendore të arbëreshëve dhe të prodhimit letrar të tyre zënë e shfaqen elemente të reja, të cilat paralajmërojnë e përgatisin kthesën e madhe, që u shënuar në pjesën e parë të shekullit XIX, me zhvillimin e fuqishëm e lulëzimin e një letërsie artistike me frymë atdhetare. Shkruhen latinisht e italisht punime historike mbi të kaluarën e Shqipërisë e historinë e ngulimeve arbëreshe të Italisë”¹⁸.

Një aspekt tjetër i dytë, shumë domethënës i konstatimit të Profesor Jup Kastratit, i cili nuk mund të thuhej lehtë dhe i cili nuk mund të thuhej pa njohje të thellë e të gjerë të të panjohurave në historinë e albanologjisë, kishte të bënte me njohjen e kësaj trashëgimie, pavarësisht se një pjesë e saj nuk ishte botuar dhe fshihej si dorëshkrime në arkivat e kishave katolike e ortodokse të arbëreshëve të Italisë, por e cila ishte zbuluar, ishte njohur e lexuar nga një brez i tërë studiuesish të proveniencës austro-gjermane. Prandaj, duke i pasur të njohura këto zhvillime Profesor Kastrati, theksonte me guximin të cilin nuk e kishin edhe shumë bashkëkohës të tij, se: “veprat e dijetarëve arbëreshë, mendimet si dhe arritjet e tyre u shfrytëzuan me përfitim e me dobi nga disa albanologë të huaj, shpeshherë

“Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985, f. 445; *Nilo Katalano (Nilo Catalano) (1637 - 1694)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985, f. 461; *Kolegji arbëresh i Sh. Adrianit (1734)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985, f. 486; *Gaetano Petrotta (1882 - 1952)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985, f. 824; *Seminari Arbëresh i Palermos (30.XI.1730)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985, f. 952.

¹⁸ Jup Kastrati, *Histori e albanologjisë*, Tiranë, 2000, f. 315.

pa u përmendur fare të dhënat e idetë e tyre, formulat dhe ekuacionet e tyre”¹⁹.

Aspekti i tretë i këtij konstatimi merrte dimensione të një mesazhi, të cilit studiuesit shqiptarë dhe jo vetëm ata, do t'i përgjigjen vetëm rreth sy dekada më vonë, e kjo është porosia e Profesor Jup Kastratit për brezat e tjerë të albanologjisë: “Është detyrë e dijetarëve të gjuhësisë shqiptare bashkëkohore, që të gjurmojnë në thellësi të shekujve për të nxjerrë në dritë ndihmesat e vyera të të parëve tanë, të cilët, në kushte të papërshtatshme, krijuan një mendim shkencor dhe hodhën themele të shëndosha në shkencën shqiptare të studimeve albanologjike”²⁰.

Në botimet e para sintetike për personalitetet e shquara letrare, folklorike, etnografike, historike e sidomos gjuhësore, Profesor Jup Kastrati theksonte për secilin prej tyre kryesisht veçoritë tematike, kombëtare të letërsisë (për Jeronim de Radën); shërbimin e vyer për gjuhën dhe kulturën kombëtare (Dhimitër Kamardën); rëndësinë e dorëshkrimeve të tij në fushë të gramatikës dhe leksikografisë (Nilo Katalanon); mbajtjen gjallë të gjuhës shqipe ndër arbëreshët, dashurinë për atdheun e të parëve dhe traditat e shquara të shqiptarëve (Kolegji Arbëresh i Shën Adrianit).

Do të duhet shumë kohë, për të mos thënë edhe disa dekada të demokracisë politike shqiptare, që çështja e kufijve të Rilindjes Kombëtare të hapet përsëri në dy drejtime: në thellësinë e saj, në të vërtetë në Pararilindjen e saj arbëreshe, të cilën e rihapi profesori Françesko Altimari²¹ dhe në dokumentin e një Lëvizjeje të brendshme të saj, të cilën e dëshmoi gjerësisht Profesor Xhevat Lloshi me veprat historiko-gjuhësore, sintezat shkencore dhe me botimet dokumentare²². Profesor Xhevat Lloshi ka dokumentuar edhe një pikëpamje të Norbert Joklit për Jernei Kopitarin (1780-1844), jo vetëm si themelues i shkencës së sllavistikës po edhe i

¹⁹ Jup Kastrati, Po aty., f. 315.

²⁰ Po aty., f. 315.

²¹ Shih, ligjëratën e tij, në Seminarin e Prishtinës, *Jeronim De Rada dhe roli i tij në rilindjet arbëreshe dhe zanafilla e rilindjes kombëtare shqiptare*. <https://sot.com.al/>

²² Shih vëllimet studimore dhe dokumentare të Profesor Xhevat Lloshit, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, 2005; *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit : 1819-1827*, 2012; *K. Kristoforidhit “Bibla: (në gegërisht) Kriesa. Të dalëtë”, 1872.* (Shoqëria Biblike, 2009); *Psalmet” gegërisht dhe toskërisht të Kostandin Kristoforidhit*, 2015; *Psalmet gegërisht dhe toskërisht* (2015); *Pesë libra të Dhiatës së Vjetër në versionin toskërisht 1882-1884* (Të Bërëtë; Të Dalëtë; Nom i Dytë; Fialët e Urta të Sollomonit; Isaia).” (2017); *Historia e Shkrimit të Shenjtë (1870 e 1872) dhe Katër katekizma (1867 e 1872).*” (2017); *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike. I. 1815-1883*”, Tiranë, 2017; *Udhëkryqet e Kristoforidhit dhe aventura e librit shqip*, Tiranë, 2021; *Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit. Vëllimi I. Jeta, veprimtaria dokumente dhe shkrime. Vëllimi II. Dokumente dhe shkrime*, Shkup, 2019 etj.

albanologjisë²³, me çka albanologjia edhe në rrethet shkencore europiane del të jetë më e motshme se sa e njohim ne me *Studimet shqiptare*(1854) të Hahnit. Gjatë kësaj kohe kufirin e zhvillimit të mendimit shkencor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e kishte lëvizur edhe intelektual i shquar i kësaj kohe Nelson Çabej²⁴.

Profesor Françesko Altimari e hapi diskutimin e kësaj çështjeje të rëndësishme për trashëgiminë tonë duke e vënë theksin në dy përbërës të rëndësishëm: “albanizmin”, koncept ky, siç thoshte Altimari, i cili nuk duhet të ngatërrohet me nacionalizmin, sepse koncepti i albanizmit ka të bëjë me njohjen e rrënjëve të popullit dhe historisë tënde”²⁵. Në këtë rrjedhë ai shihte dy “rilindje” arbëreshe të cilave u paraprinë Seminaret italo-greke arbëreshe. E para ishte rilindja e mendimit shkencor për gjuhën dhe identitetin, ndërsa e dyta rilindja kulturore e kontributit të saj në formimin gjithëkombëtar e shtetëror.

Duke ju referuar ndikimit të gjuhës dhe madje jo vetëm asaj po edhe muzikës e pikturës, studiuesi i shquar i miteve, nacionalizimit dhe vetëdijes kombëtare përgjithësisht, Anthoni Smith veç tjerash theksonte: “Roli i jashtëzakonshëm i filologëve, gramatikanëve dhe leksikografëve në aq shumë nacionalizma, përtregon rëndësinë që i kushtohet gjuhës si një kod autentik simbolesh, që mëshiron përvojat e brendshme dhe unike të etnisë. Megjithëse gjuha nuk është i vetmi aspekt domethënës i kombit, siç pretendonin shumë nacionalizma të Europës Qendrore dhe Lindore dhe, siç duket e hedhin poshtë shumë nacionalizma në Afrikë dhe në Azi, ajo mbetet një fushë simbolike dhe vitale e autentifikimit dhe mobilizimit të gjuhës amtare.”²⁶

Pararilindjes, përkatësisht Rilindjes së parë arbëreshe i priu manifesti përkatësisht fjalimi i At Gjergj Guxetes, i botuar në librin “De Albanesium Italia ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint” (1780), ashtu sikur i priu Rilindjes Kombëtare *Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë*(1846) e Naum Veçilharxhit.

Rilindja e parë, përkatësisht *Pararilindja*, nuk pati ndikim të madh në atdhe përkatësisht në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vend dhe në diasporën e lidhur ngushtë me Shqipërinë; ndërsa e dyta, Rilindja e Zgjimit Kombëtar, ishte e lidhur ngushtë me zhvillimet kulturore, ekonomike, politike dhe së fundi arsimore në Shqipëri e në diasporën kryesisht Lindore rreth saj. E para, ishte e lidhur ngushtë me zhvillimet politike, kulturore,

²³ Shih, veç tjerash Xhevat Lloshi, *Udhëkryqet e Kristoforidhit dhe aventura e librit shqip*, Tiranë, 2021 f. 76.

²⁴ Shih veprën *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare*, Tiranë, 1980, f. 115-188.

²⁵ Shih Altimari, *Jeronim De Rada dhe roli i tij në rilindjet arbëreshe dhe zanafilla e rilindjes kombëtare shqiptare*. <https://sot.com.al/>.

²⁶ Anthony D. Smith, *Kombet dhe nacionalizimi në erën globale*, Tiranë, 2008: 79; Shih edhe veprën tjetër *Nacionalni identitet*, Beograd, 2010; si edhe *Krijimi i identiteteve kombëtare*, Prishtinë, 2004.

arsimore dhe madje shkencore të Europës Perëndimore, duke pasur më tej edhe ndikimin e saj; ndërsa e dyta e lidhur ngushtë me zhvillimet politike, kulturore dhe nacionale me popujt e tjerë të Europës Juglindore, për më tej, duke marrë pjesë gjerësisht në Lëvizjet Çlirimtare të këtyre popujve, sidomos grekëve, rumunëve dhe bullgarëve.

E para, u bë fryma e Rilindjes së dytë arbëreshe dhe Rilindjes Kombëtare në përmasa europiane; ndërsa e dyta, i bëri të përhershme dhe i jetësoi synimet e popullit shqiptar: gjuhën shqipe, shkollën në gjuhën shqipe, nacionalizimin politik, përkatësisht identitetin shqiptar dhe shtetin shqiptar.

Le të thuhet më në fund se Rilindja e parë, *Pararilindja* arbëreshe e bëri europianizimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar më parë se sa këtë ta bënte Lëvizja Protestante në Shqipëri²⁷ dhe më parë se sa këtë ta realizonte Lëvizja Kombëtare (identitare, kulturore, politike, arsimore dhe ushtarake), përkatësisht Rilindja Kombëtare në Shqipëri dhe në Diasporën e lidhur ngushtë me Shqipërinë etnike të katër Vilajeteve.

Rilindjen e parë e themeloi dhe e drejtoi prifti arbëresh At Gjergj Guxeta (Hora e Arbëreshëvet, 1682 - Partinik, 1756)²⁸, themeluesi i Seminarit Arbëresh të Palermos (1734), dhe autor i Manifestit historik kombëtar me titull *Mbi të drejtat që kanë mbi Shqipërinë Mbretërit shumë të ndritshëm të të Dy Sicilive, e prandaj mund të marrin titull Mbretëresh e Despotësh, dmth. Zotrinjsh të saj*(1740), si dhe me emrin e të cilit lidhet edhe zbulimi i parë i veprës më të vjetër të njohur shqip, *Meshari* i Gjon Buzukut (1555).

Përcaktimi i studiuesve shqiptarë për kufijtë e tanishëm të Rilindjes Kombëtare, besoj erdhi si rezultat i ndikimit të shkollës albanologjike gjermane dhe austriake, të cilët Zgjimin kombëtar të shqiptarëve e shihnin dhe në kuadër të zgjimit kombëtar të popujve të tjerë të Europës Juglindore. E vërteta disa prej popujve të Europës Juglindore i filluan para shqiptarëve kryengritjet popullore kundër Perandorisë Osmane, por në kontekst të Lëvizjes mendore kombëtare, shqiptarët, përkatësisht diaspora e saj arbëreshe, këtë Lëvizje e kishte filluar shumë më herët. Studiuesit shqiptarë më tej e bënë të vetin këtë koncept dhe Rilindjen Kombëtare e

²⁷ Dokumente të rëndësishme të kësaj Lëvizjeje për herë të parë, kishte botuar Profesor Xhevat Lloshi, shih: *Të dhëna dokumentare të reja mbi veprimtarinë e V. Meksit, G. Gjirokastritit dhe K. Kristoforidhit*, në "Studime filologjike", Tiranë, 1973/4, f. 167-185; 1974/, f. 97-147; 1974/2, f. 127-157; 1974/3, f. 173-193.

²⁸ Shih veprat dhe dorëshkrimet e tij: *De Albanensium Italie rite excolendis ut sibi totique S. Ecclesie; Cronica della Macedonia fino ai tempi di Skanderbeg; Etimologico; De Albanensium Italie rite excolendis ut sibi totique S. Ecclesie* (ribotim italisht, *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, Palermo 2007) [Respektimi i ritit në mesin e arbëreshëve të Italisë, sepse ajo do të shërbejë për të ndihmuar veten dhe të gjithë Kishën]; *Del diritto che hanno i serenissimi re di Sicilia sopra l'Albania, onde ben possono intitolarsi re e despota, cioè signori di essa*, Napoli 1740.

panë në kontekst edhe të Lëvizjeve të tjera kombëtare të Europës Juglindore. Rilindja Kombëtare Shqiptare, përkatësisht zgjimi arsimor, politik dhe ushtarak është zhvilluar paralel edhe me rilindjet e tjera kombëtare të popujve të Europës Juglindore.

Studiuesi Artan Puto, duke komentuar një vepër të studiuesi çek Miroslav Hroch, Rilindjen Kombëtare të popujve të Evropës e ka ndarë në tri faza kryesore. Sipas tij: *faza A* është periudha e interesit intelektualo-studimor mbi gjuhën dhe kulturën e një kombi të caktuar (Faza e pararilindjes kombëtare shqiptare e zhvilluar brenda Diasporës historike arbëreshe, v.j.); *faza B* është periudha e veprimtarisë patriotike (Lëvizja kombëtare, së cilës i prinë intelektualisht dhe politikisht iluministi Naum Veqilharxhit, 1846, v.j.); dhe *faza C* është periudha kur lëvizja kombëtare nga një lëvizje kryesisht e shtresës së intelektualëve patriotë shndërrohet në një lëvizje masive që prek edhe shtresat e tjera të popullsisë (Periudha e angazhimit ushtarak, përkatësisht periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 1978-1981. v.j.)²⁹.

Do të duhen jo vetëm disa ndryshime shoqërore në jetën e popullit shqiptar dhe konceptuale në mendimin shkencor në fushë të albanologjisë, por edhe disa zhvillime të tjera në jetën akademike, për të ridimensionuar disa aspekte etnografike, kulturore e identitare në historinë kombëtare, në historinë e letërsisë shqipe dhe në albanologjinë përgjithësisht, për të kuptuar e pranuar pohimet e Profesor Jup Kastriotit. Do të duhen të botohen disa vepra mbi përlindjen nacionale në Europë³⁰; do të duhen të botohen disa vepra mbi lindjen dhe zhvillimin e nacionalizimit në Ballkan e Perandorinë Osmane në përgjithësi dhe ndër shqiptarët në veçanti³¹; do të

²⁹ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*, Tiranë, 2012: 137. Shih edhe Patrik Geary, *Miti i kombeve*, Tiranë, 2009.

³⁰ Shih veç tjerash, Miroslav Hroch, *Social Preconditions of National Revival in Europe (A Comparative Analysis of the Social Composition of Patriotic Groups among the Smaller European Nations)*, Cambridge University Press, 1985; E. J. Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, (Programi-miti-Realiteti), Tiranë, 2012, sado pikëpamjet e tij për arsyen e përzgjedhjes së alfabetit latin nga shqiptarët nuk janë bindëse (shih, f. 199); Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare. Europa e shekujve XVIII - XX (Originali: La création des identités nationales, Europe XVIII – XX siècle)*. Shqipëroi: Etleva Shiroka, Prishtinë, 2004 etj.

³¹ Shih veç tjerash veprën e Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*, Tiranë, 2012. Megjithëse një sintezë me mjaft ndikim në zhvillimet shkencore për shqiptarët, fakti se kjo autore i përjashton disa autorë, për të mos thënë autorët më të shquar të letërsisë së rilindjes kombëtare, sikur janë Profesor Dhimitër S. Shuteriqi dhe Profesor Rexhep Qosja, andaj arritjet e saj i bën mjaft të pasigurta. Një vepër posaçërisht e kësaj sinteze historike të Rilindjes Kombëtare është ajo e Miroslav Hroch, *Social Preconditions of National Revival in Europe (A Comparative Analysis of the Social Composition of Patriotic Groups among the Smaller European Nations)*, Cambridge

duhen të botohen sinteza e dokumente për kulturën arbëreshe³², Lëvizjen Protestante në Ballkan e Perandorinë Osmane³³ dhe sidomos dokumentet për Konstantin Kristoforidhin dhe epokën e tij³⁴, për të parë e bërë përpjekjet e para për ridimensionimin e zhvillimit të Rilindjes Kombëtare ndër Shqiptarët³⁵.

Zhvillimi i mendimit shkencor kombëtar mbi hapësirën, kolonitë, temat e mëdha, personalitetet përfaqësuese të Rilindjes Kombëtare tashmë shkante drejt majave jo vetëm me studimet, veprat dhe sintezat e mëdha të historianëve dhe studiuesve të letërsisë, po edhe të gjuhëtarëve,

University Press, 1985. Ky libër është një përkthim i rishikuar i dy veprave të studiuesit Miroslav Hroch, të cilat së bashku formojnë një analizë krahasuese pioniere të betejave të ndryshme për identitetin kombëtar në Evropën e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ajo ka të bëjë me fazën vendimtare të 'rilindjes kombëtare', kur grupe të vogla patriotësh të përkushtuar gjeneruan me sukses mbështetje masive. Kur dhe pse ishte efektive propaganda e tyre? Autori përpiqet t'i përgjigjet kësaj pyetjeje themelore duke i lokalizuar patriotët brenda strukturës bashkëkohore shoqërore dhe përdor të dhëna që rrjedhin nga shumë nacionalizma të ndryshëm. Puna është e ndarë në tre seksione; një shqyrtim teorik i origjinës së nacionalizmit dhe kombësisë, një studim sasior i strukturës shoqërore dhe territoriale të patriotëve të tetë lëvizjeve përfaqësuese kombëtare dhe një analizë krahasuese e grupeve shoqërore dhe profesionale që formuan mjedisin e patriotizmit. Tabelat dhe hartat e shumta statistikore ndriçojnë tekstin, i cili përbën një nga studimet më domethënëse të fenomenit nationalist që do të botohet vitet e fundit. (Shënim i botuesit)

³² Shih veç tjerash, veprat e Profesor Mateo Mandalasë: Ndër të tjera, ka botuar: *La diaspora e il ritorno* (1990); *Mito, storia e cultura tradizionale nell' opera di G Schirö* (1992); *Nicolo Figlia, Il codice chieutino (edizione critica e concordanza)* (1995); *Luca Matranga, E mbsuame e krështerë. Edizione critica dei tre manuscritti e dell' edizione a stampa* (2004); *Nicolo' Chetta, Nel bicentenario (1803-2003)* (2004); *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia* (2005); *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe* (2006); *Kënga e sprasëme e Balës (II Conto ultimo di Bola) di Gabriele Dora junior*, Edizione critica (2007); *Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe* (2007); *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia* (2012); *Gjurmime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe* (2012); Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra. Mbi botimin kritik të varianteve në dorëshkrim e të shtypur të veprës "E mbsuame e krështerë" (1592) (2013).

³³ Shih veç tjerash, David Hosaflook, *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816–1908* (The Protestant Movement among the Albanians, 1816–1908) (Sample), 2019, ISBN 978-608-4897-08-8, 1286 Views, 185 Pages.

³⁴ Shi veç tjerash veprat *Kristoforidhi përmes dokumentimit* (2005), *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirakastritit* (2012), *Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në vendet e huaja: 1820-1924* (2017), *Shoqëri e të Shtypuri Shkronja Shqip dhe veprimtaria e saj: 1879: përmbledhje studimesh dhe artikujsh me rastin e 140 (njëqind e dyzet) vjetorit të themelimit 1879-2019*, (bashkautor) (2019) etj.

³⁵ Shih veç tjerash: Xhevat Lloshi (1973/1974), Jup Kastrati (1986, 2000 etj), Françesko Altimari (2018) etj.

etnografëve, folkloristëve, botuesve të dokumenteve etj. Ndryshe nga studimet, veprat dhe sintezat për autorët e tjerë (Jeronim de Radën, Naim Frashërin, Jani Vreton, Thimi Mitkon e rilindës të tjerë), studimet për Naum Veqilharxhin kanë qenë posaçërisht të vona. Vetëm në vitin 1936 Fehim Zavalani, do të shkruajë artikullin e parë për raportet ndërmjet Naum Veqilharxhit dhe Naim Frashërit, për të vazhduar me një tekst përmbledhës biografik të Ilo Mitko Qafëzezi, për korçarin Vithkuqar Naum P. Predhasi Veqilharxhi si prekusori më i parë i zgjimit kombëtar (1937), me artikullin e Sevasti K. Dakos, me lajmin për gjetjen e *Abetares* së Naum Veqilharxhit të shtypur më 1844 etj. Më tej, artikuj, tekste personale e krahasuese kanë shkruar edhe studiues të tjerë, shqiptarë e rumunë, si: Dhimitër Fullani, Nasho Jorgaqi, Petraq Pepo, Bedri Dedja, Myslim Islami, Yll Zajmi, Ahmet Kondo, Vehbi Bala, Dhimitër S. Shuteriqi, Kornela Sima, Mahir Domi, Thanas Gjika e studiues të tjerë, por studimin e parë me karakter monografik *Naum Veqilharxhi*³⁶ e bëri Dhimitër S. Shuteriqi, duke saktësuar disa aspekte të karakterit historik e jetësor të tij në raport me nipin, politikën greke e rumune, në raport me sistemin otoman dhe së fundi të vërtetën e helmimit të tij, ndërsa veprën e parë monografike për Naum Veqilharxhin e ka shkruar Muslim Islami³⁷ dhe sintezën më të plotë brenda korpusit të veprës prej tre vëllimesh të *Historisë së letërsisë shqipe* (Romantizmi, 1-3) e ka bërë Profesor Rexhep Qosja³⁸. Veçori e parë e vendit të Naum Veqilharxhit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, përkatësisht Rilindjen Kombëtare Shqiptare, është fakti se jeta e tij trajtohet brenda studimit të hapësirës gjeografike të Rumanisë³⁹, ku u zhvillua Rilindja Kombëtare, ndërsa jeta dhe vepra brenda paraqitjes së personaliteteve të kohës, duke e vënë atë në vend të parë⁴⁰. Një veçori posaçërisht e rëndësishme e vendit të tij në Lëvizjen Kombëtare është fakti se Profesor Qosja ditëlindjen e tij e vendos si referencë të parë të fillimit të

³⁶ Shih, Dhimitër S. Shuteriqi, *Naum Veqilharxhi*, në “Nëntori”, nr. 4. 1974, Tiranë; ribotuar në librin *Gjurmime letrare*, Tiranë, 1974. f. 218-260.

³⁷ Myslim Islami, *Naum Veqilharxhi, Ideologu i parë i Rilindjes Shqiptare*, “8 Nëntori”, Tiranë 1977.

³⁸ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe* II, “Rilindja”, Prishtinë, 1984, shih Naum Veqilharxhi, f. 7-37.

³⁹ Shih kapitullin e parë *Struktura hapësinore: Atdheu dhe kolonitë; Kolonia e arbëreshëve të Italisë; Kolonia e Stambollit; Kolonia e Bukureshtit; Kolonia e Kajros; Kolonia e Sofjes; Atdheu; Çintegrimi i romantizmit*. (Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, (Romantizmi, I), 1984)

⁴⁰ *Naum Veqilharxhi (1797-1846): Romantikët shqiptarë - pararojë historike e Kombit; Rrethanat evropiane të veprimtarisë së Naum Veqilharxhit; Rrethanat kombëtare të veprimtarisë së Naum Veqilharxhit; Revolucioni grek dhe Rilindja Shqiptare; Kombi dhe gjuha e tij; Kombi dhe arsimiti i tij; Kombi dhe alfabetimi i gjuhës së tij; Kombi dhe historia e tij; Kombi dhe ardhmëria e tij; Zhvillimi dhe përsosja e gjuhës; Ndërmjet Scilës dhe Haribdës*. (Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe* (Romantizmi, II), 1984).

Romantizmit, krahas ngjarjeve historike të rrafshit kombëtar dhe europian, për vitin 1797: Lindet Naum Veqilharxhi.

- a. Ali Pashë Tepelena i shkruan Napoleon Bonopartit dhe kërkon t'i dërgojë dy instruktorë të artilerisë dhe dy bombardues.
- b. Fridrih Vilhelm Jozef von Sheling: *Ideen zu einer Philosophie der Natur I* (Filozofia e natyrës I). Lajpcig⁴¹

për ta saktësuar dhe ridimensionuar edhe njëherë jo vetëm me referencën historike, po edhe atë shpirtërore mbi të cilën krijohet letërsia: “ai, objektivisht, e shënon fillimin e një ndërgjegjeje të re në jetën e popullit shqiptar mbi të cilën, tani e tutje, do të krijohet letërsia shqipe”⁴²; (...) sado, disa prej tyre, nuk do t'i njohin drejtpërdrejt shkrimet e tij, kurse disa të tjerë krejt veprën e tij do ta zbresin në alfabetin”⁴³. Këtë fakt Profesor Qosja e kishte theksuar me të drejtë, se emri i Naum Veqilharxhit dhe fragmentet nga vepra e tij letrare a dokumentare mungojnë në disa nga botimet më të rëndësishme të kohës: në veprën e vëllimshme të Gaetano Petrotës, *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare* (1932) dhe në antologjinë *Nga letërsija shqipe* [mbledhë prej Hasan Vokshit e Idriz Ajetit], Prishtinë, 1951. Në të vërtetë, megjithëse *Ëvetarët* e tij nuk përbënin thjesht një alfabet po edhe tekste të përkthyer, ato nuk mjaftojnë që bashkëkohësit e tij të krijojnë një mendim tjetër më të lartë për pikëpamjet krijuese dhe filozofike të veprës së tij, në ato përmasa që më vonë do t'i krijojnë për pasardhësit e tjerë të Rilindjes Kombëtare.

Naum Veqilharxhi ishte njëri prej intelektualëve të formuar në frymën e dijes europiane të kohës, i cili gjatë jetës së tij jo shumë të gjatë, bashkonte virtytet patriotike me kulturën politike kombëtare dhe rajonale. Që në moshë të re e shohim të përpiqet që krahas intelektualëve të popujve të tjerë të pushtuar nga Perandoria Osmane të merrej me krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe (1924), e kjo do të thotë me vetëdijen e tij për gjuhën shqipe si një nga gjuhët universale⁴⁴, e kjo do të thotë të merrej me zgjimin kombëtar. Angazhimet në Lëvizjet kryengritëse dhe në lëvizjen kombëtare të popujve të shtypur bënë që vitet e fundit të jetës së tij të punonte në dy drejtime: të botonte dhe të shpërndante *Ëvetarët*⁴⁵, si dhe të

⁴¹ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, (Romantizmi, I) , 1984, f. 431.

⁴² Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe* II, “Rilindja”, Prishtinë, 1984, shih Naum Veqilharxhi, f. 32.

⁴³ Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe* II, “Rilindja”, Prishtinë, 1984, shih Naum Veqilharxhi, f. 34.

⁴⁴ Shih, Umberto Eko, *Në kërkim të gjuhës së përkryer*, Tiranë, 2008, f. 263.

⁴⁵ Shih, Abetaret: *Fort i shkurtër e i përdorshim Ëvetar shqip*. Për çdo sicilë që do të mponjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip. Mot i parë 1844; dhe *Fare i ri Ëvetar shqip për djelm nismëtorë nxjerrë e dhënë mbë dritë tani herën e parë, për djelm të vegjël me një të zgjedhur nga disa gjë të mirash e të fitimëshme*. Mot' i dytë. 1845.

shkruante e të shpërndante *Programin ideor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, në themelet e së cilës parashikonte përgatitjen dhe zgjimin kombëtar përmes të nxënimit sa më të mirë të gjuhës shqipe, dijes dhe shkollimit⁴⁶. Të parat, pra *Abetaret*, e bëjnë të njohur dhe kombëtarisht të vlerësuar për shkak të kontributit të tij për shkollën shqipe, ndërsa të dytat (*Programi i Zgjimit Kombëtar*) do ta helmojnë, për shkak të rëndësisë së tyre në Lëvizjen Kombëtare për fillimin e vetëdijesimit të kombit të tij mbi përbërësit kryesorë të trashëgimisë, gjendjes dhe perspektives kombëtare. Helmimi i tij prej filogrekësh shqiptarë dhe të huaj, ndërkaq dëshmon edhe për shfaqjen e një paradigme tjetër historike të qëndrimit të fqinjëve tanë, praninë e shovinizmit të brendshëm të institucioneve fetare politike të tyre, krahas dëshirës popullore për liri.

Në Vitin e Madh 1968 Profesor Yll Zajmi botoi si paradigme të zhvillimeve të kohës (*Demonstratat e studentëve, 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, Konsulta e Prishtinës, ligjërimi i Flamurit shqiptar në ish-Jugosllavi, përgatitjet për Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 1972 etj.*), *Pasthënien e dytë të Ëvetarit (1845)*, me titull *E parëthën me mbi djemt e rinj shqiptarë*, të cilën e nxori nga botimi i kolanës “*Kalendari Kombiar*”, Sofje, 1900. Prej këtij studimi po e sjellim vetëm listën e fjalëve me shpjegime nga Profesori ynë Yll Zajmi, jo pse kjo listë nuk është plotësuar dhe shpjeguar gjerësisht në botimet e tjera, sidomos nga Profesor Qosja, por pse duam që me këtë ta nderojmë Profesorin, i cili këtë tekst e botoi me shënime për nevojat e studentëve dhe në një moment të rëndësishëm historik për shqiptarët nën ish-Jugosllavi:

Tërë ndriçim: *Shumë të ditur*; Të qyteçmë: *të qytetëruar*; E ndëdyshme: *e dyshimtë*; Të pangjajmë: *të ndryshëm nga të tjerët, që s'u ngjasim*; Dora: *fara, raca*; Të punohen: *të japin e të marrin, korrespondojnë*; Të shkruajmë: *gjëra të shkruara, libra*; Lehsimë: *lehtësinë*; Shënimet: *shenjat*; Ëvet: *shkronjat. Fjalë e krijuar me shkronjat ë dhe v të alfabetit*; Të lartë: *të lindur*; Ië larturit: *për: të lindurit*; Fletore: *libër. Fjalë që mbeti në gjuhë me kuptimin: radhua, gazetë*; Parnderjet: *preferohet*; Thëres: *shpall, leçis, them me zë të lartë para botës*; Mkotë: *mëkotë, kotë*; Gjithimjen: *shumicën*; Kamësit: *pasanikët. Të varfërit i quan skamës*; Ndërduarçmje: *ndërmarrje*; Së nisure: *iniciativë*; Detyrën: *borxhin*; Vëntlermin: *vendlindjen, atdheun*; Kuvise: *shprehje*; Solla mbë shëmbëll: *përfytyrova*; Nismëtorë: *fillestarë*; Tërësjelltur: *përkthyer*; Të derthtonj: *derdh, krijoj, hartoj*; Vetime: *vetija, natyra*; Save: *sa prej tyre*; Sesinë: mënyrën; Tërëtherta kaqë gjëmë kohë: *sakrifikova kaq shumë kohë. Kristoforidhi krijoj therore për sakrificë*; Të pambaruara: *të papërkryera*; Mbaruara: *të përkryera. Kjo fjalë është përdorur edhe nga rilindasit e tjerë. Shtambë: shtyp. Fjala “shtypshkronjë” u krijua prej Kristoforidhit. Gjithë shkrimtarët para tij përdornin fjalën “shtambë”*; Të rëndit: *rëndësinë*; Shtoni: *këtu: dijen*; Dondermjës: *që do të*

⁴⁶ Shih letrat e njohura: *Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë, 1846*; dhe *Letër Jani Calit, 1846*.

mbahet për nder; Vetija: vetja; Të veçme: të veçanta; Mbarë-prapë: mirë-keq; Shpëronj: shpresoj; Të lënë: pakujdesi⁴⁷.

Me jetën dhe veprën e tij Naum Veqilharxhi u bë pjesë e Lëvizjes intelektuale europiane, brenda së cilës gjendej edhe trashëgimia arbëreshe e Rilindjes së parë të saj, të shekullit XVIII. Naum Veqilharxhi u bë pjesë e Lëvizjes kryengritëse të popujve të shtypur në Perandorinë Osmane të gjysmës së parë të shekullit XIX duke udhëhequr bashkëkombësit e tij brenda kryengritësve rumunë, grekë dhe bullgarë. Në këtë mënyrë Naum Veqilharxhi u bë zëri mesianik i thirrjes për ndërgjegjësime, nxënie të gjuhës amtare dhe për pjesëmarrje në kryengritjen kombëtare. Kështu ai u bë përbashkuesi i mendimit intelektual për gjuhën dhe identitetin historik edhe në diasporën historike arbëreshe në Itali, me përpjekjen për vetëdijësimin kombëtar për gjuhën si identitet, si dhe me organizimin e kryengritjes kombëtare, si kusht i çlirimit nga Perandoria Osmane dhe nga rreziku i fundosjes në pellgun e shovinizmit ballkanik.

Abstract:

The founder of the National Renaissance, Naum Veqilharxhi, with his life and work became part of the European Intellectual Movement, within which was also the Arbëresh heritage of its first Renaissance, of the 18th century. Naum Veqilharxhi became part of the insurgent Movement of the oppressed people in the Ottoman Empire of the first half of the 19th century, leading his compatriots among the Romanian, Greek and Bulgarian insurgents. In this way, Naum Veqilharxhi became the messianic voice of the call for awareness, learning the native language and participation in the national uprising. Thus, he became the unifier of intellectual thought on language and historical identity even in the historical Arbëresh diaspora in Italy, with the effort for national awareness of language as identity, as well as with the organization of the national uprising, as a condition for liberation from the Ottoman Empire and from the danger of sinking into the pool of Balkan chauvinism.

Keywords: Keywords: Naum Veqilharxhi, National Renaissance, Balkan Movement, European tradition, Albanian language

Abstrakt:

Themeluesi i Rilindjes Kombëtare, Naum Veqilharxhi, me jetën dhe veprën e tij u bë pjesë e Lëvizjes Intelektuale Evropiane, brenda së cilës ishte edhe trashëgimia arbëreshe e Rilindjes së saj të parë, të shekullit të 18-të. Naum Veqilharxhi u bë pjesë e Lëvizjes kryengritëse të popujve të shtypur në

⁴⁷ Yll Zajmi, Naum Veqilharxhi (1797-1866). Përmbledhje punimesh III. Prizren 1968. *E parëthënme mbi djemt e rinj shqiptarë*. Është Pashënia e botimit të dytë (1845), E Naum Veqilharxhit, nxjerrë nga "Kalendari Kombiar", Sofje, 1900.

Perandorinë Osmane të gjysmës së parë të shekullit të 19-të, duke udhëhequr bashkëkombasit e tij në radhët e kryengritësve rumunë, grekë dhe bullgarë. Në këtë mënyrë Naum Veqilharxhi u bë zëri mesianik i thirrjes për sensibilizimin, mësimin e gjuhës amtare dhe pjesëmarrjen në kryengritjen kombëtare. Kështu ai u bë unifikues i mendimit intelektual për gjuhën dhe identitetin historik edhe në diasporën historike arbëreshe në Itali, me përpjekjen për ndërgjegjësimin kombëtar të gjuhës si identitet, si dhe me organizimin e kryengritjes kombëtare, si kusht çlirimi nga Perandoria Osmane dhe nga rreziku i zhytjes në pellgun e shovinizmit ballkanik.

Fjalë kyçe: Fjalë kyçe: Naum Veqilharxhi, Rilindja Kombëtare, Lëvizja Ballkanike, Tradita Evropiane, Gjuha shqipe

LITERATURA

- ALTIMARI, Françesko (2014). *Jeronim De Rada dhe roli i tij në rilindjet arbëreshe dhe zanafilla e rilindjes kombëtare shqiptare*. <https://sot.com.al/kultura/francesco-altimari-rilindja-e-par%C3%AB-arb%C3%ABreshe-daton-m%C3%AB-1780>. Botuar më 14 shkurt 2014. Cituar më 15.2. 2024.
- CLAYER, Nathalie (2012). *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*. Tiranë.
- ECO, Umberto(2008), *Në kërkim të gjuhës së përkryer*. Tiranë.
- ÇABEJ, Nelson, R.(1980). *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare*. Tiranë.
- GEARY, Patrik (2009). *Miti i kombeve*. Tiranë.
- Hobsbawm, E. J. (2012). *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780, (Programi-miti-Realiteti)*. Tiranë.
- HOSAFLOOK, David (2019). *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816–1908*. “Tenda”. Prishtinë.
- HROCH, Miroslav (1985). *Social Preconditions of National Revival in Europe (A Comparative Analysis of the Social Composition of Patriotic Groups among the Smaller European Nations)*, Cambridge University Press.
- ISLAMI, Myslim (1977). *Naum Veqilharxhi, Ideologu i parë i Rilindjes Shqiptare*. “8 Nëntori”. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1985). *Gaetano Petrotta (1882 - 1952)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”. Akademia së Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1985). *Nilo Katalano (Nilo Catalano) (1637 - 1694)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë
- KASTRATI, Jup (1985). *Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda) (1821 - 1882)*, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.

- KASTRATI, Jup (1985). *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1985). *Jeronim de Rada (1814 - 1903)*, "Fjalori enciklopedik shqiptar". Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1985). *Kolegji arbëresh i Sh. Adrianit (1734)*, "Fjalori Enciklopedik Shqiptar". Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1985). *Seminari Arbëresh i Palermos (30.XI.1730)*, "Fjalori Enciklopedik Shqiptar". Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
- KASTRATI, Jup (1989). *Histori e gjuhësisë shqiptare*. Pjesa e parë (1497 - 1944). Instituti i Lartë Pedagogjik 4 - vjeçar "Luigj Gurakuqi". Shkodër.
- KASTRATI, Jup (1991). *Dr. Pal M. Parrino - albanolog arbëresh*, "Universale", I, 1, 2, 8 dhjetor 1991.Tiranë.
- KASTRATI, Jup (2002). *Histori e albanologjisë*. "Argeta LMG". Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat (1973/1974). *Të dhëna dokumentare të reja mbi veprimtarinë e V. Meksit, G. Gjirokastritit dhe K. Kristoforidhit*, në "Studime filologjike", 1973/4, f. 167-185; 1974/, f. 97-147; 1974/2, f. 127-157; 1974/3, f. 173-193. Akademia e Shkencave. Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat (2017). *Historia e Shkrimit të Shenjtë (1870 e 1872) dhe Katër katekizma (1867 e 1872)*. Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat (2017). *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike. I. 1815-1883*". Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat (2019). *Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit*. Vëllimi I. *Jeta, veprimtaria dokumente dhe shkrime*. Shkup.
- LLOSHI, Xhevat (2019). *Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit*. Vëllimi I. *Jeta, veprimtaria dokumente dhe shkrime* Vëllimi II. *Dokumente dhe shkrime*, Shkup, 2019 etj.
- LLOSHI, Xhevat (2021). *Udhëkryqet e Kristoforidhit dhe aventura e librit shqip*. Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat(2009). *Konstantin Kristoforidhit "Bibla: (në gegërisht) Kriesa. Të dalëtë"*, 1872. (Shoqëria Biblike). Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat(2012). *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, 2005; *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit : 1819-1827*, 2012
- LLOSHI, Xhevat(2015). *Psalmet" gegërisht dhe toskërisht e Kostandin Kristoforidhit*. Tiranë.
- LLOSHI, Xhevat (2017). *Pesë libra të Dhiatës së Vjetër në versionin toskërisht 1882-1884* (Të Bërëtë; Të Dalëtë; Nom i Dytë; Fialët e Urta të Sollomonit; Isaia). Tiranë.
- QOSJA, Rexhep (1984). *Histori e letërsisë shqipe* (Romantizmi, II). "Rilindja", Prishtinë.
- QOSJA, Rexhep (1984). Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe* (Romantizmi, I) , "Rilindja". Prishtinë.
- SMITH, Anthony D.,(2004). *Krijimi i identiteteve kombëtare*. Prishtinë.
- SMITH, Anthony D.,(2008). *Kombet dhe nacionalizimi në erën globale*. Tiranë.
- SMITH, Anthony D.,(2010). *Nacionalni identitet*. Beograd.

SHUTERIQI, Dhimitër S. (1974). *Gjurmime letrare*. Tiranë.

THIESSE, Anne-Marie (2004). *Krijimi i identiteteve kombëtare. Europa e shekujve XVIII - XX* (Originali: La création des identités nationales, Europe XVIII – XX siècle). Prishtinë.

ZAJMI, Yll (1966) *Naum Veqilharxhi (1797-1866). E parëthënme mbi djemt e rinj shqiptarë*. Është Pashënia e botimit të dytë, 1845, nxjerrë nga “Kalendari Kombiar”, Sofje, 1900. Në *Përmbledhje punimesh III*. Prizren.

Ismet OSMANI

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi"
Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski", Shkup
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare
ismet_osmani@yahoo.com

**MBI LEKSIKUN TERMINOLOGJIK TË TEKSTEVE MËSIMORE NË
SHKOLLAT NËNTËVJEÇARE**

**ON THE TERMINOLOGICAL LEXICON OF TEXTBOOKS IN NINE-YEAR
SCHOOLS**

Analizimi i gjuhës së teksteve mësimore në disa lëndë mësimore të arsimit 9-vjeçar (gjeografi, matematikë, biologji, fizikë, kimi etj.), nxjerr në pah një sërë problemesh të karakterit shkencor dhe metodik, tekste të mbingarkuara, përkthime aspak cilësore, shtrembërime të historisë shqiptare, mangësi në shpjegimin e duhur konceptor të termave në përputhje me moshën dhe veçoritë psikofizike të nxënësve. Autorët e teksteve mësimore dhe hartuesit e plan-programeve vazhdojnë me anomalitë e mësimdhënies dhe përmbajtjet mësimore. Tekstet mësimore duhet të jenë model dhe udhëzues për të gjithë (arsimtarët dhe nxënësit), duke përmbushur të gjitha kriteret e nevojshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Autorët e teksteve mësimore janë të ngarkuar me problemin për të thënë gjithçka dhe u mungon hapësira për shtjellimin e hollësishëm të asaj që është më e rëndësishmja, sepse udhëhiqen nga shtrirja e përmbajtjes dhe jo nga parimet themelore të thelbit logjik të përmbajtjes. Tekstet mësimore në të shumtën e rasteve nuk nxisin interesimin e nxënësve dhe informacioni u duket jointeressant. Nxënësit, ndjehen të hutuar nga "turma" e fjalëve të pakuptueshme, të cilat bëjnë që të mos e kuptojnë as edhe mesazhin e autorit. Kështu, nxënësi, në vend që të motivohet, ai fillon të shmang tekstin dhe bën rezistencë ndaj përmbajtjes mësimore dhe ndaj vet arsimit, i cili madje edhe insiston në një material të tillë të konceptuar.

Për të shmangur të gjitha këto anomali të krijuara, libri, mbi të gjitha duhet parë në kontekst të përvetësimit të koncepteve dhe të shprehjes së qëndrimeve vlerësuese e vetëvlerësuese. Nxënësit duhen të

motivohen dhe nxiten të lexojnë për të qenë të aftë në përpunimin e informacionit gjatë leximit, përmes strategjive të mësimimit (Dankert, 2005). Tekstet mësimore në ciklin 9-vjeçar si objektivi të vetin duhet të kenë komunikimin shkencor, lidhjen me përditshmërinë, mendimin kritik e krijues etj.⁴⁸ Komunikimi, kultura e leximit dhe aftësitë e të shkruarit ua mundëson nxënësve ta kuptojnë gjuhën e komplikuar të mësimëve në klasë dhe gjuhën e teksteve mësimore.

Gjuha e teksteve mësimore

Bazuar në analizat mbi gjuhën e teksteve mësimore, me përjashtim të librave për lëndën e gjuhës shqipe si gjuhë amtare, vërehen ndikime dhe prurje nga shumë anë, sidomos nëpërmjet gjuhës maqedonase dhe nëpërmjet shqipes nga disa gjuhë të tjera të huaja. Vihet re se të gjitha tekstet mësimore (përveç librit të gjuhës shqipe), janë të përkthyer, gjë që paraqesin probleme gjuhësore në leksik, morfologji, sintaksë e drejtshkrim. Tekstet mësimore të përkthyer herë na paraqiten me emrin e përkthyesit e të redaktorit gjuhësor e herë jo, por në to përgjithësisht vihen re shmangie kryesisht leksikore. *“... fjalët marrin rëndësi kur ato dëshmojnë për një mënyrë të të menduarit, për një vështrim dhe paraqitje të caktuar. Gjuha është realiteti i drejtpërdrejtë i të menduarit. Kultura e fjalës është kultura e të menduarit.”*⁴⁹

Në shumicën e teksteve mësimore vërehet një gjuhë e vështirë dhe e pakuptueshme, e cila kërkon punë të njëkohshme të një numri të madh funksionesh të ndryshme njohëse, të cilat identifikohen me përkufizime dhe shpjegime abstrakte të koncepteve. Shumë njësi mësimore kërkojnë sqarime plotësuese, sepse shembujt e dhënë në to dëshmojnë për shumë paqartësi, të cilat u krijojnë vështirësi nxënësve në zgjidhjen e detyrave. Mungon lidhja midis koncepteve shkencore dhe spontane - të parët nuk rrjedhin nga të dytët, dhe asgjë nuk arrihet përveç përvetësimit bosh të fjalëve, verbalizimit të zhveshur, i cili simulon ekzistencën e koncepteve të përshtatshme të nxënësit, por në fakt mbulon vetëm një zbrazëtimë (Vigotski, 1983).

Shpeshherë jepen përkufizime abstrakte të termave me shembuj të përpunuar shumë pak, me një terminologji të papërshtatshme për moshën e nxënësve, me simbole të komplikuar. Nga ana tjetër, futen fjalë të reja të cilat edhe më shumë e vështirësojnë përvetësimin e njohurive. Të vështira për nxënësit janë jo vetëm terma, por edhe fjalët që për çdo ditë i dëgjojmë në komunikimin e të rriturve, që për nxënësit janë të pakuptueshme. Në vend që të pasurojnë fjalorin e nxënësve duke mësuar një numër të caktuar

⁴⁸ Shih: I. Hoti, F. Koleci, M. Gjokutaj, K. Shegani, *Gjuhë shqipe – Ushtrime dhe teste të zgjidhura*, Botime PEGI, Tiranë, 2019.

⁴⁹ Xh. Lloshi, mendimet dhe fjalët në “Normat letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973, f. 97.

fjalësh të reja për çdo njësi mësimore, ato pengojnë të mësuarit sepse teksti bëhet i pakuptueshëm dhe duket se është në gjuhë të huaj. Kështu, nxënësit detyrohen të mësojnë përmendësh, sepse ju mungojnë mjetet themelore të gjykimit dhe të mësimimit, si gjuha, dhe pastaj sistemet e tjera simbolike (Vigotski, 1983).

Mbi terminologjinë e teksteve mësimore

Leksiku terminologjik në tekstet mësimore përbën një nga fushat më të larmishme, që formësohet përmes sistemeve terminologjike të shkencave të dijes si pjesë e plan-programeve mësimore në sistemin parauniversitar. Terminologjinë e teksteve mësimore duhet parë mbi bazën e ndërtimit, të formimit të tij dhe të pranisë së dukurive semantike në të. Si i tillë, duhet dhënë në mënyrë të bashkërenditur dhe të realizuar përmes mjeteve gjuhësore të ndërlidhur midis tyre në mënyrë organike dhe të sistemuar, me përkufizime të sakta. Marrëdhëniet mes termave dhe përkufizimeve të tyre, vënë në dukje lidhshmërinë e termave me njëri-tjetrin.

Leksiku terminologjik i lëndës së gjuhës (fonetikës /fonologjisë/, morfologjisë dhe sintaksës që shpërfaqet në tekstet mësimore jepet thuasht i plotë në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe të shumë autorëve (Sh. Demiraj, R. Memushaj, R. Nesimi, R. Petro etj.); nga stilistika jepen njohuri mbi stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare; nga dialektologjia jepen njohuri mbi leksikun e shqipes sipas burimit, duke motivuar dallimin e fjalës shqipe nga fjala e huaj.

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë mbështetet në përvetësimin e rregullave të gramatikës së gjuhës shqipe (fonetikë (fonologji), morfologji, sintaksë, leksikologji, etj) dhe të letërsisë shqiptare. Gjithashtu, u ndihmon nxënësve në formimin gjuhësor e letrar (respektimin e rregullave gramatikore, zbatimin e gjuhës standarde shqipe, si dhe aftësimin për të lexuar, shkruar e analizuar pjesë të ndryshme letrare) dhe në përdorimin praktik të gjuhës shqipe në përditshmëri. Gjuha, si një repertor fjalësh, d.m.th. prodhimesh tingullore ose shkrimore (Martinet, 2002, 30), është një bazë e mirë në përvetësimin e njohurive edhe mbi terminologjinë e fushave të ndryshme.

Në tekstet mësimore të shkencave të ndryshme i hasim termat: *zanore, bashkëtingëllore, togje zanoresh, togje bashkëtingëlloresh* (fonetikë), *emër, mbiemër, numëror, përemër* (morfologji), *fjali, kryefjalë, kallëzues* (sintaksë), *leksik, fjalë* (leksikologji); *rreth, kënd, katror, kon* (gjeometri), *thyesat, teoria e numrave, barazimet e Diofanit, kongruenca, polinomet, kombinatorika, struktura algjebrike /unaza, grupe/* (algjebër) - *terminologji e matematikës; kinematika, dinamika, termodinamika, optika, akustika, rrezet katodike, fizika e materies*- terminologji e fizikës; *larva, kërpudhë, fotosinteza, qelizë, transpiracioni, citoplazma, enët përçuese ksilemike, floemike, stomet, kutikula* - terminologji e biologjisë.

Të gjitha këto terme, por edhe shumë të tjera, vështirësojnë komunikimin ndërmjet vet nxënësve, si në planin teorik, ashtu edhe në atë praktik, sidomos në fushat, të cilat mundësojnë një organizim produktiv të mendimit, përvetësimit të njohurive dhe zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive punuese. Një përdorim i tillë i tepërt pa ndonjë sqarim në gjuhën shqipe zvogëlon funksionin informativ, veprues dhe ekspresiv të gjuhës së nxënësit (gjuhës shqipe). Prandaj, duhet gjetur në vetvete mjetet dhe fjalët e nevojshme për të emërtuar termat e shkencave, të teknikës dhe të arteve për të qenë të qarta për nxënësin dhe arsimtarin.

Analiza e teksteve mësimore


Analizat e bëra mbi tekstet mësimore vënë në dukje seriozitetin e problemeve gjuhësore dhe dokumentojë në mënyrë empirike një varg vështirësish që i hasin nxënësit gjatë mësimimit me tekstet mësimore. Në këtë analizë, detyrë e parë është paraqitja e të dhënave në lidhje me përvojën subjektive të nxënësve se sa ata e përdorin tekstin mësimor dhe cilat janë vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë mësimimit; e dyta, nxënësit përmes anketës së bërë pohojnë për problemet gjuhësore të teksteve mësimore, të cilat, për mendimin e tyre, janë përgjegjëse për vështirësitë që kanë në nxënien e njësive mësimore.

Hulumtimi është bërë në disa shkolla të ciklit 9-vjeçar, me një numër të kufizuar të të anketuarve (80 nxënës). Janë analizuar tekstet mësimore të *gjeografisë, biologjisë, fizikës dhe kimisë*, por edhe disa tekste të tjera (etikë, hulumtim, libri i muzikës). Pyetjet e shtruar në anketë janë të natyrës së përgjithshme dhe u referohen teksteve mësimore – përdorimit të tyre, ku jepen të dhëna të ndryshme se pse tekstet mësimore janë të vështira për ta. Nxënësit theksojnë se teksti është shpesh i paqartë, teksti është i gjerë, ka fjalë dhe shprehje të pakuptueshme, shpjegimet janë të paqarta, nuk ka shembuj të mjaftueshëm, ka shumë ilustrime (disa thonë që ka pak ilustrime), detyrat janë të vështira, jointerese, kërkojnë njohuri në detaje. Përveç këtyre të dhënave, nxënësit vënë në dukje edhe vështirësi tjera specifike, si p.sh.: jepen shumë statistika dhe numra, shumë detaje dhe emra të vendeve (gjeografia); shumë fjalë dhe shprehje latine të pakuptueshme, përkufizime të pakuptueshme (biologji); shumë përkufizime të vështira, shumë matematikë (fizikë); përkufizimet janë të vështira, ka shumë formula (kimi).

Të dhënat janë përpunuar duke përdorur teknikat statistikore përshkruese: përqindja (%), mesi aritmetik. Këtu do të interpretohen vetëm të dhënat më të rëndësishme, d.m.th ato të dhëna të cilat jepen nga një e treta e nxënësve në klasë.

Libri i gjeografisë

Libri i gjeografisë nga klasa e gjashtë deri në të nëntën në parim është i vështirë, sepse (Grafiku 2) teksti është i gjerë (21%), ka shumë statistika dhe numra (18%), shumë detaje dhe emra të vendeve (18%) dhe fjalë të pakuptueshme (12%). Bazuar në të dhënat e siguruar nga anketimi, nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë thonë se shpjegimet janë të paqarta dhe kanë probleme me zgjidhjen e detyrave; ndërsa nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë theksojnë se në tekst ka shumë të dhëna statistikore, shumë detaje dhe emra të vendeve. Nxënësit, gjithashtu, përgjigjen edhe për përdorimin e librit (e përdorin shpesh apo rrallëherë) dhe përgjithësisht thonë se teksti i gjeografisë është i vështirë dhe nuk e përdorin. Në pyetjen se si i mësojnë mësimet pa e lexuar mësimin në libër? Një pjesë e madhe e nxënësve (38%) thonë se mësojnë nga shënimet që i marrin në klasë (nga diktimi i arsimitarit në klasë) (Grafiku 1).




Grafiku 1: Libri i gjeografisë së klasës VI, VII, VIII, IX

Libri i biologjisë

Në librat e biologjisë të klasës së shtatë, tetë, nëntë hasim shumë fjalë të pakuptueshme (15%), përkufizime të paqarta (13%), teksti në shumë vende është i paqartë (16%) dhe i gjerë (14%).

Të dhënat e siguruar nga hulumtimi dëshmojnë se nxënësit e klasës së gjashtë vënë në dukje edhe vështirësi të tjera, si .p.sh.: mungesën e shembujve, shpjegime të paqarta, probleme me detyrat e dhëna në tekst etj. Një numër nxënësish të klasës së shtatë mendojnë se libri është i vështirë,

në klasën e tetë vënë në dukje fjalët e pakuptueshme latine dhe gjerësinë e tekstit, ndërsa në klasën e nëntë, shpjegimeve të paqarta u shtohen edhe ilustrimet e përgjithshme. Është interesante që nxënësit me nota të ndryshme në lëndën e biologjisë theksojnë vështirësitë e njëjta, ndërsa nxënësit e shkëlqyeshëm që kanë vërejtje mbi tekstin janë me një përqindje më të vogël, të cilët, gjithashtu theksojnë përkufizimet e paqarta, tekstin e paqartë dhe të gjerë. Të gjithë nxënësit që, mesatarisht, kanë nota të pamjaftueshme në lëndën e biologjisë, mendojnë se teksti është i paqartë, se përkufizimet janë të pakuptueshme dhe se termat latinë janë të pakuptueshëm.




Grafiku 2: Libri i biologjisë së klasës VII, VIII, IX

Libri i fizikës

Libri i fizikës së klasës së tetë dhe të nëntë në tërësi paraqitet si i vështirë për shkak të (shih grafiku 4) fjalëve të huaja të pakuptueshme (17%), tekstit të paqartë (17%), përkufizimeve të paqarta (15%), shpjegimeve të paqarta (12%) dhe tekstit të gjerë (10%). Një e treta e nxënësve, pavarësisht nga suksesi i tyre në lëndën e fizikës, vlerësojnë se ka shumë matematikë në fizikë. Këtu janë përfshirë të gjitha kategoritë e nxënësve, përveç atyre me nota të pamjaftueshme dhe nxënësve të shkëlqyeshëm, të cilat nuk japin ndonjë vlerësim.

Bazuar në të dhënat, listës së vështirësive në përvetësimin e njohurive nga lënda e fizikës në klasën e tetë dhe të nëntë i bashkëngjitet edhe problemi i detyrave të kontrollit. Në klasën e tetë, libri është i gjerë, i

pakuptueshëm dhe i paqartë për disa nxënës. Të njëjtën gjë e thonë edhe nxënësit e klasës së nëntë. Të gjitha kategoritë e nxënësve i deklarojnë kryesisht të njëjtat probleme për mossuksesin e tyre. Përdorimi i fjalëve të pakuptueshme dhe teksti i paqartë janë ndër arsyet që i deklarojnë edhe nxënësit e shkëlqyeshëm, si dhe të gjithë ata që kanë notë të pamjaftueshme në lëndën e fizikës. Dallimi është vetëm në përqindje. Nxënësit (me nota mjaftueshëm dhe mirë) vënë në dukje përkufizimet e vështira dhe asnjëri prej tyre nuk e përdor librin e fizikës, sepse siç thonë, nuk e kuptojnë fare. Mësimet i mësojnë nga shënimet që i marrin në klasë nga arsimtari.




Grafiku 3: libri i fizikës së klasës VIII e IX

Libri i kimisë

Një numër i madh i nxënësve në klasën e tetë dhe të nëntë (Grafiku 5) nuk e përdorin librin e kimisë (16%), shumë nxënës thonë se ka shumë formula (14%) dhe se teksti është i gjerë (13%).

Në bazë të të dhënave, duket qartë se nxënësit kanë vështirësi në përvetësimin e njohurive nga lënda e kimisë. Ata thonë se teksti, në të shumtën e rasteve nuk kuptohet, shpjegimet në të janë të paqarta. Një numër pak më i vogël i nxënësve përmendin përkufizimet e vështira dhe fjalët e huaja të pakuptueshme si arsye të vështirësive. Ndërsa, nxënësit që kanë notën mjaftueshëm (2) dhe shumë mirë (4) thonë se në përgjithësi nuk e përdorin librin, ndërsa nxënësit që kanë nota të shkëlqyeshme (5) e mirë (3) thonë se kryesisht e përdorin librin. Përdorimi i librit të kimisë

ndryshon në varësi të suksesit të nxënësit, por jo në mënyrë specifike. Librin e kimisë e përdorin, ose nuk e përdorin, nxënësit që kanë nota të dobëta dhe nxënësit e mirë. Kjo pasqyrë mund të jetë pasojë e disa faktorëve të rastësishëm në mësimin e kimisë në shkollën ku është bërë sondazhi. Megjithatë, edhe nxënësit që kanë nota të dobëta, por edhe ata me nota të mira përmendin të njëjtat probleme lidhur me moskuptimin e librit të kimisë. Një pjesë dukshëm e madhe e nxënësve të klasës së tetë dhe të nëntë thonë se nuk e përdorin librin e kimisë, një pjesë thonë se e përdorin shumë rrallë. Pyetjes se nga i mësoni mësimet, një pjesë bukur e madhe e nxënësve u përgjigjen se mësojnë nga shënimet të cilat ua dikton arsimtari në klasë.



Grafiku 4. Libri i kimisë për klasën VIII e IX

Përfundim

Në mbyllje mund të themi se qëllimi i këtij punimi ishte të hidhte një vështrim të përgjithshëm mbi terminologjinë e teksteve mësimore. Rezultatet e hulumtimit dëshmojnë se gjendja e teksteve mësimore nuk është në nivelin e duhur dhe tregon qartë nevojën për studime më serioze. Por ajo për të cilën ia vlen të tërheqim vëmendjen edhe një herë është përdorimi i tepruar i fjalëve të huaja, që në fakt nuk janë gjë tjetër veçse mungesë kompetence gjuhësore nga ana e hartuesve të teksteve shkollore të këtyre fushave. Në të vërtetë, tekstet mësimore të arsimit nëntëvjeçar në lëndët e shkencave të sakta (matematikë, kimi, biologji, fizikë etj.), duhet të shkruhen në stilin shkencor-mësimor; pra, nuk mund të shkruhen pa terma, por mendojmë se do të ishte mirë që për çdo term të ri të jepen përkufizimet e shpjegime e nevojshme. Për këtë qëllim do të sugjerim që

tekstet mësimore të shkencave të natyrës të kenë patjetër edhe një fjalor terminologjik, redaktor profesional e redaktor gjuhësor. Kjo me qëllim që të respektohet roli i rëndësishëm që luan shkolla, jo vetëm për formimin e vetëdijes gjuhësore, por edhe për politikën gjuhësore që ajo ndjek për përdorimin dhe përkujdesjen ndaj gjuhës.

Abstrakti

Tekstet mësimore janë ndër faktorët më të rëndësishëm të përhapjes dhe përvetësimit të normës së gjuhës letrare dhe njohurive mbi gramatikën e gjuhës shqipe dhe rregullat e saj sipas disiplinave (fonetikë, morfologji, sintaksë, leksikologji etj.), dhe mbi fushat e ndryshme që mësohen në shkollën nëntëvjeçare. Mësimi i gjuhës përmes teksteve shkollore është rruga kryesore nëpërmjet së cilës nxënësit pajisen me njohuri nga terminologjia e specializuar që përdoret në shkencë, teknologji, kulturë, art, mjekësi etj. Përvetësimi i terminologjisë ndikon në zhvillimin e mendimit e të ligjëritimit shkencor dhe modernizimin e gjuhës në përgjithësi dhe lidhet ngushtë me përparimin e arsimit, të shkencës e të kulturës. Përdorimi i termave në tekstet shkollore dëshmojnë për nevojën e standardizimit të nivelit sa më të lartë të sistemit terminologjik në tekstet në gjuhën shqipe. Objekt trajtimi në këtë kumtesë është përkthimi i teksteve mësimore të lëndëve të ndryshme të nëntëvjeçares në gjuhën shqipe.

Fjalët kryesore: *tekst shkollor, term, përkthim, vështirësi, standardizimi, fjalor terminologjik*

Abstract

Textbooks are among the most important factors in the dissemination and acquisition of the norm of the literary language and knowledge of the grammar of the Albanian language and its rules according to disciplines (phonetics, morphology, syntax, lexicology, etc.), and on the various fields taught in the nine-year school. Learning the language through textbooks is the main way through which students are equipped with knowledge of specialized terminology used in science, technology, culture, art, medicine, etc. The acquisition of terminology affects the development of scientific thought and discourse and the modernization of the language in general and is closely related to the progress of education, science and culture. The use of terms in textbooks demonstrates the need for the highest possible standardization of the terminological system in textbooks in the Albanian language. The subject of this paper is the translation of textbooks of various subjects of the nine-year school into the Albanian language.

Key words: textbook, term, translation, difficulty, standardization, terminological dictionary

Literatura

- ZENELI, Bernard & DANAJ, Sonila *Skrim akademik* (Cikël leksionesh dhe përmbledhje artikujsh), Ufo Press, Tiranë.
- ÇOMSKI, N., *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Tiranë.
- DODBIBA, L. (1965). *Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri më sot*, Konferenca e studimeve albanologjike. Tiranë.
- DURO, A. (1991). *Fjala-term dhe struktura semantike e fjalës shqipe*, Studime Filologjike, 3-4.
- DURO, A. (2001). *Terminologjia si sistem*, Tiranë.
- DURO, A. (2003). *Identifikimi i termit në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, 1-2.
- DURO, A. (2009). *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë: Fan Noli.
- FEKA, F. (1986). *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në FGJSSH*, Studime Filologjike, 2
- KRISTAL, D. (1996): *Kembrička enciklopedija jezika*. Beograd: Nolit.
- LAFE. Emil, (1972). *Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit*, Studime Filologjike, 1.
- LAFE. Emil, (1986). *Ndihmesa e N. Veqilharxhit në terminologjinë e gjuhës shqipe*, Studime Filologjike, 4.
- LAFE E., *“Rreth përmbajtjes leksikore të fjalëve në gjuhën shqipe”* në “Gjuha shqipe dhe letërsia I7”, Tiranë, 1989.
- LLOSHI, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe*, shblu Tiranë 2001
- LLOSHI Xh., *Mendimet dhe fjalët në “Normat letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”*, Tiranë, 1973.
- MANSAKU, S., *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1-2, 2000.
- MARTINET, A., *Elemente të gjuhës së përgjithshme*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 2002.
- PLUT, D.(1993):*Valjanost udžbeničkih tekstova*, Nastava i vaspitanje, br.3-4.

Tekstet mësimore

- Tekste mësimore të gjeografisë të klasës VI, VII, VIII, IX
- Tekste mësimore të biologjisë të klasës VII, VIII, IX
- Tekste mësimore të kimisë të klasës VIII, IX
- Tekste mësimore të fizikës të klasës VIII, IX

UDC 811.18'373
811.512.161'373
811.163.3'373

Punim studimor

Ajten HAJDARI - QAMILI

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi"
Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski", Shkup
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare
teni79@yahoo.com

**INTERFERENCA GJUHËSORE MES SHQIPES, TURQISHTES DHE
MAQEDONISHTES NË MAQEDONINË E VERIUT**

**LANGUAGE INTERFERENCE BETWEEN ALBANIAN, TURKISH AND
MACEDONIAN IN NORTH MACEDONIA**

Gjuhët, sikurse edhe kulturat, rrallë e kënaqin vetveten. Nevoja e folësit për një marrëdhënie të ndërsjellë gjuhësore shfaqet kur një gjuhë është në kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me një gjuhë tjetër ose me gjuhën e folësve të një kombi, i cili, për arsye politike, ekonomike ose kulturore, është gjuha mbizotëruese në një mjedis. Është e ditur se një gjuhë merr më shumë fjalë nga një gjuhë tjetër nëse folësit e atyre gjuhëve kanë marrëdhënie më të afërta dhe të drejtpërdrejta. Megjithatë, jo gjithmonë është ashtu. Kjo marrëdhënie mund të jetë miqësore ose armiqësore, sepse mund të ndikojë në zhvillimin e një biznesi ose të konsistojë në një shkëmbim vlerash shpirtërore (shkencë, fe etj.), por mund të ndrydhë ose të shuajë një gjuhë dhe kulturë të tërë.

Dihet se ka ndikime të shumta dhe të larmishme gjuhësore të ndërsjella ndërmjet gjuhës shqipe, turke dhe maqedonase në Ballkan. Ky ndërndikim gjuhësor ishte cak i kërkimeve nga shumë gjuhëtarë, si: F. Miklosiq, P. Skok, H. Bariç, K. Sandfeld, A. M. Selishçev, E. Çabej, Sh. Demiraj, A. C. Desnickaja, I. Popoviç, I. Ajeti, R. Ismaili, B. Vidoeski, O. Jashar-Nasteva, J. Gjinari dhe më pas vazhdojnë: A. Poloska, Z. Osmani, A. Hamiti, I. Osmani, L. Mulaku, A. Hajdari-Qamili etj.

Në Ballkan fliten në mënyrë aktive shqipja, maqedonishtja, turqishtja, vllahishtja, gjuha rome, serbe etj., dhe sigurisht që të gjitha kanë

ndikime të ndërsjella, por në këtë kumtesë do të trajtojmë vetëm ndërnikimin mes gjuhëve shqipe, maqedonase dhe turke. Lidhjet gjuhësore mes shqipes, maqedonishtes dhe turqishtes dëshmohen nga literatura e pasur e gjuhësisë, veprimtaria folklorike dhe etnologjike, paralelizmat dhe gërshetimi në krijimtarinë epike, lirike, legjenda, tregime, gjëegjëza, shprehje frazeologjike etj. Pavarësisht se shqipja, maqedonishtja dhe turqishtja janë gjuhë gjenetikisht josimotra (me prejardhje të ndryshme) dhe tipologjikisht të ndryshme, ato kanë krijuar shumë elemente të përbashkëta gjatë shekujve.

Sipas klasifikimit gjenealogjik të gjuhëve, shqipja dhe maqedonishtja janë gjuhë indoeuropiane, ndërsa gjuha turke i përket degës altaike të grupit të gjuhëve urale-altaike. Them i grup, sepse të dyja degët e këtij grupi nuk lidhen me njëra-tjetrën për nga origjina, por nga struktura, pra janë gjuhë aglutinative.⁵⁰ Ndryshe nga shumica e gjuhëve indoeuropiane që formojnë grupe të disa gjuhëve simotra, shqipja përbën një grup të pavarur të veçantë, ndërsa maqedonishtja është gjuhë sllave në degën e gjuhëve sllave të jugut.

Sipas klasifikimit tipologjik (morfologjik), shqipja është gjuhë flektive sintetiko-analitike (me prirje zhvillimore drejt tipit analitik të gjuhëve), sepse funksioni i emrave në fjali shprehet dyfish: me trajtat rasore të emrave dhe me parafjalë; maqedonishtja është gjuhë flektive analitike; ndërsa gjuha turke, siç e përmendëm më sipër, është gjuhë aglutinative; prandaj, nëse krahasohet me gjuhët indoeuropiane, leksiku i gjuhës turke është më i vogël për nga numri i leksemave ose, më saktë, i morfemave rrënjore. Kjo ndodh për shkak të natyrës aglutinative të gjuhës, por edhe për shkak të pjesoreve (participeve) dhe përcjelloreve (gerundeve), të cilat janë të shumta në turqishte. Nga ana tjetër, struktura morfologjike aktuale e gjuhës turke ka aftësinë të formojë shumë fjalë rrënjësore gramatikore, të cilat nuk përfaqësohen si njësi kryesore në fjali. Pikërisht ky është dallimi mes leksikut turk dhe atij indoeuropian.⁵¹

Ajo që shprehet me fjalë në gjuhët indoeuropiane, në turqisht shprehet me prapashtesa.⁵² Në vijim po japim një pasqyrë më të detajuar me shembuj në një tabelë:

turqisht	shqip	maqedonisht
gözlükçilerimden göz+lük+çi+ler+im+den (1 fjalë)	Nga shitësit e mi të syzave (6 fjalë) ⁵³	Од моите продавачи на наочари (5 fjalë)

⁵⁰ Kohëve të fundit përkrahet mendimi se këto dy grupe nuk duhet të trajtohen bashkë, po të veçanta. Më hollësisht për këtë shih: Marcantonio, Angela; Numenaho, Pirjo; Salvagni, Michela, *The Ugric-Turkic Battle*, : A Critical Review, *Linguistica Uralica* 2, 2001, f. 81 -102.

⁵¹ Ахмед, Октај, *Морфосинтакса на турските говори од охридско-преспанскиот регион*, (Докторска дисертација), Скопје, Октомври 2004, f. 8.

⁵² Ахмед, О., 2004, f. 8.

Tanıştıramadıklarındandır Tan+ı-ş-tır-(ı)l-a-ma- dık+ları+(n)dan+dır (1 fjalë)	Për shkak se nuk arritën të njohtohen mes vete (9 fjalë)	Тоа е поради тоа што не успеа да се запознаат меѓу себе (10 / 11 fjalë)
---	---	--

Sipas klasifikimit arealor, shqipja dhe maqedonishtja i përkasin Bashkësisë së Gjuhëve Ballkanike së bashku me gjuhët greke, arumune, bullgare dhe serbe jugore. Megjithatë, turqishtja, e cila është përdorur në Ballkan prej shekujsh, ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me shqipen dhe gjuhët e tjera ballkanike, për këtë arsye ka shumë elemente të përbashkëta. Gjuhët turke fliten në një zonë shumë më të gjerë, duke filluar nga pjesët lindore të Azisë e deri në Ballkan.⁵⁴ Familja e gjuhëve turke përfshin: turqishten, azerbajxhanishten, kirgistanishten, turkmenishten, ujgurishten, tatarishten etj.⁵⁵ Turqit që jetojnë në Ballkan i takojnë fisit ogus, ndërsa të folmet turke në Maqedoninë e Veriut trajtohen si rumelishte perëndimore dhe janë më autentike për sa i përket gjuhës së vjetër turke.⁵⁶

Në gjuhët ballkanike ka substrate ballkanike, shqiptarizma (albanizma), rumanizma, sllavizma, greqizma dhe turqizma. Me kalimin e kohës, numri i tyre ndryshon dhe rinovohet me elemente të reja, por jo gjithmonë emërtojnë koncepte të reja. Nën ndikimin e ballkanizmave janë bërë shumë ndryshime në strukturën morfosintaksore të gjuhës maqedonase, gjegjësisht, bëhet eptim analitik; nyja vendoset prapa (postpozitiv)⁵⁷ - *njeriu, човекom*; përdoret rimarrja e kundrinës; paskajorja humbet; e ardhmja formohet me **ke**: *do (dua) të mësoj - ću (hoću) = ke (ke учам)*. Riamrrja e kundrinës së drejtë e të zhdrejtë formohet me trajtat e shkurtra të përemrit p.sh.: *ty të shikoj - тебе те гледам, e mora librin - ја зедов книгата*. Numrat nga 11 deri në 19 formohen me parafjalë: *edu+na+eset* (еден над десет), *një+mbë+dhjetë, un+spre+zeqe*; Paskajorja humbet dhe zëvendësohet me mënyrën lidhore, p.sh.: *du me këndu > dua të këndoj; хоќу нјевату > сакам да неам; je veux chantêr > vreau să cânt*;

⁵³ Si fjalë të veçanta janë numëruar edhe trajtat e shkurtra të përemrave dhe nyjat.

⁵⁴ Johanson, Lars, *Discoveries on the Turkish Linguistic Map*, Swedish Research Institute in Istanbul, Publications 5, Stockholm, 2001.

⁵⁵ Tekin, Talat; Ölmez, Mehmet, *Türk Dilleri: Giriş, Simurg, İstanbul, 1999*; 2. Devlet, Nadir, *Yeni Türk Dilleri Kutlu Olsun!*, TürkDili, Sayı 554 – Şubat 1998, Ankara, s. 116- 120; 3. Kocaoğlu, Timur, *Türk Dili Araştırmalarında Önemli Adımlar*, TürkDili, Sayı 594 – Haziran 2001, Ankara, f. 628- 629.

⁵⁶ Nemet, Güla, *Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi VIII*, 1958, f. 141-143 (e përkthyer nga M. Mansuroğlu).

⁵⁷ Në shqipe dhe rumanishte kjo dukuri është më e vjetër, prandaj kanë ndikuar mbi gjuhët e tjera të Ballkanit.

Ekzistojnë edhe shumë shprehje frazeologjike identike ose të përafërta mes këtyre gjuhëve, si p.sh.: *bezaj da bezame, ik të ikim, kaç kaçalım, му го жадe лебот, ма ха букән*.⁵⁸

Elementet e përbashkëta gjuhësore të shqipes, maqedonishtes dhe turqishtes vërehen në të gjitha fushat e gjuhës: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë dhe në leksik.

1. Ndërndikimet (interferencat) fonetike-fonologjike⁵⁹

- Nën ndikimin e gjuhës shqipe dhe maqedonase, bashkëtingëlloret /c/ dhe /q/, të cilat nuk ekzistojnë në gjuhën standarde turke, gjenden në të folmet turke në RMV. Për shembull: *cigara, cirtalerım, centarda, qojli, Qemal*.

- Nën po të njëjtin ndikim, në vend të tingullit /ğ/ (g e butë), përdoret varianti i fortë, d.m.th. /g/-ja e rëndomtë, p.sh.: *ağaç* 'pemë', *dag* 'mal', *bogday* 'grur', *sogan* 'qepë', *sagol* 'rrofsh, falemnderit', *yagmur* 'shi', *yagar* 'bie shi', *aglarım* 'qaj'.

- Fonema /xh/ në gjuhën shqipe futet nëpërmjet depërtimit të turqizimave (orientalizimave), si: *xham, xhami, xhaxha, daullexhi, shakaxhi, sexhde* etj.

- Nën ndikimin e alfabetit latin, në shumë fjalë turke ku ka **ı** = **ë**, lexohet dhe përdoret me **i**. P.sh.: *ilan* < *yilan* (në vend të: yilan), *aldi* (në vend të: aldi), *biyik* (në vend të: bıyık), *kapi* (në vend të: kapı), *alti* (në vend të: altı), *atti* (në vend të: attı).), *yaptı* (në vend të: yaptı) etj.

- Për faktin se fonema /ö/ nuk ekziston në gjuhën shqipe, edhe në të folmet turke është shumë e reduktuar dhe zëvendësohet me fonemën /ü/ ose /o/, p.sh.: *öldüm* (në vend të: öldüm), *dünderi* (në vend të: dönderi), *ümrüm* (në vend të: ömrüm), *ünder* (në vend të: önder), *ole* (në vend të: öyle), *bole* (në vend të: böyle), *dort* (në vend të: dört), *üçretmiştir* (në vend të: üçretmiştir), *üdeyecem* (në vend të: ödeyeceim), *durum* (në vend të: dürüm), *burek / bürek* (në vend të: börek), *kyoyli* ose *qoyli* (në vend të: köylü).

Gjuhëtarja Olivera Jashar-Nasteva në kumtesat e saj pohon se e folmja maqedonase perëndimore ndikon në të folmen malazeze nëpërmjet gjuhës shqipe, si p.sh.: ruajtja e fonemës /h/, velares /l/ etj.⁶⁰

- Për shkak të të folmeve gege të shqipes, edhe në të folmet maqedonase perëndimore, bashkëtingëlloret [k̟] dhe [f̟] afrikatizohen: *ke – çe oda, źezve – uezve* etj.

2. Ndërndikimet (interferencat) morfologjike

⁵⁸ Më gjerësisht për këtë shih: Ajten Hajdari-Qamili *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018, f. 165-175.

⁵⁹ Analiza e të gjitha tipareve gjuhësore është bërë në bazë të të folmeve perëndimore të maqedonishtes.

⁶⁰ Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998, f. 25-34.

- Nën ndikimin e shqipes dhe të maqedonishtes, edhe në të folmet turke në RMV, vërehet se si përdoret prapashtesa '**-im**', d.m.th. '*iyim*', si leksemë e veçantë (sipas analogjisë 'unë jam' ose 'jac cum'): *ben iyim, sen isin*, në vend të: benim, sensin.

- Po kështu, foljet kopulative '*idık*', '*idinız*', '*idiler*', të cilat janë prapashtesa në gjuhën standarde turke, gjenden edhe si leksema të veçanta në të folmet turke (për analogji me 'ishim' ose 'бевме', 'ishit' ose 'бевте', 'ishin' ose 'беа'), p.sh.: *kız idır / kıışçe idır*, në vend të *kızdır* (nga: vajzë është = девојче е).

- Koha e kryer në të folmen turke bëhet me prapashtesat: **-miş** dhe **-ik** me variantet: **-ik**, **-ük**, **-uk**, por me fjalë të veçuara ashtu si në shqip: *ürtük imiş, ürtük imişidi, ürtük imiştir, kızarık idi, koyuk idi* (krahaso me turqishten standarde: *ürtükmüş, ürtükmüştu, kızarıkdı, koyuktu*). Shqiptarët kur flasin turqisht, zakonisht përdorin kohën e kryer kur duan të shprehin ritregim (rirrëfim). Dihet se forma foljore **л**, e cila shpreh ritregim në gjuhën maqedonase, është e bazuar në gjuhën turke (*бил покриен, било испржено, било ставено*).⁶¹ Edhe në të folmet shqipe kjo përkthehet me: *ishte mbulu / ishte mbuluër, ishte fërguar / ishte fërgjuër / ishte fërgjumun, ishte vënduar / ishte vnu*.

- Aoristi (e kryera e thjeshtë) në turqisht formohet me prapashtesat **-r**, **-ir**, **-ar**, **-er**: *arar, bilir, atar, biter*. Mohimi bëhet me prapashtesën **-ma + z** (*aramaz, bilmez, atmaz, bitmez, almaz, demez, vermem, istemeis*). Është e rëndësishme të theksohet se me aoristin, për shkak të specifikës që kjo është një kohë e vazhdueshme (permanente), në të folmen turke përdoret edhe për të shprehur kohën e tashme. Edhe kur përkthehet nga shqipja në turqisht ose anasjelltas, aoristi turk përkthehet me kohën e tashme në shqip.

- Koha e ardhme në të folmet shqipe dhe maqedonase, si dhe në shumicën e gjuhëve ballkanike, siç e përmendëm më lart, ndërtohet me pjesëzën **do** (që vjen nga folja *dua*) + **mënyra lidhore**: *do të marr, də marr, de marr, do të vë, də vë, də vnoj, do të plas, də plas, de qas, do ta gjesh, do ta shesim, do të falem, do të vij*. (gjegjesisht me **ќе** (që buron nga *хоќу*) + **folje në kohën e tashme**: *ќе земам, ќе ставам, ќе пукнам, ќе ја најдем, ќе го продадеме*). Ndërsa në të folmet turke, ndryshe nga gjuha standarde turke, ndërtohet me prapashtesat e reduktuara **-acak**, **-ecek**, si: *alacak, koyacak, patlayacak, bulacasın, koyaciz, sataciz, kılacım, gelecim*.

- Një tipar shumë i përhapur dhe i përbashkët për të gjitha të folmet në RMV është se emrat përdoren shpesh në deminutiv/zvogëlim (zakonisht me prapashtesën **-çe**, që është me origjinë persiane, ose me prapashtesa të

⁶¹ Më shumë për këtë shih: Friedman, Dr. Victor, Makedon ve Türk Dillerinde Belirli Geçmiş ve Hikâye Zamanları, II. Меѓународен симпозиум: Македонско-турските културни врски во минатото и денес, 23-25 октомври 1991, Зборник на трудови, Филолошки факултет, Скопје, f. 55- 58.

tjera), megjithëse semantikisht nuk bëhet fjalë për zvogëlim ose përkëdheli, sepse përdoret gjithmonë dhe në çdo rast, p.sh.: *çöyçe*, *kışçe*, *kaşıçe*, *süzgiçe*, *birer parçeçe ekmeçe* (turq.) dhe *cuckë*, *çunçe*, *kapaçe*, *luçkë*, *llastiçkë*, *safkë*, *druçkë*, *mackë*, *lulkë*, *topçe*, (shq.) dhe *сокче*, *камче*, *жениче* / *женичка*, *тонче*, *капаче* (maq.) e të tjera.

- Në të folmet turke, trajta mohore e foljes kopulative bëhet me pjesëzën '**değil**', pra varianti '**del**', i cili nën ndikimin e të folmeve të shqipes dhe të maqedonishtes nuk gjendet gjithmonë midis fjalës me origjinë emërore dhe foljes kopulative, por mund të gjendet edhe para foljes, p.sh.: *deldir ey = nuk është mirë* (del + dir + ey = nuk + është + mirë = не e добро), *deldir burda = nuk është këtu* = не e овде, *deldir güzel = nuk është e bukur* = не e убава, në vend që të përdoren: *iyi değil*, *burada değil*, *güzel değil*.

- Në të folmet turke ka gerunde postpozitive (përcjellore te prapavendosura), që janë në trajtën e një foljeje fundore dhe vijnë pas foljeve kryesore, p.sh.: *başlamış düşsün* (të folmet turke) / *düşmeye başlamış* (në turqishten standarde) = *ka filluar të bie* (shqip) = почнал да паѓа (maqedonisht).

- Lidhëza "**açan**" (kur) nën ndikimin e gjuhës shqipe dhe maqedonase përdoret si ndajfolje kohore: *geldim açan gittin sen = erdha kur shkove ti = дојдов кога отиде му*. Gjithashtu, lidhëza "**që**" nga shqipja dhe "**ki**" nga e folmja turke, e cila është plotësisht e njëjtë dhe ka po të njëjtën prejardhje etimologjike, edhe mënyrën e përdorimit të saj në fjali e ka të njëjtë me shqipen dhe jo me gjuhën standarde turke: *geldim burda ki deverim sana = erdha këtu që dët tregoj / kallzoi ty* (krahaso me turqishten standarde: *sana söylemeye burada geldim*).

- Pasthirrmat dhe shprehjet karakteristike në Maqedoninë e Veriut për të gjithë popujt, qofshin shqiptarë, turq, maqedonas e të tjerë, janë: *abe*, *mëre*, *ajde*, *a miri kızım = a mëj / mëri bijë = a мору ќерко*; *A be? Ya be. A be? Ja be. A be? Ja be?* (që do të thotë: Ku je? ose Si je? Këtu.).

- Gjuha turke nuk ka gjini gramatikore, por nën ndikimin e gjuhëve me të cilat ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë prej shekujsh në këto troje, te të folmet turke vërehet edhe përdorimi i gjinisë gramatikore. Kjo më së shumti arrihet me prapashtesën maqedonase **-ka**, p.sh.: *doktorka*, *yegenka*, *biberka*, *öğretmenka* / *misuska*, *arkadaşkam* etj.

- Gjuhëtarja Olivera Jashar-Nasteva në kumtesat e saj thotë se dhanorja tek emrat e përveçëm të njerëzve në të folmen maqedonase perëndimore është e ndikuar nga gjuha shqipe.⁶² Po kështu, edhe trajta e shquar e emrave të përveçëm në Gostivar, Manastir, Resnjë etj. është ndikim nga gjuha shqipe p.sh.: *Билето* (Bileja), *Марето* (Mareja), *Ленчето* (Lençeja), *Сашето* (Sashoja).

- Koha e kryer (минато неопределено време) me **имам** + mbiemër foljor është formuar nën ndikimin e gjuhës shqipe, sepse kjo

⁶² Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998, f. 25-34.

formë është tipike për të folmet maqedonase perëndimore, por ka hyrë edhe në gjuhën standarde maqedonase: *kam ardhur, ke ardhur, ka ardhur* = *имам дојдено, имаш дојдено, имат дојдено*; *e kam gjetur* = *го имам најдено*.

- Në të folmet maqedonase perëndimore ngatërrohen parafjalët **на** dhe **во**, sepse në gjuhën shqipe ka vetëm **në**: *На Струга дуќан да имам*, në vend të: *Во Струга дуќан да имам*. Në Strugë të kem dyќan. *Кога се преобраза на крава, наместо Кога се преобраза во крава* = *Kur u shndërrua në lorrë. На времето од Крали Марко*, në vend të: *За времето од Крали Марко*. Në kohën e Krali Markos.....

- Në të folmet maqedonase të Gostivarit, Resnjës, Manastirit,... nën ndikimin e gjuhës shqipe, në të cilën nuk ka gjini për trajtat e shkurtra të përremrave dhe tek rimarrja e kundrinës, për këtë arsye edhe në të folmet maqedonase gjinitë përdoren gabim, d.m.th., përdoret forma mashkullore edhe kur duhet të jetë mashkullore, edhe kur duhet të jetë femërore, p.sh. *Му го дадов на мама* (për: *й го дадаов на мама*), *Му го зедов книгата на Маја* (për: *й ја зедов книгата*), *Му реков на сестра ми* (për: *й реков на сестра ми*), *Го викнав Ана* (për: *Ја викнав Ана*).

- Përdoret parafjala *спроти* (kundrejt), në vend të *според* (sipas) dhe renditja e fjalëve në fjali është si në gjuhën shqipe, e jo siç është në natyrën e vetë maqedonishtes. Ndërsa fjala *кувет* është fjalë turke p.sh.: *Спроти куветот негов*, në vend të: *Според неговата сила*. = *Kundrejt fuqisë së tij*.

- Nën të njëjtin ndikim, ndajfolja **после** (pas) gjendet në përdorim parafjale, sepse në gjuhën shqipe **pas** mund të jetë edhe ndajfolje, edhe parafjalë. p.sh.: *После неколку месеци*, për: *По неколку месеци*. = *Pas disa muajsh*; = *Каç ау сонра*; *После песните се прикладени обичаите*. = *Pas këngëve janë vendosur zakonet*; *Ѕаркиљардан сонра*...

3. Ndërndikime (interferenca) morfosintaksore dhe sintaksore

- Në të folmet turke të RMV-së, ndryshimi, gjegjësisht, shmangia e rendit të drejtë të fjalëve në togfjalëshin emëror nën ndikimin e shqipes dhe maqedonishtes mund të vërehen në shembujt e mëposhtëm: *Struganın ortasında, ayakları nerde türbenin, agzına aının* etj.

- Mbiemri gjendet pas emrit nën ndikimin e shqipes, sepse në gjuhën shqipe mbiemri është gjithmonë i prapavendosur, p.sh.: në vend të: *güzel kız* përdoret: *kız güzel* = *vajzë e bukur* = *чыне убаво*; *bazi kızlar da gençler*, në vend të: *bazi da genç kızlar* = *disa vajza më të reja*.

- Grupet pjesore (participe) janë shkrire plotësisht, sepse struktura është e kalkuar nga gjuha shqipe dhe maqedonase, veçanërisht për ato me **'açan'** dhe **'nerde'**. Për shembull: *açan uyanır kocası* = *kur zgjohet i shoqi* = *кога се буди мажот ù*, në vend të: *kocası uyandıđı zaman*; *keser aynı o dali nerde binmiştir gendi* = *e pret degën e njëjtë në të cilën ka hipur vetë* = *ja*

сечеше истата гранка на која е искачен и самиот, në vend të: (kendi) bindiği dalı kesmek (kesiyor).

- Edhe grupi përcjellor (gerund) është i çrregulluar, sepse përdoret struktura e plotë e shqipes dhe e maqedonishtes. Për shembull: *çöyçenin babası çikarken arasın doktor* (në vend të: *çocuğun babası doktor aramaya çikarken*) = *baba djalit tu dal të kërkoe doktor* = *маткомто на момчето излегувајќи да побара лекар*.

- Në të folmen turke në disa shembuj ruhet mirë rendi i grupit partikular: *aşçi gibi, bu gün için*, por ka edhe forma ku nuk respektohet rendi për shkak të ndërndikimve gjuhësore, si: *da bir iki kari* (në vend të: *daha iki karı*) = edhe nja dy gra; *nası askerler* (në vend; *askerler gibi*) = *si ushtarë* = *како војници, çaki evinde* (në vend të: *eve kadar*) = *der në shpin e vet* = *до дома му*.

- Në të folmet maqedonase perëndimore, ndonjëherë përdoret atributi pas emrit: *живот вечна* = jetë e përrjetshme, *страх голем* = frikë e madhe, *стоит софра ставена* = qëndron sofrë e shtruar, *умот негов* = mendja e tij (ky rend është i ndikuar nga gjuha shqipe).

- Sintaksa e të folmeve turke në RMV, edhe pse nxitet nga mënyra e të menduarit, të ndjenjave dhe të logjikës turke, megjithatë ndikohet fuqishëm nga gjuha shqipe dhe maqedonase. Struktura e fjalisë në gjuhën standarde turke është: **kryefjala + kundrina + kallëzuesi**, ndërsa në të folmet turke renditja mund të ndryshojë dhe nuk ka pozicione statike të grupeve të fjalëve të mësipërme. Ndërsa në shqip dhe maqedonisht renditja është: **kryefjala + kallëzuesi + kundrina** (e drejtë apo zhdrejtë). Në vijim po japim disa shembuj të të folmes turke me ndërndikim sintaksor:

1. *Açan gidecim evde, verecim paraları.* = *Kur dë shkoj në shpi, dë t'i jap paret.* = *Кога ќе одам дома ќе ти ги дадам парите*. (për: *Eve gidince, paraları vereceğim*.);

2. *Topladım eşalarımı em geldim burda.* = *I mblodha teshat edhe erdha këtu.* = *Ги собрав плачките и додјов овде*. (për: *Eşyalarımı toplayıp buraya geldim*.);

3. *O idır çok kuvetli em büyük.* = *Ai është shumë i fortë dhe i madh.* = *Toj e многу силен и голем*. (për: *O çok güçlü ve büyüktür*.).

- Te të folmet shqipe të qytetit ndeshëm në disa struktura interesante turke, si: *Kush ka aty?* = *Kim var?* (për: *Kush është aty?*) *Delmi duheshte të vish këtu?* (për: *A nuk duheshte të vish këtu?*) *Erdha me saba* = *geldim saba+ylen* (për: *erdha që në mëngjes*).

4. Ndërndikime (interferenca) leksikore

Ndikime leksikore vërehen më së shumti nga turqishtja në shqipe dhe në maqedonishte, sepse orientalizmat hasen në të gjitha sferat e jetës materiale dhe shpirtërore. Dihet se në qytet dhe në fshatrat përreth, ku

kontaktet me turqit ishin më të shpeshta, më të ndjeshme dhe më të gjalla, depërtimi i fjalëve turke ishte më i madh.

Në përgjithësi, shumica e turqizmeve të përdorura në gjuhën shqipe dhe maqedonase janë të njohura edhe në gjuhët e tjera ballkanike. Një numër i madh fjalësh nga fusha e administratës turke, jeta juridike dhe tregtare tashmë janë vjetëruar dhe sot janë arkaizma. Numri më i madh i fjalëve dhe shprehjeve orientale përdoren në lutjet dhe zakonet fetare (te shqiptarët), shprehjet e përshëndetjes ditore, shtëpia, kuzhina, veshmbathja, zeytaria, tregtia, në fushën e jetës shpirtërore dhe pothuajse në të gjitha sferat e tjera. Ndikimi i gjuhës turke është mjaft i theksuar dhe nuk kufizohet vetëm në fjalë kuptimplota, por shihet edhe në huazimin e shprehjeve nga të cilat është marrë vetëm ana e brendshme.⁶³

Turqizmat zakonisht e bartin me vete të njëjtin kuptim semantik që e kanë pasur në gjuhën burimore (turqisht, persisht, arabisht), por jo gjithmonë ndodh kështu; ndonjëherë e njëjta fjalë depërton disa herë dhe në kohë të ndryshme, sepse trajtat e së njëjtës fjalë shprehin kuptime të ngjashme ose krejtësisht të ndryshme. Në përgjithësi, fjalët e huaja që janë marrë kohët e fundit kanë pësuar të njëjtat ndryshime fonetike si fjalët amtare (autoktone), ndërsa huazimet më të reja zakonisht i nënshtrohen dukurive më të fundit dhe nuk ndryshojnë shumë nga gjuha e burimit.

Sipas Jashar-Nastevës⁶⁴, në Gadishullin Ballkanik janë krijuar tre lloje kryesore hibridesh: 1). jotautologjike; 2). tautologjike dhe 3). hibride të krijuara nëpërmjet kryqëzimit dhe nëpërmjet etimologjisë popullore.

1). hibridet jotautologjike ndahen në:

- 1.1. hibride maqedonishte-turqishte: *борбаџица, винарџица, любовџица, водоводџица, башдевојка, башдомачин, каракамен, Каракостовџица, Карапанчеви.*
- 1.2. hibride turqishte-maqedonishte: *докусури, доарчи, избербати, заборџи, помуабети, нанишани, натамани, распача, пресепани, бојар, аџиџица, агинка, Бојациев, Терзиовџица, Чакаровџица, Џамбазовџица;*
- 1.3. hibride shqipe-turqishte: *leçkaxhi, paqellëk, nidaïma, ...*
- 1.4. hibride turqishte-shqipe: *hiçasgjë, sagllam njeri,...*
- 1.5. kompozita: *алтанмомче, мајмунчовек, некасметлија, ѓоамити; стори дикат, прави лаф, фрли имза, фаќа инат.*

2). hibridet tautologjike ndahen në:

⁶³ **DIZDARI**, Tahir, (2005), *Fjalor i Orientalizmave*, (botim elektronik), АИТС, Tiranë. // **ПЕЕВ**, К., *Кукушкиот говор II*, Скопје, 1988, f. 15. // **ЈАШАР-НАСТЕВА**, О., *Македонските калки од турскиот јазик*, МЈ, г. XIII-XIV, кн. 1-2, Скопје, 1962/63, f. 109-172.

⁶⁴ Ајтен Камили, *Јазични контакти на балканските простори*, Годишен зборник на Универзитетот "Св. Кирил и Методиј" во Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Книга 33, Скопје, f. 329-333.

- 2.1 të plota (*алцрвено, главабашија, лудоделија, правосефте, сабафзора, цар-султан, фазла повеќе, ичништо*);
- 2.2 të pjesëshme (*батачиште, чутлија, се почудиса*);
- 2.3 të krijuara:
- 2.3.1. greqisht-turqisht (*ареса бендиса, ёул трендафил, чаир ливада*);
- 2.3.2. turqisht-turqisht (*гајлелија, мераклија, долан мусандра, по зефк по сефа, килим сеџаде*).
- 2.3.3. shqip-turqisht (*tashgur*).

3). Hibridet e krijuara me anë të kryqëzimit dhe etimologjisë popullore janë të ndryshme në çdo gjuhë ballkanike ose plotësisht të njëjtat forma përdoren në të gjitha gjuhët ballkanike.

4. 1. Fjalë turke në të folmet shqipe:

Në të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut ka mjaft fjalë turke, pra fjalë orientale, por do të përmendim vetëm disa shembuj:⁶⁵ *qebe, çarshaf, këllëf, tenxhere, kapak, xhezve, tepsi, çajnik / çajdanllëk, byrjan, tyrlitavë, jagmazllëk, kadëngjybek, imam bajëlldi, sytliash, ashure, musaka, yrnek, açik, aksham (tosk.) / akshom (geg.), azër, buasllëk (tosk.) / buasllëik (geg.), bunar, byberka (tosk.) / bibierka (geg.), dane (tosk.), gafil (geg.), gjezdis (tosk.) / gjëzdis (geg.), gjol (tosk.) / xh^uol (geg.), gjuase (tosk.) / gjasem ja (geg.) / gjasme (geg.) / gjase (geg.) / gjyase, javash, jeshil, jeshile / jeshilkë, kalem (tosk.), kallaballëk (tosk.) / kallaballëik (geg.), llafe, llausk, lyrek / lirek (geg.), mavëi (geg.), mintan (tosk.) / minton (geg.), në tepet (tosk.) / n'tepe (geg.), orta (tosk.), pazar, saba, sënduq (tosk.) / sandëk / sandëjk (geg.) /, sebeb (tosk.) / sebiep (geg.), vakët, viranllëk (tosk.), ava:, avale, ajr, ajmali:, ak, aber / ab'ier (geg.), mua:ll, gajre:t, kimet, bakllava / baklla:v (geg.), fukara, ha:ll, amin, aman, amanet, arom / arom (geg.), allall, muabet, mashalla:, ymyt, arallëk / arallëik (geg.), ashiqare, bajagi, bitevi (tosk.) / bidevëi (geg.), budalla (tosk.) / buda:ll, bujrun, bakshish, vira:n, dert, dilmi, erhap, seva:p, tamam / tamom (geg.), gjyna / gjinaf (geg.), exhel, zamet, zor / z^uor (geg.), zengin, izmet, jazëk / jazik (geg.), iqendi / iqëndëi (geg.), insan / inson (geg.), iç / yç (geg.), bajrak, minare, asret, isha:lla, isharet, yrnek / irnek (geg.), dallash, kismet, çeshme, bafçe, badiava, kusu:r, azdis, këzdis, lezet, baksuz, namaz, avdes, rezil, seva:p, sefte, i sert, sevda:, sokak, syfyr / sifëir, sajgi:, sofër, sofrabez, surrat, sakat, saat, ujdís, uj, fukara:, finxhan / finxhon (geg.), çare, çallëm / çallom (geg.), çati / çatëi, çardak, xhamadon, xhami / xhamëi, xhenaze, xhade, xhevap, kadëngjybek, jagmazllëk, imambajëlldi, musaka, dyzledisem, kurulldisem, gjezdis (tosk.), e braktisa, u telefosa (tosk.), e myledis (tosk.) etj.*

⁶⁵ Shkurtesat që përdoren në këtë pjesë të tekstit nënkuptojnë: (tosk.) = të folmet toske në Maqedoninë e Veriut, (geg.) = të folmet geqe në Maqedoninë e Veriut.

Siç mund të konstatohet nga shembujt e dhënë, shumica e orientalizmeve të huazuara janë fjalë kuptimplota. Mirëpo, te të folmet shqipe ka edhe një numër të caktuar huazimesh, që janë fjalë jokuptimplota (shërbyese). Për shembull: **ndajfoljet** (*barabar, kollaj, azër, karshi / karshêi* (geg.), *sefte, sagllam / sagllom* (geg.), *iç / uç* сл.); **lidhëzat** (*bile, ama, em ... em, demek, mazalla, barem, delmi / dilmi* (geg.); **pasthirrmat** (*mashalla; aman / amon* (geg.), *ajde be, jazëk / jazik* (geg.), *shyqyr / shiqir* (geg.); **pjesëzat** (*xhanëm, amin* etj). Marrja e një lidhëzeje do të thotë diçka më shumë, sesa të marrësh një fjalë kuptimplotë, sepse dëshmon të kuptuarit e thelbit të strukturës së fjalisë së gjuhës tjetër.⁶⁶

Të folmet dialektore të shqipes përveç huazimeve leksikore kanë edhe kalke nga turqishtja. Më shpesh kalke krijojnë njerëzit që dinë dy ose më shumë gjuhë, si dhe ato mjedise gjuhësore në të cilat dygjuhësia ka prekur shtresat më të gjera të popullit.⁶⁷ Ekzistojnë edhe kalke semantike, të cilat e zgjerojnë regjistrin e kuptimeve të një lekseme më vete, dhe kjo sipas modelit të fjalës që shfaqet me të njëjtin kuptim themelor në gjuhën nga e cila është kalkuar. Për këtë prof. Peev e merr fjalën *deme* (fëmijë) si shembull tipik, "përveç kuptimit bazë në të folmet jugore, e gjejmë edhe me kuptimin *сун* (bir). Kuptimi i dytë është zhvilluar sipas modelit të gjuhës turke, ku leksema *çocuk* (ose *çöyçe*) përveç "fëmijë" do të thotë edhe "djalë".⁶⁸ Situata është e ngjashme në këto gjuhë me fjalën *çun* (tosk.) / *voc* (geg.) me kuptimin *djalë* dhe *bir* (pavarësisht se ekziston një fjalë e veçantë për bir dhe *cuc / couc* (geg.) = *kışçe* me kuptim të dyfishtë: *vajzë* dhe *bijë* (edhe pse ka fjalë përkatëse për *bijë*).

4. 2. Fjalë turke në të folmet maqedonase:

кебе, чаршаф, тенџере, капак, ѓезве, филџан, тепсија, чајник, ајран, баклава, ѓомлезе, тава, турлитава, сутлиаш, амајлија, мусака, урнек, себен, сабајле, абер, алал, ќерата, бајаги, бакшиш, бујрум, севан, таман, зор, есан, аманет, делија, муабет, бктисав, ишарет, саат, сефте, сурат, сокак, кусур, резил, лезет, тазе, бајат, ќутук, авџија, арамија, баџмајстор, каракамен, кавгаџија, чорбаџија, бостанџија, шакаџија, душман, арчи, касапин, ерген, ќора, ѓоамтити, коџамити, лаф, кабает, пишман, мајтан, инат etj.

Përveç fjalëve kuptimplota, hasim edhe **ndajfolje** (*барабар, колај, азр, карчи, саглам, ич*); **lidhëza** (*ама, ем...ем, demek, барем, чунки*); **pasthirrma** (*ајде бе, јазк, шукур, машала, аман*); **pjesëza** (*џанем*); **prapashtesa** -**лар, -џи** (*капиџии, бозаџија, винарџија, клучарџија*);

⁶⁶ Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Скопје, 1986, f. 121.

⁶⁷ Јашар-Настева О., *Македонските калки од турскиот јазик*, МЈ, XIII-XIV, f. 111.

⁶⁸ Коста Пеев, *За малупознатото калкирање на службени зборови во југоисточните периферни македонски говори*, Зборник на Филолошки факултет посветена на проф. Угринова, Скопје, f. 213.

hibride tautologjike:⁶⁹ *та дур, чак дур, хем и, ич ништо* etj.; attribute: *ѓуль девојче, ал забун, мрамор дирек.*

4. 3. Fjalë shqipe në të folmet turke dhe maqedonase:

Fjalë shqipe në të folmet maqedonase janë: *чупе, буза, тель, го шитнав, цуце, бир, пус, босилек, кумбар, кукујавка, гуша, шара, нипрка, шитнав, карпа, талас, рофја, угич, чкџмба, сојој, странга, сугар, керлук, фурка, мамалига, веленца, мочуриште, ледина, пие, камилица < katomile < amaluste < ambëlustë (lule e ambël), готово, готвам, (gati, gatuaj), гурмаз, гурман, (gërmaz, fytmadh), ватра* etj.

Edhe pse turqishtja përdoret nga një numër i madh i shqiptarëve të qyteteve të RMV-së, te të cilët vërehet një numër i madh i fjalëve shqipe, vetë turqit përdorin më pak, prej të cilave më karakteristike janë: *shpor ol burdan* (në vend të: def ol burdan 'largohu nga këtu'), *o leško* (në vend të: *o killi* ose *o tuylu*, por me kuptim të figurshëm, për: i hutuar, hupsh), *o lule* (në vend të: *o çifek*, për: i turulluar, i dehur), *pastrovaledim* (në vend të: *temizledim* pastrova), *benim mısuskam* (në vend të: *benim öğretmenim* 'mësuesja ime'), *kënaq olduk* (në vend të: *memnun kaldık* ose: *eğlendik*) etj.

Nga fusha e onomastikës është karakteristike se ka disa antroponime, të barasvlershme te banorët shqiptarë dhe turq, si p.sh. *Hekuran* (shq.) = *Demir* (tur.), *Durim* = *Sabri*, *Luan* = *Arsllan*, *Lule* = *Çifek*, *Sevinç* = *Gëzime*, *Bahar* = *Pranvera / Vera*, *Sevgi* = *Dashurie*, *Ümüt* = *Shpresa*, *Taş* = *Guri*; por edhe *Tashgur* = *taş+ gur* > *taş* (tur.) + *gur* (shq.) = *Gurgur*, pra kemi dyfishim të së njëjtës fjalë nga të dyja gjuhët, pra një hibrid tautologjik. Është gjithashtu karakteristike se shumë shqiptarë kanë emra turq (*Deniz*, *Jëlldëz*, *Gyl*, *Nurgyl*, *Gylshen*, *Ajten*) dhe shumë turq me emra shqip (*Shpresa*, *Linda*, *Lule*), ndërsa emrat arabë janë njëlloj të pranishëm te shqiptarët dhe te turqit në RMV.

4.4. Fjalë maqedonase (sllave) në të folmet shqipe dhe turke:

Shqiptarët me shekuj kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me popujt sllavë të Ballkanit, me maqedonasit, me serbët, me bullgarët etj. Në vitin 1918 Maqedonia ishte pjesë e Mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe sllavëve, kështu që deri në Luftën e Dytë Botërore në këto anë, gjuha serbokroate ishte gjuha zyrtare dhe gjuha e administratës, gjuha e arsimit, gjuha e shtypit, prandaj në të folmet dialektore shqipe të Maqedonisë së Veriut kanë hyrë shumë fjalë sllave nga fusha të ndryshme të jetës, veçanërisht nga terminologjia administrative. Numri më i madh i fjalëve sllave gjendet në popullatën e moshuar fshatare dhe të pashkolluar dhe në mesin e të rinjve të arsimuar të qytetit, të cilët qëllimisht i përdorin ato fjalë dhe shprehje për të bërë shaka, por në dekadën e fundit pothuajse të gjitha

⁶⁹ Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998, f. 56-78.

ato fjalë dhe shprehje janë zëvendësuar me anglizma. Numri i këtyre fjalëve nuk është i njëjtë në të gjitha vendbanimet ku jetojnë shqiptarët. Ky numër varet nga numri i të arsimuarve në ato vendbanime, nga numri i shqiptarëve të punësuar në institucionet shtetërore, nga rrethina e fshatit apo qytetit me vendbanime të tjera me më shumë maqedonas etj. Në vazhdim po japim disa huazime sllave: *knishkë, sud, mollbë, peshadi, strazhë, reshenje, uput, voz, granicë, dogovor, strujë, prekolicë, stanêic, bollnêic, bollovanje, domazet, domaquin, gazdë, sfillë, vunicë, potkoshulë, pllavush, razboj, stolicë, masë, ogradë, nameshtaj, visaçe, pokrivaç, pegëll, netull, sok, pivo, samboled, solenka, poplla:v, llopa:t, kosë, zhabë, kopaçar, vlla:g, mrezhë, vesllë, pedalinkë, majstor, strazhar, çistaç, poshtar, bravar, kuvar, matiçar.*⁷⁰

Ja edhe shembuj me përdorim konkret në fjali: *Shkova n'sud ta podnesi mollbën që ta tuzhi:s komshi:n. Aj qaku punon n'opshtëin, amon tēshtëi dē dale n'penzi.*

Te brezat e rinj, shumë nga këto fjalë nuk përdoren më, sepse në vend të tyre përdoren fjalë shqipe.

Huazimet maqedonase: *разни-разни, народ, живот, младина* etj., që i kanë përmendur Olivera Jashar-Nasteva⁷¹ dhe Petar Skoku⁷², nuk përdoren më fare në të folmet shqipe.

Në të folmet turke në Maqedoninë e Veriut, numri i fjalëve maqedonase është më i madh sesa në të folmet e shqipes. Shembujt e sipërpërmendur janë të pranishëm edhe në të folmet turke, andaj nuk ka nevojë të përsëriten më.

PËRFUNDIM

Nga analiza dhe krahasimi i paraqitur më lart, mund të përfundojmë se ndikimi i turqishtes në të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut është më shumë në fushën leksikore, pastaj se ndikimi i shqipes në turqisht është më shumë në sferën morfosintaksore dhe sintaksore, ndërsa ndikimet fonetike dhe morfologjike janë të ndërsjella. Gjuha maqedonase (sllavishtja) ka ndikuar më shumë në sferën leksikore, veçanërisht në terminologjinë administrative dhe ushtarake në dekadat e fundit. Në fshatra përdoren më shumë sllavizma, kurse në qytete më shumë turqizma. Shqipja ka më shumë ndikim në sferën morfologjike dhe fonologjike.

Nga rezultatet e pyetësorëve të kryera në terren, vërehet se maqedonizmat (sllavizmat) përdoren më së shumti nga popullata e vjetër, e paarsimuar e fshatrave që janë më afër fshatrave të banuara me

⁷⁰ Për këto më hollësisht shih në: Ajten Hajdari-Qamili *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018, f. 9-43 dhe në: Ajten Hajdari-Qamili, *Të folmet e Strugës*, Shkup, 2022, f. 185-187.

⁷¹ Olivera Jashar-Nasteva, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998, f. 23-24.

⁷² Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore të popullsisë joslave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (dialektologji) Prishtinë, 1978.

maqedonas. Ndërsa në të folmet shqipe dhe maqedonase në qytete apo në fshatrat më afër qytetit vërehet një numër më i madh turqizdash, për shkak të kontaktit të vazhdueshëm reciprok me turqit, pra dygjuhësisë së përditshme për shkak të: fqinjësisë, martesave të përziera, shoqërimit etj.

73

Abstrakt:

Kontaktet gjuhësore kanë qenë gjithmonë objek studimi për shumë gjuhëtarë, pasi prej aty dalin një sërë përgjigjesh për dukuritë gjuhësore ndër shekuj. Gjuhët ballkanike, për shkak të ndikimeve të ndërsjella gjatë bashkëjetesës shumëshekullore, kanë zgjuar interesimin për të hulumtuar te shumë gjuhëtarë të huaj dhe vendas. Pavarësisht që deri tash janë bërë hulumtime mbi ndikimin e maqedonishtes në gjuhën shqipe dhe turke, edhe në këtë kumtesë do të trajtohet interferenca (ndërndikimi) gjuhësor mes shqipes, turqishtes dhe maqedonishtes, por nga një kënvështim tjetër dhe shumë më i detajuar. Do të analizohen ngjashmëritë fonetike, morfologjike dhe leksikore midis shqipes, maqedonishtes dhe turqishtes që flitet në Maqedoninë e Veriut, duke dhënë shumë shembuj.

Fjalët çelës: shqip, turqisht, maqedonisht, ndikim, krahasim

Abstract:

Language contact has always been an object of study for many linguists, as it provides a series of answers to linguistic phenomena over the centuries. Balkan languages, due to their mutual influences during centuries of coexistence, have aroused the interest of many foreign and local linguists to research. Despite the fact that research has been conducted so far on the influence of Macedonian on Albanian and Turkish in North Macedonia, this paper will also address the linguistic interference between Albanian, Turkish and Macedonian, but from a different and much more detailed perspective. The phonetic, morphological, morphosyntax and lexical similarities between Albanian, Macedonian and Turkish spoken in the RNM will be analyzed, giving many examples.

Keywords: Albanian, Turkish, Macedonian, influence, comparison

⁷³ Më hollësisht për këtë shih: Ajten Kamil, *Albanските говори во струшкиот регион (во балкански контекст)* (doktorска дисертација), Универзитет “Св. Кирил и Методиј” - Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Скопје, 2011; dhe te: Ajten Hajdari-Qamili, *Të folmet e Strugës*, Shkup, 2022.

LITERATURA:

- АХМЕД, О., (2004), *Морфосинтакса на турските говори од охридско-преспанскиот регион*, (Докторска дисертација), Скопје.
- ЏАБЕЈ, Е. (1976), *Studime gjuhësore III*, Prishtinë: Rilindja.
- DEMIRAJ, Sh., (1994), *Gjuhësi ballkanike*, Shkup.
- DIZDARI, Tahir, (2005), *Fjalor i Orientalizmave*, (botim elektronik), Tiranë: AIITC.
- FRIEDMAN, Dr. Victor, (1991), *Makedon ve Türk Dillerinde Belirli Geçmiş ve Hikâye Zamanları*, II. Меѓународен симпозиум: Македонско-турските културни врски во минатото и денес, 23-25 октомври 1991, Зборник на трудови, Филолошки факултет, Скопје, f. 55- 58.
- GRÖNBECH, K., (1995), *Türkçenin Yapısı*, Çeviren: Mehmet Akın, Ankara: Türk Dil Kurumu Yayınları: 609.
- HAJDARI-QAMILI, A. *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018.
- HAJDARI-QAMILI, A. *Të folmet e Strugës*, Shkup, 2022.
- JASHAR-NASTEVA, O., (1998), *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup: Logos-A.
- JOHANSON, Lars, (2001), *Discoveries on the Turkish Linguistic Map*, Swedish Research Institute in Istanbul, Publications 5, Stockholm.
- ЈАШАР-НАСТЕВА, О., (1962/63), *Македонските калки од туркиот јазик*, Македонски јазик, год. XIII-XIV, Скопје.
- KOCAOĞLU, Timur, (2001), *Türk Dili Araştırmalarında Önemli Adımlar*, TürkDili, Sayı 594 – Haziran 2001, Ankara, s. 628- 629.
- MARCANTONIO, A.; Numenaho, P.; Salvagni, M., (2001), *The Ugric- Turkic Battle* : A Critical Review, *Linguistica Uralica* 2, стр. 81 -102 .
- Nemet, G., *Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi VIII*, 1958, стр. 141-143 (преведено на турски од М. Mansuroğlu).
- TEKIN, Talat - ÖLMEZ, Mehmet, (1999), *Türk Dilleri*: Giriş, İstanbul: Simurg.
- ТОШЕВ, К., (1979), *Струшкиот говор (според некои материјали од XIX век)*, кн.12, Скопје.
- ВИДОЕСКИ, Б., *Охридско-струшките говори*, Прилози, IX, 1, МАНУ, Скопје, 1984.
- ЌАМИЛИ, А., (2007), *Јазични контакти на балканските простори*, Годишен зборник на Универзитетот “Св. Кирил и Методиј” во Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Книга 33, Скопје.
- ЌАМИЛИ, А., (2011). *Албанските говори во струшкиот регион (во балкански контекст)* (докторска дисертација), Универзитет “Св. Кирил и Методиј” - Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Скопје.
- КОНЕСКИ, Б., *Историја на македонскиот јазик*, Скопје, 1986, стр. 121.

ЛЕОНТИЌ, М., (1997), *Начин на изразување на природниот род во турскиот и македонскиот јазик (контрастивна анализа)*, Годишен зборник на Филолошкиот факултет „Блаже Конески“ на Универзитетот во Скопје, Книга 23, Скопје.

ПЕЕВ, К. *За малупознатото калкирање на службени зборови во југоисточните периферни македонски говори*, Зборник на Филолошки факултет посветена на проф. Угринова, Скопје.

САЗДОВ, С., *Современ македонски јазик 2*, Скопје, 2008.

СКОК, Р., *Hulumtime gjuhësore të popullsisë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (dialektologji) Prishtinë, 1978.

ТОПОЉИНСКА, З., (1991), *Затемнување на границите меѓу зборовните групи како резултат на турското влијание врз македонскиот јазик*, II. Меѓународен симпозиум: Македонско-турските културни врски во минатото и денес, 23-25 октомври 1991, Зборник на трудови, Филолошки факултет, Скопје, стр. 59-68.

Farketa DIBRA – ZEQIRI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare
Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup
Email: farketadibra@gmail.com

**KONGRESI I MANASTIRIT - NGJARJE EPOKALE E HISTORISË DHE
KULTURËS KOMBËTARE****THE CONGRESS OF BITOLA (MANASTIR) – AN EPOCHAL EVENT IN
NATIONAL HISTORY AND CULTURE**

Shekulli që lamë pas, pra shekulli XX, shqiptarëve u shkaktoi mjaftë dhimbje e u hapi shumë plagë, për shkak të copëtimit të trojeve etnike, megjithatë, pikërisht në këtë shekull, veç shpalljes së pavarësisë, ndodhën edhe ngjarje të tjera të mëdha, që lirisht mund të quhen epokale për historinë e kulturën tonë kombëtare. Një ndër këta ngjarje mes tjerash është edhe Kongresi i Alfabetit, i mbajtur në Manastir, më vitin 1908. Nëse shpikja e alfabetit konsiderohet si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit, atëherë Kongresi i Alfabetit mund të vlerësohet si epoka e re e fillimit të shkrimit të shqipes me një alfabet të unifikuar për të gjithë shqiptarët anembanë botës.

Gjuha shqipe ka një traditë të gjatë të shkrimit të saj duke filluar me dokumentet e para të shkruara ose edhe më herët duke përfshirë dëshmitë e para të vitit 1285 nga Shuflai “për një zë që fliste shqip” dhe tanimë edhe me dëshmitë vizuale të veprës pa titull të Teodor Shkodranit të vitit 1210, sipas thënies së zbuluesit të saj dr. Musa Ahmedit.⁷⁴ Deri para unifikimit të alfabetit, shqipja u shkrua me abc-ë të ndryshme, kryesisht me një mozaik alfabetesh: me alfabetin latin të përshtatur sipas autorësh e krahinash; me alfabetin arab, me alfabetin grek dhe me alfabetin cirilik. Veriu përkatësisht shkrimtarët e vjetër përdornin alfabetin latin (të plotësuar me disa shkronja cirilike). Bejtëxhinjtë përdornin alfabetin arab (si Muhamet Çami, Dalip e Shahin Frashëri). Në jug përdorej alfabeti grek (Thimi Mitko,

⁷⁴ <https://www.forumishqiptar.com/threads/34059-Dor%C3%ABshkrimi-shqip-i-Teodor-Shkodranit-nga-viti1210> (shkarkuar më 20.09.2024)

Konstantin Kristoforidhi), por ka edhe pak shkrime shqipe me alfabet cirilik (Gjergj Pula).

Ky shkrim i shumëllojshëm i shqipes përbënte problem serioz, ngase veprat e shkruara lexoheshin vetëm nga një grup i kufizuar njerëzish që dinin të këndonin atë shkrim. Kjo gjë sillte përçarje, andaj edhe rilindësit tanë qenë mjaft të brengosur. Kërkesa për njësimin e alfabetit sa vinte bëhej edhe më e ngutshme sidomos nga fundi i shek. XIX e në fillim të shek. XX, sepse ndihej një mungesë e madhe për përhapjen e kulturës, të arsimit dhe të rritjes së mëtejme të ndërgjegjes kombëtare. Rilindësit mendonin se shpëtimi i kombit mund të bëhet vetëm me bashkimin e shqiptarëve dhe këtë gjë e shihnin vetëm nëpërmjet të një alfabeti dhe të një gjuhe të përbashkët letrare shqipe për të gjithë. Kjo gjë i detyroi edhe më shumë atdhetarët e Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip në Stambollit që të krijojnë një alfabet dhe në vitin 1878 në Stamboll filloi punën një komision për alfabetin, në përbërje të të cilit qenë Hasan Tahsini, Vaso Pasha, Koto Hoxhi, Jani Vretoja e Sami Frashëri etj.

Alfabeti i Stambollit u mirëprit në rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut duke u bërë alfabeti kryesor i periudhës së Rilindjes dhe i shumicës së botimeve në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX. Ai u përhap në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme, si dhe në kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Kostancës, Sofjes, Selanikut etj. Me të u botua "Alfabetare e gjuhësës shqip" (136 fq.), më 1879, me një tirazh prej 20.000 kopjesh dhe u shpërnda anembanë në të gjithë viset ku jetonin shqiptarët, u botuan tekstet shkollore të hartuara nga Samiu, Naimi e Jani Vretoja, si dhe shumë vepra të tjera me karakter letrar e politik.⁷⁵

Pavarësisht jehonës që pat ndër shqiptarët, vlerësimet për alfabetin e Stambollit rreth strukturës së ndërtimit të tij do të vijnë njëzet vite me radhë. Mendimtarë të ndryshëm kanë vënë në dukje se alfabeti i Stambollit përmbush kriterin shkencor, sepse mbështetet në parimin fonetik "një shkronjë të thjeshtë për çdo tingull të veçantë"; përmbush kriterin politik, meqë përjashton alfabetin grek dhe arab; përmbush kriterin kulturor duke zgjedhur alfabetin latin "si një alfabet i përdorur nga shumë popuj të botës". Sa për anën praktike, Samiu thotë se "mund të mësohej më lehtë dhe mund të shtypeshin libra me të kudo". Lidhur me dy kriteret e fundit, lindin dy pyetje: pse komisioni miratoi një alfabet të përzier latin-grek dhe jo një alfabet thjesht latin si ai që propozoi në komision Vaso Pasha? Dhe a ishte vërtet praktik ky alfabet, sikundër thotë Samiu?⁷⁶

Për të kuptuar pse nuk u mor alfabeti latin i plotësuar me dyshkronjësia, i propozuar nga Vaso Pasha, duhet të kujtojmë se ndarja e vendit në myslimanë e të krishterë kishte krijuar një hendek midis

⁷⁵ Farketa Dibra-Zeqiri, *Qëndrimi i tre rilindësve shqiptarë për alfabetin e gjuhës shqipe - Gjergj Qiriazhi, Faik Konica, Mit'hat Frashëri*, International Journal of Albanology, Vol. 11 | No. 21-22, f. 104-112.

⁷⁶ [https://sot.com.al/opinion-editorial/alfabeti-i-shoqerise-se-stambollit-ne-driten-e-shtypit-te-rili-i543915/\(shkarkuar](https://sot.com.al/opinion-editorial/alfabeti-i-shoqerise-se-stambollit-ne-driten-e-shtypit-te-rili-i543915/(shkarkuar) më 15.09.2024)

shqiptarëve të dy besimeve. Ky hendek, me gjithë përpjekjet e intelektualëve atdhetarë, ishte vështirë të mbushej në një kohë aq të shkurtër. Prandaj çdo përpjekje për ringritjen e kombit dhe për të arritur bashkimin kombëtar, duhej bërë me shumë kujdes, në mënyrë që të mos prekeshin ndjenjat fetare të shqiptarëve.

Sa për pyetjen e dytë, koha provoi se alfabeti i Stambollit nuk ishte praktik. Duke qenë i përzier me shkronja greke dhe me disa shkronja të veçanta, ai paraqiste mjaft vështirësi për botim librash e fletorësh nëpër shtypshkronja. Për këtë arsye mbështetja për të erdhi duke rënë, ndërkohë që po rritej numri i mbështetësve të alfabetit vetëm me shkronja latine. Kështu, kur nisën përpjekjet për botimin e gazetave dhe të revistave shqip, u pa se shkronjat e veçanta të alfabetit të Stambollit nuk gjendeshin në shtypshkronjat e vendeve ku shtypeshin këto organe. Si rrjedhim, drejtuesit e tyre hoqën dorë nga ky alfabet dhe zgjodhën t'i shtypnin gazetatat dhe revistat e tyre me shkronja latine, të kombinuara në mënyra të ndryshme për të dhënë tingujt e shqipes që nuk i ka latinishtja. Kështu, nga mbi 20 gazeta e revista që dolën në periudhën prej vitit 1888 e deri në prag të Kongresit të Manastirit, alfabetin e Stambollit e përdorën vetëm tri prej tyre. Pra, kur mendohej se çështja e alfabetit kombëtar që zgjidhur, botimi nga fundi i shek. XIX e fillimi i shek. XX i shumicës së organeve të shtypit me alfabete me bazë latine e ktheu përsëri në rend të ditës këtë çështje.⁷⁷

Duke e hetuar këtë rrezik të zhbërjes kombëtare, mendjet e ndritura përgatitën, thirrën e mbajtën me sukses Kongresin mbarëkombëtar në Manastir, më vitin 1908, me të cilin u ndërpre procesi i divergjencës ndër shqiptarët dhe u fuqizua përgjithmonë procesi i konvergencës. Detyrën e njësimimit të alfabetit të shqipes historia ia ngarkoi ta zgjidhte Kongresit të Manastirit, i cili u thirr me nismën e klubit "Bashkimi" të Manastirit, që luante rolin kryesor ndërmjet klubeve shqiptare. Drejtuesit e këtij klubi, menjëherë pas themelimit të tij, e shpallën zgjidhjen e kësaj çështjeje si detyrën më të ngutshme të lëvizjes kombëtare. Gjatë muajve gusht-shtator, pasi kishte marrë edhe pëlqimin e klubeve e të shoqërive të tjera atdhetare, klubi i Manastirit ndërmori masat konkrete për thirrjen e kongresit kombëtar për çështjen e alfabetit. Nisma e tij u prit mirë nga atdhetarët shqiptarë dhe nga klubet e shoqëritë patriotike brenda e jashtë vendit, që u treguan të gatshme të dërgonin përfaqësuesit e tyre.⁷⁸

Gjithsej 50 delegatë, nga të gjitha viset e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë dhe të kolonive shqiptare morën pjesë në Kongresin e Alfabetit. Nga delegatët me të drejtë vote u zgjodh një komision prej 11 anëtarëve, personalitete e shkrimtarë të shquar, patriot e largpamës, me përgatitje të shkëlqyer teorike e praktike, siç ishin: Ndre Mjeda, Gjergj

⁷⁷ [https://sot.com.al/opinion-editorial/alfabeti-i-shoqerise-se-stambollit-ne-driten-e-shtypit-te-rili-i543915/\(shkarkuar më 15.09.2024\)](https://sot.com.al/opinion-editorial/alfabeti-i-shoqerise-se-stambollit-ne-driten-e-shtypit-te-rili-i543915/(shkarkuar%20m%C3%A9%2015.09.2024)).

⁷⁸ Ali Vishko, *Kongreset e Alfabetit e të shkollës shqipe*, Shkup, 1992, f. 22.

Fishta, Luigj Gurakuqi, Mid'had Frashëri, Gjergj Qiriazi, Grigor Cilka, Dhimitër Buda, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Bajo Topulli e Nyz'het Bej Vrioni. Komisioni u gjend para një sprove të vështirë, përkatësisht për të shuar larmit grafike të deritanishme me tradita katër a pesë shekullore e për të mbjellë një abc-ë të vetme të pranueshme për të gjithë shqiptarët, të cilët tani ishin të përcarë, të shpërndarë nëpër botë, të helmuar me gjuhë e kultura të ndryshme të huaj.⁷⁹ Para delegatëve shtrohej detyra të shqyrtonin tre alfabetet kryesore dhe prej tyre të hartohej alfabeti i ri. Rugët qenë tri:

1. Nëse duhet të përshtatnin njërin nga tri alfabetet kryesore: “Alfabetin e Stambollit” të Sami Frashërit; “Alfabetin e Shoqërisë Bashkimit” të propozuar nga Gjergj Fishta, por i krijuar nga Preng Doci – Shkodër; apo “Alfabetin e Shoqërisë Agimi” i propozuar nga Ndre Mjeda – Shkodër.

2. Nëse duhet t'i kombinonjë të tria në një.

3. Nëse duhet t'i lënë mënjane të tria dhe të adoptojnë një tjetër krejt të ri.

Komisioni pasi i shqyrtoi alfabetet e propozuara vërejti se këto tri alfabete kishin diçka të përbashkët, e përmbanin në strukturën e tyre alfabetin latin, por të dy alfabetet e para kishte pasur ndryshime vetëm në shtatë shkronja. Pas shumë diskutimesh komisioni mori vendim të krijonte një alfabet të ri të mbështetur në alfabetin latin, duke i shqyrtuar e analizuar një për një tingujt e shqipes për të caktuar mbi kriteret të drejta shkencore e në përshtatje sa më të saktë me gjuhën shqipe, shkronjat si dhe mënyrën e shënimit të tyre.

Në këto rrethana, pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e komisionit, sikurse thuhej në vendimin e kongresit, “të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme”, nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën që të mbahej alfabeti i Stambollit me disa ndryshime dhe krahas tij, të përdorej një tjetër me shkronja latine, si më praktik për shtypjen e librave dhe transmetimin e telegrameve me kodin Mors. Kjo zgjidhje kompromisi që e domosdoshme që kongresi të mos dështonte. Për të mos shkaktuar përcarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi u mor vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabete në mes të shqiptarëve në një periudhë kalimtare prej dy vjetësh deri në kongresin e Janinës, ku do të shqyrtohej edhe çështja e drejtshkrimit të gjuhës dhe të letërsisë dhe deri atëherë do të shihej se cili alfabet do të përdorej më shumë ai do të merret si alfabet i vetëm kombëtar. Në të njëjtën kohë u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabeti të vetëm, atë latin të cilin e përdorim sot.⁸⁰

Vendimet e Kongresit të Manastirit treguan se shqiptarët, tanimë, ishin konsoliduar si një komb i bashkuar dhe se ushqenin një aspiratë të përbashkët, të hynin në rrugën e përparimit ekonomik e kulturor dhe të

⁷⁹ Asllan Hamiti, *Shtjellime gjuhësore*, Shkup, 2020, f. 22.

⁸⁰ Shaban Demiraj – Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 2008, f.5.

zinin vendin që u takonte si popull evropian në familjen e madhe të kombeve të qytetëruara të Evropës.⁸¹

Puna madhore e Kongresit të Manastirit me kokat më të zgjuara të fushës së gjuhës, letërsisë e kulturës shqiptare brenda dhe jashtë territoreve shqiptare edhe për ditët e sotme paraqet një ngjarje të rëndësishme historike, sepse flet jo vetëm për një punë disa ditore mes njerëzve që u kujdesën për të mirën e përgjithshme të shkrimit të shqipes, por edhe për një bashkim mbarëkombëtar mes shqipfolësve, pavarësisht hapësirave në të cilat jetonin dhe vepronin ata. Puna e tyre me tërë natyrën e saj hulumtuese, ashtu siç tashmë e kanë pohuar studiues të tjerë para nesh, dëshmon edhe sot e kësaj dite se historia dhe kultura e popullit, pavarësisht se e cilit mund të jetë ai, mund të kuptohet vetëm me të shikuarit thelbësor të gjuhës, sepse ajo përpos që tregon rrugën dhe zhvillimin e saj, njëkohësisht dëshmon edhe për pasurinë e madhe të cilën gjuha shqipe e ka trashëguar nga e kaluara.

Kjo rrugë që u hap ndihmoi zhvillimet e mëvonshme për ngritjen e vetëdijes dhe formimin e kombit, shuarjen e ndasive krahinore e fetare, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave si dhe përhapjen e dijes e të kulturës. Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe që për shqiptarët një kusht i domosdoshëm për tu bërë ballë ndikimeve asimiluese të gjuhëve dhe kulturave të huaja. *“Një gjuhë që s’shkruhet e s’këndohet nuk zihet gjuhë”*- thoshte Sami Frashëri.⁸² Të folurit dhe të shkruarit në gjuhën amtare është mjet i domosdoshëm për të mbijetuar një komb. Për shqiptarët, njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Unifikimi i alfabetit që parakusht për bashkimin kombëtar. Me këtë u dobësua ndikimi i politikës asimiluese, u zgjua dhe u fuqizua vetëdija kombëtare si dhe u përcaktua e ardhmja jonë. Me Kongresin e Manastirit shqiptarët dëshmuan pjekuri kulturore e politike dhe mbi të gjitha se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë dhe një alfabet.⁸³

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë mund të përfundojmë se Kongresi i Manastirit i vitit 1908, kurorëzoi me sukses përpjekjet, që mendjet më të ndritura të kombit shqiptar bënë gjatë shekujve për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit grafik të saj, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e të përshtatshëm për gjuhë shqipe e të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Natyrisht se kjo rrugë nuk ishte e lehtë e pas sfida, vetëm puna vetëmohuese e patriotëve, shkrimtarëve dhe dijetarëve tanë, pena të shquara të kombit, bëri që ato vështirësi e pengesa të përballohen, jo edhe pa sakrificat herë-herë edhe me flijim të jetës së tyre.

⁸¹ Shaban Demiraj – Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 2008, f.5.

⁸² Sami Frashëri, *Abetare e gjuhës shqipe*, Konstandinopojë, 1978, f. 24.

⁸³ Asllan Hamiti, *Shtjellime gjuhësore*, Shkup, 2020, f. 21.

Tani kur jemi në vigjilje të 116-vjetorit të alfabetit, 112- vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë dhe 52-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit mund të krenohemi me arritjet e gjuhës shqipe. Që nga hartimi i alfabetit e deri më sot, gjuha shqipe është lëvruar dhe pasuruar, janë shkruar me mijëra vepra letrare, monografi shkencore, gramatika normative, historike, fjalorë shpjegues, dygjuhësh e shumëgjuhësh, e shumë tekste mësimore për arsimin fillor, parauniversitar e universitar, etj. E gjithë kjo pasuri gjuhësore, letrare e kulturore le të shërbejnë si një nxitje e thirrje për të gjithë intelektualët e jo vetëm, se këtë shqipe të folur, të shkruar, të fituar me gjak e me djersë jo vetëm që duhet ta ruajmë, por dhe t’ua lëmë trashëgimi pasardhësve tanë, si elementin më të rëndësishëm të qenies sonë kombëtare. Nëse nuk mund të bëjmë më shumë për shqipen, atëherë së paku të mos e harrojmë, shpërfillim, përziejmë, shtrembërojmë.

Summary

Prior to the Congress of Bitola (Manastir), the Albanian language was written using a mosaic of alphabets including Turkish, Arabic, Greek, Latin, Cyrillic, and others. This diversity in writing systems posed a serious challenge, as written works could only be read by a limited group of people familiar with the respective scripts. To address the issue of alphabet unification, Albanian Renaissance leaders mobilized by utilizing all possible legal and illegal means to convene the Congress of Bitola in 1908. The Congress was a pivotal moment aimed at achieving the cultural and educational emancipation of the Albanian nation, wherever its people resided. This mission later extended to the establishment of Albanian schools and the publication of magazines, newspapers, and textbooks in the Albanian language, now written in a unified alphabet accessible to all Albanians—Ghegs and Tosks, Muslims and Christians alike.

Naturally, the road to the Congress of the Alphabet was fraught with challenges. It was only through the self-sacrificing efforts of patriots, writers, and scholars—renowned intellectuals of the nation—that these difficulties were overcome, often at great personal cost, including the ultimate sacrifice of life. Despite these obstacles, the efforts culminated in success. Over the centuries, the brightest minds of the Albanian nation had worked tirelessly on the writing and cultivation of the Albanian language, the continuous refinement of its graphic system, and the development of an alphabet that would be accurate, suitable, and shared by all Albanians.

For Albanians, the unification of the alphabet, language, and culture naturally paved the way for national unity. The standardization of the alphabet was a prerequisite for national cohesion. With the Congress of Bitola, Albanians demonstrated cultural and political maturity and, above all, affirmed that they are one nation with a shared history, a common language, and a unified alphabet.

Keywords: *The Alphabet Congress, Bitola (Manastir), Albanian language, schools.*

Përmbledhje

Deri para Kongresit të Manastirit gjuha shqipe shkruhej me një mozaik alfabetesh turk, arab, grek, latin, cirilik, etj. Ky shkrim i shumëllojshëm i shqipes përbënte problem serioz, ngase veprat e shkruara lexoheshin vetëm nga një grup i kufizuar njerëzish që dinin të këndonin atë shkrim. Andaj për ta unifikuar çështjen e alfabetit, rilindësit tanë u mobilizuan duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë legale dhe ilegale për mbajtjen e Kongresit të Manastirit më vitin 1908, që kishte për qëllim madhor emancipimin kulturor-arsimor të kombit shqiptar kudo që ishte. Mision që më vonë do të vijonte me hapjen e shkollave shqipe dhe botimin e revistave, gazetave e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, por tani me një alfabet të unifikuar për të gjithë shqiptarët kudo që ishin, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë.

Natyrisht se puna deri te Kongresi i Alfabetit nuk ishte rrugë e lehtë e pas sfida, vetëm puna vetëmohuese e patriotëve, shkrimtarëve dhe dijetarëve tanë, pena të shquara të kombit, bëri që ato vështirësi e pengesa të përballohen, jo edhe pa sakrificë herë-herë edhe me flijim të jetës së tyre. Përtej çdo vështirësie u kurorëzuan me sukses përpjekjet, që mendjet më të ndritura të kombit shqiptar bënë gjatë shekujve për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit grafik të saj, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e të përshtatshëm për gjuhën shqipe e të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Për shqiptarët, njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Unifikimi i alfabetit që parakusht për bashkimin kombëtar. Me Kongresin e Manastirit shqiptarët dëshmuar pjekuri kulturore e politike dhe mbi të gjitha se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë dhe një alfabet.

Fjalët kyçe: *Kongresi i Alfabetit, Manastiri, gjuha shqipe, shkolla.*

Bibliografia:

DEMIRAJ, Shaban – PRIFTI, Kristaq (2008). *Kongresi i Manastirit*, Tiranë.

DIBRA-ZEQIRI, Farketa (2024). *Qëndrimi i tre rilindësve shqiptarë për alfabetin e gjuhës shqipe - Gjergj Qiriaz, Faik Konica, Mit'hat Frashëri*, International Journal of Albanology, Vol. 11 | No. 21-22, Tetovë.

FRASHËRI, Sami (1978). *Abetare e gjuhës shqipe*, Konstandinopojë.

HAMIT, Asllani (2020). *Shtjellime gjuhësore*, Shkup.

VISHKO, Ali (1992). *Kongreset e Alfabetit e të shkollës shqipe*, Shkup.

[https://www.forumishqiptar.com/threads/34059-](https://www.forumishqiptar.com/threads/34059-Dor%C3%ABshkrimi-shqip-i-Teodor-Shkodranit-nga-viti1210)

[Dor%C3%ABshkrimi-shqip-i-Teodor-Shkodranit-nga-viti1210](https://www.forumishqiptar.com/threads/34059-Dor%C3%ABshkrimi-shqip-i-Teodor-Shkodranit-nga-viti1210)

<https://sot.com.al/opinion-editorial/alfabeti-i-shoqerise-se-stambollit-ne-driten-e-shtypit-te-rili-i543915/>

Arta TIKA BEKTESHI,
Universiteti Nënë Tereza,
Fakulteti i Shkencave Humane
arta.bekteshi@unt.edu.mk

Teuta AGAJ AVDIU,
Universiteti Publik Kadri Zeka,
teuta.agaj@uni-gjilan.net

MBI NATYRËN MOHUESE TË PËREMRAVE TË PACAKTUAR TË SHQIPES

ON THE NEGATIVE NATURE OF SOME ALBANIAN INDETERMINATE PRONOUNS

Hyrje

Gjuhët në pëgjithësi kanë veçantitë e tyre që dallojnë nga njëra gjuhë në tjetrën, por kanë edhe pikat e përbashkëta. Këto tipare të përbashkëta apo dalluese mund t'i vërejmë duke bërë krahasime mes gjuhëve. Nga krahasimi që kemi bërë mes gjuhës shqipe dhe asaj angleze kemi nxjerrë në pah një veçanti të përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe. Kjo veçanti ka të bëjë me atë që njihet si polaritet. Polariteti nuk është një term që përdoret vetëm në gjuhësi, përkundrazi, shumë më përpara gjuhësisë është përdorur në matematikë, fizikë, kimi e në fusha të tjera shkencore, por në të gjitha fushat polariteti tregon pak a shumë të njëjtën gjë, dy pole të kundërta – polin pozitiv dhe atë negativ. Duke u bazuar te gjuha angleze, do të mundohemi të bëjmë dallimin në mes fjalëve mohuese/negative dhe fjalëve me polaritet negativ/ mohues, si dhe të analizojmë polaritetin e përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe.

Metodologjia

Gjatë këtij studimi janë përdorur dy metoda hulumtuese, metoda krahasuese dhe ajo përshkruese. Me anë të metodës krahasuese janë krahasuar strukturat mohore të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze, ndërsa

me anë të metodës përshkruese janë përshkruar disa veçanti gjuhësore të përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe në krahasim me ata të gjuhës angleze. Fjalitë mohore që përdoren në analizë janë marrë nga romani Mos e lufto pranverën nga autori E. M. Forster, i përkthyer në shqip nga Etleva Hoxha Çepele. Pikërisht nga ky krahasim dhe përshkrim janë nxjerrë përfundimet.

Polariteti - Krahasim i gjuhës shqipe me gjuhën angleze

Është shumë me rëndësi të theksohet që ka një dallim thelbësor në strukturën e gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze pasi që gjuha shqipe është gjuhë polinegative ndërsa gjuha angleze është gjuhë mononegative. Kjo do të thotë që gjuha angleze si gjuhë mononegative në strukturën e fjalive mohore lejon vetëm një mohues, ose mohues foljor, pra pjesëz mohuese që mohon foljen ose fjalë mohuese. Fjalët mohuese në gjuhën angleze janë përemra të pacaktuar ose ndajfolje mohore, si *no one, nobody, nothing*, etj. Në rastet kur kemi mohim foljor atëherë në vend të këtyre fjalëve mohuese, në gjuhën angleze përdoren fjalët me polaritet mohues. Pra, me qëllim që të mos ketë më shumë se një mohues në fjali, përdoren fjalë të cilat nuk janë mohuese por përdoren në fjali mohuese, të tilla janë *anyone, anybody, anything*, etj.

Sipas Penka & Zeijlstra (2010) dallimi midis përemrave të pacaktuar si fjalë mohuese dhe si njësi me polaritet mohues është shumë i qartë në gjuhën angleze, dhe këtë e ilustron me shembujt:

a. I didn't see **anyone**.

b. I saw **no one**.

Por ky dallim nuk është aq i qartë te gjuhët polinegative. Ata gjithashtu japin shembuj të gjuhës polake në të cilën përemrat e pacaktuar me patjetër shoqërohen me nga një pjesëz mohuese dhe si të tilla ata më tepër ngjajnë me njësitë me polaritet negativ sesa me fjalët mohuese. Nga ana tjetër ato mund të përdoren vetëm, pa pjesëz mohuese, kur përdoren si përgjigje me fjali të paplotë. (f. 778) Si të tillë, ata nuk ngjajnë me fjalët me polaritet mohues, pasi që fjalët me polaritet mohues nuk mund të përdoren pa pjesëz mohuese. Në këtë kënvështrim gjuha shqipe ndan të njejtat veçori me gjuhën polake pasi që:

c. **Nuk** erdhi **askush**. / *Erdhi **askush**.

d. Kush erdhi? – **Askush**.

Në fjalinë (c) përemri i pacaktuar **askush** kërkon patjetër të shoqërohet nga pjesëza mohuese **nuk**. Në shembullin (d) përemri i pacaktuar **askush** përdoret si përgjigje pa pjesëz mohuese në fjali të paplotë që shpreh mohim kategorik. Pra sipas shembullit (c) mund të themi që përemri i pacaktuar është fjalë me polaritet mohues, por jo sipas shembullit (d), sepse po ta krahasojmë me anglishten, njësitë me polaritet negativ asnjëherë nuk mund të përdoren si përgjigje të shkurtra pa pjesëz mohuese:

(e) Who came? ***Anybody**.

Giannakidou (1997) bën dallimin midis gjuhëve polinegative strikte, dhe jo-strikte. Sipas saj:

- a. **Gjuhë polinegative strikte** janë ato gjuhë ku fjala mohuese (n-word) gjithmonë kërkon prezencën e një pjesëze mohuese, pa marrë parasysh pozicionin që ka në fjali.
- b. **Gjuhë polinegative jo-strikte** janë ato gjuhë ku fjala mohuese mund të përdoret edhe pa pjesëz mohuese në pozicionin para-foljor edhe në bashkëveprim me ndonjë fjalë mohuese në pozicionin para-foljor.

Në këtë kënvështrim gjuha shqipe së bashku me disa gjuhë të tjera, siç janë gjuhët slave, gjuha greke, hungareze, etj. janë gjuhë polinegative strikte (e cituar te Giannakidou & Zeijlstra, 2017, f. 9) pasi që përemrat e pacaktuar gjithmonë kërkojnë të shoqërohen nga një pjesëz mohuese dhe në këtë rast ato janë fjalë me polaritet negativ të theksuar (strong NPIs).

“Fjalët mohuese, ndryshe nga *any*, mund të ‘vetë-lejojnë’ mohimin në pozicionin para-foljor (te gjuhët polinegative strikte) dhe në përgjigje të shkurtra (te të gjitha gjuhët polinegative)”(Giannakidou& Zeijlstra, 2017, f. 11).

Duke u bazuar në këto pohime mund të përfundojmë që në gjuhën shqipe si gjuhë polinegative strikte në fjalitë mohore me mohim foljor, përemrat e pacaktuar përdoren si fjalë/njësi me polaritet mohues pasi që gjithmonë përdoren krahas pjesëzës mohuese. Për më tepër, edhe pse në gjuhën shqipe përemrat e pacaktuar përdoren si përgjigje të shkurtra në fjali të paplota ku shprehin mohim kategorik pa pjesëz mohuese – që nuk është karakteristikë e njësive me polaritet negativ- ato përsëri funksionojnë si njësi me polaritet negativ pasi që mohimi foljor nënkuptohet:

(f) Kush telefoni? – **Askush**. (**Askush nuk** telefoni)

Përemrat e pacaktuar të shqipes

Gati në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe përemrat e pacaktuar ndahen në nënndarje të njëjta, kështu që këtu do të marrim ndarjen nga *Gramatika e gjuhës shqipe I* (2002) ku për nga kuptimi leksikor ato ndahen në

1. Përemra të pacaktuar që tregojnë ose përjashtojnë vetëm frymor në mënyrë të pacaktuar – **kush, dikush, sekush, njeri, askush, asnjeri**.
2. Përemra të pacaktuar që tregojnë ose përjashtojnë vetëm sende në mënyrë të pacaktuar – **diçka, diç, seç, gjë, gjëkafshë, gjësendi, asgjë, hiçgjë, hiçmosgjë, kurrëgjë, asgjësendi, asgjëkafshë**. (f. 251-252)

Edhe pse ka edhe lloje të tjera të përemrave të pacaktuar, objekt studimi i kemi vetëm këto dy lloje kështu që të tjerit nuk i shënojmë aspak. Ngajshëm, por me emërtim pak më ndryshe, ata janë klasifikuar edhe nga Newmark, Hubbard dhe Prifti (1982)

1. Përemra të pacaktuar me referentë frymorë – **kush** 'somebody', **dikush** 'someone', **sekush** 'everyone', **njeri** 'someone', **askush** 'nobody', **asnjeri** 'no one'.
2. Përemra të pacaktuar me referentë jo-frymor – **diçka** 'something', **diç** 'something', **seç** 'something', **gjë** 'anything', **gjëkafshë** 'anything', **gjësendi** 'anything', **asgjë** 'nothing', **hiçgjë** 'nothing', **hiçmosgjë** 'nothing', **kurrëgjë** 'nothing', **asgjësendi** 'nothing', **asgjëkafshë** 'nothing' (f.282-283)

Siç mund të vërehet, ndarjet janë të ngjajshme dhe përmbajnë të njëjtët përemra. Shumica e këtyre përemrave janë sinonimikë me njëri tjetrin. Në vazhdim do të analizojmë disa shembuj për të parë natyrën dhe polaritetin e përemrave të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar të llojit *asgjë /gjë*

Përemri i pacaktuar **asgjë**, dhe rrejdhimisht edhe përemrat sinonimikë **hiçgjë**, **hiçmosgjë**, **kurrëgjë**, **asgjësendi**, **asgjëkafshë** kërkojnë përdorim të patjetërsueshëm të mohimit foljor (shembulli 1,2,3). Këto përemra nuk mund ta mohojnë vetë kuptimin e fjalisë, pra nuk janë fjalë mohuese. Në rast se e heqim pjesëzën mohuese nga fjalia (1a,2a,3a), ajo nuk ka kuptim, nuk është as pohore as mohore.

1. **Asgjë** tjetër **nuk** kishte. (Forster, p. 20)
 - 1a. * **Asgjë** tjetër kishte.
 - 1b. **Gjë** tjetër **nuk** kishte.
2. ... me njerëz për të cilët **nuk** dimë **asgjë**. (Forster, p. 13)
 - 2a. * ...për të cilët dimë **asgjë**.
 - 2b. ...për të cilët **nuk** dimë **gjë**.
3. ... jeta **nuk** të ofron **asgjë** të kënaqshme.(p. 164)
 - 3a. * ...se jeta të ofron **asgjë** të kënaqshme.
 - 3b. ...jeta **nuk** të ofron **ndonjë gjë** të kënaqshme

Përemri **gjë (anything)** (gjësendi, gjëkafshë) edhe pse nuk është morfologjikisht mohues në vete, gjithashtu përdoret në fjali mohore (si dhe në fjali pyetëse dhe të varura kushtore por që nuk janë temë diskutimi në këtë punim). Nga shembujt 1b,2b dhe 3b mund të shohim se ky përemër përdoret në fjali mohore me mohim foljor. Nëse provojmë ta heqim përemrin e pacaktuar **gjë** nga fjalitë mohore 1b,2b, dhe 3b do të shohim që nuk janë kuptimplota, dhe në vend të këtij përemri do të mund të përdorej përemri i pacaktuar **diçka**.

Këtu na del edhe një veçanti tjetër e gjuhës shqipe – edhe përemrat e pacaktuar që përjashtojnë frymorë/sendë edhe ato që tregojnë frymorë/sendë mund të përdoren si fjalë me polaritet negativ, pra të dy llojet kërkojnë prezencën e pjesëzës mohuese. Për të bërë dallimin mes këtyre dy llojeve të përemrave me polaritet negativ, mund të shfrytëzojmë terminologjinë e përdorur nga Xherija (2014) 'emphatic and non-emphatic

NPIs' *njësi me polaritet mohues të theksuar (asgjë dhe përemrat sinonimik) dhe të patheksuar (gjë dhe përemrat sinonimik).*

Përemrat e pacaktuar **njeri** dhe **kush**

Përveç përemrit të pacaktuar **gjë** i cili tregon sende, përemrat **kush** dhe **njeri** janë përemra të pacaktuar të cilët tregojnë frymorë. Pra, asnjëri nga këto përemra nuk është përjashtues por megjithatë atë përdoren vetëm në fjali mohore, gjë që i bën fjalë me polaritet mohues të patheksuar për t'i dalluar nga ato me polaritet të theksuar si **askush**, **asgjë**, **asnjeri**, etj.

4. . Ka mundësi të **mos** i tregoni **njeriu** për sjelljen time prej budallaqeje?(p. 56)
 - 4a. * Ka mundësi t'i tregoni **njeriu** për sjelljen time prej budallaqeje?
5. Të premtova që **nuk** do të bëja fjalë me **njeri**.(p. 177)
 - 5a. * Të premtova që do te bëja fjalë me **njeri**.
6. Sepse e lashë me Sesilin të **mos** ia thosha **njeriu** derisa të largohesha nga Anglia.(p. 234)
 - 6a. * ... e lashë me Sesilin t'ia thosha **njeriu**...
7.ai njeri i acartë që **nuk** i fliste **kush**. (Domi, f. 251)
 - 7a. * ...ai njeri i acartë që i fliste **kush**.

Përemri i pacaktuar **askush** (**kurrkush/ asnjëri**)

Ngajshëm sikurse **asgjë** i cili është përemër i pacaktuar që përjashton sende, edhe përemri i pacaktuar që përjashton frymorë **askush**, si dhe përemrat sinonimikë gjatë përdorimit të tyre në fjali mohore këkojnë prezencën e një pjesëze mohuese (shembujt 8, 9, 10, 11, 12), që do të thotë se edhe këto kanë tiparet e njësisive me polaritet mohues të theksuar. Ata nuk mund të përdoren në fjali pa mohim foljor, pra nuk mund ta mohojnë vetëm fjalinë (8a,9a, 110a, 11a, 12a).

8. **Askush nuk** do të më ndihmojë. (p. 201)
 - 8a. ***Askush** do të më ndihmojë.
9. **Askush nuk** do ta merrte për famullitar. (p. 15)
 - 9a. * **Askush** do ta merrte për famullitar.
10. Brenda **nuk** ishte **kurrkush** veç një turisti,... (p. 21)
 - 10a. * Brenda ishte **kurrkush** veç një turisti,...
11. . Unë e di qe **asnjeri** prej jush **nuk** do të hapë fjalë për mua.(p. 244)
 - 11a. *... **asnjeri** prej jush do të hapë fjalë për mua.
12.**asnjë** nga femrat e Da Vincit **nuk** mund të kishte diçka aq vulgare sa një "histori". (p. 109)
 - 12a. * ...**asnjë** nga femrat e Da Vincit mund të kishte diçka aq vulgare sa një "histori".

Përemri i pacaktuar ndonjë

Për dallim nga përemrat e pacaktuar **kush** dhe **njeri**, të cilët tregojnë frymorë, përemri **ndonjë** ka polaritet të dyfishtë pasi që përveç se mund të përdoret në fjali me mohim foljor (13, 14, 15), ai gjithashtu përdoret edhe në disa lloje të fjalive pohore (13*, 14*, 15*)

13. . Ajo **nuk** ishte **ndonjë** pianiste e shkëlqyer, ... (p. 38)

13*. Ajo ishte **ndonjë** pianiste e shkëlqyer,...

14.dhe me sa kam kuptuar **nuk** kishte **ndonjë** farë romani. (p. 44)

14*. ...dhe me sa kam kuptuar kishte **ndonjë** farë romani.

15. ... **nuk** ndien **ndonjë** lloj revoltimi ndaj saj. (p. 51)

15*. ...ndien **ndonjë** lloj revoltimi ndaj saj.

Përfundimi

Polariteti dhe mohimi janë dy karakteristika gjuhësore të cilat mund të dallojnë nga njëra gjuhë te tjetra, por gjithashtu kanë edhe pikat e përbashkëta. Edhe pse përemrat e pacaktuar janë pjesë përbërëse e strukturës së fjalive mohore, nuk domethënë që ato e mohojnë kuptimin e fjalisë në mënyrë të pavarur. Përkundrazi, ato e kanë të domosdoshme të përdoren krahas një pjesëze mohuese, prandaj mund t'i kategorizojmë si përemra me polaritet negativ. Pra, ata paraqiten në fjali mohore, por nuk e mohojnë fjalinë.

Duke marrë parasysh klasifikimet ekzistuese të përemrave të pacaktuar në gramatikat e gjuhës shqipe në përemra të pacaktuar që tregojnë frymorë apo sende dhe në përemra të pacaktuar që përjashtojnë frymorë apo sende, mund të përfundojmë që:

Përemrat si **askush**, **asnjë**, **kurrkush** dhe **asgjë**, **hiçgjë**, **hiçmosgjë**, kërkojnë pjesëz mohuese prandaj mund të themi se kanë polaritet negativ të theksuar. Polariteti negativ themi që është i theksuar pasi që ata në strukturën e tyre morfologjike përmbajnë element mohues si *as-*, *kurr-*, *hiç*.

Përemrat **ndonjë**, **gjë**, **njeri**, **kush** edhe pse nuk kanë kuptim mohues, as përjashtues, gjithashtu përdoren në kontekste negative, pra kanë polaritet negativ të patheksuar.

Gjuha shqipe si gjuhë polinegative përveç pjesëzës mohuese, në fjalitë mohore përdor edhe fjalë të tjera me polaritet negativ të cilat ndihmojnë në theksimin dhe përforcimin e mohimit.

Abstrakti

Secila gjuhë ka natyrën e saj, bashkë me të gjithë tiparet që e karakterizojnë. Meqenëse gjuha shqipe si gjuhë indoeuropiane përbën një degë të veçantë të gjuhëve, ajo dallon nga gjuhët tjera në disa aspekte. Një nga ato është edhe mënyra se si formohet dhe si shprehet mohimi në gjuhën shqipe. Gjuha shqipe si gjuhë polinegative dallon nga gjuhët mononegative siç është anglishtja. Me qëllim që të analizohet natyra mohuese e përemrave të pacaktuar të shqipes do ti referohemi gjuhës

angleze si gjuhë botërore. Fjalitë mohore në gjuhën shqipe përbëhen nga një pjesëz mohuese *nuk, s', mos*, etj. si dhe nga ndonjë përemër i pacaktuar apo ndajfolje mohuese. Në këtë punim do të fokusohemi vetëm te përemrat e pacaktuar të cilët përdoren në fjalitë mohore dhe do të mundohemi t'i analizojmë dhe t'i kategorizojmë ata në përemra pohues apo mohues, ose përemra me polaritet pohues dhe mohues. Në gjuhën angleze egziston dallimi midis fjalëve mohuese dhe fjalëve me polaritet mohues, ku fjalët mohuese e mohojnë kuptimin e fjalisë pa mohim foljor, pra pa përdorur pjesëz mohuese ndërkaq fjalët me polaritet mohues nuk mund ta mohojnë fjalinë por janë fjalë që përdoren vetëm në fjali mohore, pra në fjali ku përdoret pjesëz mohuese. Duke u nisur nga kjo, çfarë natyre kanë përemrat e pacaktuar të shqipes? A mund ta mohojnë kuptimin e fjalisë pa pjesëz mohuese? Apo përdoren vetëm në fjali me pjesëz mohuese? Të gjitha këtyre pyetjeve do t'u japim përgjigje përmes analizës dhe përshkrimit të bërë në vazhdim.

Fjalët kyç: Përemrat e pacaktuar, gjuha shqipe, polariteti, fjalët mohuese, fjalë me polaritet mohues

Abstract

Each language has its own nature, along with all the features that characterize it. Since the Albanian language as an Indo-European language constitutes a special branch of languages, it differs from other languages in several aspects. One of them is the way negation is formed and expressed in the Albanian language. The Albanian language as a polynegative language differs from mononegative languages such as English. In order to analyze the negative nature of Albanian indefinite pronouns, we will refer to the English language as a world language. Negative sentences in the Albanian language consist of a negative particle *nuk, s', mos*, etc. as well as from any indefinite pronoun or negative adverb. In this paper we will focus only on indeterminate pronouns which are used in negative sentences and we will try to analyze and categorize them into positive or negative pronouns, or pronouns with positive and negative polarity. In the English language, there is a difference between negative words and negative polarity items (NPIs), where negative words negate the meaning of the sentence without verbal negation, i.e. without using a negative particle, while negative polarity items cannot negate the sentence but are words that are used only in negative sentences, that is, in sentences where the negative particle is used. Based on this, what is the nature of Albanian indefinite pronouns? Can they negate the meaning of the sentence without the negative particle? Or are they only used in sentences with negative particles? All of these questions will be answered based on the following analysis and description.

Keywords: Indefinite pronouns, Albanian language, polarity, negative words, NPIs

Bibliografia

- BEKTESHI A. T. (2024) Negative transformations and translations from English into Albanian and vice versa – the influence of L1, *South East European Journal of Sustainable Development, Volume 8, Issue 1*, pp.98-103
- BEKTESHI A. T. (2024) Choosing the correct n-word or NPI – a case study with Albanian students, *International Journal Interkultura, volume 4*, pp. 149-158, UDC 811.111'243:37.091.212
- BEKTESHI A.T. & Miftari I. (2016) Forming Present and Past Simple Negative Sentences – the Difficulties that Albanian Students Face due to L1 Transfer, *KNOWLEDGE International Journal, Volume 15, Issue 3*, pp. 1441-1446
- DOMI, M. ed. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1: Morfologjia*”, Volume 1, Tirana: ASHRSH, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë
- GIANNAKIDOU, A. (2002). N-words and Negative Concord. For *The Linguistics Companion*, Blackwell
- GIANNAKIDOU, A. (2011). Negative and positive polarity items: Variation, licensing, and compositionality. In *Semantics: An international handbook of natural language meaning*. Edited by Claudia Maienborn, Klaus von Heusinger, and Paul Portner, 1660–1712. Berlin: Mouton de Gruyter.
- GIANNAKIDOU A. & Zeijlstra H. The landscape of negative dependencies: Negative Concord and N-words, <https://home.uchicago.edu/~giannaki/pubs/Giannakidou.zeijlstra.proofs.SC2017.pdf>
- GOSTURANI, Xh. (1976b). Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij në gjuhë shqipe III. In: *Studime Filologjike 4*, 49-57
- GOSTURANI, Xh. (1977a). Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij në gjuhë shqipe IV. In: *Studime Filologjike 1*, 61-71
- FORSTER, E. M. (2015). *Mos e lufto pranverën*. Translated by Etleva Hoxha Çepele. Botime Pegi
- NEWMARK, L., Philip Hubbard and Peter Prifti. (1982). *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*, Stanford: Stanford University Press
- PENKA, D. & Zeijlstra, H. (2010) . Negation and Polarity: An Introduction. *Natural Language & Linguistic Theory 28*, 4, 771-786, DOI 10.1007/s11049-010-9114-0
- PENKA, D. (2020) Negative Indefinites and Negative Concord <https://doi.org/10.1002/9781118788516.sem095>
- TURANO, G. (2000). On Clitics and Negation in Albanian. *Rivista di Grammatica Generativa: Research in Generative Grammar (RGG)*, Padova: Unipress
- XHERIJA, O. (2014). Weak and Strong NPIs: nobody and anybody in Albanian and Modern Greek. *Proceedings of the 15th Meeting of the Texas Linguistic Society*. Austin, TX: Texas Linguistics Society, Department of Linguistics, University of Texas at Austin. 184-201

Sejdi M. GASHI

Instituti Albanologjik - Prishtinë

sgashi.iap@gmail.com

**MODALITETI I SAKTËSISË DHE KUPTIMI KOHOR I FORMAVE FOLJORE
DO TË JEM /DO TË KEM NË GJUHËN SHQIPE (ANALIZË KONTRASTIVE)**

**TEMPORAL PRECISION AND TENSE MEANINGS OF THE VERB FORMS
DO TË JEM/ DO TË KEM IN THE ALBANIAN LANGUAGE (CONTRASTIVE
ANALYSIS)**

Hyrje

Shprehja e kuptimit modal të probabilitetit prej formave foljore të tipit *do të* (*do të jetë/ketë, do të kem punuar, do të ishte /kishte, do të kishte ndodhur*), forma që përbëjnë një ndër mënyrat e realizmit të supozimeve, në studimet e ndryshme gramatikore brenda shqipes, ka pasur prirjen të shpjegohet në dy mënyra të ndryshme, si: a) si një ndër kuptimet gramatikore të së ardhmes me *do*⁸⁴; b) elementi *do* është trajtuar si bartës i kuptimit modal të probabilitetit, duke bërë fjalë në këtë mënyrë për ndërtime analitike modale *do+ lidhore*⁸⁵, gjë që i afron këto ndërtime me ato të foljeve modale *mund/duhet+lidhore*.

⁸⁴ Fatmir Agalliu, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, në: "Studime Filologjike", nr.2, Tiranë,1968, f.133-134; Shih edhe: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 316.

⁸⁵ Xhevat Lloshi, *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, në: "Studime Filologjike", nr.4, Tiranë, 1966, f. 188. Shih edhe: Shaban Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, në: "Studime Filologjike" nr.3, Tiranë, 1977, f. 109.

Pranimi i shpjegimit të parë, se te kjo vlerë modale kemi një ndërlidhje të dyfishtë; a) lidhje kohore: nga sfera e së ardhmes në të tashmen; b) lidhje modale: nga sfera e realitetit dhe sigurisë, që janë tipare të së tashmes, në sferën e hipotezës dhe mundësisë, që janë tipare të së ardhmes, kërkon sqarimin e çështjeve të tilla si:

- I. A karakterizohen format modale nga kuptimi kohor i së tashmes dhe si duhet interpretuar kjo?
- II. A dëshmon e ardhmja e shqipes vlerë të hipotezës, të mundësisë dhe të pasigurisë ?

Në lidhje me drejtimin e dytë të konceptimit të këtyre formave si ndërtime të tipit do+lidhore lipset sqarimi:

- Nëse do ta ruajë kuptimin e pashlyer në ndërtimet e probabilitetit, përse shprehja e probabilitetit nga foljet që shënojnë veprim realizohen me anë të trajtave foljore *do të jetë duke shikuar* dhe *do të shikojë/ do të jetë duke punuar* e jo *do të punojë?*

Dhënia përgjigje në këto pyetje do të na mundësojë mbajtjen e një qëndrimi më të argumentuar në lidhje me çështjen nëse ndërtimet me *do* në gjuhën shqipe duhen trajtuar pa përjashtim si ndërtime të së ardhmes, apo ndërtimet modale duhen klasifikuar veçmas atyre të së ardhmes. Kjo shtron nevojën e shqyrtimit krahasues në rrafshin sinkronik të kuptimeve kohore dhe modale të ndërtimeve me *do* në gjuhën shqipe nën këndvështrimin e teorive më të reja.

Pasqyrimi i kundërvënieve përkatëse gramatikore midis ndërtimeve të probabilitetit dhe atyre të së ardhmes, na jep mundësinë të hedhim dritë dhe të nxjerrim në pah ndërvarësitë dhe kushtëzimet që ekzistojnë midis kuptimeve gramatikore të *modalitetit, kohës dhe aspektit*.

Raportet kohore në ndërtimet me do

Nga shqyrtimi i raporteve kohore të ndërtimeve me *do* vërejmë se format që shprehin modalitet të probabilitetit ndahen në ndërtime sa që karakterizohen nga një kuptim kohor i pakufizuar (akroni) dhe në ato që kanë një kuptim kohor të identifikueshëm me atë të formës së lidhore që shoqëron elementin *do*. Nga shembujt e vjelë na rezulton se të gjitha foljet që dalin në ndërtimet modale të tipit *do të jem* karakterizohen nga aspekti i brendshëm *amperfekt*. Akronia lidhet kryesisht me foljen *jam* dhe kushtëzohet nga funksioni i saj në fjali të tipit: 1. *Këto do të jenë angleze, jo gjermane,- thashë unë.*

Rasti (1) “këto do të jenë angleze” është shembull tipi i akronisë kohore, e përcaktuar kjo nga një raport identifikues midis temës (*këto*) dhe remës (*angleze*), të cilin e realizon folja *jam*. Ky funksion i foljes *jam* e cila del në rolin e një mjeti lidhës, karakteristik edhe për disa gjuhë të tjera⁸⁶ e

⁸⁶ M.A.K. Halliday, Ch. Matthiessen, *An Introduction to functional grammar*, Third edition, Hodder Arnold, London 2004, f. 69.

paraqet raportin *temë-remë* për të tashmen e dëftores si barazim (=) / mosbarazim (≠). P.Sh.: *Ky është Albani, - i tha një, -një shok i afërt i Dritanit. / temë (ky), remë (Albani).*

*Siç duket do të jem hidhëruet për ata që jetojnë tej ishullit, atëherë fjalët e mia do të kenë peshë. Tema (unë) rema (do të jem hidhëruet). Siç vihet re nga shembujt e dhënë, format supozuese shprehin një raport kohor parakohësie në lidhje me format përkatëse të së ardhmes. Kështu, e ardhmja e përparme shpreh një raport paskohësie në lidhje me çastin e ligjërimin dhe parakohësi në lidhje me një veprim të së ardhmes. P.sh. *Ana ka emrin e nënës suaj, por kur ajo të rritet njerëzit do ta kenë gjetur ilaçin e kulerës!*⁸⁷. Ndërkaq, forma homonime supozuese shpreh një raport parakohësie në lidhje me çastin e ligjërimin. P.sh.: *Mund ta marrim me mend se si dikush në Shqipëri do të ketë qenë aq i pasjellshëm, sa do ta ketë pyetur shkëlqesinë e tij, lordin, se sa e lashtë ishte familja e tij.*⁸⁸ Në rastin kur shprehet supozim, veprimi i supozuar nuk vendoset në raport kohor me një veprim tjetër. P.sh.: *Do të jenë dashur shumë vjet që nga zbulimi i thjeshtë i një alfabeti e deri te zhvillimi i një letërsie. Atëherë mund të shtrohet pyetja: Kur do të ketë nisur të shkruhet shqipja?**

E njëjta pasqyrë del edhe për të ardhmen e përparme të së shkuarës. Kur përdoren në kuptimin e të ardhmes ato karakterizohen nga kuptimi kohor i paskohësisë në raport me një veprim të caktuar, veprim ky domosdoshmërisht i shprehur prej një ndërtimi tjetër foljor ose i nënkuptuar. Në këtë kuptim kohor këto forma përdoren në periudhat hipotetike. P.sh.: *Po të kish ndodhur vdekja e plakut, kur i biri ndodhej në Petërsburg, pa fjalë, Vesa do të ish ndodhur në varrim; dhe Gjilpëra ish i sigurt se Vera do t'i kish dhënë atë të puthur që në varret, ndoshta, që në kishë brenda.*⁸⁹... *Njoh shumë të tjerë që do të ishin bërë myslimanë në qoftë se do të kishin regjimin e bagëtive.*⁹⁰

Kur ndërtimet gramatikore shprehin supozim karakterizohen nga raporti kohor i parakohësisë në lidhje me një veprim ose çast të së shkuarës, çast ky i nënkuptueshëm prej kontekstit gjuhësor. P.sh.: *Kalorësi do ta kish gjetur këtë kalë në sheshin e luftës, kushedi se si, dhe i qe hedhur në shpinë në luftim e sipër.*⁹¹

Kundërvënia kohore e formave supozuese homonime me të ardhmen e së shkuarës del jo shumë e qartë falë aspektit të pakryer të foljes. Është vështirë të dallohet nëse kemi përdorim me vlerën e së ardhmes apo me vlerë modale të probabilitetit të këtyre formave. P.sh.: *Edhe ai do të dëshironte të më përcillte sa më parë.*⁹²

⁸⁷ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, "Mapo Editions", Tiranë, 2010, f. 236.

⁸⁸ Alfred Uçi, *Eстетika e Groteskut*, IV, "Nobël", Tiranë, 2001, f.164.

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, "Mapo Editions", Tiranë, 2010, f. 9.

⁹¹ Bilal Xhaferi, *Vepra letrare 3*, "Arbëria", Tiranë, 2010, f.42.

⁹² Po aty, f.337.

Kuptimet modale të formave me do

Parashtrimi i raporteve kohore të ndërtimeve foljore *do+lidhore* na jep mundësinë për të zbuluar lidhjet e mundshme mes kohës, aspektit e modalitetit si kategori gramatikore. Duke marrë për bazë klasifikimin e Palmer-it për modalitetet, veçohen dy prej tyre “*propositional modality*”⁹³ (epistemik-evidencial) dhe “*event modality*”⁹⁴, pra (deontik-dinamik)⁹⁵, vërejmë se ndërtimet modale të probabilitetit, të cilat shprehin vlerësimin e folësit ndaj statusit të veprimit të shprehur ndaj foljes, karakterizohen nga modalitetit epistemik.⁹⁶P.sh.: *Me sa duket-arsyetonte kryetari- do të ketë rënë ndonjëherë në zjarr* ⁹⁷.

dhe evidencial:

Diçka *do t'i ketë ndodhur* hetuesit tim, që nuk arriti ta përfundojë.

Në gjuhën shqipe nuk ka shënjes gramatikore për të diferencuar modalitetin epistemik nga ai evidencial kur përdoret forma *do+lidhore*. Për një diferencim të tillë shërben prania e sintagmave që shënojnë evidencën përkatëse, si “*nuk arriti ta përfundojë*”, në rastin ose kontekstin gjuhësor. Në ndërtimet e kohës së ardhme modaliteti del më i larmishëm. Modaliteti epistemik paraqet përfundim të një analize logjike ose bindjeje të brendshme dhe është rasti më i rëndomtë i përdorimit të së ardhmes. P.sh.: *Djemtë e mi do të martohen në fshat aty ku një ditë bashkë me fëmijët e tyre do nderojnë varrin tim*.⁹⁸ Ndërkaq, modaliteti evidencial është rezultat i zotërimit prej folësve të të dhënave evidenciale, informacionit, njohjes së rrjedhës faktike të ngjarjeve etj. P.sh.: *Këndonjësit do gjejnë shumë gjëra për të cilat kanë për të qeshur mi kurriz të auktorit*.⁹⁹ Nga ana tjetër, modaliteti deontik del më i larmishëm se llojet e tjera të modalitetit.

Ai shfaqet si:

-detyrim në formën e direktivës:

Askush nuk *do të prekë* mish nga kafshët e Ibrahimit.¹⁰⁰

-detyrim në formën e urdhrit:

Sado mall të kesh, sado, atë gjë s'do ta bësh.¹⁰¹

⁹³ Në shqip mund të përdoret termi *modaliteti i gjendjes*, pasi që “lidhet me qëndrimin e folësit ndaj vlerës së vërtetë ose të gjendjes faktike të veprimit” (Palmer, 2001:70).

⁹⁴ Mund të përdoret termi *modalitet i ngjarjes*, pasi që modaliteti deontik dhe dinamik u referohen ngjarjeve jo aktuale, që nuk kanë ndodhur, por janë potenciale për të ndodhur (Palmer, 2001:70).

⁹⁵ F.R. Palmer, *Mood and modality*, Cambridge Textbooks in Linguistics, “Cambridge University Press”, 2001, f. 8-9.

⁹⁶ Vjen nga greqishtja *episteme*, d.m.th. *dije*, nga greqishtja jonike *epistathai*, d.m.th. “të di si t’ia dalë mbanë, kuptoj”; fjalë për fjalë “qëndroj sipër”, nga *epi-sipër, afër + histathai-qëndroj*.”

⁹⁷ Fatos Kongoli, *Si-do-re-la*, “Toena”, Tiranë, 2011, f.106.

⁹⁸ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, “Mapo Editions”, Tiranë, 2010, f. 46.

⁹⁹ F. S. Noli, *Vepra 2*, Tiranë, 1988, f.342.

¹⁰⁰ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, “Mapo Editions”, Tiranë, 2010, f. 46.

-detyrim në formë të këshillës:

*Do hash diçka të ëmbël, mundësisht hurma me ujë kur perëndon dielli, dhe ky është iftari. Pastaj do falësh namazin e mbrëmjes.*¹⁰²

Modaliteti *dinamik* ndeshet vetëm si modalitet i *vullnetit*. Format e së ardhmes të karakterizuara nga ky lloj modalitet shprehin:

dëshirë:

*Vëllai i Mihalit nuk e mbajti dot zemërimin dhe thirri: Ibrahim o derr, me dorën time do të ther.*¹⁰³

ofertë:

*Mihali do të rrijë në shtëpinë time.*¹⁰⁴ Ju ndoshta do të donit një kakao, iu drejtua Rudianit.¹⁰⁵

premtim:

*Do ta jap, i tha Kabi, por duhet të më japësh një peng.*¹⁰⁶

vendim:

*Sonte do të rri këtu, i tha Aliu.*¹⁰⁷

Diakronia si mbështetje e sinkronisë

Për ne merr një rëndësi të veçantë njohja e origjinës së formës me *do* të ardhmes, pasi “rrethanat që kanë formuar këtë gjendje na ndriçojnë natyrën e vërtetë të saj”.¹⁰⁸ Formimi i të ardhmes në gjuhën shqipe është bërë brenda gjedhes ballkanike, e ndryshme nga ajo e gjuhëve neolatine perëndimore. Është krejt e natyrshme që kuptimet e ndryshme modale që shprehin format foljore të shikohen në lidhje me tipologjinë përkatëse, së cilës ato i përkasin. Shqyrtimi dhe krahasimi i gjendjes sinkronike me atë diakronike të fazës së dokumentuar të shqipes, që përkon me bashkekzistencën e formave të vjetra të së ardhmes *kam të punoj, kam me punue* dhe lindjen e formave të reja të tipit *do të shkruaj, kam për të shkruar*, na jep mundësinë të japim një përgjigje të kënaqshme në lidhje me pyetjet e shtruara më parë.

“Përgjithësimi i të ardhmes me do në gjuhën shqipe është bërë përmes konkurrimit të trajtës *kam të shkruaj* prej dy trajtave të tjera të së ardhmes: *do të shkruaj* dhe *kam për të shkruar*”.¹⁰⁹ Konkurrimi është bërë jo vetëm në një kuptim të caktuar gramatikor, por në të gjitha kuptimet

¹⁰¹ Po aty, f. 203.

¹⁰² Po aty.

¹⁰³ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, “Mapo Editions”, Tiranë, 2010, f. 42.

¹⁰⁴ Po aty.

¹⁰⁵ Ismail Kadare, *E penguara*, “Onufri”, Tiranë, 2009, f.69.

¹⁰⁶ Ben Blushi, *Të jetosh në ishull*, “Mapo Editions”, Tiranë, 2010, f.337.

¹⁰⁷ Po aty, f. 51.

¹⁰⁸ Ferdinand de Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, “Dituria”, Tiranë, 2002, f.112.

¹⁰⁹ Seit Mansaku, *Tipologjia e së ardhmes së tipit kam të shkoj në kontekstin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, në: “Albanohellenika”, nr.4, Athinë, 2011, f.17.

semantike-gramatikore që bartin këto ndërtime. Pikërisht te zëvendësimi i konstrukteve *kam + lidhore* prej atyre *do+ lidhore* ne shikojmë edhe shumë funksione të elementit *do*, të cilin mund ta përmbledhim në prirjet kryesore:

a. kuptim kohor = e ardhme+modalitet deontik, dinamik

b. do+lidhore = e ardhme+modalitet epistemik, evidencial

c. kuptim modal = probabilitet (epistemik,evidencial)

a) *funkcion semantik-gramatikor*: kuptimi modal (*i domosdoshmërisë, i probabilitetit, i*

mundshmërisë);

b) *funkcion gramatikor*: kuptimi kohor i të ardhmes. Kjo nuk ka rezultuar me një klasifikim në përputhje me prirjen për zhvillimin e tyre, pasi kuptimet kohore dhe ato modale pleksen midis tyre, herë duke dalë ai kohor e herë ai modal në plan të parë. E konsiderojmë të drejtë trajtimin e konstruktit *do + lidhore* si një konstrukt me shumë funksione, kuptimi kohor i të cilit është një ndër funksionet e tij, dhe jo si një konstrukt i të ardhmes së dëftores që realizon edhe funksione të tjera modale. Vlen të theksohet se disa kuptime modale, si ai i domosdoshmërisë apo i detyrimit janë të pandashme nga kuptimi i kohës së ardhme, ndërsa kuptimi modal i probabilitetit është i mëvetësishëm.

Përfundime

Nga shqyrtimi i kuptimeve modale të ndërtimeve foljore me *do* në gjuhën shqipe, vërejmë se kuptimi kohor i të ardhmes shfaqet si kuptim parësor në raport me modalitetin vetëm në rastet kur ato shprehin modalitet *epistemik* dhe *evidencial* - të sigurisë. Në rastet kur shprehin modalitet *deontik* dhe *dinamik*, funksioni parësor i këtyre ndërtimeve nuk është ai kohor, por modal duke dalë në plan të parë, ndërsa kuptimi kohor del dytësor. Në ndërtimet modale të probabilitetit merr rëndësi aspekti si kuptim semantik-gramatikor dhe jo koha.

Nga parashtrimi i mësipërm i raporteve kohore dhe modale të ndërtimeve me *do* në gjuhën shqipe dallojmë se për format e të ardhmes është karakteristik modaliteti *epistemik, evidencial, deontik* dhe *dinamik*. Ndërtimet modale të tipit *do të jem/ do të kem* janë ndërtime modale *epistemiike* dhe *evidenciale*. Por, ndryshe nga modaliteti *epistemik* dhe *evidencial* i të ardhmes, i cili karakterizohet nga siguria e folësit në lidhje me veprimin e shprehur prej foljes, modaliteti i probabilitetit është modalitet *epistemik* i gjasës, i mundësisë për të qenë i vërtetë ky veprim. Kundërvënia modale *siguri// gjasë* nuk justifikon lëvizjen modale nga e ardhmja në të tashmen.

Në të gjitha format e të ardhmes është i pranishëm kuptimi kohor i paskohësisë në lidhje me çastin e ligjëritimit ose me një çast të caktuar të së

shkuarës. Ndërtimet modale karakterizohen nga kuptimi kohor i njëkohësisë, parakohësisë apo akronisë. Në rastet e akronisë funksioni kohor i foljes është zëvendësuar prej atij identifikues. Kjo ndodh kryesisht për foljen *jam*. Kundërvënia nuk është vetëm *paskohësi //njëkohësi//paskohësi*, por edhe kuptim *kohor //akroni*. Jo vetëm folja *jam*, por edhe foljet e tjera përmbushin funksionet kohore tipike për të tashmen e dëftores. Dalja e vetëm këtij grupi foljesh në ndërtimet e probabilitetit nuk mund të shpjegohet përmes zhvendosjes kohore. Në qoftë se zhvendosja kohore e të ardhmes në të tashmen do të përdorej në gjuhën shqipe si mjet modal për të shprehur *probabilitet*, atëherë kjo nuk do të duhej të përbënte një dukuri me karakter përjashtues, dhe rezultati i pritshëm do të ishte që, çdo folje e përdorur në kohën e ardhme të dilte me këtë vlerë modale në ndërtimin përkatës të tipit me *do*. Por ky nuk është rasti në gjuhën shqipe. Është për t'u theksuar se edhe e tashmja e lidhore, kur përdoret me vlerë hamendësuese në pyetje të tipit "*Të jenë këto angleze?*", karakterizohet nga të njëjtat kuptime dhe raporte kohore me ato të ndërtimeve modale të probabilitetit. Kjo pyetje mund të marrë disa përgjigje të mundshme: a) *Po janë / Jo, nuk janë* (kur folësi është i sigurtë për statusin e gjendjes); b) *Mund të jenë /duhet të jenë /do të jenë* (kur folësi nuk është i sigurtë për statusin e gjendjes).

Në rastin (b) kemi tri gjykime *epistemike* të ndryshme të folësit të bazuara në analizën e tij logjike ose në të dhënat e zotëruara prej tij: spekulativ, deduktiv, dhe supozues. Në rastin "*mund të jenë*", kemi një përfundim të mundshëm, spekulativ pasi që folësi nuk zotëron të dhëna evidenciale apo njohje të mjaftueshme mbi objektin e thënies. Në "*duhet të jenë*" kemi konkluzionin e vetëm të mundshëm, deduktiv, bazuar në përpunimin e të dhënave evidenciale ose në arsyetimin logjik mbi rrethanën e dhënë në bazë të përvojës vetjake.

Në rastin '*do të jenë*' kemi një përfundim të arsyeshem, supozim pasi folësi e gjykon veprimin e shprehur prej foljes me shumë gjasa për të qenë i vërtetë. Të tri kuptimet e ndryshme modale lidhen me foljet modale *mund*, *duhet* dhe pjesën modale *do*. Të tria këto elemente të sistemit modal të gjuhës shqipe modifikojnë në mënyra të ndryshme kuptimin e foljes së lidhore *të jenë*. Struktura e tyre është *element modal + lidhore*. Ajo që mbetet për të sqaruar përse *do*-ja si element modal nuk arrin të dalë si e tillë edhe në bashkëvajtje me lidhoren e foljeve që shënojnë veprimin e tipit *do të mësojë*. Kjo mendojmë se lidhet me kushtëzimin e natyrës semantike-gramatikore që vepron në gjuhën shqipe, pra përmes përcjellores siguron aspektin imperfekt të foljes. Prandaj, në bazë të parashtrimin të mësipërm mund të shprehemi se është më se e dobishme të kërkojmë shprehjen e modalitetit të probabilitetit te konstrukti *do (modale)+lidhore (hamendësuese) imperfekte*.

Abstrakt:

Trajtimi i modalitetit të probabilitetit si një ndër kuptimet gramatikore të kohës së ardhme në gramatikat e gjuhës shqipe, bazuar në shpjegimin e përdorimit të së ardhmes me vlerën e së tashmes, është bërë objekt shqyrtimi për faktin se ky proces zhvendosjeje në gjuhën shqipe nuk është dëshmuar përmes të dhënash të sakta gjuhësore, prandaj ka mbetur në kornizat e hipotezës. Objekt kryesor i trajtimit në këtë studim është përqsja e kuptimeve kohore dhe modale në aspektin sinkronik si dhe mos-ndërtimi modal i probabilitetit ku elementi *do* ruan pavarësi semantike ndryshe nga *do*-ja e gramatikalizuar plotësisht, e të ardhmes. Parë nga ky këndvështrim, kuptimi kohor në një pjesë të rasteve të përdorimit nuk është ai i së tashmes, por akronia, prandaj janë ekzistojnë disa arsye për trajtime nga këndvështrime të reja të formave të probabilitetit si ndërtime të pavarura modale dhe të klasifikueshme jashtë formave me *do* në gjuhën shqipe.

Fjalët çelësa: Modalitet, kuptim gramatikor, kohë e ardhme, format foljore *do të jem /do të kem*.

Abstract:

In recent years, the modality of probability has attracted the attention of linguists. According to traditional Albanian grammar books, the modality of probability is interpreted as a grammatical meaning of the future tense. However, this hypothesis has never been tested with precise empirical data. The main aim of this article is to provide a contrastive overview of tense and modal meanings and the (non-)construction of the modality of probability, where the element *do* retains its semantic meaning, in contrast to the fully grammaticalised *do* of the future tense. From this perspective, the meaning of the future tense is, at least in some cases, not the meaning of the present tense, but is tense-independent. Thus, there are reasons to rethink the different forms of probability as independent forms of modality, which can be classified independently of the *do*-variants in Albanian.

Key words: Modality, grammatical meaning, future tense, verb forms I will be / I will have.

LITERATURË

- AGALLIU, Fatmir, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, në: "Studime filologjike", nr. 2, Tiranë, 1968.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002.
- BLUSHI, Ben, *Të jetosh në ishull*, "Mapo Editions", Tiranë, 2010.
- Demiraj, Shaban, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, në: "Studime Filologjike", nr. 3, Tiranë, 1977.
- HALLIDAY, M.A.K. & Matthiessen, Ch., *An Introduction to functional grammar*, Third edition, Hodder Arnold, London, 2004.
- KADARE, Ismail, *E penguara*, "Onufri", Tiranë, 2009.
- KONGOLI, Fatos, *Si-do-re-la*, "Toena", Tiranë, 2011.
- LLOSHI, Xhevat, *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, në: "Studime Filologjike", nr.4, Tiranë, 1966.
- MANSAKU, Seit, *Tipologjia e së ardhmes së tipit kam të shkoj në kontekstin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, në: "Albanohellenika", nr.4, Athinë, 2011.
- NOLI, Fan S., *Vepra 2*, Tiranë, 1988.
- PALMER, F.R., *Mood and modality*, Cambridge Textbooks in Linguistics, "Cambridge University Press", 2001.
- SAUSSURE, Ferdinand de, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, "Dituria", Tiranë, 2002.
- UÇI, Alfred, *Estetika e Groteskut*, Libri IV, "Nobël", Tiranë, 2001.
- XHAFERI, Bilal, *Vepra letrare 3*, "Arbëria", Tiranë, 2010.

Rilind MAHMUDI¹, Majlinda ISMAILI-MAHMUDI²

¹Mother Teresa University – Skopje, North Macedonia
Fakulteti i Shkencave Humane
(rilind.mahmudi@unt.edu.mk)

²Mother Teresa University – Skopje, North Macedonia
(majlinda.ismaili@unt.edu.mk)

THE ROLE OF LEXICON AND TRANSLATION IN SENTENCE STRUCTURE

ROLI I LEKSIKUT DHE I PËRKTHIMIT NË STRUKTURËN E FJALISË

Introduction

Languages are highly complex and dynamic systems that include different elements working together to create meaning. Among these elements, lexicon and translation play important role on sentence structure and meaning, and how they are conveyed through words and their arrangement. The lexicon of a language, which consists of its vocabulary, forms the foundation of communication by providing words and their meanings used to construct sentences. However, these words are not static because they may have different nuances, connotations and grammatical properties that can influence the way how sentences are structured in a specific language. On the other hand, translation acts as a very important process that connects linguistic elements and systems, transferring meaning from one language to another, while attempting to preserve the original sentence structure as much as possible depending on the text. The task of translation is often challenging, especially when dealing with idioms or literary texts, as the translator must keep in mind structural differences and the cultural context in order to maintain the meaning of the original text.

The relationship between the lexicon and translation is important for the construction of sentences in both the source and target languages. The

lexicon provides the necessary elements (words, phrases and their meanings) that form sentences. These are not only isolated elements, but they are interconnected with syntax to form grammatically correct and meaningful sentences. The choice of words and their specific syntactic roles can influence the ways in which sentences can be structured.

When translating from one language to another, the translator must keep in mind the structural and sometimes even conceptual differences between languages. This requires more than just word-for-word translation, and often requires adjustments in the sentence structure. Hence, word order is also important when translating sentences from English to Albanian and vice versa. Therefore, a translator must consider whether to preserve the original word order, or to restructure the sentence to conform to the rules of the target language, while ensuring that the meaning remains the same.

The lexicon and translation are connected with cultural and cognitive aspects of language use as well. Words and phrases in one language may have no direct equivalent in the other language, forcing translators to find words that are appropriate and relevant on the cultural and contextual aspect. This is particularly evident when translating idioms, metaphors or literary texts, which may require significant adaptation to maintain their intended meaning in the target language. This paper focuses on how the lexicon contributes to the syntactic arrangement of words in sentences and how translation influences sentence structure. The task of a translator is finding a balance, which is a very challenging process during translation.

Lexicon – Words carrying meaning

The lexicon is not only a collection of words, but a dynamic system that interacts with syntax in order to form sentences. As Bloomfield claims, the lexicon of a language is an appendix of grammar and the speaker who knows constituents and grammatical pattern can utter them without ever having heard of them (Bloomfield 1933:275). This means that lexical choices influence syntactic patterns, or more specifically word order. For instance, '*Ja dhash.*' in Albanian is translated to '*I gave it to him/her.*'. This simple example is only a small portion highlighting sentence structure differences that may result from translation.

Lexical categories, such as nouns, verbs, adjectives and adverbs are the pillars in sentence construction. According to Chomsky, deep structure is used to determine semantic interpretation, and surface structure determines its phonetic interpretation (Chomsky, 1965:16). Hence, lexical items are inserted into deep structure positions determined by the syntactic component. This means that lexical items are placed into specific positions in the deep structure based on the rules and requirements of grammar. This helps in aligning sentence structure with grammatical rules for further transformations and realization of the surface structure.

Grammar rules are essential in forming grammatically correct sentence structures. For example, languages like English and Macedonian place adjectives before nouns, while in Albanian the situation is different, like in the following example: *good boy/добар дејко/djalë i mirë*. This is a simple example, but when a translator is given a more complex example, then the situation is different and may change the sentence structure/word pattern significantly. For example, the word *serendipity* has no direct translation in Albanian, but it must be explained descriptively – *gjetje ose ndjenjë e rastësishme e diçkaje të vlefshme*. When combined with another word, in this case with an adjective, *bittersweet serendipity*, this phrase combines two concepts, both of which lack direct translation. One option of translating this phrase would be – *ndjenjë e rastësishme që përmban si kënaqësi ashtu edhe hidhërim*. In order to achieve the transfer of meaning, the phrase in English is transformed to a clause in Albanian, resulting with a totally different structure. Thus, the lexicon not only provides the building blocks, but also constrains and guides the syntactic possibilities when constructing sentences.

Translation – Transfer of meaning

Translation is a complex process that involves the transfer of meaning from a source language to a target language, while maintaining the sentence structure as close as possible to the original structure. However, structural differences between languages often result with adjustments in sentence construction. Translation is not merely a transposition of words. According to Vinay and Darbelnet, certain stylistic effects cannot be transposed into the target language without upsetting the syntactic order, or even the lexis because of structural or metalinguistic differences (Vinlay & Darbelnet 1995:31). Certain stylistic effects in a source language may be impossible to replicate in the target language without changing the sentence structure or word choice. This can happen due to differences in linguistic structure or cultural differences that may lead to changes in word order or lexis in order to preserve the transfer of meaning. For example: *'Never before had she felt that happy.'* is translated to *'Ajo asnjëherë nuk ishte ndjerë aq e lumtur.'* Visible syntactic differences are visible in these two examples, starting from the position of the adverb, up to the subject-verb order.

One of the challenges in translation is dealing with variations in word order. While English has fixed word order S-V-O (Quirk et al. 1985:720), the situation is different in Albanian. For example: *'He bought a bike.'* → *'Ai bleu biçikletë'* → *'Biçikletë bleu ai.'* → *'Biçikletë ai bleu.'* can be translated using different word orders (with a change of the position of the words, but without a change of their syntactic functions), still preserving the meaning.

Translators must decide whether to prioritize syntactic clarity or style in the target language. In the translation of literary texts, the choice of

lexical items can dramatically affect the tone and meaning of sentences. Differences in translation can be accounted for by three factors in translating: the nature of the message, the purpose of the author and the type of audience (Nida 1964:156). Such differences arise because the content of the message may require adaptation to align with linguistic or cultural norms. Furthermore, the purpose of the author influences how closely translation reflects the original, and the characteristics of the audience shape style and complexity of the language that is used. An example to illustrate the importance of knowing the language and cultural nuances of a language may be *'He kicked the bucket.'* A translator may initially choose word-for-word translation that is grammatically and semantically correct (*Ai e goditi kovën.*), but when used in a text, such translation would be considered as incorrect and the translator should check if this is an idiom that would transfer the correct meaning. This specific sentence, *'He kicked the bucket.'* means that *'He died.'*, and the correct translation would be *'Ai vdiq.'* Translators should find a lexical equivalent that conveys the same idea, even if the sentence structure is different.

Knowing the methodology of translation is crucial for translators. Translators must know the seven main methods of translation related to direct and oblique translation: borrowing, calque, literal translation, transposition, modulation, equivalence, adaptation (Vinlay & Darbelnet 1995:41). When a language borrows words or phrases from another, it often adopts not only the lexicon, but also the syntactic patterns associated with it. Haugen claims that the borrowing process starts from isolated, one-time usage of a copied form in normal bilingual speech, to complete acceptance and integration into the target language (Haugen 1950:212). Such cross-linguistic influences can change native sentence structures, as it can be sometimes seen in different texts in media or newspapers, especially titles. For example, in the title *'World's first flying car unveiled.'* the verb is written in the end without a subject of the sentence. Translating this sentence results with different sentence structure in Albanian: *'Zbulohet makina e parë fluturuese në botë.'* where the verb is in the initial position in the sentence.

The main difficulties in translation are lexical, not grammatical, i.e. words, collocations and fixed phrases or idioms; these include neologisms and 'unfindable' words (Newmark 1988:32). In technical translations, the precision of lexical choices is fundamental because specialized vocabulary determines the clarity and accuracy of the text. Finding the appropriate word when translating technical texts poses a great challenge, even for experienced translators. Find appropriate substitutes is challenging not only for technical texts, but other texts as well. Take for example the following sentence in Albanian: *'Buldozeri amerikan e vizitoi vendin tonë.'* This sentence is translated using a word-for-word translation in order to preserve the same stylistic effect: *'The American bulldozer visited our*

country.’, where it is clear that the word ‘*bulldozer*’ does not refer to a vehicle, but to a very influential and important person in politics.

Cultural nuances must be taken into account when translating similar sentences in order to transfer meaning, and to ensure that translation aligns with the target audience by reflecting their cultural norms. This process often requires adapting idiomatic expressions, metaphors, or specific terms that may not have direct equivalents in the target language. A literal translation, in some cases, might fail to capture the intended tone or context, resulting with misinterpretation or ambiguity. For example, ‘*Break a leg.*’ in English means ‘*Good luck.*’. A translator without good background knowledge of English culture might miss the correct meaning and translate it to a semantically ambiguous sentence ‘*Thyej këmbën.*’ instead of ‘*Paç fat.*’.

Translators must be aware of different changes resulting from translation. According to Chesterman, there are three types of changes: changes in the phrase structure, changes in the clause structure and changes in the sentence structure (Chesterman 1997:94). This division means that the translation of a text might undergo syntactic changes at three levels. Furthermore, the translation of literal works is also done through paraphrasing, resulting with visible sentence structure changes. As seen above with idioms, the structure of an idiomatic expression can change both at phrase and clause level. Nevertheless, Nuhiu claims that linguistic interferences exist mostly in spoken language where, in addition to code switching, there is also a complete transfer of the structure of one language to the other (Nuhiu 2013:289), directly affecting word order in sentences, resulting with ambiguous sentences.

The role of lexicon and translation in sentence structure

The lexicon is crucial not only for understanding a single language, but becomes more significant when comparing two languages in translation. A rich vocabulary allows easier translation, and to some extent better adaptation of sentence structures. The sentences below, translated from English to Albanian, reflect linguistic differences discussed so far.

(1)

a) *The feedback was not enough.*/Rezultati/Reagimi/Reaksioni/Prapaveprimi nuk ishte i mjaftueshëm.

b) *Multitasking is important.*/Ekzekutimi i më shumë detyrave është i rëndësishëm.

c) *Vjehrra ime është atje.*/My *mother-in-law* is there.

Based on the above examples, and undoubtedly many others, it is evident that the lexicon is very important in translating from one language to another. These sentences show examples where a single word, such as noun or gerund, is translated into the form of a noun or a noun phrase. On the other hand, sentence 1(b) results in a clause in Albanian because there is no single word substituting the gerund ‘*multitasking*’. Subject and verb

concord is the same in both languages because adaptation is done by grammatical means.

(2)

a) *Measles is contagious./Fruthi është ngjitës.*

b) *Maths is important./Matematika është e rëndësishme.*

Similarly, there are sentences where the subject is singular in one language but plural in another, requiring the verb to adjust to the subject's number based on translation and adaptation.

(3)

The proceedings were published two weeks ago./Përmbledhja e punimeve ishte publikuar para dy javësh./Punimet janë publikuar para dy javësh.

In the last example in sentence (3), we cannot say 'Punimet janë publikuar dje.' because 'proceedings' does not refer to papers, but to a 'collection of papers' – journal. This is an example where the lack of terminology in certain situations can also affect the structure of the sentence, even the number of the verb. Other examples highlight the lack of appropriate words that can affect the subject, or even the object or another syntactic element. If syntactic analysis is carried out using tree diagram, we will have different structure in English and Albanian language for such sentences.

(4)

Africa is inhabited by 1.3 billion people./Afrika banohet nga 1.3 miliard njerëz.

In spoken language, structures can be completely transferred to the target language, and such sentences, although somehow meaningful, would lack natural fluency due to structural changes. In such situations, a sentence in Albanian should be written in active voice in order to be grammatically and semantically correct: '1.3 miliard njerëz banojnë në Afrikë.', or rephrased as 'Afrika ka 1.3 miliard njerëz.'. This sentence acquires correct word order in order to be correct both in the syntactic and semantic aspect.

Dy nga shembujt më të njohur të diplomacisë ndërkulturore janë përpjekjet e Suedisë dhe Kanadasë. Këto vende janë bërë modele të bashkëjetesës multikulturore dhe përdorin diplomacinë ndërkulturore në politikat e tyre të jashtme dhe të brendshme. Suedia vlen si një nga vendet më të hapura ndaj migracionit dhe diversitetit kulturor. Ky vend ka aplikuar diplomacinë ndërkulturore në konflikte të vendeve si Afganistani dhe Siria. Përmes programeve të përfshirjes kulturore, Suedia ka ndihmuar në krijimin e një klime të dialogut ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Suedia¹²⁷ ka promovuar diplomacinë ndërkulturore në konfliktet në Siri dhe Afganistan përmes ndihmave humanitare dhe mbështetjes së dialogut paqësor. Në Siri, ka mbështetur konferenca ndërkombëtare dhe përfshirjen e grupeve etnike e fetare në proceset paqësore. Në Afganistan, përmes agjencisë SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), ka financuar projekte që fuqizojnë të drejtat e grave dhe të rinjve, duke nxitur dialogun dhe stabilitetin në komunitete. Këto përpjekje pasqyrojnë rolin e Suedisë si promotor i paqes dhe mirëkuptimit ndërkulturore. Kanadaja me politikën e saj të njohur të multikulturalizmit ka luajtur një rol kyç në diplomacinë ndërkulturore globale. Një shembull i rëndësishëm është angazhimi i saj në proceset e paqes në Ruandë dhe Haiti, ku diplomatët kanadezë kanë ndihmuar në adresimin e tensioneve kulturore që kanë kontribuar në konflikte. Kanadaja luajti një rol jetik në Ruandë gjatë gjenocidit të vitit 1994, ku gjenerali kanadez Roméo Dallaire udhëhoqi misionin e OKB-së pavarësisht kufizimeve të mëdha në burime dhe mandat. Në Haiti, Kanadaja kontribuoi në përpjekjet për stabilizim përmes trajnimit të policisë, mbështetjes së

¹²⁵<https://www.penguinrandomhouse.com/books/73813/beyond-culture-by-edward-t-hall/>

¹²⁶ https://openlibrary.org/books/OL2198453M/Beyond_culture

¹²⁷ <https://www.government.se/contentassets/ab4737ebc5f84fbd9e74a376b0375035/swedens-regional-strategy-for-the-syria-crisis-20242026.pdf>

qeverisjes dhe ndihmës humanitare si pjesë e misionit të OKB-së në vitet 2000¹²⁸.

3. Përfitimet nga diplomacia ndërkulturore

Ashtu siç nënvizua më lartë, diplomacia ndërkulturore paraqet një instrument thelbësor për ndërtimin e urave mes vendeve, organizatave ndërkombëtare dhe komuniteteve të ndryshme kulturore. Duke promovuar dialogun dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, ajo mundëson zgjidhjen e konflikteve dhe krijimin e një platforme për bashkëpunim global.¹²⁹ Bashkëpunimi ndërmjet shteteve kërkon mirëkuptim të ndërsjellë mbi kulturat, traditat dhe perceptimet e ndryshme. Diplomacia ndërkulturore ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme duke inkurajuar respektin dhe tolerancën për diversitetin kulturor. Për shembull, programet ndërkombëtare si UNESCO dhe iniciativa si Erasmus+ promovojnë shkëmbime kulturore që ndihmojnë studentët dhe profesionistët të njohin më mirë botën përreth tyre dhe të zhvillojnë aftësi ndërkulturore. UNESCO dhe iniciativat si Erasmus+ ofrojnë përfitime të rëndësishme, duke rritur ndërgjegjësimin kulturor dhe aftësitë ndërkulturore për studentët dhe profesionistët. Këto programe ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për komunikim dhe bashkëpunim në mjedise shumëkulturore, përmirësojnë mundësitë profesionale dhe forcojnë marrëdhëniet ndërkombëtare. Duke nxitur respekt dhe mirëkuptim për diversitetin, ato kontribuojnë në paqen globale dhe krijimin e rrjeteve të qëndrueshme të bashkëpunimit.¹³⁰

Një tjetër shembull është diplomacia e përtëritshme e kombeve të bashkuara, e cila ka përdorur kulturën për të ndihmuar në bashkimin e kombeve të përfshira në konflikte. Përmes këtyre mekanizmave, shtetet dhe organizatat mund të adresojnë sfida të përbashkëta si ndryshimet klimatike dhe pandemitë, duke zhvilluar zgjidhje të bazuara në mirëkuptim kulturor.

3.1 Konsolidimi i paqes dhe stabilitetit global

Një nga avantazhet kryesore të diplomacisë ndërkulturore është ndikimi i saj në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Kur liderët dhe diplomatët kuptojnë dhe respektojnë pikëpamjet e njëri-tjetrit, ata janë më të aftë të negociojnë zgjidhje që janë të pranueshme për të gjitha palët. Për shembull, në Lindjen e Mesme, përpjekjet diplomatike që përfshijnë ndër-mjetësues të njohur për ndjeshmërinë e tyre ndërkulturore kanë ndihmuar në zbutjen e tensioneve midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

Një rast konkret është marrëveshja e paqes midis Izraelit dhe Egjiptit në vitin 1979, ku ndërmjetësimi ndërkulturor i Shteteve të Bashkuara luajti

¹²⁸ <https://canadahistory.ca/sections/war/Peace%20Keepers/peacekeeping.html>

¹²⁹ <https://www.unesco.org/>

¹³⁰ <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000230899>

një rol kyç. Duke njohur vlerat dhe perceptimet kulturore të secilës palë, ndërmjetësuesit ishin në gjendje të adresonin mosmarrëveshjet dhe të siguronin një zgjidhje paqësore.

Në nivel bilateral, diplomatët përballen me sfida për të kuptuar dhe respektuar kulturat lokale të vendeve pritëse. Kjo njohuri është thelbësore për të shmangur keqkuptimet dhe për të siguruar qëndrime që respektojnë ndjeshmëritë lokale. Por, në shumë raste, për shkak të dallimeve kulturore dhe perceptimeve të ndryshme mbi normat dhe vlerat, arritja e një dialogu të suksesshëm është shpesh e vështirë.

Në diplomacinë multilaterale, kompleksiteti rritet ndjeshëm për shkak të pjesëmarrjes së shumë kulturave me interpretime të ndryshme për konceptet kryesore, si të drejtat e njeriut. Kuptimi dhe interpretimi i koncepteve shpesh mbeten subjekt i perceptimeve kulturore, duke krijuar sfida në arritjen e konsensusit. Një shembull është qasja ndaj barazisë gjinore, që interpretohet ndryshe nga kultura të ndryshme.

Historikisht, diplomacia dhe ligji ndërkombëtar kanë qenë të dominuara nga kultura perëndimore. Kjo trashëgimi vazhdon të ndikojë marrëdhëniet ndërkombëtare, megjithëse disa rajone si vendet e botës islame ruajnë identitetin e tyre kulturor në çështje të caktuara. Diversiteti kulturor dhe ndikimet koloniale shpesh përcaktojnë pozicionet e vendeve në organizatat ndërkombëtare.

Në epokën e globalizimit, vlerat perëndimore si demokracia, transparenca dhe të drejtat e individit janë promovuar si universale. Megjithatë, shumë rajone mbeten skeptike ndaj idesë së një unifikimi kulturor, duke theksuar rëndësinë e respektimit të diversitetit si një element thelbësor për harmoninë globale. Rezistenca ndaj uniformitetit kulturor tregon nevojën për qasje të kujdesshme dhe përfshirëse në negociatat ndërkombëtare.

Për diplomatët dhe politikanët, njohja dhe respektimi i diversitetit kulturor janë kritike për të kuptuar shkaqet e konflikteve dhe për të nxitur zgjidhje kompromisi. Kjo qasje ndihmon në shmangien e imponimit të pikëpamjeve të njëanshme dhe promovon dialogun ndërkulturor, duke forcuar paqen dhe stabilitetin në nivel global.

3.2 Promovimi i diversitetit kulturor si një vlerë globale

Në një botë gjithnjë e më globale, diversiteti kulturor është bërë një burim i rëndësishëm i inovacionit dhe kreativitetit¹³¹. Diplomacia ndërkulturore nxit këtë diversitet duke inkurajuar dialogun dhe shkëmbimin kulturor. Për shembull, festivalet ndërkombëtare dhe ekspozitat kulturore ndihmojnë në prezantimin e trashëgimisë kulturore të vendeve të ndryshme për audienca globale, duke krijuar një ndjenjë respekti dhe admirimi të ndërsjellë¹³².

¹³¹ https://brill.com/view/journals/hjd/14/1-2/article-p117_9.xml

¹³² <https://worldjurisprudence.com/cultural-diplomacy/>

Një shembull tjetër është nisma e forumeve botërore të kulturës të cilë cila synojnë të sjellin bashkë artistë, mendimtarë dhe liderë nga kultura të ndryshme për të zgjidhur sfida të përbashkëta dhe për të krijuar një të ardhme më të qëndrueshme. Këto përpjekje ndihmojnë në përforsimin e idesë se diversiteti kulturor është një pasuri që duhet mbrojtur dhe promovuar¹³³.

4. Konkluzioni dhe rekomandimet

Diplomacia ndërkulturore ka një rol të rëndësishëm në krijimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të qëndrueshme dhe të harmonishme. Ajo ndihmon në përmirësimin e komunikimit dhe në uljen e tensioneve që mund të lindin nga keqkuptimet kulturore. Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, diplomacia ndërkulturore është thelbësore për zhvillimin e marrëdhënieve paqësore, sidomos kur përballen shtetet me tradita dhe praktika të ndryshme. Shkëmbimet kulturore ndihmojnë në ngritjen e besimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke mundësuar adresimin e problemeve globale si ndryshimet klimatike, krizat humanitare dhe konflikte të ndryshme rajonale. Përdorimi i diplomacisë ndërkulturore ofron mundësi për një bashkëpunim më të gjerë dhe më të thellë mes kombeve, duke promovuar stabilitetin dhe paqen globale.

4.1 Rekomandime

Për të forcuar ndikimin pozitiv të diplomacisë ndërkulturore, është e nevojshme që diplomatët dhe liderët politikë të zhvillojnë aftësi të avancuara ndërkulturore. Një hap i parë është trajnimi i vazhdueshëm për njohjen dhe respektimin e kulturave të tjera. Trajnimet duhet të përfshijnë aspekte si komunikimi ndërkulturor, praktikat dhe normat e ndryshme kulturore, dhe mënyrat e efektshme për të menaxhuar konflikte që mund të lindin nga ndryshet. Gjithashtu, diplomatët duhet të përfshihen në shkëmbime kulturore dhe misione ndërkombëtare për të pasur mundësi të përjetojnë drejtpërdrejt sfidat dhe mundësitë që sjell diplomacia ndërkulturore. Angazhimi i ekspertëve lokalë për të siguruar që diplomacia është e përshtatshme për kulturën dhe realitetin lokal gjithashtu është kyç për një diplomaci më të suksesshme dhe më të respektuar.

Për të maksimizuar efektivitetin e diplomacisë ndërkulturore, është e domosdoshme që qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare të përfshijnë ndërkulturalizmin në politikat e tyre diplomatike dhe ndërkombëtare. Shtetet duhet të krijojnë strategji të qarta dhe të qëndrueshme për promovimin e diversitetit kulturor dhe integrimin e këtij diversiteti në politikat e jashtme. Kjo mund të arrihet përmes mbështetjes për projekte ndërkulturore dhe investimeve në misione diplomatike që promovojnë

¹³³<https://www.forbes.com/councils/forbescoachescouncil/2022/07/14/understanding-the-value-in-different-cultures-when-exploring-global-expansion/>

dialogun dhe shkëmbimet kulturore. Po ashtu, diplomacia ndërkulturore duhet të jetë një pjesë e politikave të jashtme, duke u mundësuar vendeve që të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të respektojnë kulturat e ndryshme, pa imponuar norma dhe vlera të një kulture të vetme. Për më tepër, është e rëndësishme që të inkurajohen studimet dhe kërkimet që eksplorojnë ndikimin dhe mundësitë që ofron ndërkulturalizmi në diplomaci.

4.2 Përfundim

Diplomacia ndërkulturore është një mjet i fuqishëm për të përmirësuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për të siguruar një botë më të harmonishme. Duke investuar në zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe duke përfshirë ndërkulturalizmin në politikat diplomatike, shtetet mund të adresojnë më mirë sfidat globale dhe të promovojnë paqen afatgjatë. Kjo qasje ka të ngjarë të lejojë një bashkëpunim më të thellë dhe më efektiv, duke siguruar që diplomacia të jetë një mjet i fuqishëm në përballimin e tensioneve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërkombëtar.

Abstrakt

Diplomacia ndërkulturore është imponuar së fundi si një mjet thelbësor për të adresuar kompleksitetet e një bote gjithnjë e më të ndërvarur. Duke ndërthurur ndërgjegjësimin kulturor me strategjitë diplomatike, ajo forcon dialogun, redukton keqkuptimet dhe promovon bashkëpunimin ndërmjet kombeve. Ky punim eksploron konceptin e diplomacisë ndërkulturore, duke theksuar rolin e saj në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve përmes një kuptimi më të thellë të normave, vlerave dhe stileve të komunikimit kulturor. Diskutimi përfshin rëndësinë e inteligjencës kulturore në diplomaci, duke paraqitur shembuj konkretë ku mungesa e ndërgjegjësimit ndërkulturor ka çuar në dështime diplomatike dhe ku zbatimi i saj ka zgjidhur mosmarrëveshje. Gjithashtu, trajtohen sfidat me të cilat përballet diplomacia ndërkulturore, si barrierat gjuhësore, stereotipet dhe paragjykimet kulturore, duke ofruar strategji për t'i kapërcyer këto pengesa. Përmes studimeve të rasteve nga rajone si Lindja e Mesme dhe vende si Kanadaja dhe Suedia, punimi tregon se si diplomacia ndërkulturore mund të kontribuojë në paqen e qëndrueshme dhe stabilitetin global. Së fundi, theksohet nevoja për integrimin e parimeve ndërkulturore në programet e trajnimit diplomatik për të pajisur liderët me aftësitë e nevojshme për angazhime efektive ndërkulturore. Ky punim nënvizon potencialin transformues të diplomacisë ndërkulturore në ndërtimin e një komuniteti ndërkombëtar bashkëpunues dhe bën thirrje për përfshirjen e saj më të gjerë në politikëbërjen globale dhe përpjekjet për zgjidhjen e konflikteve.

Abstract

Intercultural diplomacy has emerged as a critical tool in addressing the complexities of an increasingly interconnected world. By intertwining cultural awareness with diplomatic strategies, it enhances dialogue, reduces misunderstandings, and fosters cooperation among nations. This paper explores the concept of intercultural diplomacy, highlighting its role in preventing and resolving conflicts through a deeper understanding of cultural norms, values, and communication styles. It examines the importance of cultural intelligence in diplomacy, presenting real-world examples where the lack of intercultural awareness has led to diplomatic failures and where its application has resolved disputes. The discussion also delves into the challenges faced in intercultural diplomacy, including language barriers, stereotypes, and cultural prejudices, and offers strategies to overcome these hurdles. Through case studies from regions such as the Middle East and countries like Canada and Sweden, the paper demonstrates how intercultural diplomacy can contribute to sustainable peace and global stability. Finally, it emphasizes the necessity of integrating intercultural principles into diplomatic training programs to equip leaders with the skills required for effective cross-cultural engagement. This paper underscores the transformative potential of intercultural diplomacy in bridging divides and building a collaborative international community, advocating for its broader adoption in global policy-making and conflict-resolution efforts.

Literatura:

- ANG, I. (2001). *On Not Speaking Chinese: Living between Asia and the West*. Routledge.
- BRILL. (n.d.). Understanding cultural differences in global jurisprudence. *Hague Journal of Diplomacy*, 14(1-2), 117-131. Retrieved from https://brill.com/view/journals/hjd/14/1-2/article-p117_9.xml;
- Canada History. (n.d.). Peacekeepers. *Canada History*. Retrieved from <https://canadahistory.ca/sections/war/Peace%20Keepers/peacekeeping.html>
- Diplomacy.edu. (n.d.). Intercultural competence and its relevance for international diplomacy. *Diplomacy.edu*. Retrieved from <https://dspace-api.diplomacy.edu/server/api/core/bitstreams/7f391041-6af7-48b7-a1c7-13c08595e7e3/content>
- FORBES Coaches Council. (2022, July 14). Understanding the value in different cultures when exploring global expansion. *Forbes*. Retrieved from <https://www.forbes.com/councils/forbescoachescouncil/2022/07/14/understanding-the-value-in-different-cultures-when-exploring-global-expansion>

- GANNON, M. J., & Pillai, R. (2013). *Understanding Global Cultures: Metaphorical Journeys Through 28 Nations, Clusters of Nations, and Continents*. Sage Publications.
- HALL, E. T. (1976). *Beyond culture*. Anchor Press/Doubleday. Retrieved from [https://openlibrary.org/books/OL2198453M/Beyond culture](https://openlibrary.org/books/OL2198453M/Beyond_culture)
- HALL, E. T. (1976). *Beyond Culture*. Garden City, NY: Anchor Books.
- HALL, E. T. (1976). *Beyond culture*. Penguin Random House. Retrieved from <https://www.penguinrandomhouse.com/books/73813/beyond-culture-by-edward-t-hall/>
- MELISSEN, J. (2005). *The New Public Diplomacy: Soft Power in International Relations*. Palgrave Macmillan.
- NYE, J. S. (2004). *Soft Power: The Means to Success in World Politics*. PublicAffairs.
- POLITICO. (2009, April 22). Did Obama's iPod gift make the cut? *Politico*. Retrieved from <https://www.politico.com/story/2009/04/did-obamas-ipod-gift-make-the-cut-020788>
- POLITICSPHERE. (n.d.). *Politicsphere*. Retrieved from <https://www.politicsphere.com/>
- SIMON Fraser University. (n.d.). *SFU*. Retrieved from <https://www.sfu.ca/>
- Swedish Government. (2024). Sweden's regional strategy for the Syria crisis 2024–2026. *Swedish Ministry for Foreign Affairs*. Retrieved from <https://www.government.se/contentassets/ab4737ebc5f84fbd9e74a376b0375035/swedens-regional-strategy-for-the-syria-crisis-20242026.pdf>
- United Nations Framework Convention on Climate Change (UNFCCC). (n.d.). *UNFCCC*. Retrieved from <https://unfccc.int/>
- World Jurisprudence. (n.d.). Cultural diplomacy. Retrieved from <https://worldjurisprudence.com/cultural-diplomacy>
- UNESCO. (n.d.). *UNESCO*. Retrieved from <https://en.unesco.org/>
- Protocol Today. (n.d.). The importance of cultural understanding in diplomacy. *Protocol Today*. Retrieved from <https://protocoltoday.nl/the-importance-of-cultural-understanding-in-diplomacy/>
- UNESCO. (n.d.). *UNESCO*. Retrieved from <https://www.unesco.org/>
- UNESCO. (n.d.). UNESCO document on intercultural dialogue. *UNESCO*. Retrieved from <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000230899>

Avni AVDIU
Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup
Fakulteti i Shkencave Sociale
E-mail: avni.avdiu@unt.edu.mk

GLOBALIZMI MEDIATIK

MEDIA GLOBALIZATION

1. Hyrje:

Shumë studiues pajtohen se globalizmi nuk është ndonjë gjë e re. Disa thonë se zuri fill që prej momentit kur njerëzit filluan të kalojnë kufijtë e shoqërisë së tyre në kërkim të hapësirave të reja, ndërsa të tjerët thonë se ka nisur para njëqind vitesh e më tepër ose më saktë në fund të shekullit të XVIII, në kohën kur Evropa ishte përfshirë nga një valë ndryshimesh shoqërore. Si proces historik globalizimi filloi në epokën e hershme moderne të shekullit XV.

2. Nocioni

Termi “globalizim” për herë të parë u shfaq më 1961 në fjalorin e gjuhës angleze të Dirk Mesnerit. Në enciklopedinë *online* në “Stanford Encyclopedia of Philosophy”, globalizimi përkufizohet: “pak më tepër sesa një sinonim për një a më shumë nga fenomenet në vijim: përkrahje e politikave klasike liberale (ose të: *tregut të lirë*) të ekonomisë botërore (*liberalizimi ekonomik*), dominimi në rritje i formave të jetës politike, ekonomike dhe kulturore perëndimore (ose edhe amerikane), përhapje e shpejtë e teknologjive të reja të informacionit (*revolucionit i internetit*), si dhe nocioni se njerëzimi është duke qëndruar në pragun e realizimit të një bashkësie të vetme të njësuar, në të cilën forcat e mëdha që kanë shkaktuar konflikte shoqërore janë duke u zhdukur (*integrimi global*)”. Ndërkaq, sipas sociologut Anthony Giddens, globalizimi paraqet “intensifikimin e

marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese sikurse edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg, dhe anasjelltas" (Giddens, A., 1990:64). Sipas tij "globalizimi ka ardhur si rrjedhojë historike e kolonializmit dhe industrializimit të Perëndimit dhe ndikimit të këtij të fundit në vendet e Botës së Tretë dhe se globalizimi duhet të trajtohet më shumë si dukuri sociologjike, për shkak të ndikimit që ka në jetën dhe në ndryshimet shoqërore".

Sipas Robertsonit globalizimi është "dendësimi i botës dhe shtimi i vetëdijes si tërësi (...) ndërvarësia e vërtetë globale dhe vetëdijësimi për tërësinë globale në shekullin e njëzetë" (Robertson, R., 1992:8). Uaters e përkufizoi si proces shoqëror "në të cilin humbin kufizimet gjeografike të ngjarjeve socio-kulturore dhe në të cilat njerëzit vetëdijësohen gjithnjë e më shumë për të" (Waters, M., 1995:3).

Monbiot konsideroi se globalizmi nuk do të thotë thujasë asgjë: ky term është bërë aq i papërcaktuar saqë më pothuajse nuk domethënë asgjë, atij i përshkruhet gjithçka dhe shumçka, nga terrorizmi global deri te muzika botërore (Monbiot, G., 2006:24).

3. Ndryshimet

Të gjithë jemi dëshmitarë të transformimit të jashtëzakonshëm që ka pësuar bota në të gjitha fushat. Shoqëritë anekënd botës janë bërë më të lidhura se kurrë më parë. Ky ndryshim marramendës, veçmas viteve të fundit është bërë më së shumti në saje të zhvillimit tekniko-teknologjik, qarkullimit të lirë të mallrave në një ekonomi të tregut neoliberal, prodhimit enorm të kompanive shumëkombëshe, shpejtësisë së transportit dhe mënyrave të reja të komunikimit medial. Duke e pasur parasysh faktin se globalizimi po depërton në çdo pore të jetës dhe i prek të gjithë banorët e tokës, pikërisht për këtë edhe i janë kushtuar një numër i madh librash, artikujsh, emisionesh e komentesh të ndryshme. Këtë proces "dialektik nëpërmjet të cilit ndryshuan stilet e jetesës në nivel planetar studiuesit e quajtën globalizim, me anë të të cilit nënkuptuan formësimin e botës si një tërësi globale" (Crespi, 2006:158).

4. Politika

Teoricienët pikërisht në globalizmin politik i shohin edhe rrënjët e problemeve për dobësimin e shteteve kombëtare, ndotjes dhe shkatërrimit të mjedisit, migrimeve, konflikteve ndërretnike e ndër-racore, tensioneve për shkak të të drejtave njerëzore e qytetare (Abercrombie et al. 2008:114-115). Funkzioni i shtetit tashmë nuk është hartimi i politikave, por vetëm të zbatojë vendimet e elitave përmes institucioneve të tyre.

Stiglic ka vënë theksin te shtimi i ndikimit dhe rëndësisë së institucioneve dhe organizatave politike (Kombeve të Bashkuara, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Organizatës Botërore të Tregtisë) si manifestim i globalizimit ekonomiko-politik. Organizatat e cekura tregtare e financiare ndërkombëtare me përkufizimin e tyre të ngushtë të aspekteve ekonomike të globalizimit shkaktojnë polemika, shkruajnë rregulla, urdhërojnë ose shtyjnë vendime përmes liberalizimit të kapitalit të tregut” (Stiglitz, J., 2004:30). Në mënyrë të njëjtë Bashkimi Evropian e kufizon gjithashtu sovranitetin e shteteve në sferën ekonomike, shoqërore e politike (Abercrombie et al. 2008:114). Në globalizëm *lojën botërore* e luajnë shtetet e fuqishme nën petkun e një *qeverisjeje globale*, e të cilat eksportojnë e imponojnë gjithçka, madje edhe “të drejtat e njeriut” sipas recetës së tyre. Kështu që shikuar nga ky kënd, globalizmi “nuk është asgjë përveçse rikolonizim në frymën e re” (Neeraj, J., 2001:6-7).

5. Ekonomia

Në sferën e globalizimit ekonomik sundon “feja e re, ajo e tregut”. Tregu mbi baza neoliberalë paraqet burimin e pafund të konsumit. Nga ky këndvështrim marrëdhëniet shoqërore reduktohen në prodhim, shkëmbim tregtar dhe konsum mallrash. Paratë, mallrat dhe shërbimet qarkullojnë gjithnjë e më të lira. Kjo mendohet të sjellë më shumë mirëqenie, thonë ata që e besojnë liberalizimin. Njëkohësisht është rritur edhe presioni i konkurrencës.

Gjithnjë e më i ndjeshëm është hendeku i madh në mes të varfërve të pasurve. Gjithnjë e më shumë njerëz jetojnë në varfëri. Shumicës prej tyre u mungon uji i pijshëm, kujdesi mjekësor dhe arsimit. Të shumtë janë bërë miliarderët, ndërsa i madh është bërë edhe numri i milionerëve, të cilët fitojnë fuqi e ndikim të konsiderueshëm në bazë të parave, kapitalin e të cilëve s’mund ta kontrollojë askush dhe të cilët për vete krijojnë struktura të përgjithshme varësie (më parë vetëm Rokfeler, Rotshild..., e sot Bill Gejts, Elion Musk, Mark Cukenberg etj).

Të gjitha avantazhet që i pretendon globalizmi sipas Xhozef Stiglicit mbështeten në “ideologjizimin e supremacisë së tregut”. Kjo nënkupton primatin e interesave dhe vlerave tregtare si dhe udhëheqjen me globalizmin nga qendrat e pasurisë dhe fuqisë”(Stiglic, J., 2002:32-33).

6. Kultura

Globalizimi ndodh në të gjitha nivelet, kurse të gjitha elementet e tij në thelb përcaktohen nga kultura. Kultura shoqërore krijon ambientin ku individët dhe grupet shoqërore i formësojnë identitetet e tyre.

Globalizimi kulturor presupozon realizimin e njëmendtë të një shoqërie multietnike e multikulturore të bazuar në pranimin, legjitimimin dhe

legalizimin e modeleve të ndryshme kulturore, prej të cilëve asnjëri nuk do të jetë dominant dhe në të cilin të gjithë do të orientohen kah bashkëjetesa ose bashkëpunimi i ndërsjelltë (interkulturalizmi).

Po ashtu globalizimi kuptohet si një ndërveprim kulturor në shkallë globale, që forcon vetëdijen për jetën e përbashkët njerëzore. Sipas Roland Robertsonit fjala është për një proces të përgjithshëm botëror që synon të afirmojë vlerat universale si përmbajtje të përbashkët të bashkësisë më të gjërë botërore (Robertson, R., 1992:18).

E shpërndarë gjerësisht anembanë në hapësira globale, kultura është e shpërndarë nga çfarëdo e kaluar. Ajo është këtu, tani dhe kudo, ndërsa e kaluara i shërben sa për të ofruar ndonjë shembull të dekontekstualizuar ose ndonjë element për enigmën e saj kozmopolite. Kjo ndjenjë e pakohësisë fuqishëm është e shprehur në diskursin e saj të natyrës së dominimit teknik. Pra kultura eklektike globale, universale, e pakohshme - kultura globale është kultura e “konstruktuar” (Smith, D., 1990:171-191).

As vetë konsumi nuk është i drejtpërdrejtë: artikujt global të industrisë kulturore gjithnjë hyjnë te njerëzit në kulturat lokale. Konsumi gjithmonë është një takim në mes materialitetit të të mirave kulturore dhe formimit kulturor të konsumatorit. Edhe pse sot realitetin lokal nuk mund ta mendojmë jashtë sferës së ndikimit global, të mendohet globalizmi vetëm si një proces i eksportit është njëjtë sikur të anashkalohen shumë gjëra që në të vërtetë ndodhin (Storey, J., 2003:112-113).

7. Pikëpamjet

Qëndrimet e shfaqura ndaj globalizmit janë diametralisht të kundërta dhe sillen nga ato që e mbrojnë me çdo kusht si diçka që sjell veç të mira, e gjer tek ato globofile që hapur e kritikojnë dhe e akuzojnë atë si ferr i vërtetë që po i përgatitet botës.

Për funksionalistët globalizmi paraqet një proces të zhvillimit modern të ndërlikueshmërisë së ndërsjellë e gjithnjë e më të madhe ekonomike, politike e kulturore të botës bashkëkohore që është mundur nga teknologjia më e re informatike.

Për të tjerët globalizmi është “një mit i ri ideologjik” pas të cilit fshihen interesat, qëllimet dhe synimet e mëhershme imperialiste, kurse mjetet të cilat shfrytëzohen janë gjithashtu të njëjta: forca ushtarake, bllokatat ekonomike, presionet politike, propaganda agresive dhe manipulime të ndryshme të individëve, grupeve dhe popujve e shteteve të vogla e të varfra.

Për hiperglobalistët globalizimi paraqet një epokë të re në të cilën njerëzit kudo janë subjekte të disiplinuar nga tregu global. Sipas tyre disa vende nuk mund t’i kontrollojnë flukset ekonomike brenda kufijve kombëtarë për shkak të rritjes së madhe të tregtisë ndërkombëtare. Nëse dikur ideali politik ishte krijimi i shteteve kombëtare të vetëmjaftueshme, sot në shekullin e 21 ky ideal është shteti transnacional, që sipas hiperglobalistëve

është mbërthyer në rrjetin e dendur të institucioneve rajonale e ndërkombëtare. Pavarësisht qëndrimeve kundërthënëse ideologjike besimi i përbashkët i hiperglobalistëve është se: globalizimi është kryesisht dukuri ekonomike, ekonomia në botë gjithnjë e më shumë është e integruar dhe nevoja për kapitalin global imponon disiplinën adekuate ekonomike që prek shumicën e qeverive në botë deri në atë masë sa që politika gjithnjë e më pak është “art i së mundshmes” dhe gjithnjë e më shumë praktikim i “menaxhimit të ekonomisë së vlefshme”. Hiperglobalistët sipas interpretimit të Heldit e pranojnë se globalizimi sjell gjer te polarizimi gjithnjë e më i madh në shoqëri në mes humbësve dhe fituesve të rendit të ri ekonomik. Globalizimi sipas hiperglobalistëve shënon fundin e shtetit kombëtar, ajo thua se gati e ka zbrazur tërësisht edhe sovranitetin dhe autonominë e tij. Shembja dhe gërryerja e fuqisë dhe rëndësisë së shteteve kombëtare dhe strukturave të vjetra ndodh nën kujdesin dhe drejtimin e kapitalizmit dhe teknologjive të reja.

Në të kundërtën e hiperglobalistëve, skeptikët konsiderojnë se ideja e globalizimit është ekzagjeruar, ngaqë tregtia botërore nuk është integruar mjaftueshëm (pjesa më e madhe e tregtisë botërore zhvillohet në tri rajone: Evropë, Amerikën e Veriut dhe me Azi me Paqësorin). Prandaj skeptikët konsiderojnë se qeveritë kombëtare edhe më tej vazhdojnë t’i përfaqësojnë aktorët kryesorë në rregullimin dhe koordinimin e veprimtarive ekonomike. Qeveritë jo vetëm që nuk janë viktima pasive të ndërkombëtarizimit, por ato vetë janë kreatorët kryesorë të tij. Fenomeni i globalizimit është një mit, sepse nuk ekziston një treg i përkryer ekonomik globalisht i integruar (Held, D.; McGrew, A. 2000:2).

Sipas botëkuptimit të transformacionistëve globalizimi i përshtatet më për së afërmi rrjedhave të zhvillimit bashkëkohor të shoqërisë. Ata te globalizmi shohin karakterin e dyanshëm (rrjedhën e imazheve, informatave dhe ndikimit). Sipas tyre, edhe pse rendi i ri botëror po transformohet, modelet e vjetra të sjelljes dhe veprimeve mbeten. Kështu qeveritë ende e ruajnë pjesën më të madhe të fuqisë së tyre, pavarësisht nga ndërvarësia gjithnjë e më e madhe. Transformimet sipas tyre, nuk kufizohen vetëm në ekonomi, por janë të pranishme edhe në politikë, kulturë dhe në jetët personale. Për transformacionistët globalizimi është i ndërlidhur me format e reja të shtresëzimit global në të cilat disa shtete, shoqëri ose bashkësi bëhen gjithnjë e më të rrjetëzuara dhe të lidhura në një rend global, përderisa shtetet, shoqëritë ose bashkësitë e tjera bëhen gjithnjë e më të margjinalizuara. Transformacionistët nuk duhet të flasim më për skemën klasike piramidale të strukturës sociale dhe elitat e pakëta në krye dhe për shtresat gjithnjë e më të gjera e të shumta duke shkuar kah shkallët e poshtme, por rreth një skeme treshtresore të ngjashme me rrathët koncentrikë. Transformacionistët besojnë se ekonominë kombëtare transformohen me proceset ekonomike globale në atë masë sa që hapësira ekonomike kombëtare thjesht nuk përputhet më me kufijtë kombëtar e shtetëror. Globalizmi bashkëkohor sipas transformacionistëve rikonstituon

ose ridizajnon fuqinë, funksionet dhe autoritetin e qeverive kombëtare. Globalizimi është real, e në të njëjtën kohë edhe i ndërlikuar e kundërtshëm që fut në lëvizje dhe dinamizon ndryshimet shoqërore, politike dhe ekonomike, duke i transformuar shoqëritë moderne dhe tërë rendin botëror.

8. Media

Lirshëm mund të pohohet globalizmit i dhanë hov pikërisht zbulimet e reja veçmas ato të komunikimit dhe teknologjisë mediale. Rol vendimtar luajtën kompanitë e mëdha të cilat gradualisht u shtrinë në internet me platformat e tyre.

Se sa konsiderohet sot interneti i rëndësishëm për jetën e përditshme dëshmon edhe fakti se Kombet e Bashkuara e kanë shpallur të pasurit qasje në internet si një nga të drejtat (elementare) të njeriut.

Që nga momenti kur hapim sytë në mëngjes e gjatë tërë ditës derisa të biem në shtrat për të fjetur, pak më shumë se gjysma e popullsisë së botës është e pranishme në forma të ndryshme në internet (është online).

Përmes televizionit satelitor e gjithë bota në të njëjtën kohë mund të përcjell një spektakël muzikor, bie fjala sikurse është evrovizioni ose koncerti i vitit të ri në Vjenë. Po ashtu edhe ngjarjet e mëdha me përmasa botërore. Të njëjtat mbështeten edhe nga interneti.

Në vitin 1990 të lidhur në rrjetin e internetit ishin rreth 100.000 vetë, kurse gjashtë vjet më vonë më 1996 numri u rrit në 12.8 milionë sosh (Held, D., 1999:345). Në vitin 2000 numri i përdoruesve të internetit u shtua në 360 milionë vetë, kurse më 2013 në 2.5 miliardë njerëz (Internet World Stats, 2013).

Sipas të dhënave të Internet World Stats në qershor të vitit 2019, 57.3% e popullsisë së botës kishte qasje në internet.

Interneti është parë si një “hapësirë në të cilën bashkohen individët në bashkësi dhe bisedojnë për marrëdhëniet e tyre” (Agre, P. E. (1998:78), “hapësirë në të cilën të gjithë të pranishmit mund të flasin lirshëm” (Poster, M., 2006:42), ku jetojnë “qytetarët dixhitalë” - netizenët (Poster, M 2006:84).

McLuhan ishte i pari që më 1960 e përdori termin “*fshati global*”, duke paralajmëruar se bota po vazhdon të tkurret për shkak të teknologjive të reja të komunikimit. “Është bota jonë e re e parave...koha ka ndaluar. Hapësira është zhdukur. Ne tani jetojmë në fshatin global...në ngjarjet e njëkohshme..Ne e gjejmë veten sërish në hapësirën akustike. Ne rishtazi kemi filluar të ndërtojmë ndjenja primitive, emocione fisnore nga të cilat na ndajnë disa shekuj të shkrim-leximit” (McLuchan, M.1967:63).

Castells në veprën “*Galaktika e internetit*” dhe “*Trilogjia e epokës informative*” theksoi se ekonomia, shoqëria dhe kultura argumentojnë se roli i teknologjisë informative në kohën moderne është plotësisht i njëjtë

me rolin që pati energjia elektrike për revolucionin industrial, respektivisht se interneti është “indi i jetës sonë”(Castells, M. 2003:11).

Perandoritë ekonomike mediale njihen sipas emrit të korporatave: *Disney, Sony, News Corporation, Renterva, Ge, Media/At&T, AOLTime, Warner, Viacom, Vivendi, Bertlsmann...*, po dominojnë mediat globale.

Në gjysmë e parë të vitit 2000 bizneset në mediet globale, në internet dhe telekomunikim arritën fitimin në 300 miliard dollarë, që është trefish në raport me gjysmë e parë të vitit 1999.

“Interneti pjesërisht e ka frymëzuar besimin se me përparimin teknologjik vjen edhe epoka e re e komunikimeve demokratike” (Herman, E.S. et., al 2004:289).

Megjithëkëtë, edukimi i dobët mediatik ka sjellur një masë shfrytëzuesish amorf, të patakt, gjysmëanalfabet, që s’dinë t’i lidhin dy-tri fjalë e që megjithatë duan të shprehen, njerëz pa minimum shkollimi që s’mund ta shkruajnë një fjali pa bërë dhjetëra gabime drejtshkrimore, etj.

9. Përmbyllje

Për ta kuptuar sa më mirë se sa mediet janë bërë zgjatime të trupit tonë po e përmbyllim me një përmbledhje të gazetës “Shqip” në faqen e parë të shtojcës “Ndryshe” me titull: *“Edukata joqytetare dixhitale, dhjetë situata tipike”*. “Epoka në të cilën po jetojmë mund të quhet me plot gojën si epoka e paqytetëruar dixhitale. Këtë e dëshmojnë shumë situata që tashmë na prekin çdo ditë. Ja se cilat janë ato...Nuk mund të jetojnë pa tabletin e tyre, nuk rezistojnë dot pa i hedhur një sy rrjeteve sociale edhe gjatë mbledhjeve të punës, ndërsa merren me telefonin edhe gjatë vakteve të ngrënies ose momenteve të intimitetit. Janë protagonistë të “paqytetarisë mobile”, të epokës në të cilën personat abuzojnë me teknologjinë në çdo formë dhe situatë të saj, edhe në ato më pak të përshtatshme. Ja dhjetë situata tipike. **Gjatë mbledhjeve:** A ju ka ndodhur që gjatë mbledhjeve kolegu ose kolegja juaj të marrë në dorë celularin dhe të fillojë të luajë me aplikacionin më të fundit që është në modë? Ky është maksimumi i shprehjes së epokës së paqytetarisë mobile. **Gjatë momenteve intime:** Imagjinoni sa e bezdisshme është të vini re se si hutohet partneri juaj, duke e përqendruar vëmendjen e tij te smartfoni, pikërisht në momentet më të pakta të intimitetit?! **Në tavolinë:** Nëse së bashku me ju gjatë një vakti ngrënieje, gjendet edhe një person i cili fotografon çdo pjatë, për ta shpërndarë në rrjetet sociale, dijeni se keni të bëni me një protagonist të paqytetarisë mobile. **Duke i dhënë makinës:** Përveçse është shumë irrituese për shoqëruesit e udhëtimit, përdorimi i pajisjeve mobile, ndërsa i jepni makinës, mund të jetë një rrezik vërtet i madh për jetën tuaj: më mirë shmangeni në mënyrë absolute! Në kinema: Kujt nuk i ka ndodhur që të shkojë në kinema dhe të ulet pranë një personi të paedukatë i cili/e cila telefonon gjatë projekcionit dhe e lë volumin e ziles shumë të lartë?! Në këtë kohë është e vështirë që askush të mos jetë bërë pjesë e një situatë të

tillë. **Në biçikletë:** Janë qindra ata të cilët lëvizin nëpër trotuare me biçikletë, duke iu përgjigjur telefonit, mesazheve dhe e-mail-eve, duke rrezikuar jo vetëm jetën e tyre, por edhe të këmbësorëve. **Në kohën e lirë:** Epoka e mungesës së civilizimit mobil, manifestohet sidomos në kohën e lirë: gjatë darkave me partnerin, ndërsa mbrëmjet me miqtë minohen nga prezenca gjithnjë e më e bezdisshme dhe e pavolitshme e pajisjeve të lëvizshme, siç janë llojet e ndryshëm të celularëve dhe tabletave. **Në avion:** Avioni është një vend plot me të meta për këdo që dëshiron të udhëtojë në qetësi të plotë gjatë epokës së paqytetarisë mobile: tableta, kompjuterë, lap-topë, MP3, të gjithë me volum të lartë, janë makthi i udhëtarëve. **Në vendet publike:** Në vendet publike e veçanërisht nëpër linjat urbane të autobusëve, fenomeni i ndenjes në celular është tepër i njohur. Çdokush dëshiron të injorojë botën përreth dhe të rrijë larg saj. **Gjatë sportit:** Marrja me sport është një gjë shumë e shëndetshme, i bën mirë si mendjes ashtu edhe trupit; por të bësh gjoking duke shikuar vazhdimisht celularin, paraqet një rrezik serioz për atë që e bën këtë veprim, por edhe për këdo që kalon aty pranë (Shqip/Ndryshe, 2015:1).

Abstrakt

Kur flitet për globalizmin që në fillim duhet ta kemi parasysh atë si dukuri dhe globalizimin si proces. Mirëpo shtjellimi i dukurisë dhe procesit është sikurse narrativa e shumëpërfolur e “pulës dhe vesë”, se cila është e para: a shfaqet një herë dukuria e pastaj rrjedh si proces, a lind si proces e pastaj shndërrohet në dukuri. Kjo qasje vjen në shprehje më tepër për shkak të karakterit historik, sepse bëhet fjalë për një koncept të ri që ka histori të largët. Sido që të jetë, tashmë dihet se globalizmi është dukuri, kurse globalizimi është proces dhe edhe si dukuri, por edhe si proces i ka pllakosur shumë fusha, në veçanti ato: politike, ekonomike, shkencore (tekniko-teknologjike) dhe shoqërore (kulturore). Varësisht nga vështrimet e ndryshme autoriale, këto shtrirje quhen dimensione ose karakteristika. E rëndësishme është se bëhet fjalë për ngjarje e gjëra që jo vetëm se i prekin këto fusha, por kanë edhe shtrirje e zgjerim anembanë globit. Pra thelbi është për t’u “kaluar kufijtë lokalë e rajonal me qëllim që diçka të marrë përmasa botërore (globale)”. Ndërkaq e para gjë që të bie ndërmend kur përmendet ky tipar është media, cilado qoftë ajo. Askush më shumë, më shpejtë dhe më gjerë nuk e ka këtë aftësi sesa media. Në këtë studim të shkurtër do të shtjellojmë globalizmin mediatik, duke e lidhur me aktualitetin dhe qasjet e ndryshme autoriale.

Fjalë kyç: globalizmi, media, politika, ekonomia, shoqëria

Abstract

When discussing about globalization, it is essential to consider it both as a phenomenon and as a process from the beginning. However, the elaboration of the phenomenon and the process resembles the well-debated "chicken and egg" narrative: Which comes first? Does the phenomenon appear first and then flows as a process, or does it emerge as a process and then transforms into a phenomenon? This approach is primarily due to its historical nature, as globalization is a new concept with distant roots. Nevertheless, it is now understood that globalization is a phenomenon, while globalizing is a process. Both as a phenomenon and as a process, it has profoundly impacted many fields, particularly political, economic, scientific (technical-technological), and social (cultural) fields. Depending on various authorial perspectives, these influences are referred to as dimensions or characteristics. The important thing is that these are events and developments that not only affect these fields but also extend and expand globally. Essentially, it is about "crossing local and regional boundaries to achieve global dimensions." The first thing that comes to mind when this feature is mentioned is media, in whatever form it exists. No other entity has this ability to a greater extent, faster, and more widely than media. This short study will explore media globalization, connecting it to current realities and diverse authorial approaches.

Keywords: Globalization, media, politics, economy, society

Literatura/Referenca

- ABERCROMBIE, N.; HILL, S. dhe TURNER, B.S., *Rječnik sociologije*, Jesenski i Turk, Zagreb, 2008
- AGRE, P. E. *Designing Genres for New Media: Social, Economic, and Political Contexts*. In S. G Jones (ed.), *Cybersociety 2.0 Revisiting Computer-Mediated Communication and Community* (pp. 69–99): Sage, London, 1998
- CASTELLS, M., *Kraj tisućljeća*, Golden marketing; Zagreb, 2003
- CRESPI, F. *Sociologija kulture*, Politička kultura, Zagreb, 2006
- Gazeta "Shqip", e enjte, 15 shkurt 2015
- GIDDENS, A., *The Consequences of Modernity*, Polity Press, Cambridge 1990
- HELD dhe MCGREW, *The Global Transformations Reader: An Introduction to the Globalization Debate*, Polity Press, Cambridge, 2000
- HELD, D. i A. MCGREW, D. Goldblatt, J. Perraton, *Global Transformations. Politics, Economics and Culture*. Polity.Held et al., Cambridge, 1999
- HERMAN, E.S. & R.V. Mekčesni, „Globalni mediji“, Clio, Zagreb, 2004
- MCLUCHAN., M., *The medium is the message*, Bantam Books, An Inventory of effects, New York, 1967
- MONBIOT, G. , *Doba dogovora*, Algoritam, Zagreb, 2006

- NEERAJ, J., *Globalisation or Recolonisation*, Pune, Elgar, 2001
- POSTER, M., *Information Please: Culture and Politics in the Age of Digital Machines*,: Duke University Press Poster, London, 2006
- ROBERTSON, R., *Globalization*, Sage, London 1992
- ROBERTSON, R., *Globalization: Social Theory and Global Culture*, SAGE, London, 1992
- Smith, D. Anthony., "Towards a Global Culture?". *Theory, Culture & Society* 7/2-3:171-191. Smith 1990
- STIGLIC, Dž. E, *Protivrečnosti globalizacije*, SBM-x, Beograd, 2002
- STIGLITZ, J., *Globalizacija i dvojbe koje izaziva*,: Algoritam, Zagreb, 2004
- STOREY, John., *Inventing Popular Culture*,: Blackwell. London, 2003
- WATERS, M., *Globalization*, Routledge, London 1995

Drenusha KAMBERI

Ligjëruese në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup,

Fakulteti i Shkencave Sociale

E-mail: drenusha.kamberi@unt.edu.mk

TELOSI I KULTURËS KAPITALISTE

THE TELOS OF CAPITALIST CULTURE

Hyrje

Kultura është një dimension i gjithëpranishëm i diskursit njerëzor që përdor ndryshimin për të shprehur ose për të gjeneruar koncepte të ndryshme të identitetit grupor (Apaduraj, A., 2011:28-29). Kultura globale është një kulturë në të cilën dallimet respektohen, por nuk vihen në plan të parë.

Shpejtësia e ndryshimeve shoqërore e kulturore lidhet ngushtë me kapitalizmin dhe industrializmin si forcë e tij kryesore. Duke e pasur parasysh faktin se modernizimi ndodh në kontekstin historik të globalizmit, është e rëndësishme të kihen parasysh lidhjet në mes aspekteve kulturore të kapitalizmit dhe modernitetit. “Kapitalizmi është një sistem ekonomiko-kulturor ekonomikisht i organizuar rreth institucioneve të pronësisë dhe prodhimit të mallrave, kurse kulturalisht i bazuar në faktin e shkëmbimit të marrëdhënieve të blerjes dhe shitjes, që përshkon pjesën më të madhe të shoqërisë” (Bell, D., 1979:14).

Në literaturë mund të hasim në termet: *kapitalizmi kognitiv*, *shoqëria postindustriale*, *shoqëria neoliberales*, *shoqëria e informacionit*, *shoqëria me ekonomi digjitale*, *shoqëri sipërmarrëse*, *shoqëri postkapitaliste*, *shoqëria postfordiste*, *shoqëri e rrezikut*, madje edhe *shoqëri e mërzitshme* e kështu me radhë.

1. Tradicionalja

Shoqëria tradicionale kishte një model identiteti të parapërgatitur e të pandryshueshëm. Zygmund Bauman kujton se në të kaluarën e largët

koha rridhte shumë ngadalë, ndërsa njerëzit në varfërinë e tyre shpresonin në reinkarnim dhe ringjallje. “Në kohën tonë, në botën fluide të modernitetit erdhi gjer te kthesat e mëdha në kuptim të avancimit të kushteve të jetesës, por mund të vërehen edhe disa ngjashmëri në lidhje me reinkarnimin: identiteti nëpërmjet ringjalljes së dikurshme lidhet me mundësinë e lindjes së sërishme, *duke u ndal së qenuri ai që je dhe shndërrimi në atë që ende nuk je*. E tërë kjo falë rimodelimit, rinovimit, riciklimit dhe riparimit të vazhdueshëm kompulsiv e obsesiv të identitetit” (Bauman, Z., 2009:17). Vlen të ceket se sintagma e Baumanit *moderniteti fluid* merret si alternativë konceptuale e *postmodernizmit*.

Kultura tradicionale e lidhur me kontekstin kombëtar ka pësuar transformim rrënjësor dhe ka humbur namin që kishte më parë. Individu ndryshon si subjekt modern në ambientin e ri të industrializimit, urbanizimit dhe ndryshimeve kulturore, duke u bërë gjithnjë e më i vetëdijshëm me “*të tjerët e rëndësishëm*” dhe lidhet edhe më shumë me klasën të cilës i përket si grup shoqëror. Në shoqërinë moderne multikulturore vjen gjer te shumimi dhe rindërtimi i identiteteve.

2. E kaluara

Shpesh njerëzit ndiejnë nostalgji për të kaluarën, edhe sikur ta kenë jetuar me vështirësi. Mirëpo malli sigurisht se nuk ndjell për vështirësitë, por për kohën e kaluar.

Duke u kthyer pas në kohë, kuptojmë se sa me fat jemi që jetojmë në këtë kohë...Sot i kemi të gjitha ato që dikur u mungonin paraardhësve tanë. **Mungonin mjetet e transportit** Në ditët e sotme mund të themi se asnjë vend në planet nuk është i paarritshëm. Sigurisht, marrja e një avioni nuk është e vështirë dhe nëse nuk ju pëlqen avioni, mund të merrni gjithnjë trenin, anijen, makinën, helikopterin etj. Por, në të kaluarën, vajtja në qytetin më të afërt, kushtonte disa orë të mira më këmbë. Nëse ishe me fat, mund të shkoje me karrocë ose me kalë. **Nuk kishte status social** Me fjalë të thjeshta, nëse lindje i varfër, do të mbesje gjithmonë i tillë. Sot jemi me shumë fat. Arsimi fillor, të paktën në shumicën e vendeve të botës, është i arritshëm për të gjithë dhe ne posedojmë mjete për të studiuar. Gjithkush ka mundësinë për t’u bërë çfarë të dojë. Në të kaluarën, dallimet sociale ishin shumë të theksuara. **Nuk kishte privatësi edhe kur shkohej në banjë** Le të shkojmë pak më pas në kohë, në periudhën e romakëve të vjetër. Banjat ishin publike në kuptimin e vërtetë të fjalës. Njerëzit shkonin në vendet e përcaktuara për jashtëqitje të gjithë së bashku. Çdokush bënte nevojat e tij me qetësinë më të madhe pa e vrarë mendjen për turmën. Ndërkohë, për pastrim të gjithë përdornin një sfungjer të përbashkët. E tmerrshme apo jo?! **Arsimimi ishte i kufizuar** Arsimi është një nga arritjet më të bukura që ka njerëzimi sot. Në të kaluarën, mundësia për të studiuar ishte dhurata më e madhe që mund t’i bëhej një fëmije për të ardhmen e tij. Kjo gjë ishte shumë e vështirë, ndërsa sot, jo edhe aq. **Injoranca dhe**

paragjykimet mbretëronin si sovranë Për të shpjeguar këtë çështje nuk mjafton as një libër i tërë. Që nga momenti që arsimimi ishte në një nivel të pamjaftueshëm, injoranca dhe paragjykimet mbretëronin gjithë sovranitet. Shembujt janë të pafund. Çfarë mund të thuhet për gjuetinë e shtrigave apo për të gjitha gratë që u vranë e u dogjën pa asnjë lloj arsyeje, për të gjithë ata që u dënuan me vdekje sepse ishin të pushtuar nga djalli? Kjo ishte mesjeta për fatin e keq të atyre që e jetuan! **Mjetet e komunikimit ishin inekzistente** Në ditët e sotme, nëse duam të kontaktojmë me një mik ose të afërm, sado larg të jetë ai, kemi të gjitha mënyrat për ta bërë: Whatsapp, Viber, Skype, Facebook etj. Por imagjinojeni pak veten në mes të shkretëtirës në Egjiptin antik...ose edhe diku tjetër...**Mjekësia ishte shumë e prapambetur** Një tjetër fat i madh i ditëve tona është edhe mjekësia, e cila në të vërtetë ka bërë hapa gjigantë në krahasim me të kaluarën. Jemi në gjendje që të zbulojmë dhe të parandalojmë sëmundje shumë të rënda si AIDS, ose tumore. Në të shkuarën gjërat ishin krejt ndryshe: njerëzit vdisnin nga ftohja, ndërsa temperatura i terrorizonte njerëzit. Përhapja e sëmundjeve ishte shumë e madhe. Dhe ata që vdisnin për shkaqe banale, ishin të shumtë. **Higjiena ishte thjesht një mirazh** Padyshim, shkak i të gjithë problemeve me sëmundjet lidhet pikërisht me këtë gjë: mungesën totale të higjienës personale. Tani për tani, jemi mësuar që me vete të kemi një dezinfektant për t'ia hedhur duarve në çdo moment ose situatë, shtëpitë tona janë të pastra, banjat janë të ndara nga dhomat dhe nga vendet ku ushqehemi (Shqip/Ndryshe:2015:1).

3. E tashmja

Njeriu në tërësinë dhe plotësinë e tij shpreh dhe rrezaton kulturën e vet, sepse kultura formëson njerëzit, kurse njerëzit kulturën. Kultura është trashëgimi, por edhe krijimtari e vazhdueshme.

Kultura perëndimore me të gjitha karakteristikat e saj është shpallur vlerë universale njerëzore. Studiuesi amerikan Samuel Hanington e konsideroi kulturën si bazë të identitetit me ndihmën e së cilës dallohen armiqtë nga miqtë, duke prognozuar se në të ardhmen është e mundshme “lufta e qytetërimeve”, veçmas nëse dallimet qytetëruese ndeshen me interesat konfliktuoze politike dhe ekonomike. Sipas tij Perëndimi për një kohë të gjatë do të ketë supremaci teknologjike e ushtarake më shumë se çdo vend tjetër joperëndimor. Sipas tij nëse do të vinte gjer te një luftë e madhe botërore, ajo do të zhvillohej në mes qytetërimit perëndimor dhe atij joperëndimor.

“Kultura në masë të madhe e përcakton se si anëtarët e shoqërisë mendojnë dhe ndiejnë, ajo drejton veprimet e tyre dhe përkufizon botëkuptimet e tyre. Anëtarët e shoqërisë zakonisht e kuptojnë kulturën si diçka të vetëkuptueshme në vete. Ajo bëhet pjesë e tyre në atë masë sa shpesh nuk janë as të vetëdijshëm se ekziston” (Haralambos, M., 1989:17). Ajo “...është një dukuri universale njerëzore, e dhënë antropologjike dhe një

karakteristikë qenësore gjenerike e njeriut si qenie krijuese individuale, shoqërore e shpirtërore. Së këtejmi mund të themi se nuk ka asnjë shoqëri në histori pa një shkallë të caktuar të kulturës në kuptimin më të gjerë të fjalës, d.m.th si organizim dhe mënyrë mbijetese, as të individit si pjesëtar (normal) i shoqërisë konkrete, që të mos i ketë përvetësuar veçoritë themelore të kulturës përkatëse gjatë procesit të socializimit” (Skledar, N., 2001:167).

4. Kapitalizmi

Sipas Kellnerit kush dëshiron të flasë për kapitalizmin duhet të flasë rreth globalizmit dhe se s’mund të teoritizojmë për globalizmin pa folur rreth ristrukturimit të kapitalizmit (Kellner, D., 2002:289).

Kapitalizmi e promovon procesin e krijimit të identitetit nëpërmjet konsumit. Mediet të rinjta ushqejnë imagjinatën, joshjen dhe magjepsjen pas jetës së ëndrrave, ashtu sikurse e jetojnë VIP-at. Diskursi postmodern legjitimon ekzistimin e këtyre antinomive, ku secili e fiton të drejtën në perceptimin e tij për realitetin dhe formësimin e identitetit të tij.

Në qendër të analizës së kulturës kapitaliste ndodhet praktika kulturore e konsumit.

Në të vërtetë të gjitha qeniet konsumojnë, por ajo që është thelbësore në idenë e “kulturës së konsumit” ose të të ashtuquajturit “konsumerizëm” është fakti se bëhet fjalë për kulturën preokupimi kryesor i së cilës është konsumi. Zaten konsumi është qëllimi kryesor i kulturës kapitaliste. Në të vërtetë theksi nuk është në faktin e thjeshtë të shkallës së lartë të konsumit në shoqëritë e zhvilluara kapitaliste, por në kuptimin e tij kulturor (Tomlinson 1992:122). Përvoja e të jetuarit në kultura të tilla imponon çështjen e domethënies që njerëzit ia japin praktikave të konsumit, kuptimin që ka ajo për ndjenjat, mendimet, fatin, identitetin njerëzor e kështu me radhë. Natyrisht se këto praktika nuk janë statike, por ndryshojnë nga shoqëria në shoqëri. Natyra e kulturës në thelb është dinamike, prandaj edhe përmbajtja e kulturave ndryshon e transformohet nëpër kohë. Në këtë kontekst asnjë kulturë nuk duhet parë si produkt lokal i një shoqërie, sepse përmban gjurmë të kulturës së mëparshme të po asaj shoqërie, por edhe të kulturave të tjera përreth saj.

Sot flitet për “imperializmin kulturor” si dominim global i kulturës kapitaliste. Nisur nga ky fakt disa mendojnë se ajo që e zëvendëson “*imperializmin*” është pikërisht globalizmi...Mirëpo përderisa imperializmi nënkupton zgjerimin e qëllimshëm të një sistemi shoqëror nga një qendër e pushtetit në mbarë botën, ideja e globalizmit sugjeron ndërvarshmërinë dhe ndërlidhshmërinë e të gjitha rajoneve të botës. Së këtejmi për kulturën globale mund të flitet edhe si për një proces të ngjeshur sipas të cilit bota bëhet aq e bashkuar saqë mund të shihet edhe si një vend i vetëm. Efektet e globalizmit e dobësojnë koherencën kulturore të shteteve kombëtare veç e veç, përfshirë edhe “*fuqitë imperialiste*” (Tomlinson, J., 1992:175). Ky

zhvillim përfshin rritjen e korporatave shumëkombëshe, shtimin e mjeteve të komunikimit masiv, por edhe mundësinë e katastrofave teknologjike që nuk njohin kufij kombëtar (Urry, J., 1989:97).

5. Globalizmi

Kapitalizmi jo vetëm që përkufizon dhe strukturon politikën e ekonomisë globale, por përcakton edhe kulturën globale dhe rrjedhimisht kjo duhet parë si një kulturë kapitaliste globale. Standardizimi dhe përafrimi i qasjeve të ndërsjella në të mirat kulturore është i dukshëm në trajtshmërisht në mbarë botën që nga veshja, tek ushqimi, muzika, televizioni, filmi e kështu me radhë. Kësisoj disa stile, marka, shije dhe praktika kanë vlerë uniforme e globale dhe si të tilla mund të hasen kudo në botë. Praktikrat kulturore janë bërë mallra që shiten e blihen gjithandej. Përvojat kulturore bëhen homogjene, por të mbërthyer në këtë proces mbjellin edhe huti, pasiguri dhe pafuqi. Pasiguria e përgjithshme kulturore e globalizmit është përshkruar në disa qasje të veçanta të shqyrtimit të postmodernitetit. Përndryshe disponimi mbisundues i posmodernitetit është pasiguria, paradoksi, humbja e legjitimitetit moral dhe kultura e tërthortë.

Njerëzit gradualisht e kuptojnë dhe bëhen të vetëdijshëm se jeta e tyre tashmë kontrollohet gjithnjë e më shumë nga forcat që janë jashtë ndikimit të kontrollit të tyre, por edhe jashtë kontrollit të institucioneve të tyre kombëtare. Nuk mund të shprehemi brenda ose jashtë korporatave shumëkombëshe ose të sistemit ndërkombëtar tregtar, përdërisa ato gjithnjë e më shumë ndikojnë në jetët tona sesa qeveritë tona kombëtare që i votojmë (Tomlinson 1992:174-176). E gjithë kjo mund të shihet si një përvojë kulturore e globalizmit e cila shtrihet në të gjitha vendet e botës.

Për dallim nga kulturat kombëtare, kultura globale është një kulturë pa kujtesë. Kulturat kombëtare bazohen në të kaluarën tradicionale të tyre, në kujtimet historike, mitet dhe simbolet e kombit. Ndërkaq, kultura globale synon drejt një identiteti kolektiv, sepse bazohet në kujtime e ndjenja të përbashkëta.

Duke shkruar për tensionin ndërmjet homogjenizimit dhe heterogjenizimit kulturor si një ndër problemet kryesore të ndërveprimit global, Arxhun Apanduraj theksoi se gjithnjë ka ekzistuar frika e shteteve të vogla se do të absorbohen kulturalisht nga shtetet e mëdha. Ai vazhdon konstatimin e tij se lista me vendet që shfaqin këtë frikë nga amerikanizimi mund të zgjerohet edhe më tej.

Integrimi kulturor mbështetet fort në idenë e multikulturalizmit të kuptuar si rrugë e mesme midis segregacionit dhe marrëdhënies asimiluese ndërmjet kulturave të shumicës dhe pakicës. Baza e globalizimit është "integrimi i përshpejtuar i kapitalit, prodhimit dhe tregjeve në nivel botëror, të udhëhequr me logjikën e përfitimit të korporatës" (Belo 2004, p.xii).

6. Postmodernizmi

Për të përshkruar ndryshimet shoqërore postmodernizmi si koncept na jep një ndihmesë të konsiderueshme. Lindi dhe u zhvillua brenda kapitalizmit, me ç'rast erdhi gjer te ndryshimet në organizimin e shoqërive të bazuara në vllugun e prodhimit dhe konsumit. “Për këtë si zëvendësim të këtij nocioni shfrytëzohen edhe sintagmat shoqëri postindustriale, postkapitaliste dhe shoqëri konsumi” (Gidens, E, 1998:14). Është kjo faza e shembjes së epokës moderne, që shoqërohet kryesisht me hedhjen poshtë të racionalizmit iluminist dhe dominimit të arsyes.

Nga aspekti i raportit ndaj identiteteve veçmas i rëndësishëm është kalimi nga moderniteti në të ashtuquajturin postmodernitet, që ndodh shkallshmërisht dhe thuhet në mënyrë të padukshme.

Postmodernizmi karakterizohet nga mosbesimi në narracionet e mëdha ose metanarrativat, vetërefleksiviteti dhe të cituarit intertekstual, përzjerja eklektike e paradigmave dhe stileve, pluralizmi i këndështimeve dhe antireduksionizmi. Ndryshohet qasja ndaj krijimtarive dhe identiteteve. Postmodernizmi në kulturën e popullarizuar shfaqet si reagim ndaj shterimit të projektit modern dhe si pasojë e frymës së kohës në të cilën dominon ndjeshmëria postmoderne.

Në vazhdimësi njeriu bëhet i fragmentuar si subjekt postmodern dhe ngërthen në vete një mori identitetesh të papërfunduara e kundërthënëse. Në kundërshtim me identifikimin me klasën, tashmë ai më shumë identifikohet në bazë të gjinisë, kombësisë, moshës dhe orientimit politik. Identitetet postmoderne bëhen kundërthënëse, sepse identifikimi i individëve ndryshon dhe përzihet (Hall, S. 1995:597–598).. Në botën postmoderne vjen deri te dekonstruimi dhe pluraliteti i interpretimeve. Postmodernizmi diversitetin e vendosi në plan të parë, e fragmentoi realitetin shoqëror e kulturor, e hoqi çdo formë esencialiste dhe për parim kulturor e identitar e shpalli konstruktivizmin. Prandaj edhe nuk ekzistojnë bazat e përhershme fikse, të pandryshueshme e të lindura të identitetit, por se identiteti del si gjithnjë i prodhuar brenda konteksteve të ndryshme historike diskursive e shoqërore.

7. Identiteti

Identitetet ndërtohen në lojën e dallimeve, andaj edhe “tjetri” është tema përcjellëse e diskurseve bashkëkohore mbi identitetet, identiteti është një përshkrim emocional i vetes, por edhe një përshkrim që na bëjnë të tjerët. Mu për këtë asnjë identitet nuk ka rëndësi pozitive ose objektive, por se identiteti vazhdimisht ndërtohet, njihet dhe lexohet në të menduarit e dallimeve. Identiteti si efekt diskursiv është i decentralizuar, i paqëndrueshëm, i ndërprerë dhe gjithnjë i gatshëm për transformim. Çdo identitet ndërthuret me identitetet e tjera dhe jep mundësinë e shprehjeve të përvojave dhe përjetimeve të ndryshme. Veç e veç secili ka një identitet

të shumëfishtë: një person në një moment është serioz, pastaj momentin tjetër qesharak, një herë i moralshëm, pastaj i pamoralshëm, i urtë pastaj i marrë, e kështu me radhë.

Globalizimi heshtur e shpall krizën e identiteteve personale dhe kolektive. Globalizimi pashmangshëm çon edhe në globalizimin e identitetit, në kuptimin që ai inkurajon formimin e identiteteve të reja. Mirëpo njëkohësisht globalizimi e dekurajon edhe identifikimin me komunitetin përkatës, duke prodhuar destabilizim të identitetit ekzistues, gjersa e gjithë kjo shpie në huti e pasiguri.

Komunikimi i ri global dhe gjeografia elektronike e internetit bën që në kohën postmoderne në qendër të vëmendjes të vendoset problemi i identitetit virtual. Në hapësirën e përbashkët virtuale ndeshim në situata kur modelet identitare të botës reale përzihen me atë të botës së trilluar, të mashtrimit dhe formave nxitëse.

Në botën mediatike të simulakrumeve dhe simulimeve publiku mund të identifikohet me yllin, si në bazë të ngjashmërive ashtu edhe në bazë të dallimeve. “Shumë forma të identifikimit përfshijnë një proces të transformimit dhe prodhimit të identiteteve të reja, duke kombinuar identitetin ekzistues të shikuesit me identitetin e dëshiruar dhe leximin e tij për identitetin e yllit” (Stacey, J., 1991:160). Në këtë kombinim ka shumë variante, por forma mbizotëruese e identifikimit të të rinjve, është ajo që për të ndërtuar shpesh “veten” e vet yjet paraqesin mënyrën e imitimit si riformësim të vetes sipas modelit të yllit. Këto procese në botën postelektronike falë ndryshimeve të mëdha teknologjike dhe mundësive që ka ofruar ajo, në veçanti intelijenca artificiale, e kanë bërë imagjinatën si një fakt kolektiv të gjithëpranishme në shumë përmbajtje mediatike. Në këtë mënyrë në botën globale imagjinata u përhap nga arti e miti duke u shtrirë në jetën e përditshme dhe hyri në logjikën e jetës së zakonshme, prej së cilës dikur ishte përjashtuar.

Mediet thelbësisht kanë pushtuar fushën e kulturës së popullarizuar, kurse njerëzit i ndërtojnë identitetet e tyre nëpërmjet përdorimit të mesazheve mediatike dhe në ndërveprim me to. Si rregull, dëshirat nuk plotësohen asnjëherë mjaftueshëm, sepse kur konsumi bëhet mënyrë jetese, ai vazhdimisht krijon nevoja të reja. Kultura e epokës postmoderne në kapitalizmin e zhvilluar është prodhim i konsumimit global, ndërsa njerëzit në kërkim të identitetit detyrohen që gjithnjë ta rishqyrtojnë shijen dhe nevojat e tyre kulturore. Në epokën postmoderne, dallimi në mes multimedialitetit dhe sistemeve të komunikimeve të reja, artit dhe kulturës së popullorizuar bëhet gjithnjë e më i hollë. Të gjitha vlerat bëhen të kuantifikueshme. Kultura e popullarizuar bëhet e vetmja kulturë. Ajo i përfshin të gjitha fushat e ndryshme të jetës së përditshme: modën, konsumin, kohën e lirë dhe format e ndryshme të zbavitjes, duke përfshirë të gjithë spektrin e kulturës mediale nga televizioni, filmi e deri te zhanret e ndryshme të muzikës. E gjithë kjo bëhet e mundshme për shkak të krijimit të një klime të re sociale e kulturore dhe më së shumti për shkak të

zhdukjes së autonomisë estetike e cila vlente në epokën e modernitetit. Postmodernizmi është i pranishëm në kulturën dhe artin e popullarizuar me të gjitha karakteristikat e tij, të cilat janë: manipulimi i marrëdhënieve të së ardhmes me të tashmen e të shkuarën, përzierjes së zhanreve, intertekstualitetit - numrit të madh të citimeve. Proceset e identifikimit, qofshin si asimilim-imitim ose individualizim-personalizim, në epokën postmoderne marrin forma të reja. Pasi postmodernizmi është i lidhur ngushtë me kulturën e popullarizuar, të cilën e portretizojnë mediet dominuese, të cilat identifikojnë nëpërmjet imazhit, stilit dhe pamjes, tashmë më e rëndësishme është të dukesh mirë sesa të jesh i mirë. Ndikimi i yjeve mediatike është i padiskutueshëm dhe i madh, kurse mundësia e simulimit është aq e madhe, sa që secili vetes ia përshtat personalitetin që e ka idol (qoftë aktorë, yje, këngëtarë, modele) ose edhe personazhe mediatike (nga filmi ose televizioni).

Kështu globalizimi kulturor zgjerohet përmes mjeteve të reja teknologjike. Stili hedonist i jetesës dhe kulti i kohës së lirë zgjerohen duke rrënuar sistemin e vlerave tradicionale. Është subkultura e të rinjve me veshjet xhins e minifunde, me format e reja të zbavitjes, me muzikën rok, filmin, sportin etj., ajo që zgjerohet gjithnjë e më shumë.

8. Përmbyllje

Kuptimi i kulturës kapitaliste sipas formatit shqiptar gjithashtu është i gjerë, por në kontekst të hapësirës së kufizuar po e përmbyllim me përmbledhjen e shkurtër të opinionistit Aleksandër Çipa “Në realitetin e sotëm të shoqërisë shqiptare mbishquan kriza e pakulturimit. Është prezente në shumëçka, por më tepër shfaqet në debatin publik, në polemikat publike, në komunikimin dhe ligjërimin publik dhe në mënyrën më tronditëse e të turpshme, në jetën politike dhe sidomos atë parlamentare të vendit....Të gjithë të pakënaqurit e kulturuar, ata që janë jashtë atdheut, por që e ndjekin orë më orë realitetin e tij, si dhe të heshturit e mençur brenda tij, kanë një fajësi: Nuk ia kanë dalë dhe nuk po ia nisin të organizojnë dhe formojnë një bashkësi të kulturuarish...Se mungon kjo bashkësi, prandaj nuk po ia dalim të krijojmë kontrastin me këtë realitet të ndenjtur, ku sundon kaosi dhe injoranca krenare...Kriza jonë ka vetëm një emër: Është krizë e antisistemistëve që ia kanë dalë të vendosin regjimin e anarkisë dhe kaosit. Për ta, ligjet dhe ndryshimet ligjore janë thjesht një alibi. Dalja nga kriza jonë nis kur do t’ia dalim të organizojmë dhe strukturojmë bashkësitë tona të të kulturuarve dhe të të kualifikuarve. Në këto bashkësi nevojitet të rreshtohen matanë diferencave ose rekrutimeve partiake pikërisht të heshturit dhe refuzuesit e heshtur të kësaj shoqërie” (“Shqip”, 2015:9).

Abstrakt

Prof.asoc.dr. Drenusha Kamberi¹³⁴

Kapitalizmi është sistem dhe ideologji ekonomiko-politike që ka ndikim dhe shtrirje të gjerë edhe në kulturë. Thelbi ekonomik është prona, interesi dhe fitimi, kurse ai politik është mbështetja institucionale e korporatave dhe bizneseve në frymën (neo)liberale dhe lufta kundrejt oponentëve socialistë e komunistë. Karakteri kulturor i kapitalizmit është i lidhur me konsumin dhe mënyrën e shfrytëzimit të tij. Në kapitalizëm konsumi bëhet mënyrë jetese, shndërrohet në identitet dhe merr forma të ndryshme të paraqitjes. Pikërisht për këtë kultura kapitaliste kryesisht është kulturë e konsumit. Përtej kësaj, kapitalizmi krijon edhe “nevoja të rreme”. Këto nevoja ai i nxit dhe i promovon përmes reklamave propagandistike. Përmes këtij studimi të shkurtër do të analizojmë mënyrën kapitaliste të prodhimit të kulturës, duke e krahasuar aktualitetin me aspektin teorik të shtjellimit të tematikës nga autorë të ndryshëm. Ideja është që të jepet një pasqyrë gjithëpërfshirëse e kulturës dhe perceptimit të saj në kohën e tashme.

Fjalë kyç: Kapitalizmi, kultura, ideologjia, propaganda, identiteti

abstract

Capitalism is an economic-political system and ideology that has a significant influence and broad reach, even in the realm of culture. The economic essence is property, interest, and profit, while its political essence is the institutional support of corporations and businesses within a (neo)liberal framework, alongside opposition to socialist and communist adversaries. The cultural character of capitalism is closely tied to consumption and the ways it is utilized. In capitalism, consumption becomes a way of life, transforms into identity, and takes various forms of expression. Precisely for this reason, capitalist culture is predominantly a culture of consumption. Beyond this, capitalism also creates "false needs," which it stimulates and promotes through propagandistic advertisements. This short study will analyze the capitalist mode of cultural production, comparing current realities with the theoretical elaboration of the topic by various authors. The idea is to provide a comprehensive overview of culture and its perception in the present time.

Keywords: Capitalism, culture, ideology, propaganda, identity

¹³⁴ Ligjëruese në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, drenusha.kamberi@unt.edu.mk

Literatura/Referenca

- APADURAJ, A. *Kultura i globalizacija*, Biblioteka XX vek, Beograd, 2011
- BELL, Daniel, *The Cultural Contradictions of Capitalism*, Heinemann Educational, London, 1979
- BAUMAN, Z., *Fluidni život*,: Mediterran Publishing, B Novi Sad, 2009
- BELLO, W., *Deglobalization – Ideas for a new world economy*,: Zedbooks, BELO, London 2004
- “Curiosone”, Faqja e parë e shtojcës “Ndryshe”, gazeta “Shqip”, e diel, 22 mars 2015
- GIDENS, E, *Posledice modernosti*,: „Filip Višnjić“, Gidens, Beograd, 1998
- Gazeta “Shqip”, e premte, 24 korrik 2015, ; Aleksandër Çipa, “Kriza për bashkësinë e të kulturuarve”
- HARALAMBOS, M., *Uvod u sociologiju*, Globus. Haralambos, Zagreb, 1989
- HALL, S. The Question of Cultural Identity. In: *Modernity: An Introduction to Modern Societies* (Edited by S. Hall, D. Held, D. Hubert and K. Thompson, : Blackwell Publishers, Oxford, 1995
- KELLNER, D., *Theorizing globalization*, Sociological Theory, Vol., 20, No.3, 2002
- SKLEDAR, N., *Čovjek i kultura, Uvod u socio-kulturnu antropologiju*, Zavod za sociologiju Filozofskog fakulteta u Zagrebu i Matica hrvatska Zaporešić Skledar, 2001
- STACEY, J., *Feminine Fascinations: Forms of Identification in STAR/Audience Relations*. In: *Stardom: Industry of Desire* (Ed. C. Gledhill), pp. 141–163, Routledge London,; 1991
- TOMLINSON, John. *Cultural Imperialism*. Baltimore: The John Hopkins University Press. Tomlinson 1992
- URRY, John., *"The End of Organised Capitalism"*. U S. Hall i M. Jacques: *New Times: the Changing Face of Politics in the 1990s*.: Lawrence and WISHART, London, 1989

Albulena DEHARI

Universiteti Nënë Tereza –Shkup

Fakulteti i Shkencave Humane

Albulena.dehari@unt.edu.mk

DALLIMET GJATË PËRSHËNDETJEVE NË MES GJINIVE TË KUNDËRTA

DIFFERENCES IN GREETINGS BETWEEN OPPOSITE GENDERS

Hyrje

Larmia e përshëndetjes ka rrjedhur kryesisht nga marrëdhëniet ndërmjet njerëzve që përfaqësojnë statuset e institucioneve të ndryshme. Ata që përshëndesin, natyrisht, mëtojnë edhe të mbërrijnë qëllime të caktuara politike, fetare, shoqërore etj. (Ibrahimi 2018:386).

Zakonisht heterogjeniteti dhe diversiteti shoqëror janë shumë ngushtë të lidhur njëri me tjetrin, madje mund të themi se bashkekzistojnë në një vijë paralele me heterogjenitetin gjuhësor. Në asnjë rast nuk mund të themi se bashkësia etnokulturore dhe shoqërore janë homogjene nga aspekti gjuhësor, por as e kundërta e kësaj nuk është se rezultojnë. Studimet e deritanishme tregojnë se ekzistojnë pesë faktorë të diferencimit të sjelljes gjuhësore të individëve të një bashkësie shoqërore. Ato janë: klasa ekonomike - shoqërore, niveli i arsimit, mosha, gjinia dhe grupi etnik. Dy faktorët e parë kanë karakter shoqëror, kurse tre të tjerët kanë karakter natyror.

Mësimi i të folurit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e përgjithshëm. Ndarja e njerëzve në gjini nuk ka të bëjë me atë se si ndahen njerëzit në bazë të seksit në meshkuj dhe femra, si ndarje themelore, madje kjo ndarje shkon edhe sipas moshës, foshnjë dhe fëmijë, adoleshentë dhe të rinj, të rritur dhe të moshuar duke dalluar, sidoqoftë, tre breza gjuhësorë a më saktë sociolinguistik (Shkurtaj 2009:115), ku kemi një dallim në raport të femrave dhe meshkujve. Dimë që shoqëria ka bërë ndarjen gjinore të punës, burrat janë ata që merren më shumë me punë fizike, kurse gratë, si gjithmonë, merren më shumë me punët e shtëpisë, kjo rezultojnë edhe në një ndarje të përdorimit të gjuhës në fushën e leksikut e të frazeologjisë gramatikore (Bhasin 2006:10).

Femrat edhe meshkujt edhe kur flasin gjuhën e njëjtë, pra kanë pikëpamje të njëjtë dialektore (janë të së njëjtës familje) dallimet e tyre vërehen edhe sipas seksit të tyre. Kjo ndarje tradicionale e punës në vetvete ka qenë edhe një ndarje shoqërore në të folur, në mënyrat e shprehjes, e zotërimit të një sfere terminologjike ndaj një tjetre edhe sipas seksit. (Shkurtaj 2005:232).

Dallimi i njerëzve sipas gjinisë, pra mashkullore e femërore është një nga variabellet e rëndësishme të studimit sociolinguistik. Nga studimet që janë bërë deri në ditët e sotme, del se kemi mjaft dallime mes gjinive dhe se femrat flasin ndryshe nga meshkujt. Ky dallim i femrave dallohet edhe në rrethin e ngushtë familjar, pra femrat flasin ndryshe nga bashkëshorti i tyre madje edhe nga bijtë e tyre.

Kjo temë, po hap një interesim më të gjerë, pasi duke u munduar që të zbulojmë konceptet që lidhen me gjuhën dhe gjininë, ne këtu po thellohem edhe më shumë duke u lidhur edhe me faktorët jashtëgjuhësorë (kulturorë, socialë etj.) ku janë të pranishme në të njëjtin mjet të komunikimit në ligjërim njerëzor. Spektri i kësaj teme është shumë i gjerë. Duhet bërë shumë analiza analitike për të arritur në qëndrime të sakta, gjithmonë duke u bazuar në leksikologji dhe në frazeologji.

Dallime gjuhësore midis gjinive janë të pranishme edhe në të folmen e Grupit të Gegërishtes Qendrore në Maqedoninë e Veriut, ku në disa fusha të kulturës së jetesës përdoren forma vetëm nga njëra gjini, ndërsa gjinia e kundërt, edhe pse i njeh, prapë nuk i përdor. Ky fenomen paraqitet në raste të ndryshme, por më karakteristik është gjatë: përshëndetjeve dhe urimeve, përdorimit të mallkimeve popullore, gjatë përdorimit të betimeve (kur duan sa më shpejt ta bindin dikë), dallime ekzistojnë edhe gjatë ofendimeve të ndryshme si dhe gjatë përdorimit të leksemave të ndryshme. (Ibrahimi-Xhaferi 2006:46).

Si përshëndetin meshkujt e si femrat në qytetin e Tetovës

Në çdo vend të botës, ku jetojnë dhe veprojnë njerëzit, pavarësisht nga kushtet, nga mjedisi apo nga rrethina në të cilën jetojnë, e qysh nga kohët shumë më të hershme e deri në ditët e sotme, njeriu është dashur të ndër marrë e të vendosë lidhje me njerëzit e tjerë me të cilët jeton, apo me të cilët ndeshet çdo ditë në rrugë, kafene, punë etj. Kjo përbën një dukuri universale. Që nga mëngjesi kur ngihet e deri në mbrëmje, kur shtrihet për të fjetur, njeriu është i përfshirë në një sërë veprimesh me shoqërinë e rrethin ku jeton, ku shpeshherë mund të shihen edhe si stereotipe, e shumë herë janë shprehje të cilat janë krijuar në mënyrë të vetvetishme brenda njeriut, por që të gjitha këto veprime, e gjithë kjo lidhje mes shoqërisë nis me përshëndetjet dhe me to mbaron.

Në përditshmëri, gjatë komunikimit me bashkëfolësit, çdokush për ta tejkaluar konfliktin apo momentin jo të dëshiruar e fillon ditën me një përshëndetje, e madje kjo është një formë komunikimi e cila e bën edhe më

të harmonishme bisedën, pra njeriu përdor formulat e mirësjelljes për të krijuar një bisedë të mirë, apo edhe për të pasur një ditë të mbarë. Pra të marrim një shembull të thjeshtë: *nëse ndonjë do të shkonte në mëngjes në punë dhe në momentin që do të hynte në zyrë apo në objektin e punës nuk do të bënte një përshëndetje për kolegun/ kolegët e punës atëherë nga ana tjetër do të nënkuptonin sikur diçka nuk është në rregull, apo sikur është i mërzhitur me ndonjërin aty.* Nga kjo mund të themi se përshëndetjet janë baza kryesore për një bisedë të mirëfilltë dhe për të krijuar një raport shoqëror.

Përshëndetjet, janë pikënisja e çdo komunikimi dhe me këtë lirisht mund të themi se janë të lashta sa vetë ekzistenca e njeriut, përmes tyre ne kyçemi në një komunikim, bëhemi pjesë e një bisede, përmes tyre ne kuptojmë edhe qasjen e tjetrit ndaj nesh, pasi jemi të vetedijshëm se si përshëndetemi në rrethet shoqërore e si me njerëz më të largët, kjo është një nga treguesit bazë se çfarë qasje mund të mbajmë në komunikimin që do të bëjmë, për këtë arsye përshëndetjet kanë një rëndësi të madhe për gjuhësinë.

Më lartë, kemi shënuar në formë të përgjithësuar përshëndetje dhe urimet që bëhen në qytetin e Tetovës, po tani do të ndalemi më hollësisht të shohim se si përshëndeten gjinia mashkullore e si gjinia femërore, apo çfarë forme urimi shprehin meshkujt e çfarë gratë. Në këtë pjesë do të bazohemi tek vëzhgimi që kemi bërë në diferencat e sjelljes gjuhësore të të rinjve në qytetin e Tetovës.

Pika e parë që vërejtëm te ky vëzhgim ishte nëse ka një ndryshim të theksuar në ligjërimin e vajzave me atë të djemve. Ndryshimet më të mëdha do të shfaqen në fjalët e mirësjelljes nga të dyja gjinitë, pasi këto fjalë janë një tregues shumë i mirë që tregojnë lidhjen e një individi me rrethin shoqëror apo me botën e jashtme. (Drass 1986:234). Megjithatë, vërejtëm edhe një mori shprehjesh të tjera që lidhen me anën emocionale, me lidhjen familjare e miqësore mes individëve, pra se si ato shprehen në këto raste.

Si pikë e dytë e rëndësishme në këtë punim është edhe koncepti kulturor e social në krijimin e ndryshimeve gjinore në të shprehur. Mund lirisht të shprehem në këtë pikë, se kërkimet e shumta rreth literaturës për këtë tematikë në gjuhën shqipe janë shumë të pakta, shqiptarët shumë pak janë munduar të studiojnë mënyrën e shprehjes së burrave dhe grave, por ne do të mundohemi të japim një analizë të mirëfilltë rreth kësaj çështjeje.

Përshëndetjet në raport burrë / grua

Gjuha gjinore, paraqet një element shumë të rëndësishëm, pasi ne arrijmë të kuptojmë se burrat dhe gratë kanë nënsisteme të veçanta, ku këto dy sisteme shkojnë paralel njëri me tjetrin. Pse themi dy nënsisteme, si burrat kanë një gjuhë me të cilën merren vesh mes veti, gjithashtu edhe gratë kanë, po të njëjtën gjuhë me të cilën kuptohen. Kjo më mirë mund të sqarohet, se kemi një gjuhë të përbashkët, pra një gjuhë standarde dhe një zhargon të veçantë “mashkull” e “femër”.

Gratë dhe burrat në raport mes tyre janë më të kufizuar në shprehje, apo mund të themi se përdorin një gjuhë që është përgjithësuese.


Siç shprehen edhe profesorët Mustafa Ibrahimimi e Hamit Xhaferi, se “Për të gjitha vaftet shqipja ka edhe përshëndetjet përkatëse, gjithnjë të çiftëzuara sipas drejtimit: dhënës-pritës. Siç do të shohim nga shembujt e mëposhtëm, përshëndetja mund të shprehet:

(a) me një togfjalësh të qëndrueshëm të përbërë nga: emër i çastit të caktuar të ditës apo të natës (në trajtën e shquar) + mbiemrin (i, e) mirë: natja e mir/nadja e mir, pramja e mir/pramja e mirë;

(b) me një fjalë të përngjitur, ku pjesa e parë është ndajfolja mirë: mirëmëngjes /mirmjes, mirëdita /mirdita, mirëmbërëma /mirmrama.” (Ibrahimimi-Xhaferi 2006:66).

Nga anketa që e kemi bërë, vërejmë se tetovarët e kanë shprehi të përshëndeturën. Në Pyetjen që kemi bërë; *Në momentin që takoni një shok a e përshëndetni, apo kur i shënoni në rrjetet sociale?* Nga 500 të anketuarit, 436 janë shprehur se po përshëndeten, vetëm një përqindje e vogël janë shprehur se hyjnë menjëherë në temë. Vërejmë se përshëndetjet janë pjesë e fjalorit të të rinjve tetovarë.

Nga përshëndetjet të cilat i kemi marrë nga anketa se si një mashkull përshëndet një femër; *Si përshëndeteni kur i drejtoheni një vajze?* më të shumtat janë: *Hey, prsh., xhi bon, alo.* Nga 220 të anketuarit 133 janë përgjigjur se përdorin këto forma përshëndetjeje kur takohen apo flasin me një vajzë, kurse 87 janë përgjigjur se varësisht nga miqësia që kanë ashtu dhe përshëndeten. Grafiki i kësaj skemë do të dukej kështu:



Fi5. 2. Si përshëndetin djemtë.

Nga përgjigjet e marra shohim, se përshëndetjet që bëhen janë në të folurën e Tetovës kryesisht në të folmen e vendit dhe gjithashtu në komunikimin social të rinjtë përdorin shumë format e shkurtuara të fjalëve.

Ndërsa nga 280 femra të anketuara se si ata përshëndeten me një mashkull 176 janë përgjigjur: *Tung, mirëdita, përshëndetje, ç'kemi*. Kurse pjesa tjetër 104 vajza janë përgjigjur se nëse kanë një raport shoqëror më të afërt përshëndeten: *hey shoçi, si të kam, xhi bon etj.*

Grafikisht kjo skemë do të dukej kështu:




Fig.3. Si përshëndetin vajzat.

Këtu shohim se vajzat në raport me djemtë janë më të kujdesshme, kur bëhet fjalë për një raport jo shumë të afërt dhe përdorin përshëndetje të cilat janë të pranishme edhe në standardin e gjuhës shqipe, kurse në raportin miqësor ato shprehen në dialekt.

Urimet në raport burrë / grua

Më lart kemi treguar se urimet janë një nga shprehjet më me vlerë për gjuhën shqipe, dhe për gjuhët në përgjithësi. Në Tetovë, urimet për festat personale apo që janë individuale janë shumë më të theksuara se sa ato për festat e përgjithshme. Ne kemi bërë anketën edhe për urimet se si urojnë tetovarët dhe nga kjo kemi parë se kur kemi një raport femër / femër urimi është më me shumë fjalë e shprehje, pra nuk e ka atë formën e zakonshme të shprehur vetëm me mënyrën dëshirore, por aty ai është më i zgjeruar dhe shprehet me më shumë togfjalësha të dashur. Kurse e kundërta ndodh me meshkujt ata në raport burrë / burrë thuhet janë më praktikë vetëm urojnë dhe nuk zgjaten më shumë.

Për ta shqyrtuar më mirë këtë temë, gjithmonë do të mbështetemi tek anketa që e kemi realizuar. Aty kemi bërë pyetjen, *Një vajzë si e uroni për ditëlindje?* Nga 220 meshkuj 113 janë përgjigjur se e urojnë: *Urime ditëlindjen! Hbd, urime, kurse 72 janë përgjigjur, Urime mmv! Edhe 100!*

Kurse 35 meshkuj janë përgjigjur se nuk i urojnë apo harrojnë të bëjnë një urim për ditëlindje. Kjo formë do të dukej kështu:




Fig.4. Si i urojnë djemtë vajzat.

Kurse, femrat duke qenë në përgjithësi më të kujdesshme janë përgjigjur se të gjitha i urojnë shokët e tyre me rastin e ditëlindjes. Nga gjithsej 280 vajza, 187 janë përgjigjur se urojnë me, *Urime! Shëndet e t'mira!* Kurse 41 e tyre, gjithmonë duke mbështetur atë raportin shoqëror janë përgjigjur se i urojnë shokët e tyre me shprehjet, *U bëfsh sa malet! Edhe 100 bossi!*




Fig.4. Si i urojnë vajzat djemtë.

Nga gjithë kjo vërejmë se të rinjtë në urimet për ditëlindje mundohen që të ruajnë standardin e gjuhës shqipe, pra të mos shprehen në dialekt,

gjithashtu kemi një tendencë shumë të madhe të shkurtimeve të fjalëve si dhe të shprehjeve në gjuhën angleze.

Abstrakt

Përsëndetjet, janë pikënisja e çdo komunikimi dhe me këtë lirisht mund të themi se janë të lashta sa vetë ekzistenca e njeriut, përmes tyre ne kyçemi në një komunikim, bëhemi pjesë e një bisede, përmes tyre ne kuptojmë edhe qasjen e tjetrit ndaj nesh, pasi jemi të vetedijshëm se si përsëndetemi në rrethet shoqërore e si me njerëz më të largët, kjo është një nga treguesit bazë se çfarë qasje mund të mbajmë në komunikimin që do të bëjmë, për këtë arsye përsëndetjet kanë një rëndësi të madhe për gjuhësinë. Në përditshmëri, gjatë komunikimit me bashkëfolësit, çdokush për ta tejkaluar konfliktin apo momentin jo të dëshiruar e fillon ditën me një përsëndetje, e madje kjo është një formë komunikimi e cila e bën edhe më të harmonishme bisedën, pra njeriu përdor formulat e mirësjelljes për të krijuar një bisedë të mirë, apo edhe për të pasur një ditë të mbarë. Duke u nisur nga aspekti gjuhësor ne do të vërejmë se gjuha shqipe në mbarë vendet ku ajo është e shtrirë në Ballkan, por edhe në pjesën e diasporës, atje ku jetojnë shqiptarët ka një leksik mjaft të pasur me shprehje të ndryshme, por sidomos me përsëndetje dhe urime. Lirisht mund të themi, se shqiptarët kanë qenë dhe vazhdojnë të kenë qëndrimin e njëjtë ndaj përsëndetjeve dhe urimeve. Andaj në punimin tonë ne do të paraqesim se si krijohen këto përsëndetje e urime mes meshkujve dhe femrave, a ka ndryshime dhe cila gjini posedon fjalor më të pasur.

Vlen të përmendet se në përsëndetjet shqiptare ndikim kanë pasur edhe fetë, si ajo katolike, myslimane e ortodokse. (Ibrahimi 2018:386-388).

Abstract

Greetings, are the starting point of any communication and with this we can freely say that they are as old as human existence itself, through them we communicate, we become part of a conversation, through them we also understand the others' approach to us, as we are aware of how we greet in closer social circles and with more distant people, this is one of the basic indicators of what approach we can take while communicating, therefore greetings have great importance for linguistics. In everyday life, during communication with interlocutors, in order to overcome the conflict or the unwanted moment, everyone starts the day with a greeting, so this is a form of communication that makes the conversation even more harmonious, and people use politeness phrases to create a good conversation, or even to have a good day. Starting from the linguistic aspect, we will note that the Albanian language throughout the countries, wherever it is spoken in the Balkans and the diaspora as well, has had a rich vocabulary with various expressions, especially with greetings and congratulations. We can freely say that Albanians have had and continue to have the same attitude towards greetings and congratulations. Therefore, in our paper we will

present how these greetings and congratulations are created between males and females, if there are any differences and which gender has a richer vocabulary.

Literatura

- BHASIN, K., (2006). Të kuptosh përkatësinë gjinore, Tiranë.
- DRASS, K. A., (1986). The Effect of Gender Identity on Conversation Author, United States, 1986, f.296.
- IBRAHIMI, M. - XHAFERI, H. (2006). *Dallimet gjuhësore midis gjinive dhe figura e gruas në poezinë popullore*. UEJL, Tetovë.
- IBRAHIMI, Mustafa (2021). Sociolinguistika. UNT, Shkup
- NDRECA, Mikel. (2007). Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe, Toena, Tiranë.
- SHKURTAJ, Gj. (2005). Sociolinguistika, Tiranë.
- SHKURTAJ, Gjovalin.(2009). Sociolinguistikë e shqipes. Nga dialektologjia te etnografia e të folurit, Shtëpia botuese Morava, Tiranë.
- TABLOT, M. (2010). Language and Gender - An introduction, USA.
- THOMAI, J. (1981). Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë.
- THOMAI, J. (1992). Teksti dhe gjuha, SHBLU, Tiranë.

Revista INTERKULTURA	Përmbajtja
	<p>Zeqirja NEZIRI - Aspekte ndërkulturore të kancelarisë së Skënderbeut (7-14) Mustafa IBRAHIMI - Koncepte, dallime dhe konflikte të multikulturalizmit përballë globalizmit (15-28) Rizvan SULEJMANI- Zgjidhja e konflikteve ndëretnike – rasti i Maqedonisë (29-44) Avzi MUSTAFA - Kufiri ndërmjet kulturave të ndryshme, vështruar përmes romanit “Ballkanbabilonasit” të Luan Starovës (45-52) Gjylymsere KASAPI - dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni (53-60) Sefer TAHIRI - Skicë për mbindërtimin e Maqedonisë shumëkulturore dhe ndërkulturore (61-80) Rubin ZEMON - Sfidat bashkëkohore në drejtimin e shoqërive të diversitetit (81-92) Mirjana MALESKA - Multikulturalizmi - koncepti pluralist dhe tolerues për integrim (93-100) Kosta MILLKOV - I kujt është vendi? Kufizime kulturore dhe territoriale në kontekst të konflikteve ballkanike dhe kriza e refugjatëve në lindjen e mesme (101-113)</p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Respekti i ndërsjell – bazament i një kohezioni social në shoqëri – fjalë përshëndetëse Zeqirja NEZIRI - Pjetër Bogdani afirmues i teozofisë baroke (9-26) Vebi BEXHETI - Përmasa universale në poezinë e Migjenit (27-32) Mustafa IBRAHIMI - Elemente etnografike dhe arti shqiptar në muret e kishave të Prilepit dhe Ballkanit nga piktori mesjetar Onufri (33-46) Sunaj RAIMI - Jan Kukuzeli – kompozitori shqiptar mesjetar me dimensione botërore (47-60) Avzi MUSTAFA - Grigor Përliçevi dhe kontributi i tij interkulturore (61-72) Asllan HAMITI - Rëndësia e «Fjalorit tri gjuhësh» të Gjorgji Puleskit (73-88) Nebi DERVISHI - Kontributi i Josif Bagerit për gjuhën dhe kulturën shqipe në Rekën e Epërme (89-98) Mixhait POLLOZHANI - Tradita jonë interkulturore në artet pamore (99-112) Rizvan SULEJMANI - Sa kanë ndikuar dallimet fetare dhe kulturore në formimin e kombit “modular” shqiptar? (113-130)</p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Sistemi arsimor faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore – fjalë përshëndetëse Don Lush GJERGJI, Nëna Tereze - simboli i paqes dhe dashurisë, mishërimi dhe paradigma e interkulturalizmit universal (Rizvan SULEJMANI, Arsimi interkulturore dhe kultura në kohë Pandemie Mustafa IBRAHIMI, Reformmat gjuhësore në arsimin e shoqërive shumëkulturore - rasti Maqedonia e Veriut Rubin ZEMON, Historia, antropologjia dhe kompetencat ndërkulturore Ajten HAJDARI-QAMILI, Iterkulturalizmi në institucionet publike në RMV Berton SULEJMANI, Interkulturalizmi gjuhësor nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase Ismet OSMANI, Interkulturalizmi në procesin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut Sunaj RAIMI, Disa komponentë interkulturore në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm Mixhait POLLOZHANI, Arti si veprimtari e kultivimit të interkulturalizmit</p>

 <p>ISSN 2017-2004</p> <p>INTERKULTURA <small>Вестник на Факултетот за Шкencески Науки Журнал на Факултетот за Шкencески Науки Journal of the Faculty of Human Sciences</small></p> <p>4</p> <p>ICONLIC 2023</p> <p><small>INTERKULTURA No. 4 Pg. 1-191 Shkup 2024</small></p>	<p>Zeqirja Neziri: Fati i të folmes së arbneshëve të Zarës Mustafa Ibrahim: Ekolinguistika përballë interkulturalitetit në një shoqëri shumëgjuhëshe Vebi Bexheti: Toka me shije, ulliri pak të hidhur pak të ëmbël Azis K. Pollozhani: Interkulturalizmi një paradigmë e re e shoqërive multietnike Begzad Baliu: Pikëpamjet e linguistike të profesor Shefki Sejdiut Ismet Osmani: Përkthimi si akt ndërkulturor Izaim Murtezani: Ligjërime imagologjike apo konstruktiv diskurziv i tjetrit dhe tjetërsisë Teuta Arifi: Interkultura, një koncept progresiv i rilindjes kombëtare shqiptare Rubin Zemon: Ndërkulturalizëm pa kulturë dhe kontakte në Ballkanin Perëndimor Qatip Arifi: Anglishtja si lingua franca (alf) dhe aplikimi i saj në procesin e mësimdhënies së kësaj gjuhe Ajten Hajdari-Qamili: Leksiku ndërkulturor dhe ndërgjuhësor në të folmen urbane të strugës Sejdi M. Gashi: Roli i medieve në (mos) ngritjen e prestigjit të shqipes Agron Vrangalla: Analizë kritike e diskursit: gjuha e Albin Kurtit në intervistën e dhënë për cnn (31 maj) Kosovare Krasniqi: Imagologjia dhe përkthimi Arta Tika Bekteshi: Choosing the correct n-word or npi - a case study with albanian students Viktoria Elenova: Процесите кон восприемање и предавање странски јазик Јордана Шемко-Георгиевска - Елена Пренцова: Превод на билингвалните и дводомните културолошки елементи во примери од чикана поезијата Jetlira Beqiri: Interkulturaliteti në emërtimet e lidhjeve farefisnore në dialektet e gjuhës shqipe</p>
--	---



